

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i gjashtë)

TIRANË, 2016

Titulli: **KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT**

(Xhuzi i gjashtë)

Autori: **Eruditi, juristi dhe komentuesi**

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: **Vullnet MERJA**

E përktheu nga arabishtja: **Agim REÇAJ & Vullnet MERJA**

Radhitja kompjuterike: **Kumrije QAZIMI**

E redaktoi: **Dorina BASHA**

Korrektura teknike: **Vjollca KARAJ**

Përkujdesja grafike: **Sabrie FEZA**

Kapaku: **Sabrie FEZA**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

Copyright: **Shoqata "FLLADI"**

Shtypshkronja e shtëpisë botuese **LILLO**

Ajetet 148 - 149

لَا يُحِبُّ اللَّهُ الْجَهْرَ بِالسُّوءِ مِنَ الْقَوْلِ إِلَّا مَنْ ظَلَمَ ۚ وَكَانَ اللَّهُ
سَمِيعًا عَلِيمًا ﴿١٤٨﴾ إِنْ تُبْدُوا خَيْرًا أَوْ تُخَفُّوهُ أَوْ تَعْفُوا عَنْ سُوءٍ
فَإِنَّ اللَّهَ كَانَ عَفُورًا قَدِيرًا ﴿١٤٩﴾

"All'Ilahu nuk do që të thuhën hapur fjalë të këqija, përveçse nga të privuarit. All'Ilahu dëgjon dhe di gjithçka."

"Në qoftë se ju bëni ndonjë vepër të mirë haptazi ose fshehurazi ose falni ndonjë vepër të keqe, All'Ilahu është Falës i madh dhe i Plotfuqishëm."

Komentimi

Në këtë ajet ka dy qartësime për obligimet morale islame. I pari qartëson se All'Ilahu nuk i dëshiron fjalët e këqija dhe nuk është me atë që e fillon fjalën me të metat e njerëzve dhe me demaskimin e veprave të tyre, për këtë All'Ilahu i Lartësuar thotë: "All'Ilahu nuk do që të thuhën hapur fjalë të këqija."

Me të vërtetë, moskënaqësia për përhapjen e veprave të këqija të njerëzve, buron nga realiteti dhe e vërteta se All'llahu është Ai i cili mbulon të metat. Dhe, nuk është detyrë e robëve të Vet që të zbulojnë të metat e të tjerëve dhe të hedhin baltë mbi dinjitetin e tyre.

Çdo njeri ka pikën e vet të dobët e të fshehtë dhe nëse zbulohen këto të meta, shoqërinë do ta pushtojë mendimi për keq ndërmjet individëve të saj. Atëherë bashkëpunimi ndërmjet këtyre individëve bëhet i vështirë.

Për këtë arsye, Islami e ka ndaluar që të flitet për mangësitë dhe për të metat e të tjerëve, në mënyrë që marrëdhëniet shoqërore të jetë gjithmonë të forta dhe e mira e humanizmi të sundojë në të.

Është i vlefshëm të përmendet se fjala "*suun*" që ka ardhur në këtë ajet, përmbledh të gjitha llojet e fjalëve të këqija e të skandaleve dhe qëllimi me shprehjen "*thuhen hapur fjalët*" është çdo rast kush zbulon fjalë haptazi, sido që të jenë këto fjalë në formë rrëfimi, tregimi, mallkimi, fyerjeje apo thashethemesh.

Ky ajet është argument për ndalimin e thashethemeve, por kuptimi i tij nuk është i kufizuar në cilësinë e fundit, por i përfshin të gjitha fjalët e këqija. Mirëpo ajeti nuk e ka ndaluar plotësisht "**fjalën e këqe**". Ai ka veçuar një rast ku mundet për të zbuluar dhe ai rast është nëse i ndodh njeriut padrejtësi. All'llahu i Lartësuar thotë: "**përveçse të privuarit**".

Me këtë argument i privuari mund ta mbrojë veten që të zbulojë skandalet e zullumqarit, sido që të jetë në formë ankese, për të skandalizuar zullumqarin apo duke drejtuar padi për të dhe nuk hesht derisa të kthehen të drejtat e tij. Dhe e vërteta e këtij veçimi është se All'llahu me këtë gjë dëshiron t'u rrëmbejë zullumqarëve mundësinë e keqpërdorimit të kësaj rregulle të

ndaluar dhe që kjo rregull të mos jetë shkak që i privuari të heshtë për të kërkuar të drejtën e tij derisa të rikthejë të drejtën e vet nga i padrejtji.

Nga ajeti qartësohet se procesi i zbulimit të të këqijave duhet të kufizohet në rrethin e sqarimit të padrejtësisë së të padrejtës tek mbrojtja nga të privuarit apo tek vetëmbrojtja e të padrejtës.

Ky ajet, për t'i prerë rrugën çdo mashtruesi që kërkon keqpërdorimin e këtij rregulli, me ankesën se i është bërë padrejtësi, vërteton se All'illahu i mbikëqyr veprat e njerëzve dhe se Ai di dhe dëgjon çdo vepër që kryhet prej tyre. All'illahu i Lartësuar thotë: **"All'illahu dëgjon e di gjithçka"**.

Në ajetin pasardhës Kur'ani tregon një pikë që i drejtohet kësaj rregulle, ku lejon të flitet për të mirat e personave ose fshehjen e tyre, (e kundërta e të këqijave të cilat duhet të fshihen me përjashtim të rasteve të veçanta).

Po ashtu, lejon, ose më mirë e nxit personin që ta falë atë që i ka bërë keq, sepse falja kur është e mundur është prej cilësive të All'illahut, i Cili i fal robtë e Vet, megjithëse posedon fuqi për t'u hakmarrë me çfarë mënyre që Ai do. Për këtë ajet thotë: **"Në qoftë se ju bëni ndonjë vepër të mirë, haptazi ose fshehurazi, ose falni ndonjë vepër të keqe, All'illahu është Falës i madh dhe i Plotfuqishëm."**

Hulumtime

Falja ndaj agresorit dhe ndikimi në prirjen armiqësore

Këtu shtrohet pyetja: “A nuk konsiderohet falja ndaj zullumqarit agresor përkrahje për padrejtësinë e tij dhe nxitje për t’iu larguar armiqësisë? A nuk çon falja në dukjen e një gjendjeje negative prej indifirentizmi tek të privuarit?

Përgjigjja: Në të vërtetë, falja nuk ka lidhje me çështjen e realizmit të drejtësisë dhe luftimit të padrejtësisë dhe argument për këtë është ajo çfarë lexojmë në librat e jurisprudencës islame nga ndalimi i kryerjes së padrejtësive dhe urdhërimi për të mos iu përulur atij, sikurse ka ardhur në ajetin 279, në suren “El Bekare”, ku All’llahu i Lartësuar thotë: **“Në këtë mënyrë, nuk dëmtoni askënd e as nuk dëmtoheni vetë.”**

Dhe thënia e prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebi Talib (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!), që thotë: “Kemi qenë për të padrejtët armiq dhe për dëmtuesit ndihmëtar”.¹

All’llahu i Lartësuar, në ajetin 9 të sures “El Huxhurat” thotë: **“atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e All’llahut”**.

Nga ana tjetër lexojmë urdhrin e faljes sikurse ka ardhur në ajetin 237 të sures “El Bekare”, në të cilin All’llahu i Lartësuar thotë: **“Por që të falni është më pranë devotshmërisë.”**. Dhe ne lexojmë ajetin 22 të sures “En Nur”, ku All’llahu i Lartësuar thotë: **“le t’i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni ju që t’ju falë All’llahu?”**

¹ “Biharul Enuar”, vëll. 42, f. 256, “Nehxhul Belaga”, këshilla 47.

Disa mendjelehtëve mund t'u shkojë në mendje se ka kundërshtim në mes të këtyre dy rregullave. Duke vënë re ato që ndodhen në burimet islame për këtë çështje, qartësohet se falja duhet që të jetë në një vend ku të mos keqpërdoret ky rregull. Kurse thirrja për luftimin e padrejtësisë dhe kundërshtimin e të padrejtit është një temë tjetër.

Është e vlefshme të qartësohet se falja kryhet kur zotëron mundësinë (për t'u hakmarrë) dhe kur triumfon ndaj armikut dhe e mposht përfundimisht atë. Pra, në gjendjen kur nuk supozohet realizimi i asnjë rreziku të ri nga ana e armikut dhe falja ndaj tij të jetë shkak i ndreqjes, udhëzimit dhe i nxitjes që ai të rishikojë sjelljet e tij.

Historia islame është e mbushur me shembuj të tillë. Dhe hadithi i njohur është thënia: “Nëse ke mundësi (që të hakmerresh) ndaj armikut tënd, atëherë bëje faljen ndaj tij falë nderim për mundësinë që ke ndaj tij (për t'u hakmarrë)”. Kjo fjalë është argumenti më i mirë.

Ndërsa në rastin kur ekziston rreziku nga ana e armikut, apo është e mundur që falja ta bëjë atë më agresor, apo ai e konsideron faljen si dorëzim ndaj padrejtësisë dhe nënshtrim ndaj saj, Islami nuk e lejon kurrë këtë falje, sikurse prijësit islamë nuk e kanë lejuar këtë mënyrë faljeje si në shembullin e këtyre rasteve.

Ajetet 150 - 152

إِنَّ الَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ وَيُرِيدُونَ أَنْ يُفَرِّقُوا بَيْنَ اللَّهِ
 وَرُسُلِهِ وَيَقُولُونَ نُؤْمِنُ بِبَعْضٍ وَنَكْفُرُ بِبَعْضٍ وَيُرِيدُونَ أَنْ
 يَتَّخِذُوا بَيْنَ ذَلِكَ سَبِيلًا ۖ أُولَٰئِكَ ۖ هُمُ الْكَافِرُونَ حَقًّا ۖ وَأَعْتَدْنَا
 لِلْكَافِرِينَ عَذَابًا مُّهِينًا ۖ وَالَّذِينَ ءَامَنُوا بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ وَلَمْ يُفَرِّقُوا
 بَيْنَ أَحَدٍ مِّنْهُمْ أُولَٰئِكَ سَوْفَ يُؤْتِيهِمْ أَجُورَهُمْ ۗ وَكَانَ اللَّهُ غَفُورًا
 رَّحِيمًا

“Vërtet, ata që mohojnë All’llahun dhe të dërguarit e Tij dhe
 dëshirojnë të ndajnë All’llahun nga të dërguarit e Tij, duke
 thënë: ‘Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë’ dhe duke dashur
 që kështu të zgjedhim një rrugë të ndërmjetme,

"pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim
 poshtërues për mohuesit."

"Ndërsa atyre që besojnë në All’llahun dhe të dërguarin e Tij
 dhe nuk bëjnë dallim mes asnjërit prej tyre, Ai do t’u japë
 shpërblimin (e premtuar). Se All’llahu është Falës e
 Mëshirëplotë."

Komentimi

Nuk ka dallim mes Profetëve

Ajetet e mëparshme treguan qëndrimin e një grupi prej mohuesve dhe për qëndrime të tjera të një grupi nga besimtarët. Po ashtu, ato ajete treguan përfundimin e gjithësecilit grup. Në këtë mënyrë ato janë plotësuese të ajeteve të mëparshme që kanë folur për çështjen e hipokritëve.

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë thotë: **“Vërtet, ata që mohojnë All’llahun dhe të Dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë All’llahun nga të dërguarit të Tij, duke thënë: ‘Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë’ dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme.”**.

Ajeti flet për një grup i cili bënte dallim mes Profetëve, disa i konsideronin në rrugë të drejtë dhe disa jo në rrugë të drejtë. Ajeti dëshmon dhe përforcon se ky grup njerëzish është me të vërtetë mohues jobesimtar.

Në të vërtetë, ky ajet tregon qëndrimin e jehudinëve dhe të krishterëve. Jehudinjtë e kanë refuzuar besimin dhe Profetin e të krishterëve Isain (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) dhe jehudinjtë e të krishterët së bashku, kanë mohuar që t’i binden Profetit Islam, Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ndërkohë që Librat e tyre qiellorë kanë treguar dhe kanë argumentuar profetësinë e këtyre Profetëve.

Ky dallim ndërmjet të vërtetave të pakundërshtueshme, pranimit të disa prej tyre dhe refuzimit të disa të tjerave ndodh sepse ata kanë ndjekur egon dhe dëshirat e tyre, kanë ecur pas fanatizmit dhe mendimit të tyre jolargpamës.

Ky është argument i mosbesimit të tyre në Profet e në All’llahun e Lartësuar, sepse besimi nuk është pranimi i asaj që

anon nga dëshira apo refuzimi i asaj çfarë refuzon egoja e njeriut. Ky rast nuk është vetëm një lloj adhurimi i vetvetes dhe nuk ka lidhje me besimin.

Besimi i vërtetë është ai që e nxit njeriun për të pranuar të vërtetën, sido që të jetë, që i përshtatet dëshirave dhe prirjeve të tij apo e kundërshton atë. Për këtë, Kur'ani Famëlartë në të vërtetë i ka konsideruar mohues të vërtetë ata që pretendojnë se besojnë në All'llahun dhe mohojnë disa Profetë. Bazuar në këtë, ai besim që shfaqin ata është i pavërtetë dhe i pavlerë, sepse nuk buron nga shpirti i vërtetë.

Këta njerëz dhe të ngjashëm me ta, Kur'ani Famëlartë i lajmëron, se ata do t'i gadasë poshtërimi dhe nënçmimi. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim poshtërues për mohuesit."**

Ka mundësi që përshkrimi i ndëshkimit në këtë ajet me fjalën "el muhijn", poshtërues, është përshkak se ata i pranojnë disa Profetë dhe refuzojnë disa të tjerë prej tyre. Në të vërtetë ata përballen me poshtërimin nga padrejtësia ndaj disa Profetëve. Për këtë ata duhet të marrin ndëshkimin poshtërues që i përshtatet poshtërimit të tyre.

Përshtatshmëria mes mëkatit dhe ndëshkimit

Është e rëndësishme që të shpjegojmë këtu se ndëshkimi mund të jetë i dhimbshëm, ndonjëherë si goditje dhe ndëshkim fizik, mund të jetë përçmues, si gjuajtje e njeriut me mbeturina ose të jetë ndëshkim i rëndë, si ndëshkimi përpara njerëzve dhe ndikimi i saj i thellë të vazhdojë për një kohë të gjatë në shpirtin e njeriut, ky quhet ndëshkim i rreptë dhe lloje të tjera si këto ndëshkime.

Është e qartë se përshkrimi i ndëshkimit me një prej cilësive përshtatet me llojin e mëkatit. Për këtë në shumë ajete kur'anore ka ardhur se ndëshkimi i zullumqarëve (të padrejtëve) është një ndëshkim i dhimbshëm, sepse i përshtatet dhimbjes dhe padrejtësisë së zullumqarit ndaj të privuarit.

Po kështu edhe për llojet e tyre të ndëshkimit. Qëllimi në këtë shpjegim është afrimi i çështjes së ndëshkimit në mendjet e njerëzve, duke e ditur se ndëshkimi i Botës Tjetër është një gjë që nuk mund të përcaktohet me atë çfarë ekziston në botën tonë.

Ajeti i fundit flet për qëndrimin e besimtarëve të cilët kanë besuar në All'llahun dhe në të gjithë Profetët e Tij, nuk kanë veçuar asnjë prej Profetëve dhe të Dërguarve, janë të sinqertë për të vërtetën dhe kanë luftuar të gjitha llojet e fanatizmit të kotë.

Ky ajet qartëson se All'llahu do t'i shpërblejë në një të ardhme të afërt: **"Ndërsa atyre që besojnë All'llahun dhe të dërguarit e Tij dhe nuk bëjnë dallim mes asnjërit prej tyre. Ai do t'ju japë shpërblimin (e premtuar)."**

Është e pakundërshtueshme se besimi në të gjithë Profetët dhe të Dërguarit nuk është në kundërshtim me çështjen e përparësisë së tyre nga njëri-tjetri, sepse çështja e përparësisë lidhet ngushtë me rëndësinë e madhësisë në përgjegjësinë që mbart gjithsecili prej tyre.

Është e natyrshme se përgjegjësia që u është dhënë Profetëve ndryshon sipas rëndësisë dhe rrezikut të gjithsecilit prej tyre. Kjo çështje është e argumentuar prerë.

E rëndësishme këtu është që mos të ndodhë dallim dhe ndarje në besimin tek Profetët dhe në pohimin e profetësisë së tyre.

Në mbyllje, ajeti dëshmon dhe përforcon se All'llahu i Lartësuar do t'i falë besimtarët, të cilët kanë bërë gabim për

fanatizmin e tyre dhe dallim ndërmjet Profetëve, nëse sinqerisht ata (besimtarët) besojnë tek ata dhe tek All'llahu, sigurisht që pendohen për gabimet e tyre të mëparshme, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **“Se All'llahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”**.

Duhet patur vëmendja se ajetet e fundit përmendin se ata që qëllimisht bëjnë dallim mes Profetëve, janë me të vërtetë mosbesimtarë, ndërkohë nuk ka treguar për ata që kanë besuar në të gjithë Profetët se janë me të vërtetë besimtarë, por vetëm i ka cilësuar si besimtarë.

Ka mundësi që ky ndryshim në përshkrim është për të treguar se besimtarët e vërtetë janë ata njerëz, besimi i të cilëve u është ngulitur në zemër dhe ndikimet e atij besimi duken në veprat e tyre, sikurse thotë hadithi: “Besimi është ajo çfarë është ngulitur në zemër dhe e vërtetojnë punët.”

Për këtë tregojnë edhe ajetet në fillim të sures “El Enfal” të cilat përmendin disa cilësi të besimtarëve, e para besimi në All'llahun, falja e namazit, dhënia e zeqatit dhe mbështetja tek All'llahu, pastaj, pas përmendjes së këtyre cilësive, vjen përforcimi: **“Njëmend, ata janë besimtarë të vërtetë...”**.

Ajetet 153 - 154

يَسْأَلُكَ أَهْلُ الْكِتَابِ أَنْ تُنِزَلَ عَلَيْهِمْ كِتَابًا مِّنَ السَّمَاءِ ۚ فَقَدْ سَأَلُوا مُوسَىٰ أَكْبَرَ مِنْ ذَلِكَ فَقَالُوا أَرِنَا اللَّهَ جَهْرَةً فَأَخَذَتْهُمُ الصَّعِقَةُ بِظُلْمِهِمْ ۚ ثُمَّ اتَّخَذُوا الْعِجْلَ مِن بَعْدِ مَا جَاءَتْهُمْ أَلْيَنَ ۚ فَعَفَوْنَا عَنِ ذَلِكَ ۚ وَءَاتَيْنَا مُوسَىٰ سُلْطٰنًا مُّبِينًا ﴿١٥٣﴾ وَرَفَعْنَا فَوْقَهُمُ الطُّورَ بِمِثْقَلِهِمْ وَقُلْنَا لَهُمْ ادْخُلُوا الْبَابَ سُجَّدًا وَقُلْنَا لَهُمْ لَا تَعْدُوا فِي السَّبْتِ وَأَخَذْنَا مِنْهُمْ مِّيثَاقًا غَلِيظًا ﴿١٥٤﴾

“Ithtarët e Librit kërkojnë prej teje (o Muhammed!) që t’u zbresësh një libër prej qielli. Në të vërtetë, ata i kërkuan Musait diçka edhe më të madhe (duke i thënë): ‘Na e trego All’Ilahun haptazi!’ Atëherë i shkatërroi rrufeja për shkak të poshtërsisë që bënë. Pastaj zgjodhën viçin (për adhurim), pas shenjave të qarta që u patën ardhur. Ne ua falëm atë dhe i dhamë Musait pushtet të dukshëm.”

"Ne ngritëm mbi ata malin Tur, sipas besëlidhjes me ta. Pastaj u thamë: ‘Hyni në portë duke u përulur’ dhe ‘mos e shkelni Sebtin (ditën e shtunë)!’ dhe morëm nga ata një besë të fortë.”

Shkaku i zbritjes

Ka ardhur në tefsiret “Tibjjan”, “Mexhmaul Bejjan” dhe “Ruhul Meanij” rreth shkakat të zbritjes së këtyre dy ajeteve, se një grup jehudinjsh shkuan te Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i kanë thënë atij, se nëse në të vërtetë je Profet i dërguar prej All'llahut na e paraqit neve librin tënd qiellor të plotë (të shpallur përnjëherë), sikurse i ka ardhur Musasë (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) Teurati njëherësh. Këto dy ajete zbritën duke iu përgjigjur këtyre jehudinjve.¹

Komentimi

Qëllimi i jehudinjve nga shpikja e shfajësimeve

Ajeti i parë tregon për kërkesën e ithtarëve të Librit “Jehudinjtë” që i bë në Profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që t’u zbriste atyre librin nga qielli të plotë (të shpallur përnjëherë), ku All'llahu i Lartësuar ka thënë: **“Ithtarët e Librit kërkojnë prej teje (o Muhammed) që t’u zbresësh një libër prej qiellit.”**

Nuk ka dyshim se ata nuk kanë qenë të singertë në qëllimet e tyre me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse qëllimi në zbritjen e librit qiellor është udhëzimi në rrugë të drejtë dhe në rrugë n e edukimit.

¹ Tefsiret “Mexhmaul Bejan”, vëllimi 3, faqe 228; “Biharul Enuar”, vëllimi 9, faqe 77.

Nga një anë, ky qëllim mund të realizohet nga rruga e zbritjes së librit të plotë nga qielli të paktën njëherësh dhe nganjëherë tjetër, ky qëllim realizohet nga mënyra e zbritjes së librit qiellor pjesë-pjesë, në mënyrë graduale.

Duke u bazuar në këtë do të ishte më e vlefshme për jehudinjtë që t'i kërkojnë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) argument, t'i kërkonin atij që t'i mësonin këto vepra, t'i përcaktonin rrugën e zbritjes së librit qiellor dhe t'i kërkonin atij që t'u zbriste atyre një libër në atë formë që ata ia përcaktuan.

Për këtë shkak, All'llahu i Lartësuar i ka demaskuar qëllimet e tyre të këqija pas kësaj kërkesë të tyre dhe i shpjegoi Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), se ky veprim ishte mashtrim i jehudinjve, sepse ata janë shquar për intrigat dhe krijimet e shkaqeve e të arsyeve dhe të kundërshtimit me Profetin e madh të tyre Musanë (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Ata i kërkuan Profetit të tyre, Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) diçka më të habitshme kur i thanë atij që t'ua shfaqte atyre All'llahun që ta shihnin! Për këtë, ajeti thotë: **“Në fakt, ata i kërkuan Musait diçka edhe më të madhe** (duke i thënë) **“Na e trego All'llahun haptazi.”**

Burimi i kësaj kërkesë të habitshme, jashtë logjikës dhe e paretizueshme është veçse mburrja dhe kokëfortësia e tyre. Me këtë kërkesë, ata kanë ndërtuar besimin e tyre idhujtar në personifikimin e All'llahut të Lartësuar dhe përcaktimin e Tij.

Kundërshtimi i tyre i çoi ata në ndëshkimin e All'llahut përmbi ta, rrufeja nga qielli i përfshiu ata për padrejtësinë e madhe që bënë dhe All'llahu i Lartësuar thotë: **“Atëherë i shkatërroi rrufeja, për shkak të poshtërisë që bënë.”**

Pastaj ajeti tregon për një vepër të shpifur të cilën e bënë jehudinjtë dhe në atë kohë iu drejtua adhurimit të viçit, pasi ata me sytë e tyre shikonin mrekullitë e mëdha dhe argumentet e qarta, ku All'llahu i lartësuar thotë: **“Pastaj zgjodhën viçin (për adhurim) pas shenjave të qarta që iu patën ardhur.”**.

Me të gjithë këtë mburrje, kokëfortësi dhe idhujtari, All'llahu u paraqet zemërgjerësinë dhe mëshirën e Tij dhe i fal ata, ndoshta ata kthehen nga qëllimi i tyre, i dhuron Profetit të tyre një famë të madhe dhe të qartë, demaskon Samiriun, të zotin e viçit dhe zhduk përçarjen e tij. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ne ua falëm atë dhe i dhamë Musait pushtet të dukshëm.”**.

Por, për shkak të keqes që gjendej në brendinë e jehudinjve, ata nuk u zgjuan nga pavëmendshëmria e hutimi, nuk dolën nga humbja e thellë dhe nuk hoqën dorë nga mendjemadhësia dhe mashtrimi i tyre. All'llahu e ngriti Malin e Turit, që t'ua zbriste mbi kokat e tyre, derisa e mori prej tyre betimin dhe premtimin. All'llahu i urdhëroi ata që të hyjnë të përulur të frikësuar nga dera e Bejtul Makdesit, si argument të pendimit të tyre dhe u garantoj atyre që të mos bëjnë asnjë punë ditën e shtunë, të mos ndjekin rrugën e armiqve dhe të hanë peshk, të cilin ua ka ndaluar që ta gjuajnë në këtë ditë.

Sipas të gjitha këtyre, All'llahu mori premtimin e madh dhe të sigurt, por ata absolutisht nuk e mbajtën premtimin e tyre. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ne ngritëm mbi ta malin Tur sipas besëlidhjes me ta. Pastaj u thamë: ‘Hyni në portë duke u përulur’ dhe ‘Mos e shkelni Sebtin (ditën e shtunë)!’ dhe morëm nga ata një besë të fortë.”**.

A është e mundur që ky grup, i cili ka një të shkuar të keqe dhe histori të zezë, të jetë i sinqertë me Profetin Muhammed (*Paqja*

dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për atë çfarë i kërkuan atij?

Nëse ata janë të singërtë, atëherë përse nuk e zbatojnë atë që ka zbritur e qartë në librin e tyre qiellor rreth shenjave të veçanta për vulën e mbarë Profetëve?

Përse atë herë këmbëngulin në injorimin e çdo gjëje të qartë e të argumentuar që solli Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)?

Këtu është e vlefshme që të tregojmë dy çështje:

E para: nëse kundërshton, kundërshtari thotë se ata vepra kanë qenë specifike dhe të veçanta për jehudinjtë e mëparshëm dhe cila është lidhja me jehudinjtë në kohën e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)?

Ne themi se jehudinjtë në kohën e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk kanë shfaqur kundërshtimin dhe mohimin e veprave të të parëve të tyre, por ata kanë shfaqur kënaqësi për ato vepra.

E dyta: veçon çështjen e zbritjes së Teuratit përnjëherësh. Në shakkun e zbritjes së këtyre dy ajeteve thamë se jehudinjtë e pretendonin zbritjen e këtij libri qiellor (Teuratit) përnjëherë, ndërkohë që kjo çështje nuk konsiderohet si çështje e sigurt. Ndoshta ajo gjë që i çoi në këtë hamendësim, janë dhjetë këshillat (*uesaja ashratu*), të cilat i kanë zbritur në pllaka përnjëherë Profetit Musa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Mirëpo ne nuk kemi argument të qartë për zbritjen e rregullave të tjera të Teuratit përnjëherësh.

Ajetet 155 - 158

فَبِمَا نَقْضِهِمْ مِيثَاقَهُمْ وَكُفْرِهِمْ بِآيَاتِ اللَّهِ وَقَتْلِهِمُ الْأَنْبِيَاءَ بِغَيْرِ
 حَقٍّ وَقَوْلِهِمْ قُلُوبُنَا غُلْفٌ ۚ بَلْ طَبَعَ اللَّهُ عَلَيْهَا بِكُفْرِهِمْ فَلَا يُؤْمِنُونَ
 إِلَّا قَلِيلًا وَكَفَرِهِمْ ۖ وَقَوْلِهِمْ عَلَىٰ مَرْيَمَ هُتَنَّا عَظِيمًا ۖ
 وَقَوْلِهِمْ إِنَّا قَتَلْنَا الْمَسِيحَ عِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ رَسُولَ اللَّهِ وَمَا قَتَلُوهُ
 وَمَا صَلَبُوهُ وَلَٰكِن شُبِّهَ هُمْ ۚ وَإِنَّ الَّذِينَ اخْتَلَفُوا فِيهِ لَفِي شَكٍّ مِّنْهُ
 ۚ مَا لَهُم بِهِ مِنْ عِلْمٍ إِلَّا اتِّبَاعَ الظَّنِّ ۚ وَمَا قَتَلُوهُ يَقِينًا ۖ بَلْ
 رَفَعَهُ اللَّهُ إِلَيْهِ ۚ وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا ۖ

“(Ne i mallkuam ata) për shkak të besëlidhjes nga ana e tyre, për shkak të mohimit që i bënë shpalljeve të All’Ilahut, për shkak të vrasjes së Profetëve pa kurrfarë të drejte dhe për thënien e tyre: ‘Zemrat tona janë të mbyllura në këllëf (prandaj s’i kuptojmë fjalët e Profetëve).’ Nuk është kështu, por All’Ilahu ua ka vulosur ato për shkak të mohimit të tyre, prandaj pak prej tyre besojnë.

“(I mallkuam ata) për shkak të tyre {ndaj Isait (Pagja e All’Ilahut qoftë mbi të!)}, për shkak të shpifjeve të mëdha që thanë kundër Merjemes.”

"Dhe për fjalët e tyre: 'Ne e vramë Mesihun - Isain, të birin e Merjemes, të dërguarin e All'llahut.' Por, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan me çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur asgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Në të vërtetë, ata nuk e kane vrarë,

"Por, All'llahu e ka ngritur pranë Vetes. All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijsëm."

Komentimi

Plane të tjera armiqësore të praktikuara nga jehudinjtë

Këto ajete tregojnë planet e tjera nga shkeljet dhe veprat armiqësore të Beni israilëve, me të cilat kundërshtuan Profetët e All'llahut.

Ajeti i parë tregon për, thyerjen e besëlidhjeve nga ana e jehudinjtë, për renegatimin e disa prej tyre, për mosbesimin e tyre ndaj argumenteve të All'llahut dhe vrasjen e Profetëve nga ana e tyre. Me këto vepra ata e merituan zemërimin e All'llahut dhe privimin nga mëshira dhe një pjesë e mirësive të Tij.

Ata mohuan argumentet e All'llahut pasi thyen besëlidhjen dhe ndoqën me këtë rrugën e humbur. Ata nuk u mjaftuan me këtë cak, por e zgjeruan më shumë mashtrimin e tyre dhe bënë me duart e tyre krime të mëdha, ku qëllimisht vranë udhëzuesit e drejtuesit për në rrugë të drejtë. Të gjithë këtë e bënë përshkak të kokëforcisë së tyre për të ndjekur rrugën e kotë e të padrejtë dhe për t'u larguar nga rruga e vërtetë.

Jehudinjtë kanë qenë kokëfortë, mburravecë dhe arrogantë. Ata u përgjigjeshin fjalëve të Profetëve me përçmim dhe tallje. Çështja e tyre arriti deri aty sa të thonë qartë se zemrat e tyre i ka mbuluar perdja nga dëgjimi dhe pranimi i fjalëve të Profetëve!

All'llahu i Lartësuar thotë në ajetin e parë: **“(Ne i mallkuam ata) për shkak të shkeljes së besëlidhjes nga ana e tyre, për shkak të mohimit që u bënë shpalljeve të All'llahut, për shkak të vrasjes së Profetëve pa kurrfarë të drejte dhe për thënien e tyre: ‘Zemrat tona janë të mbyllura në këllëf (prandaj s’i kuptojnë fjalët e Profetëve)’.”.**

Këtu Kur’ani Famëllartë dëshmon dhe përforcon se me të vërtetë zemrat e tyre janë të vulosura dhe në to nuk depërton asnjë e vërtetë. Shkak i kësaj është mosbesimi i tyre. Ata nuk besojnë përshkak të mburrjes dhe të kokëfortësisë, me përjashtim të një numri të pakët prej tyre. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Nuk është kështu, por All'llahu ua ka vulosur ato për shkak të mohimit të tyre, prandaj pak prej tyre e besojnë.”.**

Ata kriminelë e kaluan kufirin dhe i ngjitën (mveshën) Merjemes së pastër e virgjëreshë akuza të tmerrshme dhe shpifje të mëdha. Ajo është nëna e një prej Profetëve të mëdhenj të All'llahut, ajo mbeti shtatzanë me lejen e All'llahut, pa e prekur njeri. All'llahu i Lartësuar thotë: **“(i mallkuam ata) për shkak të mosbesimit të tyre {ndaj Isait (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)), për shkak të shpifjeve të mëdha që thonë kundër Merjemes.”**

Ata kriminelë u krenuan me vrasjen e Profetëve dhe supozuan se ata e vranë Isain, të birin e Merjemes, të Dërguarin e All'llahut, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **“dhe për fjalët e tyre: ‘Ne e vramë Mesihun - Isain, të birin e Merjemes, të Dërguarin e All'llahut’.”**

Ndoshta ata e kanë përdorur shprehjen *të dërguarin e All'llahut* si përçmim dhe tallje. Vërtet, ata janë gënjeshtarë në pretendimin e tyre për vrasjen e Isait, sepse ata as nuk e vranë e as nuk e kryqëzuan, por kryqëzuan një person tjetër të ngjashëm me Isain. All'llahu i Lartësuar e tregon këtë të vërtetë duke thënë: **“Por ata as e vranë, as e kryqëzuan, po ashtu u është dukur.”**

Ky ajet argumenton se ata u përçanë në çështjen e Mesisë. Ata ishin në dyshim në vetvete për çështjen e tyre dhe asnjë prej tyre nuk ka besuar në atë çfarë ka thënë, por kanë ndjekur hamendësimin, për të cilin All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur kurrgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë nuk e kanë vrarë.”**

Komentuesit kanë bërë kërtime për mospajtimin që ka ardhur në këtë ajet. Disa kanë thënë se mospajtimi është për gradën dhe pozitën e Mesihu, ku një grup prej të krishterëve e kanë konsideruar Mesihun si birin e All'llahut dhe një grup tjetër e kanë refuzuar se ka qenë Profet, si p.sh., jehudinjtë. Por të gjithë ishin të gabuar.

Por, ka gjasa që qëllimi i kundërshtimit të jetë në temën se si është vrarë Mesihu, ku disa kanë thënë se ai është vrarë dhe disa të tjerë kanë thënë që nuk është vrarë. Por asnjë prej dy grupeve, nuk kanë qenë të sigurtë në thënie. Ose, ndoshta, ata të cilët supozuan për vrasjen e Mesisë, ranë në dyshim në këtë çështje nga mosnjohja e tyre për Mesinë dhe dyshuan në atë që vranë, a ka qenë ai Mesihu apo ka qenë një person tjetër.

Këtu Kur'ani Famëlartë shpjegon dhe përforcon se ata nuk e kanë vrarë Mesinë, por All'llahu e ka ngritur atë tek Ai dhe se All'llahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë dhe se Ai është i Urtë për atë çfarë bën. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ata në të vërtetë**

nuk e kanë vrrarë, por All'llahu e ka ngritur pranë vetes. All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm."

Hulumtime

Legjenda e kryqit

Kur'ani Famëllartë dëshmon dhe përforcon në këtë ajet se Mesihu (Isai) as nuk është vrrarë dhe as nuk është kryqëzuar, por jehudinjve u është hamendësuar kjo çështje dhe menduan se e kanë kryqëzuar, por ata asnjëherë nuk e kanë vrrarë!

Ndërsa Katër Ungjijtë që ekzistojnë sot në mesin tonë thonë se Mesihu është kryqëzuar dhe është ekzekutuar në këtë formë dhe kjo thënie ka ardhur në kapitujt e fundit nga këto Ungjij, si ungjilli i Mateut, i Markut, Lukës dhe i Gjonit.

Të krishterët e sotëm besojnë me këtë çështje në një formë të përgjithshme dhe çështja e kryqit apo e vrasjes së Mesisë sot konsiderohet si një nga çështjet më themeltare dhe bazë për fenë e krishterë.

Ne e dimë se të krishterët sot nuk e konsiderojnë Mesinë vetëm si Profet i dërguar udhëzues për njerëzinë, por besojnë se ai është i biri i All'llahut, një nga shtyllat e trinitetit të shenjtë tek ta dhe sugjerojnë se qëllimi i ardhjes së Mesisë në këtë botë për t'u bërë kurban dhe për të flijuar veten është pranimi i gabimeve dhe i mëkateve që bëjnë njerëzit.

Ata thonë se ai ka ardhur për të flijuar veten për shkak të gabimeve dhe mëkateve të tyre dhe se ai u kryqëzua dhe u

ekzekutua për t'i larë mëkatet e njerëzimit me gjakun e tij dhe për ta shpëtuar atë nga mëkatet. Prandaj ata besojnë se rruga e pastërtisë dhe shpëtimi nga ndëshkimi është besimi në këtë temë.

Dhe nga ky këndvështrim, ata nganjëherë e quajnë krishterimin si fenë e shpëtimit apo si fenë e flijimit dhe e quajnë Mesinë "Shpëtimtar" apo "pastrues nga mëkatet" apo "i flijuar".

Besimi i tyre i tepërt për kryqin e ka bërë atë slogan për veten e tyre, por në të vërtetë përqendrohet në çështjen e ekzekutimit dhe të kryqëzimit.

Ndërsa myslimanët nuk kanë dyshim në kotësinë, falsifikimin dhe mashtrimin e këtij besimi, sepse Mesihu, Isa ibn Merjem, ka qenë Profet si të gjithë Profetët e All'Ilahut dhe nuk ka qenë as Zot, as i biri i Zotit, sepse All'Ilahu është Një i Vetëm që nuk ka shok (partner në adhurim), nuk ka nevojë për asgjë, nuk ka gjë që i përngjet atij, nuk ka grua dhe as fëmijë, kjo është e para!

E dyta: me të vërtetë, çështja e flijimit për shkak të mëkateve të të tjerëve konsiderohet si çështje e palogjikë dhe çdo njeri gjykohet sipas mëkatit dhe veprës së tij. Me të vërtetë, rruga e shpëtimit është vetëm me besim dhe me vepra të mira.

E treta: në të vërtetë, besimi në flijim për shkak të mëkateve konsiderohet nxitësi më i mirë për shkatërrimin dhe praktikimin e mëkateve dhe e shpie njerëzimin në ndotje e shkatërrim.

Kur vërejmë se Kur'ani Famëlartë dëshmon dhe e vërteton çështjen e moskryqëzimit të Mesisë (Isait), këtë e bën me qëllim që të shfarosë besimin e kotë të flijimit dhe t'i ndalojë të krishterët nga ekzagjerimi në këtë doktrinë shkatërruese dhe të besojnë se rruga e shpëtimit varet nga veprat e tyre dhe nuk është nën hijen e kryqit.

E katërta: gjenden argumente që konstatojnë hamendësimin dhe dobësinë e çështjes së besimit në kryqëzimin e hazreti Isait dhe ato janë:

1- Është e vërtetë se Katër Ungjijtë që përdoren në kohën e sotme dhe që dëshmojnë kryqëzimin e hazreti Isait, janë përmbledhur e shkruar pas shumë vitesh. Ato i kanë shkruar apo përmbledhur apostujt apo ata që e kanë ndihmuar atë.

Këtë të vërtetë e dëshmojnë edhe historianët e krishterë. Sikurse ne e dimë, apostujt e hazreti Isait janë larguar pasi i kanë luftuar armiqtë dhe vetë Ungjijtë e vërtetojnë këtë gjë¹ dhe, duke u bazuar në këtë, me të vërtetë apostujt e kanë dëgjuar çështjen e kryqëzimit nga goja e njerëzve të tjerë dhe nuk kanë qenë të pranishëm gjatë kryqëzimit të Mesisë (Isait). Zhvillimet që ndodhën në atë kohë çuan në përgatitjen e rrethanave ndihmuese në ngjashmërinë e një personi tjetër dhe në kryqëzimin e tij në vend të hazreti Isait (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!)

2- Një faktor tjetër që çoi në dyshimin e një personi tjetër në vend të hazreti Isait mund të jetë se grupi i cili ishte ngarkuar për kapjen e hazreti Isait (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) dhe që shkuan në kopshtin *Xhestijmani*, ai grup përbëhej nga pjesëtarët e ushtrisë romake, të cilët ishin specialistë për çështjet ushtarake, por ata nuk i njihnin jehudinjtë as në gjuhën dhe zakonet e tyre, sikurse nuk kanë ditur t'i dallojnë apostujt e hazreti Isait nga vetë hazreti Isai (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!).

3- Ungjijtë tregojnë se mësymja ndaj vendit të Isasë (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) është bërë natën dhe është e pakundërshtueshme se errësira e natës konsiderohet ndihmësja

¹ Ungjilli sipas Mateut, kapitulli 27, fraza 57.

më e madhe që personi i kërkuar të fshihet e të largohet dhe të bjerë një person tjetër në duart e ushtrisë.

4- Konkluzioni i të gjithë ungjijve është se i akuzuari apo i arrestuari ka përzgjedhur heshtjen përpara mbretit “Pilatij”, udhëheqës romak i Bejtul Makdis në atë kohë, dhe ka folur veçse pak për të mbrojtur veten. Nuk ka gjasa që Mesihu (Isai) të bjerë në një rrezik të tillë dhe të mos e mbrojë veten, kur ka të drejtë ta bëjë këtë dhe kur njihet për retorikën e të shprehurit dhe për trimërinë e tij.

Është e mundur që në këtë rast të jetë një person tjetër, si Jehudha El Eskherbuti, i cili i ngjante shumë atij dhe e ka tradhtuar Mesinë. Kur u kap në vend të hazreti Isait atë e kaploi frika e paniku dhe nuk ka qenë i aftë për të mbrojtur veten. Ne lexojmë në ungjijtë se Jehudha El Eskherbuti nuk është dukur asnjëherë pas ngjarjes së kryqëzimit, sikurse thonë këta ungjij, se ai ka vrarë veten.¹

5- Ungjijtë tregojnë se apostujt u larguan kundër rrezikut që po u kanosej, sikurse u larguan dhe u fshehën ndihmësit e tyre. Gjithsecili shikon vendndodhjen e tjetrit, ndërkohë u bë personi i vetëm i kapur në mesin e ushtrisë romake dhe nuk ka qenë asnjë prej shokëve të tij afër tij dhe për këtë nuk duket e habitshme që të bëhet gabim në zbulimin e një personi të kapur.

6- Dhe prapë lexojmë në ungjijtë se personi i kryqëzuar u ankua te zoti i vet sepse ai – sipas fjalës së tij - e ka lënë dhe e ka harruar në duart e armikut për ta vrarë.²

Nëse do të pranojmë thënien se hazreti Isai (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!) ka ardhur në këtë botë për t’u kryqëzuar dhe me kryqëzimin e tij të shpëtojë njerëzimin nga ndëshkimi i

¹ Ungjilli sipas Mateut, kapitulli 27, fraza 6.

² Ungjilli sipas Mateut, kapitulli 27, fraza 46-47.

gabimeve dhe i mëkateve të tyre, kjo nuk përputhet me qëllimin e madh që kishte hazreti Isai (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!). Ky është argument se personi i kryqëzuar nuk ka qenë hazreti Isai, por ka qenë një person i dobët, frikacak e i paaftë. Ato fjalët e mëparshme mund të thuhën nga një person i tillë dhe jo nga hazreti Isai (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!).

7- Disa ungjij të pranishëm e kanë mohuar çështjen e kryqëzimit të Mesisë, si ungjilli i Barnabës (dhe ky ungjill është tjetër ungjill nga katër ungjijtë që i pranojnë të krishterët), ku një grup prej të krishterëve dyshojnë në çështjen e kryqëzimit¹ dhe disa kërkes kanë shkuar edhe më larg se kaq, dhe supozuan se historia ka treguar dy persona me emrin Isa njëri prej tyre, Isai i kryqëzuar dhe tjetri Isa jo i kryqëzuar, dhe ndërmjet tyre ka një periudhë ndonëse pesëqind vjet.²

Të gjithë këta shembuj përforcojnë thënien e Kur'anit të famshëm në çështjet e shembujve të tyre e të ngjasimit të ndodhur në ekzekutimin apo kryqëzimin e tij.

¹ El Menar, vëllimi 6, faqe 34.

² Tefsiri Mijjzan, vëllimi 27, faqe 345.

Ajeti 159

وَإِنْ مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ إِلَّا لِيُؤْمِنَنَّ بِهِ قَبْلَ مَوْتِهِ ۖ وَيَوْمَ الْقِيَمَةِ
يَكُونُ عَلَيْهِمْ شَهِيدًا ﴿١٥٩﴾

“Të gjithë ithtarët e Librit do t’i besojnë Isait para se ai të vdesë dhe, në Ditën e Kiametit, ai do të jetë dëshmitar kundër tyre.”

Komentimi

Në komentimin e këtij ajeti janë thënë disa sugjerime dhe gjithsecili prej këtyre sugjerimeve është i vlefshëm që të shqyrtohet nga disa këndvështrime.

1- Me të vërtetë, ky ajet qartëson se çdo njeri nuk mund të konsiderohet nga ithtarët e Librit nëse nuk beson para vdekjes së tij në hazreti Isain. Ai thotë: **“Të gjithë ithtarët do t’i besojnë Isait para se ai të vdesë”**. Kjo çështje kryhet e plotësohet kur njeriu i afrohet vdekjes, dobësohet lidhja e tij me këtë botë dhe forcohet lidhja me Botën Tjetër pas vdekjes. Nga sytë e tij ngrihen perdet dhe pas kësaj shikon shumë të vërteta dhe, në këtë moment, shikon hazreti Isain me syrin e zemrës së tij dhe beson në të. Ata që e kanë mohuar profecinë e tij, i besojnë atij dhe ata që e kanë cilësuar si zot, do ta kuptojnë gabimin e tyre.

Në këtë moment e mësojnë gabimin dhe devijimin e tyre dhe është e pakundërshtueshme se shembulli i këtij besimi nuk i ka dobi të zotit të tij, sikurse Faraonët dhe popujt e tyre, kur u

erdhi ndëshkimi thanë “besuam”, por besimi i tyre asnjëherë nuk u pati dobi. Është me vlerë që njeriu të besojë para se t’i shfaqet momenti i ndëshkimit, kur i vjen vdekja, sepse nuk i ka dobi besimi i tij.

Çka është e vlefshme të tregohet këtu se përemri në shprehjen “para se ai të vdesë” kthehet tek ithtarët e Librit duke u bazuar në këtë komentim që treguam.

2- Qëllimi i këtij ajeti mund të jetë se të gjithë ithtarët e Librit besojnë në Isanë përpara vdekjes së tij dhe jehudinjtë besojnë në profetësinë e tij dhe të krishterët distancohen nga besimi i Mesisë për zot. Dhe kjo ndodh, sipas transmetimeve islame, kur hazreti Isai zbret nga qielli dhe të vijë Mehdiu i premtuar (All’llahu e shpejtoftë ardhjen e tij!). Kjo është e qartë se në këtë ditë Isai do të lajmëroj bashkimin e tij dhe qëndrimin e tij nën flamurin Islam, sepse legjislacioni (sheriati) qiellor që solli hazreti Isai ka ardhur para Islamit dhe për këtë ajo është e abroguar me Islamin.¹

Duke u bazuar në këtë komentim, përemrin në shprehjen “para se ai të vdesë” kthehet te Hazreti Isai.

Transmetohet nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai ka thënë: “Si do të jeni ju kur të zbresë te ju Isai, i biri i Merjemes dhe Imami i juaj prej jush (Imam Mehdiu).”²

Është e natyrshme se ky komentim përfshin jehudinjtë dhe të krishterët, të cilët janë të pranishëm në kohën e shfaqjes së Mehdiut të premtuar (All’llahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) dhe të zbritjes së Isait nga qielli.

¹ Biharul Enuar, vëllimi 25, faqe 137, Ujunul Ahbar, vëllimi 2, faqe 202.

² Musnedi i imam Ahmedit, vëllimi 2, faqe 144; Sahih Buhari, vëllimi 4, faqe 143; Sahih Muslim, vëllimi 1, faqe 94; Tefsiri “Mijzan” vëllimi 5, faqe 144.

Ka ardhur në tefsirin e “Ali Ibn Ibrahim” të transmetuar nga “Shehr ibn Hausheb” se një ditë Haxhaxhi ka thënë se në Kur'an ndodhet një ajet i cili e ka munduar shumë dhe ai është i çoroditur për kuptimin e atij ajeti.

Shehri e pyeti atë për ajetin. Haxhaxhi i tha Shehrit se është ajeti **“Të gjithë ithtarët e Librit...”**. Ai përmendi se kishte vrarë jehudinj dhe të krishterë dhe nuk kishte parë tek ata ndonjë shenjë të këtij besimi. Shehri iu përgjigj se komentimi i ajetit nga ana e tij nuk ka qenë komentim i saktë. Haxhaxhi u habit dhe e pyeti për komentimin e saktë.

Shehri iu përgjigj se komentimi i ajetit është se hazreti Isai zbret prej qiellit para se të mbarojë bota dhe të gjithë jehudinjtë i besojnë atij para vdekjes dhe se Mesihu (Isai) do të falet pas Mehdisë së shumëpritur. Kur i dëgjoi Haxhaxhi këto fjalë i tha Shehriut “I mjeri ti. Nga e ke marrë këtë komentim?” Dhe i është përgjigjur Shehriu se ai e ka dëgjuar nga Muhammedi ibn Ali Husejn ibn Ali ibn Ebi Talibi. Atëherë Haxhaxhi i ka thënë: “Betohem në All'llahun se këtë lajm e ke sjellë nga një burim i pastër”¹

Ajeti në mbyllje thotë: **“Në ditën e Kiametit, ai do të jetë dëshmitar kundër tyre.”** Sigurisht, dëshminë e Mesisë për popullin se ai e ka kryer mesazhin e tij dhe nuk i ka bërë thirrje atyre që ta bënim atë Zot, por ai i ka bërë thirrje që të adhuronin të vetmin All'llah të Plotfuqishëm.

Pyetje: Disa mund të kundërshtojnë se Mesihu, sikurse ka ardhur në ajetin 117 të sures “El Maide”, se dëshmia e tij kufizohet vetëm me kohën kur ai ka qenë i pranishëm në mesin e popullit të vet dhe nuk është për kohët që vijnë më pas. Këtë e argumenton

¹ Tefsiri “Burhan”, vëllimi 1, faqe 426.

edhe ajeti: **“...Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe, qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë.”**¹

Mirëpo ajeti të cilin jemi duke komentuar tregon se hazreti Isai dëshmon mbi të gjithë ata Ditën e Kiametit, qofshin ata të kohës së tij apo ata të cilët nuk kanë qenë në kohën e tij.

Përgjigje: Përgjigja e këtij kundërshtimi është se nëse thellohem në përmbajtjen e këtyre dy ajeteve të përmendur do të kuptojmë se këto tregojnë se ajeti të cilin po komentojmë flet për dëshminë rreth predikimit të mesazhit dhe mohimit të hyjnizimit të Mesisë, ndërsa ajeti 117 i sures “El Maide” dëshmon për veprat e atij populli.

Ajeti i fundit tregon se hazreti Isai do të dëshmojë për të gjithë ata të cilët e konsideruan atë zot, qofshin ata të kohës së tij apo ata të cilët kanë ardhur pas tij. Ajeti vërteton dhe përforcon se ai nuk i ka bërë thirrje atij populli asnjëherë me këtë çështje (se ai është Zot apo i biri i Zotit). Ndërsa ajeti 117 i sures “El Maide” thotë se ai përveç thirrjes në mesazhin e tij me metodë të drejtë, ai ka jetuar një kohë të gjatë në mesin e atij populli, pa asnjë devijim. Mirëpo, ata devijuan pas tij dhe i atribuuan atij cilësitë e Zotit në kohën që ai nuk ishte i pranishëm mes tyre.

¹ Sure "Maide", ajeti 117.

Ajetet 160 - 162

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ ۚ إِنَّ اللَّهَ مَعَ
 الصَّابِرِينَ وَلَا ۖ ﴿١٥٣﴾ تَقُولُوا لِمَنْ يُقْتَلُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ أَمُوتَ ۚ بَلْ
 أَحْيَاءٌ وَلَكِنْ لَا تَشْعُرُونَ وَلَنَبْلُوَنَّكُمْ ﴿١٥٤﴾ بِشَيْءٍ مِّنَ الْخَوْفِ
 وَالْجُوعِ وَنَقْصٍ مِّنَ الْأَمْوَالِ وَالْأَنْفُسِ وَالثَّمَرَاتِ ۗ وَدَشِّرْ
 الصَّابِرِينَ ﴿١٥٥﴾

"Ne ua ndaluam atyre disa ushqime të mira, të cilat ishin të lejuara për ta, për shkak të prapësive që bënë, për shkak se ata pengonin shumë njerëz nga udha e All'Ilahut."

"Për shkak se merrnin kamatë, megjithëse kjo ishte e ndaluar për ta dhe për shkak se përvetësonin padrejtësisht pasurinë e njerëzve. Jobsimtarëve midis tyre, Ne u kemi përgatitur një dënim të dhembshëm."

"Mirëpo të thelluarit në dituri prej tyre (hebrenjve) dhe besimtarët besojnë në atë që të është shpallur ty (o Muhammed) dhe në atë që është shpallur para teje. Posaçërisht atyre që falin namazin, atyre që ndajnë zeqatin dhe atyre që besojnë në All'Ilahun dhe në Ditën e Kiametit, me siguri do t'u japim shpërblim të madh."

Komentimi

E ardhmja e të mirëve dhe e të këqijve jehudinj

Ajetet e mëparshme kanë treguar planet përdhosëse e poshtëruese të jehudinjve, ndërsa këto ajete tregojnë komplete të tjera përdhosëse dhe qartësojnë ndëshkimet që meritojnë për shkak të kokëfortësisë dhe mosbindjes së tyre. Ndëshkimin që kanë marrë e do të marrin si rezultat i kësaj në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Ajeti tregon se All'llahu i Lartësuar i ka ndaluar disa gjëra të pastra të jehudinjve, për shkak të përdorimit të tyre të padrejtësisë dhe ndalimi i tyre për ata që ecin në rrugën e All'llahut të Lartësuar që thotë: **“Ne u ndaluar atyre disa ushqime të mira, të cilat ishin të lejuara për ta, për shkak të prapësive që bënë, për shkak se ata pengonin shumë njerëz nga udha e All'llahut.”**

Sikurse i ka ndëshkuar All'llahu me ndalimin e disa të mirave për veprimin e tyre me kamatë dhe kundërshtimin, duke e pasur parasysh ndalimin e tyre në bashkëpunimin me kamatë (sepse ata në mesin e tyre e kishin të ndaluar kamatën, por me të tjerët e lejonin dhe kjo është një padrejtësi e madhe që u bëhet të tjerëve) dhe posedimi e gllabërimi i tyre mbi pasurinë e të tjerëve në rrugë jo të ligjshme, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **“për shkak se merrnin kamatë, megjithëse kjo është e ndaluar për ta dhe për shkak se përvetësonin padrejtësisht pasurinë e njerëzve.”**

Ajeti shpjegon se ndëshkimi i jehudinjve për këtë mëkat nuk kufizohet në ndëshkimin e kësaj bote, por do të shijojnë gjithashtu ndëshkimin e All'llahut në Botën Tjetër, i cili përfshin mohuesit prej jehudinjve, ku All'llahu i Lartësuar thotë:

“Jobesimtarëve midis tyre u kemi përgatitur një dënim të dhembshëm.”.

Këtu është e vlefshme që të shpjegohen disa çështje:

1- Qëllimi me gjërat e mira që u ka ndaluar jehudinjtë janë ato që i ka treguar ajeti 146 i sures “El Enam”, të cilët kanë përfshirë disa kafshë dhe yndyra, kafshët e tjera, si lopët dhe të imtat (dhentë dhe dhitë), të cilat i kanë dashur shumë jehudinjtë dhe ky ndalim nuk ka qenë "ndalim krijimtar" (tekuinij), por ka qenë ndalim legjislativ (teshriij).

Sigurisht që jehudinjtë janë ndaluar që t’i përdorin këto mirësi, të cilat kanë qenë të lehta në duart e tyre.

Këto ndalime kanë ardhur në Teurat, i cili ndodhet në duart e jehudinjtë sot, dhe gjejmë në librin "Seferul Auijin", kapitulli 11. Por Teurati i sotëm nuk e tregon ndëshkimin e këtij ndalimi.¹

2- A përfshin ky ndalim dallimin me ndjekjen e përgjithshme, jo të padrejtët nga jehudinjtë apo veçon vetëm të padrejtët prej tyre?

Ky ajet dhe ajeti 146 i sures “El Enam” në dukje tregon se ndalimi i përfshin të gjithë me argumentin e shprehjes “për ta”, në të kundërt ndëshkimi në Botën Tjetër, e cila veçon në ajet, “jobesimtarëve midis tyre”.

Në bazë të kësaj, me të vërtetë ndalimi ka ndëshkim për sa u përket zullumqarëve dhe së padrejtës nga jehudinjtë, sikurse mund të jetë sprovë për ata që janë të sinqertë e të drejtë prej tyre dhe ata janë të pakët në numër.

Disa komentues të Kur’anit kanë thënë se ndalimi i përfshin edhe zullumqarët e padrejtë nga jehudinjtë, sikurse tregojnë disa transmetime për këtë mendim, të ardhur në tefsirin “Burhan” në komentimin e ajetit 146 të sures “El Enam”, se Imam

¹ Shih fundin e ajetit 93 të sures "Ali Imran" në këtë komentim.

Sadiku (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ka thënë: “Me të vërtetë, paria e Beni izrailitëve ia ndaloi të varfërve të tyre ngrënien e mishit të zogjve dhe yndyrën e kafshëve dhe për këtë shkak All'llahu u ka ndaluar atyre të padrejtëve këto mirësi si ndëshkim për ata dhe për zullumin e padrejtësinë e tyre.”¹

3- Ky ajet tregon gjithashtu ndalimin e kamatës, ku nuk është përcaktuar ndalimi i saj vetëm për Islamin, por ka qenë e ndaluar edhe për popujt e tjerë dhe në fetë e mëparshme.

Teurati i sotëm dhe që është i devijuar, ua ndalon jehudinjtë që të bashkëpunojnë me kamatë me pjestarët e besimit të tyre dhe nuk e konsideron të ndaluar bashkëpunimin me kamatë me të tjerët.²

Ajeti i tretë dhe i fundit tregon një të vërtetë të rëndësishme që e ka mbështetur Kur'ani disa herë në disa ajete, dhe ajo është se qortimi dhe kritika e jehudinjtë në Kur'an absolutisht nuk bazohet në racizëm, sepse Islami nuk qorton asnjë grup apo element përshkak të përkatësisë së medh'hebit apo kombësisë, por ai (Kur'ani) ia drejton qortimin dhe kritikën vetëm të devijuarve dhe të humburve prej tyre.

Për këtë ky ajet i ka veçuar besimtarët e devotshëm nga jehudinjtë, i ka lavdëruar dhe i ka përgëzuar ata me marrjen e një shpërblimi të madh, ku All'llahu i Lartësuar thotë: “**Mirëpo të thelluarit në dituri prej tyre (hebrenjtë) dhe besimtarët besojnë në atë që të është shpallur ty (o Muhammed) dhe në atë që është shpallur para teje. Posaçërisht atyre që falin namazin, atyre që**

¹ Tefsiri “Burhan”, vëll. 1, f. 559.

² Teurati, Seferu Tethnijeh, kapitulli 23, fjalë 19 dhe 20.

ndajnë zeqatin dhe atyre që besojnë në All'llahun dhe në Ditën e Gjykimit, me siguri do t'u japim shpërblim të madh."¹

Një grup prej parisë së jehudinje besuan dhe hynë në Islam kur u dërguar Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe dëshmuan përpara të tij argumentet e vërtetësisë së Islamit.

Ata e mbrojtën Islamin me vetat e tyre dhe me pasurinë e tyre. Ata kanë qenë të respektuar tek Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe tek besimtarët.

¹ Shprehjen "të thelluarit në dituri" e kemi sqaruar me një lloj detaji në fundin e ajetit 7 të sures "Alí Imra" të këtij komentimi.

Ajetet 163 - 166

إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَى نُوحٍ وَالنَّبِيِّنَ مِنْ بَعْدِهِ ۚ
 وَأَوْحَيْنَا إِلَى إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطِ
 وَعِيسَىٰ وَيُؤُسَ وَهَارُونَ وَسُلَيْمَانَ ۚ وَآتَيْنَا دَاوُدَ زُبُورًا ﴿١٦٣﴾
 وَرُسُلًا قَدْ قَصَصْنَاهُمْ عَلَيْكَ مِنْ قَبْلُ وَرُسُلًا لَمْ نَقْصُصْهُمْ
 عَلَيْكَ ۚ وَكَلَّمَ اللَّهُ مُوسَىٰ تَكْلِيمًا ﴿١٦٤﴾ رُسُلًا مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ
 لئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ ۚ وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا
 حَكِيمًا ﴿١٦٥﴾ لَئِنْ اللَّهُ يَشْهَدُ بِمَا أَنْزَلَ إِلَيْكَ ۚ أَنْزَلَهُ بِعِلْمِهِ ۚ
 وَالْمَلَائِكَةُ يَشْهَدُونَ ۚ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ شَهِيدًا ﴿١٦٦﴾

"Ne të frymëzuam ty (o Muhammed) me shpallje, ashtu siç frymëzuam me shpallje Nuhun dhe Profetët pas tij; siç frymëzuam me shpallje edhe Ibrahimin, Ismailin, Is'hakun, Jakubin dhe bijtë e tij, Isain, Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin dhe Dautin, të cilit i dhamë Zeburin."

"Për disa të dërguar të kemi treguar më parë dhe për disa të tjerë nuk të kemi treguar ty. Dhe (është e vërtetë se) All'llahu i ka folur Musait drejtpërdrejt.

"(Këta janë) të dërguar që kanë sjellë lajme të mira e kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj All'llahut, pas ardhjes së të dërguarve. Vërtet, All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm."

"Por All'llahu dëshmon për atë që të ka shpallur ty (o Muhammed), se Ai ta ka shpallur atë me dijeninë e Tij; po ashtu, edhe engjëjt dëshmojnë për këtë. All'llahu është i mjaftueshëm si dëshmitar."

Komentimi

Ajetet e mëparshme trajtuan çështjen e dallimit të cilin e kanë ushtruar jehudinjtë ndaj Profetëve. Ata i besonin disa nga Profetët e All'llahut të Lartësuar dhe i mohonin disa të tjerë.

Ndërsa ky ajet u përgjigjet jehudinjve dhe u siguron se All'llahu i Lartësuar i ka zbritur Shpallje Profetit të Tij, Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) sikurse i ka zbritur Shpallje edhe Profetëve të tjerë që kanë ardhur pas Profetit Nuh (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). E ka frymëzuar atë njësoj sikurse ka frymëzuar Ibrahimin, Ismailin, Is'hakun, Jakubin, Isain, Ejubin dhe Junusin, Harunin, Sulejmanin, Dautin, etj. All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ne të frymëzuam ty (o Muhammed) me shpallje, ashtu siç frymëzuam me shpallje Nuhun dhe Profetët pas tij. Siç frymëzuam me shpallje edhe Ibrahimin dhe bijtë e tij, Isain, Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin dhe Dautin, të cilit i dhamë Zeburin."**

Ky ajet u përgjigjet jehudinjve, duke dëshmuar dhe përforcuar se legjislacionet e Profetëve të mëdhenj kanë ardhur nga një burim, i cili quhet Revelatë hyjnore dhe se ata ecin të gjithë në një rrugë të vetme dhe për këtë nuk duhet që të bëhen dallime ndërmjet tyre.

Ka mundësi që ky ajet të jetë mesazh për idhujtarët dhe mohuesit prej arabëve para Islamit, të cilët shfaqnin habinë për ardhjen e revelatës Profetit të Islamit, Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ajeti është një përgjigje e sigurt për ata që të mos habiten për shpalljen e Revelatës Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) sepse Revelata u ka zbritur edhe Profetëve të mëparshëm.

Pastaj ajeti sqaron se zbritja e Revelatës nuk është e kufizuar vetëm me këta Profetë, por u është shpallur edhe Profetëve të tjerë, tregimet e disave prej tyre All'llahu ia ka treguar Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), dhe të disave nuk ia ka përmendur. Të gjithë ata Profetë All'llahu i ka dërguar te krijesat e Tij dhe u ka zbritur atyre Revelatën nga ana e Tij. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Për disa të dërguar të kemi treguar më parë dhe për disa të tjerë nuk të kemi treguar ty.”**

Ky ajet në fund tregon një çështje shumë të rëndësishme dhe ajo është se All'llahu i ka folur Musait, në vend që t'i shpallë Revelatë. Ajeti thotë: **“Dhe (është e vërtetë se) All'llahu i ka folur Musait drejtpërdrejt.”**

Duke u bazuar mbi këtë me të vërtetë lidhja (zinzhiri) e Revelatës ka mbetur në mesin e njerëzve dhe nuk është në

drejtësinë e All'Ilahut të Lartësuar, që të lërë njerëzimin pa udhëzues dhe pa udhëheqës apo që t'i lërë ata pa u përcaktuar atyre detyrat dhe obligimet e tyre. Ai është i Cili i ka dërguar Profetët dhe të dërguarit përgëzues dhe qortues, që t'i përgëzojnë njerëzit për mëshirën dhe për shpërblimin dhe t'u të rheqin atyre vërejtje nga ndëshkimi dhe të mos ketë asnjë prej tyre shkak apo argument për t'u shfajësuar e për t'u justifikuar.

All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“(këto janë) të dërguar që kanë sjellë lajme të mira e kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj All'Ilahut, pas ardhjes së të dërguarve.”**

All'Ilahu i Plotfuqishëm dhe i Plotpushtetshëm e ka forcuar planin e dërgimit të Profetëve dhe e ka zbatuar atë me shumë përpikëri. Me këtë ajeti: **“Vërtet All'Ilahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm.”** argumenton se urtësia e Tij obligon realizimin e kësaj vepre. Në të kundërt neglizhimi i kësaj çështjeje të rëndësishme ose tregon mungesën e dijes apo të informacionit ose tregon paafësinë dhe All'Ilahu i Madhëruar është i pastër nga të gjitha këto të meta.

Ndërsa ajeti tjetër e qetëson Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i qartëson se e rëndësishme është që All'Ilahu është dëshmitar për zbritjen e Librit dhe nuk është e rëndësishme që të besojnë një grup prej tyre në këtë Libër apo të mohojnë. Ajeti thotë: **“Por All'Ilahu dëshmon për atë që të ka shpallur ty (o Muhammed).”**

Përzgjedhja e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në pozitën e profetësisë, nga ana e All'Ilahut, nuk ka qenë një çështje loje dhe e

pabazë - All'llahu na ruajtë - por kjo përzgjedhje ka qenë nga burimi i dijes së Tij se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) gëzonte aftësinë dhe meritën për këtë pozitë madhështore dhe për zbritjen e ajeteve të Tij. Për këtë ajeti thotë: **“se Ai ta ka shpallur me dijeninë e Tij.”**

Është e mundur që ky ajët, gjithashtu, të përfshijë një kuptim tjetër, i cili është se çfarë i ka shpallur All'llahu Profetit të Tij nga ajetet, ato burojnë nga deti i pashterur i dijes së All'llahut të Lartësuar. Përmbajtja e këtyre ajeteve konsiderohet argumenti më i qartë se ato rrjedhin nga dituria e All'llahut. Duke u bazuar mbi këtë, dëshmia e vërtetësisë së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) janë ajetet e Kur'anit dhe nuk ka nevojë për argument tjetër për të konstatuar thirrjen e tij. Sikur Muhammedi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të mos e merrte Revelatën nga ana e All'llahut të Lartësuar, asnjëherë nuk do të kishte mundësi - kur është e ditur se ai ka qenë analfabet - që të sillte një libër si Kur'ani, i cili përfshin mësimet më të larta dhe filozofitë, ligjet dhe parimet e moralit dhe programet shoqërore.

Kur'ani Famëlartë argumenton se nuk është vetëm All'llahu që dëshmon se thirrja e Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është e vërtetë, por me atë dëshmojmë edhe melekët në vërtetësinë e kësaj thirrjeje, edhe pse dëshmia e All'llahut është e mjaftueshme në këtë fushë. Ajeti i begatë thotë: **“All'llahu është i mjaftueshëm si dëshmitar.”**

Hulumtime

Këtu i duhet kushtuar vëmendje disa çështjeve, të cilat janë:

1- Disa komentues e kanë kuptuar nga shprehja kur'anore **“Ne të frymëzuam ty (o Muhammed) me shpallje ashtu siç frymëzuam...”** se ajo ka për qëllim t'i tregojë një të vërtetë Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që është se të gjitha veçoritë, të cilat kanë ardhur në legjislacionet qiellore, që u janë shpallur Profetëve të mëparshëm, kanë ardhur të përmbledhuar në legjislacionin që atij i ka shpallur All'llahu dhe çdo veçori me të cilat All'llahu i ka cilësuar robtë e Vet punëmirë e të drejtë ekzistojnë në të. Këtë e kanë treguar edhe disa transmetime të ardhura nga Ehlil Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) për këtë temë dhe ajo çfarë kanë inspiruar komentuesit nga ky ajet, buron tek ato transmetime.¹

2- Në këtë ajet lexojmë se Zeburi është prej librave qiellorë të cilin All'llahu ia zbriti Dautit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Ajetet kur'anore dhe transmetimet islame qartësojnë se librat qiellorë të cilët u kanë zbritur Profetëve janë dy llojesh.

Lloji i parë: Libra që përfshijnë rregulla legjislative ku secili nga këta libra ka lajmëruar legjislacion të ri. Në të vërtetë, këta libra qiellorë janë vetëm pesë dhe u kanë zbritur vetëm pesë Profetëve dhe ata janë Profetët e vendosmërisë së lartë (ulul azmi).

Lloji i dytë: Libra që nuk përmbanin procedura të reja por në to gjendeshin rregulla, këshilla, udhëzime, porosi dhe lloje

¹ Tefsiri “Safijj”, vëllimi 1, faqe 512, tefsiri “Burhan”, vëllimi 1, faqe 427.

lutjesh. Libri i “Zeburit”, i cili i ka zbritur Dautit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), është prej këtij llojit të dytë nga librat qiellorë. “Mezamiret e Daudit” ose “Zeburi i Daudit”, emri i të cilit ka ardhur në Testamentin (Dhiatën) e Vjetër është argument për këtë çështje që ne konstatuam. Dihet se edhe libri “Testament i vjetër” nuk ka shpëtuar nga falsifikimi, sikurse nuk kanë shpëtuar librat e “Testamentit (Dhiatës së Re) të ri” dhe të tjerë nga devijimi. Përveçse mund të thuhet se këta libra janë ruajtur në një farë mënyre me formën e tyre të vjetër.

Libri “Psalmet e Dautit” përbëhet nga njëqind e pesëdhjetë kapituj. Çdo kapitull quhet “psalm”, i cili nga fillimi deri në mbarim përfshin këshilla, udhëzime, lutje dhe përgjerime.

Transmetohet nga Ebu Dherri se ai e ka pyetur Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për numrin e Profetëve dhe ai i është përgjigjur se numri i tyre arrin në 124000. E pyeti se sa ka qenë numri i të dërguarve nga mesi i atyre Profetëve dhe ai iu përgjigj se numri i tyre është 313 të dërguar dhe të tjerët janë lajmëtarë. E pyeti Ebu Dherri edhe një herë tjetër për numrin e librave qiellorë dhe ai iu përgjigj se ata janë 104 libra qiellorë, dhjetë i janë shpallur Ademit, pesëdhjetë i janë shpallur Shitit, tridhjetë Idrizit, dhjetë i janë shpallur Ibrahimit, të gjithë këta libra bëhen njëqind, dhe katër të tjerë janë: Teurati, Zeburi, Ungjilli dhe Kur’ani Famëlartë.

2- Me të vërtetë fjala *Eshat* është shumësi i fjalës *Sebete* dhe kuptimi i saj është grupacione të Beni izrailitëve. Por qëllimi në këtë ajet janë Profetët që janë dërguar nga këto grupacione.¹

3- Zbritja e Revelatës Profetëve ka qenë në forma të ndryshme. Nganjëherë u zbriste me anë të melekut, i cili është i obliguar për këtë mision, nganjëherë u zbriste me ndërmjetësimin e inspirimit të zemrës dhe një herë tjerët u zbriste në formën e zërit që e dëgjonte Profeti . Që do të thotë se All'llahu krijon valë zanore në hapësirë apo në trupa dhe atë e dëgjojnë Profetët e Tij. Me këtë ndërmjetësim kryhej bashkëbisedimi mes tyre dhe All'llahut të Lartësuar.

Ai i cili ka patur fatin e bashkëbisedimit me All'llahun e Lartësuar është Profeti Musa i biri i Imranit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Ai e dëgjonte zërin herë nga pema e *Uadil Ejmen* dhe nganjëherë në malin Tur.

Për këtë ky Profet është emërtuar me emërtimin *Kelijmull'llah*, që do të thotë "*Folësi me All'llahun*." Ndoshta përmedja e emrit të Profetit Musa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në ajetet e fundit në formën më spikatëse është për të shpjeguar këtë veçori dalluese, me të cilën është dalluar Profeti Musai nga të gjithë Profetët e tjerë të All'llahut të Lartësuar.²

¹ Eshatet janë përmendur me detaje në fundin e ajetit 136 të sures Bekare" të këtij komentimi.

² Tefsiri "Mexhmaul Bejjan".

Ajetet 167 - 169

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا وَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ قَدْ ضَلُّوا ضَلَالًا بَعِيدًا
 إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا وَظَلَمُوا لَمْ يَكُنِ اللَّهُ لِيَغْفِرَ لَهُمْ وَلَا لِيَهْدِيَهُمْ
 طَرِيقًا إِلَّا طَرِيقَ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ۚ وَكَانَ ذَلِكَ عَلَى
 اللَّهِ يَسِيرًا

"Me të vërtetë, ata që kanë mohuar dhe kanë larguar njerëzit nga rruga e All'Ilahut, ata kanë humbur larg prej udhës së drejtë."

"Ata që nuk besojnë dhe bëjnë padrejtësi, All'Ilahu nuk i fal, as nuk do t'i udhëzojë në kurrfarë rruge."

"Përveçse drejt rrugës së Xhehennemit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Dhe kjo për All'Ilahun është e lehtë."

Komentimi

Në ajetet e mëparshme u fol rreth besimtarëve dhe jobesimtarëve. Ndërsa në këto tri ajete flitet për një grup, i cili ka zgjedhur llojin me të keq të mohimit. Ata persona, në shtesë të devijimit dhe humbjes së tyre, garonin për të devijuar dhe për të çuar të tjerët në humbje. Me veprën e tyre ata i bënë padrejtësi vetes së vet dhe të tjerëve, sepse nuk ecën në rrugën e drejtë dhe nuk i lanë të tjerët të ecin në rrugën e drejtë.

Ky ajet i përshkruan ata se janë në humbje të largët ku thotë: **“Me të vërtetë, ata që kanë mohuar dhe kanë larguar njerëzit nga rruga e All’llahut, ata kanë humbur larg prej udhës së drejtë.”** Vallë, përse ata e kanë merituar këtë largim nga rruga e drejtë? Me të vërtetë, ata e kanë merituar këtë për shkak se i ftonin të tjerët për në rrugë të humbur. Ata e përzien mohimin e tyre me kokëfortësi dhe përshkruan rrugën e humbjes e të devijimit duke u larguar shumë nga rruga e drejtë.

Ndërsa ajeti tjetër tregon se ata që mohuan dhe bënë padrejtësi, si fillim ata i bënë padrejtësi të vërtetës përshkak të mosinteresimit të tyre për të vërtetën. Po ashtu, me këtë veprim i bënë padrejtësi vetes së tyre duke ia ndaluar kënaqësinë dhe ranë në grackën e humnerës. Ata u bënë padrejtësi edhe të tjerëve, duke i penguar për t’u drejtuar nga rruga e vërtetë. Ata kurrë nuk i përfshin falja e All’llahut dhe All’llahu kurrë nuk i udhëzon, vetëm se në rrugën e Xhehennemit. Ajeti thotë: **“Ata që nuk besojnë dhe bëjnë padrejtësi, All’llahu nuk i fal, as nuk do t’i udhëzojë në kurrfarë rruge, përveçse drejt rrugës së Xhehennemit.”** Ata do të qëndrojnë përgjithmonë në Xhehennem, siç thotë ajeti: **“ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”**

Është detyrë që ata ta dinë se premtimi i All'Ilahut është i vërtetë dhe se kërcënimi i Tij do të realizohet pa asnjë mëdyshje dhe kjo nuk është e vështirë për All'Ilahun. Ajeti thotë: **“Dhe kjo për All'Ilahun është e lehtë.”**

Në këto dy ajete vërejmë një përforsim të një lloji të veçantë rreth këtij grupi prej mohuesve si dhe ndëshkimet që do të marrin. Nga njëra anë e përshkuan devijimin e tyre me humbje të largët dhe nga ana tjetër, ajeti me përdorimin e shprehjes **“All'Ilahu nuk”**, përforcon se falja ndaj atyre mohuesve nuk përputhet me pozitën e All'Ilahut të Lartësuar.

Nga ana tjetër ka ardhur përforsimi se ata janë të përhershëm në zjarr dhe nuk do të dalin prej tij sepse të tillë njerëz në shtesë të devijimit dhe të daljes së tyre nga rruga drejtë ata garuan për largimin dhe devijimin e të tjerëve nga kjo rrugë dhe për këtë mbajnë përgjegjësi dhe mbartin mëkat të madh.

Ajeti 170

يَأْتِيهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمْ الرَّسُولُ بِالْحَقِّ مِنْ رَبِّكُمْ فَتَأْمِنُوا خَيْرًا
لَكُمْ وَإِنْ تَكْفُرُوا فَإِنَّ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ ۚ وَكَانَ اللَّهُ

عَلِيمًا حَكِيمًا

“O njerëz! I Dërguari ju ka sjellë të vërtetën nga Zoti juaj, prandaj besoni, se për ju është më mirë! E në qofte se nuk besoni, ta dini se All’llahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. All’llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.”

Komentimi

Ajetet e mëparshme sqaruan përfundimin dhe ndëshkimin e njerëzve jobesimtarë. Kurse ajeti në fjalë bën thirrje për besim dhe qartëson rezultatin e këtij besimi. Për t'i nxitur njerëzit në këtë qëllim të lartë ajeti përdor shprehje dhe fjalë që ngjallin dëshirë dhe shtytje drejt besimit.

Ky ajet në fillim tregon se Profet i dërguar është ai të cilin e kanë pritur njerëzit që të shprehin besimin e tyre dhe kjo është ajo ç’ka kanë treguar librat e mëparshëm qiellorë, që ata mbartin legjislacionin e së vërtetës dhe së drejtës, ku All’llahu i Lartësuar thotë: **“O njerëz, i Dërguari ju ka sjellë të vërtetën.”**¹

¹ Disa transmetime të ardhura nga burimet e Ehli Bejtit se fjala *e vërtetë* në këtë ajet ka për qëllim udhëheqjen, që pas Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i takon Ali ibn Ebi Talibit, shih tefsirin “Usulul Kafij”, vëll. 1, f. 424. Tefsiri “Nurul Thakalejn”, vëll. 1, f. 576.

Pastaj, ajeti përsërit po të njëjtën gjë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ju ka ardhur nga ana e All'llahut të Lartësuar, i cili ka për qëllim të edukojë krijesat në përgjithësi dhe kjo tregohet rreth kësaj fraze kur'anore, që ka ardhur në këtë ajet: **“nga Zoti juaj.”**

Pas kësaj, ajeti vërteton dhe përforcon se dobia e besimit u kthehet njerëzve. Pra, nëse njeriu beson, ai i shërben vetes së tij përpara se t'u shërbejë të tjerëve. Ajeti thotë: **“Prandaj besoni, se për ju është më mirë.”**

Gjithashtu, në fund, ky ajet përforcon se kush ndjek rrugën e mosbesimit, nuk i bën dëm All'llahut të Lartësuar me veprën e tij, sepse All'llahu posedon çfarë ka në qiell e çfarë ka në Tokë dhe Ai nuk ka nevojë për asgjë dhe për askënd. Për këtë ajet thotë: **“E në qoftë se nuk besoni, ta dini se All'llahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë.”**

Në mbyllje ajeti tregon se rregullat dhe urdhrat e All'llahut të Lartësuar janë të gjitha në dobi të njerëzimit, sepse ata burojnë nga urtësia dhe dija e All'llahut, që është e ngritur mbi baza për të realizuar dobite të njerëzve. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“All'llahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.”**

Nga ky këndvështrim vërejmë se ajo çfarë ka dërguar All'llahu prej legjislacioneve është për të sistemuar shoqërinë njerëzore me ndërmjetësimin e Profetëve dhe se All'llahu absolutisht nuk ka nevojë për ato ligje. Ato ligje burojnë nga urtësia dhe dija e Tij. Pas këtij sqarimi, a kanë të drejtë njerëzit që të largohen nga rruga e besimit dhe të ndjekin rrugën e mohimit?!

Ajeti 171

يَأْهَلِ الْكِتَابِ لَا تَغْلُوا فِي دِينِكُمْ وَلَا تَقُولُوا عَلَى اللَّهِ إِلَّا
 الْحَقَّ ۚ إِنَّمَا الْمَسِيحُ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ رَسُولُ اللَّهِ وَكَلِمَتُهُ
 أَلْقَاهَا إِلَى مَرْيَمَ وَرُوحٌ مِنْهُ ۖ فَآمِنُوا بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ ۖ وَلَا تَقُولُوا
 ثَلَاثَةٌ ۚ أَنْتَهُوا خَيْرًا لَّكُمْ ۚ إِنَّمَا اللَّهُ إِلَهُ وَاحِدٌ ۖ سُبْحَانَهُ أَنْ
 يَكُونَ لَهُ وَلَدٌ ۚ لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۚ وَكَفَى بِاللَّهِ
 وَكِيلًا ﴿١٧١﴾

“O ithtarët e Librit! Mos e kaloni kufirin në besimin tuaj dhe për All’llahun thoni vetëm të vërtetën! Mesihu - Isai, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i All’llahut dhe Fjala e Tij, të cilën ia ka dërguar Merjemes, si dhe shpirt (i krijuar) nga Ai. Pra, besojini All’llahut dhe të dërguarve të Tij! Dhe mos thoni: ‘Tre zota!’ Hiqni dorë, se është më e mirë për ju! All’llahu është vetëm Një Zot - qoftë lavdëruar Ai! Ai është tepër i Lartësuar për të pasur fëmijë. E Tij është gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. All’llahu mjafton për rregullim të drejtësisë.”

Komentimi

Lejenda imagjinare e trinitetit

Ky ajet dhe ajeti në vijim (172) bëjnë fjalë për një nga devijimet më të rëndësishme të grupit të krishterë, dhe ky devijim është besimi i tyre në trinitet, që do të thotë se ekzistojnë tre zota. Ky ajet në fillim i paralajmëron ithtarët e Librit nga ekzagjerimet dhe devijimet në fenë e tyre dhe u bën thirrje atyre që të mos thonë ndaj All'Ilahut veçse të vërtetën ku thotë: **“O ithtarët e Librit! Mos e kaloni kufirin në besimin tuaj dhe për All'Ilahun thoni vetëm të vërtetën!...”**

Çështja e ekzagjerimit në të drejtën e udhëheqësve të mëparshëm ka qenë një nga burimet e devijuara më të rrezikshme në fetë qiellore. Meqenëse njeriu anon kah vetvetja, me këtë anim ai nxitet që t'i paraqesë udhëheqësit dhe drejtuesit e tij më të mëdhenj se sa janë. Për të përçuar në veten e tij madhësinë dhe rëndësinë nëpërmjet atyre udhëheqësve, ka mundësi që njeriu të imagjinojë kotësisht se besimi është ekzagjerim dhe teprim në respektimin dhe nderimin e udhëheqësit. Me këtë veprim ai bie në devijim.

Ekzagjerimi dhe teprimi (*el guluu*) në origjinalitet përmban një të keqe të madhe dhe shkatërron elementin bazë të fesë, që është adhurimi i All'Ilahut të Lartësuar e të Pashoq dhe Njësimit e Tij. Për këtë arsye, Islami ka vepruar me ekzagjeruesit dhe tepruesit me ashpërsi. Në librat e jurisprudencës (*fikhut*) dhe të besimit (akaidit) ky grup njerëzish njihen si jobesimtarët më të ashpër se të tjerët.

Pas kësaj, ajeti tregon disa pika të rëndësishme, ku gjithsecila prej tyre në brendësinë e vet tregon argumentin për iluzionin e gabuar të trinitetit dhe mosvërtetësinë e hyjnizimit të Isait - Mesisë (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) dhe këto pika janë:

1- Ky ajet ka përkufizuar se Mesihu i biri i Merjemes është Profet, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Mesihu - Isai, i biri i Merjemes është vetëm i Dërguari i All'llahut ..."** duke treguar për profecinë e hazreti Isait. Kjo ka ardhur në 16 vende të Kur'anit Famëlartë.¹

Kjo tregon se Mesihu, pra Profeti Isa, është njeri si të gjithë njerëzit, është krijuar në barkun e nënës së tij, ka kaluar etapa e zhvillimit në mitrën e saj dhe i ka hapur sytë në këtë botë kur ka lindur nga barku i Merjemes së pastër (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!), sikurse lindin të gjithë njerëzit nga barku i nënave të tyre. Ai ka kaluar periudhën e gjidhënies dhe është rritur e edukuar në prehërin e nënës së tij. E gjitha kjo tregon se ai zotëron të gjitha cilësitë e njeriut. Atëherë, pas kësaj që u tha, si mundet që Mesihu të jetë Zot, ndërkohë që në ekzistencën e tij është i gjykuar nga fenomenet dhe ligjet materiale natyrore dhe ndikohet nga ndryshimet që ndodhin në këtë botë ekzistuese?! Dhe shprehja "*innema*", e cila ka ardhur në këtë ajet, kufizon dhe përcakton se Mesihu (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) është i biri i Merjemes. Ajo përforcon se edhe nëse ai nuk ka pasur baba kjo nuk do të thotë se baba i tij është All'llahu, porse ai është vetëm i biri i Merjemes.

2- Ajeti garanton se Mesihu (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) është i Dërguari i All'llahut dhe i dërguar te njerëzit nga ana e Tij

¹ El Bekare 87,153. Al Imran 45. En Nisa 157,171. El Maide 46,78,110,112,114,116. Merjem 34. El Ahzab 7. El Hadid 27. Es Saff 6,14.

dhe se grada e tij, sigurisht grada e profetësisë, nuk përshtatet me pozitën hyjnore.

Është e vlefshme të kujtojmë se fjalët e Mesihut (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!), një pjesë e të cilave në Ungjijtë që gjenden sot në mesin e njerëzve, tregojnë vetëm e vetëm profecinë dhe dërgimin e tij për udhëzimin e njerëzimit – dhe nuk ka argument për supozimin e tij hyjnor dhe Zot.

3- Ajeti sqaron se Isai (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) është fjala e All'llahut, të cilën ia ka frymëzuar Merjemes. Ajeti thotë: **“...dhe fjala e tij të cilën ia ka dërguar Merjemes...”**. Fjala *kelimetun*, do të thotë *fjalë*, me të cilën përshkruhet hazreti Isai, dhe kjo është përmendur në disa ajete kur'anore. Kjo tregon se Profeti Isa është krijesë njerëzore, se fjalët janë të krijuara nga ana e All'llahut, sikurse janë të gjitha krijesat në univers të krijuara nga ana e All'llahut. Ashtu sikurse fjalët shpjegojnë sekretin dhe të fshehtën tonë, se jemi njerëz, gjithashtu, tregon cilësitë, moralet dhe reagimet tona njerëzore. Në të vërtetë, krijesat e universit flasin apo tregojnë qartë cilësitë e Krijuesit të tyre dhe ata gjithashtu tregojnë për bukurinë dhe madhësitinë e All'llahut të Lartësuar.

Duke u bazuar në këtë, shprehja *kelimetun*, që do të thotë *fjalë*, ka ardhur në disa ajete kur'anore për të përfshirë të gjitha krijesat e All'llahut, njësoj si në ajetin 109 të sures “Kehf” dhe në ajetin 29 të sures “Lukman”. Është e natyrshme se fjalët e All'llahut ndryshojnë nga njëra-tjetra në grada dhe në vendosmëri, dhe Isai konsiderohet si një nga fjalët e qarta e të rëndësishme të All'llahut, sepse ai është krijuar pa baba, duke pasur parasysh se ai gëzon gradën e Profetit të All'llahut.

4- Ajeti tregon se Isai është shpirt (frymëzim) i krijuar nga All'llahu. Ajeti thotë: **“...Si dhe shpirt (i krijuar) nga Ai...”** Kjo

shprehje, e cila ka ardhur në çështjen e krijimit të Ademit (Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!) ose thënë ndryshe në krijimin e gjithë njerëzimit, tregon madhështinë e atij shpirti, të cilin e ka krijuar All'Ilahu dhe e ka vendosur tek të gjithë në formë të përgjithshme dhe tek Isai dhe të gjithë Profetët e tjerë në mënyrë të veçantë.

Disa e kanë keqpërdorur këtë shprehje dhe kanë komentuar se Mesihu është pjesë nga All'Ilahu i Lartësuar, duke u mbështetur në shprehjen *minhu*, që do të thotë “nga Ai”, por ajo që është e qartë se në këto raste fjala “min”, që do të thotë “nga” nuk tregon pjesëzim, por tregon burimin, formimin dhe origjinën e ekzistencës së diçkaje.

Në një ndodhi interesante historike thuhet se Harun Rashidi ka pasur një doktor të krishterë, i cili një ditë ka diskutuar me Ali ibn Husejn El Uakidij, një ndër mendimtarët e Islamit në atë kohë. Doktor i krishterë i tha: “Në librin tuaj qiellor gjendet një ajet që tregon se Isai (Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!) është pjesë nga All'Ilahu” dhe lexoi këtë ajet. El Uakidij iu përgjigj duke lexuar ajetin 13 të sures “El Xathije”, ku All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej e në Tokë, të gjitha janë prej Tij.”** Dhe i qartësoi se fjala *min*, që do të thotë *nga*, nëse do të kishte kuptimin e pjesëzimit, atëherë të gjitha krijesat e qiellit dhe të tokës, sipas këtij ajeti, janë pjesë nga All'Ilahu. Kur e dëgjoi doktor i krishterë këtë fjalë nga El Uakidij e pranoi menjëherë Islamin.

Edhe Haruni u gëzua për Islamin e tij dhe e shpërbleu El Uakidijun me një shpërblim të përshtatshëm.

Çfarë është e habitshme se të krishterët e shohin lindjen e Mesisë (Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!) me nënë dhe pa baba si argument për hyjnizimin e tij dhe harrojnë se Ademi (Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!) është lindur pa baba dhe pa nënë dhe

asnjëri nuk e shikon këtë veçori dalluese tek Ademi si argument për hyjnizimin e tij.

Pas kësaj, ajeti përforcon domosdoshmërinë e besimit në All'llahun e Vetëm e të Pashoq, në Profetët e Tij dhe heqjen dorë nga besimi në trinitet, duke i përgëzuar besimtarët se kjo do të jetë një mirësi e madhe. Ajeti thotë: **"...Pra, besojini All'llahut dhe të Dërguarit të Tij! Dhe mos thoni: 'Tre zota!' hiqni dorë, se është më mirë për ju!..."**

Ajeti përsërit përforcimin e njëshmërisë së All'llahut, ku thotë: **"...All'llahu është vetëm Një Zot..."** Ai u drejtohet të krishterëve, se ata kur bëjnë thirrje në trinitet përsëri e pranojnë njësinë e All'llahut. Por, sikur All'llahu të kishte fëmijë do të ishte e domosdoshme që fëmija t'i ngjante të atit. Ky rast mohon parimin bazë të Njehsimit të All'llahut të Lartësuar.

Si është e mundur që All'llahu të ketë fëmijë dhe Ai është i pastër dhe pa të meta që të ketë nevojë për grua ose fëmijë? Gjithashtu, Ai është i pastër nga trupëzimi? Ajeti thotë: **"...Qoftë lavdëruar Ai! Ai është tepër i Lartësuar për të pasur fëmijë..."** All'llahu është Ai i cili posedon çdo gjë që ndodhet në qiej e në Tokë dhe të gjitha krijesat janë të krijuara nga Ai. Edhe hazreti Isai (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) gjithashtu është një nga krijesat e All'llahut të Lartësuar. Atëherë, si mundet të pretendohet kjo veçori tek ai? A është e mundur që i sunduari dhe i krijuari të jetë fëmijë i sunduesit dhe i Krijuesit?! Duke e përforcuar këtë gjë, ajeti thotë: **"... e Tij është gjithçka që gjendet në qiej e në Tokë..."** All'llahu është Ai i cili i drejton çështjet. Ai është ruajtësi, Furnizuesi, dhe Mbrojtësi për të gjitha krijesat e Tij, ku thotë: **"... All'llahu mjafton për rregullsinë e gjithësisë."**

E vërteta është se All'llahu nuk ka fillim dhe nuk ka mbarim, është i Përhershëm, i ruan të gjitha krijesat që nga fillimi (zanafilla

e krijimit) e deri në mbarim, Ai nuk ka nevojë për fëmijë. A mund të jetë Ai si njerëzit që të ketë nevojë për fëmijë që ta zëvendësojë atë pas vdekjes?!

Hulumtime

Doktrina e trinitetit është bestytia më e madhe e krishterimit

Nuk ka devijim më të madh, në të cilin është implikuar bota e krishterë, se sa devijimi i doktrinës (besimit) së trinitetit, sepse me të vërtetë të krishterët besojnë singerisht në trinitetin hyjnor. Në të njëjtën kohë thonë se All'llahu është Një! Pra, ata e shohin të vërtetën në trinitet dhe në monoteizëm si një të vetme. Kjo çështje - e cila ka dy anë të kundërta - ka krijuar një problem të madh tek mendimtarët dhe hulumtuesit e krishterë.

Sikur të krishterët të ishin të gatshëm për të pranuar çështjen e Njehsimit të All'llahut, se ajo është "figurative" dhe pranimin e çështjes së trinitetit se është e vërtetë, apo e kundërta, do të ishte i mundur shfajësimi i kësaj çështjeje, por ata e shohin të vërtetën në bashkimin e këtyre dy të kundërtave. Ata thonë se tre janë një, sikurse thonë po në të njëjtën kohë se një është tre.

Çfarë vërehet në pretendimet e tyre që gjenden në shkrimet misionare të krishterimit kohët të fundit, të cilët ua shpërndajnë njerëzve të painformuar dhe injorantë, është se triniteti është diçka figurative, por në të vërtetë është diçka e mbushur me hipokrizi dhe absolutisht nuk përshtatet me burimet themelore të krishterimit, sikurse nuk përputhet me besimet e vërteta të inteligjencës se krishterë.

Ky pretendim i të krishterëve nuk pajtohet me logjikën. Ekuacioni që ata supozojnë se $1=3$ nuk e pranojnë as fëmijët që

janë në shkollat fillore. Për këtë ata thonë se kjo çështje nuk matet me matje logjike dhe thonë se bindja ndaj kësaj çështjeje arrihet me anë të asaj që ata e quajnë "shikim të adhurimit të zemrës."

Ky kundërshtim ka lindur si pasojë e largimit të ndodhur tek ata mes fesë dhe arsyes. Shkaku i kësaj është se ata e kanë çuar fenë në këtë konfuzitet të rrezikshëm, gjë që i detyroi ata të thonë se feja nuk ka lidhje me mendjen ose në fe nuk ka natyrë të logjikuari dhe ajo është veçse urdhër që duhet të zbatohet. Pra, çfarë t'u thuhet njerëzve atë të bëjnë dhe të mos mendojnë e as të logjikojnë. Kjo është baza e kundërshtimit midis fesë dhe shkencës në logjikën e krishterimit. Dija gjykon se tre nuk janë të barabarta me një, kurse të krishterët e sotëm këmbëngulin se janë të barabarta!

Rreth këtij besimi të krishterë duhet të shqyrtojmë disa pika:

1- Asnjë nga Ungjijtë që sot janë në përdorim nuk tregojnë për çështjen e trinitetit. Për këtë studiuesit e krishterë besojnë se burimi i trinitetit është i fshehtë e jo i qartë. Në këtë fushë, studiuesi amerikan Haks thotë: *'Çështja e trinitetit, në Dhiatën e vjetër dhe në Dhjatën e re, konsiderohet çështje e fshehur dhe jo e qartë.'*¹

Historianët tregojnë se çështja e trinitetit është shfaqur pas shekullit të tretë pas lindjes së Mesisë (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!). Burimi i kësaj risie, nga njëra anë ka qenë ekzagjerimi dhe teprimi (el guluu) dhe nga ana tjetër, përzierja e të krishterëve me popuj të tjerë. Disa supozojnë se burimi i trinitetit tek të krishterët rrjedh nga besimi i trinitetit të hinduve, pra, tek adhurimi i tre zotave tek hindutë.²

2- Me të vërtetë, çështja e trinitetit, tre në një, konsiderohet si një çështje e papranuar logjikisht dhe atë e refuzon mendja pa

¹ El Kamusul Mukades, f. 345.

² Shih Dairetul Mearif li karnil ashrijn, i Ferijid el Uuxhdij, lënda "thaluth".

hezitim. Gjëja e vetme që ne dimë, është se feja nuk mund të jetë e ndarë nga logjika dhe nga dija. Dija e vërtetë dhe feja e saktë, të dyja bashkë, janë gjithmonë në përshtatje me njëra-tjetrën dhe në raport të drejtë me njëra-tjetrën. Nuk mund të pranohet thënia se feja është vetëm adhurim, sepse nëse ne e lemë mendjen në një anë për pranimin e bazave fetare dhe do t'i bindeshim një adhurimi të verbër dhe të shurdhë t, atëherë nuk do të bënim dallimin mes feve të ndryshme.

Në këtë rast, cili është argumenti që e detyron njeriun për të adhuruar All'llahun dhe për të mos adhuruar idhujt? Cili është argumenti që të krishterët ftojnë në fenë e tyre dhe jo në ndonjë fe tjetër?

Nga ky këndvështrim, veçoritë të cilat i shohin të krishterët në fenë e tyre dhe këmbëngulin që njerëzit t'i pranojnë kur predikojnë, kjo është në vetvete argument se feja duhet të njihet e të pranohet logjikisht dhe kjo bie në kundërshtim me thirrjen e tyre me thirrjen e tyre rreth çështjes së trinitetit, në të cilën ata e mendojnë se feja është e ndarë nga logjika. Nuk ka fjalë më të keqe që mund të shkatërrojë fenë se sa të thuhet se feja nuk zotëron natyrë logjike, por ajo ka vetëm natyrë të pastër adhurimi.

3- Me të vërtetë, argumentet e shumta të cilat dëshmojnë Njehsimin e All'llahut dhe konstatimin e Teuhidit të Tij, refuzon çdo lloj dytësimi apo triniteti. All'llahu i Lartësuar është ekzistenca absolute dhe nuk kufizohet nga anët. Ai është i Përhershëm, i Pari pa fillim dhe i Fundit pa mbarim. Dija dhe fuqia e Tij janë absolute dhe të pakufizuara.

Është e pakundërshtueshme se nuk mund të imagjinohet dyzim në të pakufizuarat, sepse supozimi i ekzistencës së dy të pakufizuarve çon në atë që ekzistenca e të parit ka nevojë për fuqinë e ekzistencës së të dytës, sikurse ekzistenca e së dytës ka

nevojë për ekzistencën dhe veçoritë e së parës. Duke u bazuar në këtë, secila nga këto të dy ekzistenca janë të kufizuara. Thënë ndryshe: Nëse ne supozojmë ekzistencën e dy të pakufizueshmeve nga të gjitha anët, atëherë kur arrin e pakufizuara e parë te mjedisi i të pakufizuarës së dytë patjetër që kjo përfundon në atë cak. Po ashtu, kur e pakufizuara e dytë arrin cakun e të pakufizuarës së parë, ajo gjithashtu përfundon. Bazuar në këtë, të dyja këto janë të kufizuara dhe tek asnjëra nuk vërtetohet cilësia e të pakufizuarës por ato janë që të dyja të kufizuara dhe jo absolute. Rezultati i kësaj është se Veta e All'llahut, i Cili është Ekzistenca absolute, nuk pranon kurrë shumësi, sepse Ai është Një i Vetëm dhe i Pashoq.

Po kështu, nëse ne pranojmë që ekzistenca e All'llahut përbëhet nga tre hyjni, nuk duhet që gjithsecili nga këta tre hyjni të jetë i kufizuar dhe nuk ë shtë e drejtë që ato të cilësohen të pakufizuara dhe të pafundme. Po ashtu, çdo përbërës në formimin e tij ka nevojë për pjesët e tij me të cilat është formuar. Pra, prania e të formuarit është shkak i pranisë së pjesëve të tij.

Nëse ne supozojmë përbërjen në Vetën e All'llahut, atëherë duhet që kjo vetë të jetë nevojtare ose pasojë e një shkakut të mëparshëm. Ndërkohë që ne e dimë se All'llahu nuk ka nevojë për asgjë dhe Ai është shkak kryesor i ekzistencës së mbarë gjithësisë dhe shkak i të gjitha shkaqeve që në fillim e deri në pafundësi.

4- Duke pasur parasysh gjithçka që treguam më lart, si është e mundur që ekzistenca e All'llahut të trupëzohet në strukturën njerëzore, për t'u bërë i nevojshëm për trup dhe vend, ushqim dhe veshje e të tjera si këto?

Supozimi i kufizimit të All'llahut, që është i Pari pa fillim dhe i Fundit pa mbarim, apo trupëzimi i Tij në strukturën njerëzore dhe vendosja e Tij foshnje në barkun e nënës

konsiderohen prej trillimeve dhe shpifjeve më të shëmtuara që i mvishen Vetës së shenjtë të All'llahut, e cila është e pastër nga çdo mangësi. Po ashtu, supozimi se All'llahu ka djalë, është një supozim jologjik dhe është absolutisht larg çdo logjike të shëndoshë. Kjo për faktin se çdo njeri që nuk është rritur në një ambient të krishterë dhe nuk është edukuar që në fëmijërinë e tij me këto mësimë hamendësuese e të gabuara, kur dëgjon këto përshkrime, që janë në kundërshtim me natyrën njerëzore dhe në kundërshtim me atë çfarë gjykon mendja e njeriut, do të ndiejë përçmim dhe neveri. Nëse të krishterët nuk shikojnë ndonjë gjë të keqe në fjalët në "All'llahu - ati", "All'llahu - biri", kjo është përshkak se ata janë brumosur me këto mësimë të gabuara që kur ata i ishin fëmijë të vegjël.

5- Është verifikuar kohët e fundit se një grup prej misionarëve të krishterë mbështeten në shembuj të shtrembruar e të pavërtetë për t'i mashtruar njerëzit injorantë e të paditur që të pranojnë çështjen e trinitetit. Dhe nga këta shembuj, fjala e tyre se bashkimi i njësimit me trinitetin së bashku mund të ngjasojnë me një disk dielli, ku drita dhe nxehtësia burojnë nga ky disk, dhe ata janë tre gjëra në një gjë të vetme.

Ose shembëlltyra e tyre me reflektimin e pamjes së njeriut në tri pasqyra në të njëjtën kohë, dhe ky njeri është po një i vetëm, përveçse ai duket, sikurse me qenë tre persona në tre pasqyra. Ata gjithashtu e ngjasojnë trinitetin me trekëndëshin, i cili ka tri kënde nga jashtë dhe thonë se nëse këto tri kënde shtrihen nga brenda, dhe të gjithë do të arrinin në një pikë të vetme?!

Nëse do të përqendroheshim pak në këto shembuj do të na qartësohej se nuk kanë lidhje aspak me temën tonë. Disku i diellit është një gjë, drita e tij është gjë tjetër, drita nga e cila përbëhen rrezet sipër së kuqes (ultravjollcë) ndryshon nga nxehtësia, e cila

përbëhet nga rrezet jo të kuqe dhe këto tri gjë ra ndryshojnë nga njëra-tjetra nga pikëpamja shkencore, dhe sipas pikëpamjes shkencore të gjitha këto së bashku nuk janë një gjë e vetme. Nëse kjo fjalë është e vërtetë se ato tri gjë ra janë një e përbashkët, në të vërtetë ajo mund të jetë veçse tolerim ose përshkimit figurativ dhe asgjë tjetër.

Më e qartë se kjo është shembulli i trupit dhe i tri pasqyrave, sepse pamjet e trupit që shihen në pasqyra nuk janë gjë tjetër përveçse reflektim i dritës. Është e pakundërshtueshme se reflektimi i dritës nga një trup i caktuar nuk është i njëjti trup. Bazuar në këto, nuk gjendet asnjë unifikim mes trupit dhe pamjes së tij që reflekton në pasqyrë. Këtë çështje e kupton edhe nxënësi fillestar i shkencës së fizikës.

Ndërsa në shembullin e tretë, çështja është e qartë sikurse në dy shembujt e mëparshëm ku këndet nuk kanë lidhje me zgjatimin e brendshëm që ndodh në këto tri kënde që i çon të gjithë në një pikë të vetme.

Ajo që të habit më shumë është përpjekja e disa të krishterëve orientalistë për të përshtatur çështjen e “njësimit në trinitet” me teorinë e panteizmit, të cilën e thonë edhe disa sufistë. Çështja në këtë fushë është e qartë dhe nuk ka nevojë për argument. Sikur të pranojnë teorinë e gabuar dhe të devijuar të panteizmit, kjo do të na obligonte që të bindemi se çdo krijesë në botë apo në univers është pjesë nga Veta e All'Ilahut të Lartësuar. Jo vetëm kaq, por do të bindeshim se ato janë vetë Veta e All'Ilahut.

Atëherë nuk mbetet kuptim për trinitetin, por bëhen të gjitha krijesat, të vogla dhe të mëdha, pjesë e konstatimit të ekzistencës së All'Ilahut të Lartësuar, të Vetëm e të Pashoq. Bazuar mbi këtë, nuk mund të përputhet teoria e trinitetit të krishterimit me teorinë

e panteizmit në asnjë formë prej formave. Duhet ditur se kjo teori e sufistëve është hedhur poshtë dhe është dukur pavërtetësia e saj.

6- Disa të krishterë nganjëherë thonë se kur e emërtojnë (quajnë) Mesihun (Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!), me të birin e All'Ilahut, ata e bëjnë këtë sikurse veprojnë myslimanët në emërtimin e nipit të Profetit të All'Ilahut Husejn ibn Ali ibn Ebi Talib "thar All'Ilah ue ibn tharih" (dëshmor i All'Ilahut) dhe (i biri i dëshmorit)." Ose sikurse emërtimi, i cili ka ardhur në disa transmetime për Ali ibn Ebi Talib, "dora e All'Ilahut". Ata të krishterë e kanë komentuar fjalën "thar", që do të thotë shehid (dëshmor), se ajo fjalë do të thotë gjak. Në këtë mënyrë fraza e përmendur për Imam Husejnin, sipas komentimit të tyre: "gjaku i All'Ilahut dhe gjaku i biri i tij". Me të vërtetë, kjo çështje është vetë gabimi sepse:

Së pari: Arabët nuk e kanë përdorur asnjëherë fjalën "thar" me kuptimin gjak, por e kanë konsideruar fjalën "thar" vlerë për gjakun dhe për këtë kuptimi i kësaj shprehjeje është se All'Ilahu vlerëson gjakun Husejnit dëshmor dhe kjo çështje është dorën e Tij. Sigurisht që Husejni nuk ka qenë melek apo ndjekës i ndonjë fisi apo populli të caktuar për t'iu kërkuar atyre gjakun e tij, por ai është për mbarë botën dhe njerëzimin. Ai është pjesë e kësaj bote të krijuar nga All'Ilahut. Husejni është i biri i Ali ibn Ebi Talibit, i cili ka rënë shehid në rrugë të All'Ilahut dhe për këtë, All'Ilahu është Ai i cili e vlerëson gjakun e këtij shehidi.

Së dyti: Kur nganjëherë u thuhet disa të dashurve të All'Ilahut se janë "dora e All'Ilahut", me të vërtetë kjo shprehje është vetëm me kuptimin figurativ.

A ia lejon ndonjë i krishterë vetes së tij të thotë se shprehja "i biri Zotit" që thuhet për Mesihun ka kuptimi figurativ? Është e pakundërshtueshme se ai nuk e pranon këtë se burimet e krishtera

e kanë konsideruar cilësinë e birësisë së All'llahut të veçantë për Mesihun (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) dhe jo për tjetër kënd dhe e kanë konsideruar këtë cilësi të vërtetë dhe jo figurative. Ajo që thonë disa të krishterë se kjo cilësi nuk është me kuptim të vërtetë, por me kuptim figurativ, me të vërtetë këtë e thonë për të mashtruar mendjelehtët nga njerëzit.

Për sqarime më të shumta ne i rekomandojmë lexuesit që të lexojnë librin “Kamusul Mukades”, që do të thotë “fjalori i shenjtë” në lëndën “All'llah”, ku thuhet se shprehja “i biri i All'llahut” është një nga emërtimet e shpëtimtarit, flijuesit të të krishterëve dhe ky emërtim nuk i jepet ndonjë personi tjetër, vetëm argumente që sqarojnë se qëllimi nuk është i biri i vërtetë i All'llahut.¹

¹ El Kamusul Mukades, f. 345.

Ajetet 172 - 173

لَنْ يَسْتَنْكِفَ الْمَسِيحُ أَنْ يَكُونَ عَبْدًا لِلَّهِ وَلَا الْمَلَائِكَةُ الْمُقَرَّبُونَ
 وَمَنْ يَسْتَنْكِفَ عَنْ عِبَادَتِهِ وَيَسْتَكْبِرْ فَسَيَحْشُرُهُمْ إِلَيْهِ جَمِيعًا
 ﴿١٧٢﴾ فَأَمَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَيُوَفِّيهِمْ أُجُورَهُمْ
 وَيَزِيدُهُمْ مِّنْ فَضْلِهِ ۗ وَأَمَّا الَّذِينَ اسْتَنكَفُوا وَاسْتَكْبَرُوا
 فَيُعَذِّبُهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا وَلَا يَجِدُونَ لَهُم مِّن دُونِ اللَّهِ وَلِيًّا وَلَا
 نَصِيرًا ﴿١٧٣﴾

"Mesihu nuk do ta përbuzte kurrë që të ishte rob i All'Ilahut, as edhe engjëjt më të afërm. Ata që e shpërfillin dhe e nënçmojnë me arrogancë adhurimin ndaj Tij, All'Ilahu do t'i sjellë të gjithë para Vetes."

"Sa për ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Ai do t'ua plotësojë shpërblimin dhe do t'ua shtojë atë nga mirësitë e Tij. Por, ata që shpërfillin dhe mburren, do të dënohen me ndëshkim pikëllues. Ata nuk do të gjejnë për vete as mbrojtës dhe as ndihmës tjetër në vend të All'Ilahut."

Shkaku i zbritjes

Një grup komentuesish kanë transmetuar se ky ajet ka zbritur për një grup të krishterë nga Nexhrani kur ata vizituan Profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i kërkuan atij që të shpjegonte pse e kundërshton Profetin e tyre Mesihun (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i pyeti se për cilin kundërshtim bëhet fjalë. Ata i thanë: “Me të vërtetë, ti thua se Mesihu është rob i All'llahut dhe i dërguari i Tij...”. Atëherë zbritën këto dy ajete duke iu përgjigjur atyre.¹

Komentimi

Mesihu (Isai) është rob i All'llahut

Megjithëse këto dy ajete kanë një shkak zbritjeje të veçantë dhe që u përket vetëm atyre, mirëpo ato të dy janë vazhdim i ajeteve të mëparshme, të cilët folën për hyjnizimin e Mesihut. Dhe është e qartë lidhja e këtyre ajeteve me ajetet e mëparshme në hedhjen poshtë të pretendimit të trinitetit.

Në fillim, ajeti i parë, prej dy ajeteve në fjalë, tregon një argument tjetër për hedhjen poshtë të pretendimit të hyjnizimit të Mesihut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), i cili duke iu drejtuar të krishterëve u thotë: si besoni në hyjnizimin e Isait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ndërkohë që hazreti Isai nuk e ka përbuzur kurrë përluljen dhe adhurim e Tij? Po ashtu, ai nuk i përbuz kurrë

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 3, f. 250.

melekët që afrohen me këtë adhurim. Ajeti thotë: **“Mesihu nuk do ta përbuzte kurrë që të ishte rob i All’llahut as edhe engjëj më të afërt...”**

Është e pakundërshtueshme se ai që është rob nuk është e mundur që të bëhet i adhuruar në të njëjtën kohë. A është e mundur që njeriu të adhurojë vetveten? A është e mundur që në të njëjtën kohë të jetë rob dhe i adhuruar një?!

Në këtë kontekst disa komentues përcjellin një ngjarje interesante që tregon se Imam Ali ibn Musa Rizai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*), për të kundërshtuar dhe për të hedhur poshtë besimin e devijuar në trinitetit i ka thënë njërit prej të mëdhenjve të krishterë në atë kohë i cili emërtohej me pseudonimin “Xhathlijk” se Mesihu (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ka qenë i mirë në çdo gjë por ka patur një të metë në të që ishte adhurimi i tij i pakët. Kur dëgjoji këto fjalë Xhathlijku u zemërua dhe i tha Imam Rizait (*Paqja qoftë mbi të!*): “Sa i madh është gabimi që bëre! Vërtet, Isai (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ka qenë adhuruesi më i madh në kohën e vet.” Menjëherë Imami e pyeti “Cili ishte ai që ka adhuruar Mesihu?!” E sheh, ti vetë e pohove se Mesihu ka qenë rob dhe krijesë e All’llahut dhe se ai e ka adhuruar All’llahun dhe nuk ka qenë as zot dhe as i adhurur. Atëherë, Xhathlijku heshti dhe nuk i ktheu përgjigje.¹

Pas kësaj, ajeti tregon se ata që nuk e adhurojnë All’llahun dhe nuk i binden Atij me adhurim, nuk e bëjnë kë të (adhurimin) nga mendjemadhësia dhe egoizmi dhe se All’llahu do t’i ringjallë ata njerëz Ditën e Gjykimit dhe do ta dënojë gjithsecilin me ndëshkimin që ai meriton. Për këtë ajeti thotë: **“...Ata që e shpërfillin dhe e përçmojnë me arrogancë adhurimin ndaj Tij, All’llahu do t’i sjellë të gjithnjë para vetes.”**

¹ Menakib, i ibn Shehr Ashub, vëll. 4, f. 352.

Me të vërtetë, All'llahu i Lartësuar do t'i shpërblejë Ditën e Kiametit, të gjithë ata që kanë besuar dhe kanë kryer vepra të mira do t'u japë atyre shpërblimin e plotë pa asnjë mungesë dhe do t'u dhurojë atyre shumë mirësi. Ndërsa ata të cilët u bënë arrogantë, egoistë dhe nuk e adhuruan All'llahun, me të vërtetë ata do të marrin një ndëshkim të dhimbshëm e të rreptë dhe nuk do të gjejnë Ditën e Gjykimit për veten e tyre as shok e as mbrojtës që t'i mbrojnë, përveç All'llahut. Ajeti thotë: **"Sa për ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Ai do t'ua plotësojë shpërblimin dhe do t'ua shtojë atë nga mirësitë e Tij. Por, ata që shpërfillin dhe mburren, do të dënohen me ndëshkimin e pikëlluar. Ata nuk do të gjejnë për vete as mbrojtës dhe as ndihmës tjetër në vend të All'llahut."**

Dy hulumtime

Në këtë ajet ka dy pika të rëndësishme të cilat duhet të kihet vëmendja:

1- Me të vërtetë fjala *istinkafu* vjen me kuptimin *ndalim dhe pakënaqësi e madhe ndaj diçkaje*. Ajo ka kuptime të gjëra. Këtu i përkufizohet kuptimi, sepse pas saj ka ardhur fjala "**istekberu**" *u mburrën*, sepse ndalimi për adhurimin e All'llahut dhe refuzimi i përruljes ndaj Tij lind ose nga injoranca ose nga pavetëdija, dhe nganjëherë lind nga mburrja, egoizmi dhe mashtrimi. Megjithatë të dy llojet e mosadhurimit konsiderohen mëkat, mirëpo i dyti është shumë herë më i shëmtuar se i pari.

2- Ajeti përmban shprehjen e cila qartëson se melekët e afërt të All'llahut nuk e shpërfillin adhurimin e Tij. Kjo është një përgjigje për të krishterët, të cilët e bëjnë Zotin tre (Babë – bir - dhe shpirt i shenjtë) si dhe për të konstatuar Njehsimin e Vetës së

shenjtë të All'lahut të Madhëruar. Ka mundësi që ky ajet të jetë tregues për idhujtarinë, në të cilën kishin rënë arabët dhe për idhujtarinë në të cilën ishin implikuar të krishterët, sepse në kohën e xhahiletit (kohën e injorancës para ardhjes së Islamit), i konsideronin melekët bijtë e All'lahut të Lartësuar ose i konsideronin pjesë nga Ai. Dhe ky ajet ka ardhur që t'u përgjigjet atyre dhe të hedhë poshtë fjalët e tyre.

Nëse thellohem në këto dy çështje, do të na qartësohet se ajeti nuk ka ardhur për të treguar dallimin mes melekëve dhe Profetëve. Por ka ardhur vetëm për të kundërshtur dhe për të hedhur poshtë besimin në trinitet apo për të kundërshtuar besimin e idhujtarëve arabë që kishin për melekët. Në këtë ajet nuk gjendet asnjë argument për çështjen e përsosmërisë mes Mesihut dhe melekëve.

Ajetet 174 - 175

يَأْتِيهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَكُمْ بُرْهَانٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكُمْ نُورًا مُّبِينًا ﴿١٧٤﴾
فَأَمَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا بِاللَّهِ وَاعْتَصَمُوا بِهِ ۖ فَسَيَدْخُلُهُم فِي رَحْمَةٍ مِّنْهُ
وَفَضْلٍ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمًا ﴿١٧٥﴾

"O njerëz! Me të vërtetë, juve ju ka ardhur një provë bindëse (Muhammedi) nga Zoti juaj dhe ju është zbritur një Dritë e dukshme (Kur'ani)."

"Kështu, ata që besojnë All'llahun dhe mbështeten fort tek Ai, (ta dinë se) Ai do t'i fusë në mëshirën dhe mirësinë e Vet dhe do t'i udhëzojë drejt Vetes përmes rrugës së drejtë."

Komentimi

Drita e dukshme

Pasi ajetet e mëparshme trajtuan temën e devijimit të ithtarëve të Librit për sa i përket parimit të Njehsimit dhe mësimëve të Profetëve, këto dy ajete vijnë për të përfunduar thënien duke sqaruar rrugën e shpëtimit prej atyre devijimeve dhe bestytive.

Fillimisht, thënia u drejtohet të gjithë njerëzve, duke u sqaruar se All'llahu ka dërguar nga ana e tij Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili mbart argumente të qarta dhe ka dërguar me të dritën e dukshme (Kur'anin Famëlartë), i cili i udhëzon njerëzit në rrugën e lumturisë së përhershme. Ajeti thotë: "O njerëz! Me të vërtetë, juve ju ka ardhur një provë bindëse

(Muhammedi) **nga Zoti juaj dhe ju është zbritur një Dritë e dukshme (Kur'ani).**"

Disa dijetarë besojnë se fjala "burhan", që ka ardhur në këtë ajet, rrjedh nga fjala "berehe", që do të thotë bardhësi. Kur argumentet janë të qarta për dëgjuesin, sqarojnë të vërtetën, janë të ndriçueshme, të qarta e të bardha, për këtë janë quajtur me fjalën *burhan*.

Qëllimi me fjalën *burhan*, që ka ardhur në këtë ajet, sikurse e kanë thënë komentuesit, është Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe qëllimi me fjalën dritë është Kur'ani famëlartë, të cilin e kanë edhe ajetet e tjera, dhe ata gjithashtu, e quajnë Kur'anin "Dritë".

Edhe në hadithet e ndryshme të transmetuara nga Ehlil Bejti, të cilat kanë ardhur në tefsiret "Nurul Thekalejn", "Ali ibn Ibrahim" dhe "Mexhmaul Bejjan" thuhet qartë se "*burhan*" është Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe "*nur*" është Ali Ibn Ebi Talibi.¹

Ky komentim nuk bie në kundërshtim me atë që shpjeguam më parë, sepse fjala *nur*, mund të përdoret në kuptime të shumta ku përfshin "Kur'anin" dhe prijësin e besimtarëve Ali ibn Ebi Talibin, i cili konsiderohet ruajtës dhe komentues i Kur'anit.

Ajeti i dytë tregon përfundimin e pasimit të këtij burhani dhe të kësaj drite, duke vërtetuar dhe duke përforcuar se ata që besuan në All'llahun dhe u kapën fort pas këtij Libri qiellor, padyshim që All'llahu do t'i fusë në mëshirën e Tij të gjerë, do t'i shpërblejë me mirësinë e Tij dhe do t'i udhëzojë në rrugë të drejtë. Ajeti thotë: **"Kështu, ata që besojnë All'llahun dhe mbështeten fort tek Ai, (ta dinë se) Ai do t'i fusë në mëshirën dhe mirësinë e Vet dhe do t'i udhëzojë drejt Vetes përmes rrugës së drejtë."**

¹ Tefsir Mexhamul Bejan, vëll. 3, f. 252, fundi i ajetit në fjalë.

Ajeti 176

يَسْتَفْتُونَكَ قُلِ اللَّهُ يُفْتِيكُمْ فِي الْكَلَالَةِ ۚ إِنِ امْرُؤٌ هَلَكَ لَيْسَ لَهُ
 وَلَدٌ وَلَهُ أُخْتُ فَلَهَا نِصْفُ مَا تَرَكَ ۚ وَهُوَ يَرِثُهَا إِن لَّمْ يَكُنْ هَا
 وَلَدٌ ۚ فَإِن كَانَتَا اثْنَتَيْنِ فَلَهُمَا الثُّلَثَانِ مِمَّا تَرَكَ ۚ وَإِن كَانُوا إِخْوَةً
 رِّجَالًا وَنِسَاءً فَلِلذَّكَرِ مِثْلُ حَظِّ الْأُنثَيَيْنِ ۗ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ أَن
 تَضِلُّوا ۗ وَاللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿١٧٦﴾

"Ata kërkojnë nga ti (Muhammed) gjykim (për dikë që vdes pa pasur trashëgimtarë). Thuaju: 'All'illahu ju udhëzon juve për një njeri të tillë. Nëse një burrë vdes pa pasur fëmijë (dhe prindër), ndërkohë që ka një motër, atëherë asaj i takon gjysma e trashëgimisë. Në qoftë se një grua vdes pa pasur fëmijë (dhe prindër), atëherë vëllai i saj është i vetmi që do ta trashëgojë. Në qoftë se një burrë pa fëmijë (dhe prindër) ka dy motra, atëherë ato do të trashëgojnë dy të tretat e pasurisë; por, nëse ai ka edhe vëllezër edhe motra, atëherë mashkullit i takon trashëgim sa pjesa e dy femrave. Kështu All'illahu ju sqaron juve, në mënyrë që të mos humbisni. All'illahu është i Dijshëm për çdo gjë."

Shkaku i zbritjes

Shumë komentues të Kur'anit transmetojnë nga Xhabir ibn Abdullah el Ensarij, se ai vuante nga një sëmundje e rëndë. Një ditë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e vizitoi atë. Profeti mori abdes tek ai dhe e spërkati Xhabirin me ujin e abdesit. Xhabiri, i cili po mendonte për vdekjen, i përmendi Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se trashëgimtarët e tij janë vetëm motra. Ai i kërkoi Profetit që t'i shpjegonte se si do të ndahej pasuria ndërmjet tyre. Atëherë, zbriti ky ajet, i cili gjithashtu quhet "*ajeti i ndarjes së pasurisë*" dhe shpjegoi se si ndahet trashëgimia ndërmjet tyre. (Ky transmetim përmendet edhe në tefsiret: "Mexhmaul Bejjan", "Et Tibjan", "El Manar", "Ed Durul Menthur"...)

Disa besojnë se ky ajet është ajeti i fundit prej ajeteve të rregullave islame që i ka zbritur Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).¹

Komentimi

Ky ajet i lartpërmendur shpjegon sasinë e trashëgimisë për vëllezërit dhe motrat. Gjithashtu kjo (ndarja e trashëgimisë) përmendet në fillimin e sures "Nisa" - në komentimin e ajetit 12 të saj. Thamë se Kur'ani përmban dy ajete për të shpjeguar çështjen e trashëgimisë së vëllezërve dhe motrave. Njëri nga ato dy ajete ishte ajeti i 12 i sures "El Nisa" dhe ajeti i dytë është ajeti që po shpjegojmë, i cili është dhe ajeti i fundit i kësaj sureje.

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 3, f. 254. Tefsiri "Mijzan", vëll. 5, f. 154-155.

Megjithë ndryshimet që gjenden në dy ajetet përta i përket sasisë së trashëgimisë, mirëpo secili prej dy ajeteve flet për një lloj prej vëllezërve dhe motrave, sikurse e kemi shpjeguar në fillim të kësaj sureje.

Ajeti i parë është për vëllezërit dhe motrat të cilët janë nga një nënë e vetme dhe nga baballarë të ndryshëm.

Ndërsa ajeti i dytë, i cili është edhe i fundit i kësaj sureje, trajton çështjen e trashëgimisë së vëllezërve që janë nga një nënë dhe një baba, ose nga nëna të ndryshme dhe nga një baba.

Argumenti i kësaj thënies tonë është se kush ka lidhje me personin e vdekur me ndërmjetësim, sasia e trashëgimisë së tij është aq sa trashëgon ndërmjetësuesi me të vdekurin. Pra, vëllezërit dhe motrat, të cilët janë nga një nënë e vetme dhe me baballarë të ndryshëm, trashëgojnë sasinë e trashëgimisë së nënës së tyre, e cila është një e treta.

Ndërsa vëllezërit dhe motrat, të cilët janë nga një nënë dhe një baba ose nga një baba dhe nëna të ndryshme trashëgojnë aq sa sasia e baballarëve të tyre, e cila është dy të tretat.

Ajeti i dymbëdhjetë i sures "El Nisa" ka treguar për sasinë që është një e treta që trashëgojnë vëllezërit dhe motrat. Kurse ajeti i fundit i kësaj sureje trajton sasinë e dy të tretave. Për këtë, ne shohim se ajeti i mëparshëm është i posaçëm për vëllezërt dhe motrat, të cilët nuk janë të një gjaku, por kanë lidhje me të vdekurin nëpërmjet nënës së tyre. Ndërsa ajeti i fundit është i veçantë për vëllezërit e motrat që janë vëllezër të cilët kanë lidhje me të vdekurin nga rruga e babait ose e babait dhe e nënës.

Transmetimet e ardhura nga Imamët e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) në këtë fushë gjithashtu e vërtetojnë këtë të vërtetë.

Sido që të jetë, nëse sasia e vëllait ose e motrës është një e treta apo dy të treta, atëherë pjesa tjetër e trashëgimisë ndahet

sipas legjislacionit Islam ndërmjet pjesës tjetër të trashëgimtarëve. Dhe kështu pasi u shpjegua dhe u qartësua se nuk ekziston asnjë kundërshtim mes këtyre dy ajeteve, le të fillojmë në komentimin e rregullave që gjenden në këtë ajet të fundit të kësaj sureje.

Është e vlefshme që të tregohet se ky ajet ka ardhur për të shpjeguar trashëgiminë e vëllezërve dhe të motrave (el kelaletu)¹. Ajeti thotë: **"Ata kërkojnë nga ti (Muhammed) gjykim (për dikë që vdes pa pasur trashëgimtarë). Thuaju: 'All'illahu ju udhëzon juve për një njeri të tillë...'"** Pra, ata të pyesin ty o Muhammed dhe t'i lajmëroi ata se All'illahu i Lartësuar është Ai i Cili e cakton rregullën e trashëgimisë së vëllezërve dhe të motrave (el kelaletu).

Pas kësaj, ajeti tregon disa rregulla, të cilat janë:

1- Nëse personi vdes pa pasur fëmijë dhe ka një motër të vetme, atëherë kjo motër trashëgon gjysmën e pasurisë. Ajeti thotë: "...Nëse një burrë vdes pa pasur fëmijë (dhe prindër), ndërkohë që ka një motër, atëherë asaj i takon gjysma e trashëgimisë..."

2- E nëse vdes gruaja dhe ajo nuk ka fëmijë , por ka një vëlla të vetëm nga babai ose nga babai dhe nëna, atëherë ky vëllai i saj e trashëgon atë. Ajeti thotë: "...Në qoftë se një grua vdes pa pasur fëmijë (dhe prindër), atëherë vëllai i saj është i vetmi që do ta trashëgojë..."

3- Nëse vdes një person që ka vetëm dy motra, ato të dyja trashëgojnë dy të tretat nga trashëgimia e tij. Ajeti thotë: "...Në qoftë se një burrë pa fëmijë (dhe prindër) ka dy motra, atëherë ata do të trashëgojnë dy të tretat e pasurisë..."

4- Nëse numri i trashëgimtarëve të të vdekurit nga vëllezërit dhe motrat është më shumë se dy, atëherë trashëgimia e tij ndahet

¹ Për t'u njohur me kuptimin e fjalës "el kelaletu" dhe me shkakun e emërimit të vëllezërve dhe të motrave me këtë emërtim, shih fundin e ajetit 12 të sures "Nisa".

ndërmjet të gjithë pjesëtarëve ku pjesa e vëllait të jetë dy herë më shumë se pjesa e motrës. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"...por nëse ai ka vëllezër dhe motra, atëherë mashkullit i takon trashëgim sa pjesa e dy femrave."**

Dhe në mbyllje ajeti përforcon se All'Ilahu i Lartësuar ua shpjegon njerëzve këto të vërteta, për t'i ruajtur ata nga devijimi dhe humbja dhe u tregon atyre rrugën e vërtetë. Është mëse e vërtetë se rruga që vizaton All'Ilahu për njerëzit dhe i udhëzon në të, ajo është rruga e saktë dhe e vërtetë. Sigurisht, All'Ilahu është i Gjithëdituri për çdo gjë. Për këtë ajeti thotë: **"... kështu All'Ilahu ju sprovon juve, në mënyrë që të mos humbisni, All'Ilahu është i dijshtëm për çdo gjë."**¹

Këtu është e vlefshme që të tregohet se ajeti në fjalë tregon vetëm për sasinë e trashëgimisë që u takon vëllezërve dhe motrave, në rastin kur personi i vdekur nuk ka fëmijë. Ajeti nuk flet për praninë e babait dhe të nënës së personit të vdekur. Por duke u bazuar në ajetet që gjenden në fillim të sures "El Nisa", me të vërtetë, prindërit vijnë në shkallën e fëmijëve në grupin e parë të atyre që trashëgojnë. Prandaj, qartësohet se qëllimi i këtij ajeti të fundit është rast i mosekzistencës së fëmijëve dhe i prindërve të personit të vdekur.

Fundi i sures "En Nisa."

¹ Fjalja "*en tedil'lu*" ka kuptimin "*en la tedil'luu*". Këtu fjala "la" është e aluduar. Kur'ani dhe bisedat e oratorëve dhe letrarëve arab janë të mbushura me këto lloj fjalësh retorike.

Surja “El Maide”

Vendzbritja: Medine

Numri i ajeteve: 120

Me të vërtetë, kjo sure është e zbritur në Medine dhe quhet medinase, përbëhet nga 120 ajete dhe thuhet se ajo është zbritur pas sures “El Fet’h”. Transmetimet tregojnë se kjo sure është zbritur plotësisht në periudhën e Haxhit të lamtumirës ndërmjet Mekës dhe Medinës.¹ Kjo sure përmban një grumbull njohurish të doktrinëslame si dhe një varg rregullash dhe obligimesh fetare.

Në pjesën e parë të kësaj sureje bëhet fjalë rreth çështjes së ndryshimit pas Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Po ashtu në këtë pjesë flitet edhe për çështje të tjera, si doktrina e trinitetit tek të krishterët, tematika të veçanta që flasin për Ditën e Kiametin, Tubimit të njerëzve në Mahsher dhe përgjigjet e Profetëve rreth popujve të tyre.

Ndërsa pjesa e dytë përfshin çështjen e mbajtjes së premtimeve, çështjen e drejtësisë shoqërore, çështjen e dëshmisë së drejtë, çështjen e ndalimit të vrasjes së vetvetes (nëpërmjet tregimit të dy bijve të Ademit ku Kabili vret vëllain e vet Habilin). Përveç këtyre përfshin sqarimin e disa llojevë të ushqimeve të ndaluara dhe të lejuara, si dhe një pjesë prej rregullave të abdesit dhe të tejemumit.

Ndërsa emërtimi i kësaj sureje me emrin “El Maide” (Sofra) është bërë për arsye të tregimit të zbritjes së sofrës nga qielli apostujve të Mesisë, hazreti Isait (Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!) në ajetin 114 të kësaj sureje.

¹ Tefsiri “El Menar”, vëll. 6, faqe 116. Duhet patur parasysh se qëllimi me sure medinase është për ato sure që kanë zbritur pas emigimit (hixhretit) të Profetit nga Meka për në Medine edhe nëse surja nuk ka zbritur brenda në Medine.

Ajeti 1

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا أَوْفُوا بِالْعُقُودِ أُحِلَّتْ لَكُمْ بَهِيمَةُ الْأَنْعَامِ إِلَّا مَا
يُتَلَى عَلَيْكُمْ غَيْرَ مُحِلِّي الصَّيْدِ وَأَنْتُمْ حُرْمٌ إِنَّ اللَّهَ يَحْكُمُ مَا يُرِيدُ ﴿١﴾

“O ju që keni besuar! Përbajuni marrëveshjeve! Ju është lejuar ngrënia e kafshëve, përveç atyre që do t’ju citohen dhe nuk ju lejohet gjuetia gjatë kohës që jeni muhrimë¹. Vërtet, All’llahu vendos çfarë të dëshirojë.”

Komentimi

Domosdoshmëria e mbajtjes së premtimit dhe e zbatimit të marrëveshjes

Transmetimet islame dhe thëniet e komentuesve të Kur’anit tregojnë se kjo është surja e fundit ose ndër suret e fundit që i është zbritur Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ka ardhur në komentimin e Ajashit, të transmetuar nga Imam Bakiri (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*), se Imam Ali ibn Ebi Talibi (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) ka thënë: “Surja “El Maide” është zbritur dy ose tre muaj përpara se

¹ *Muhrim*: është personi i veshur me ihram.

të ndërronte jetë Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)."¹

Kjo sure, e cila ka një pozitë të veçantë, ndër të tjera përforcon një grumbull mësimesh islame, programet dhe legjislacionet e fundit fetare dhe çështjen e udhëheqjes së umetit dhe të zëvendësit (kalifit) të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ndoshta kjo mund të jetë arsyeja që kjo sure fillon me çështjen e mbajtjes së premtimit dhe të zbatimit të marrëveshjeve, për të cilat All'llahu i Lartësuar thotë: **"O ju që keni besuar! Përbajuni marrëveshjeve!..."**. E kjo, me qëllim që besimtarët t'u përmbahen marrëveshjeve dhe premtimeve që kanë bërë në të shkuarën me All'llahun e Lartësuar ose të atyre marrëveshjeve dhe premtimeve që përmend kjo sure.

Ky përforcim është njësoj si veprimi që bën udhëtari në momentin e fundit, ku përshëndet familjen e tij, të afërmit dhe përkrahësit e tij dhe u thotë atyre që të mos harrojnë porositë dhe këshillat e tij dhe t'u përmbahen marrëveshjeve që kanë lidhur me të.

Duhet të dihet se fjala "*ukud*", është shumësi i fjalës "*akd*", e cila në origjinalitet ka kuptimin lidhja fort e dy anëve të diçkaje. Nga këtu, edhe lidhja e dy anëve të litarit apo lidhja e dy litarëve me njëri-tjetrin është quajtur "*akd*".

Pas këtij kuptimi të ndjeshëm, ajeti kalon në një kuptim të brendshëm spiritual (shpirtëror) dhe e quan çdo marrëveshje "*akden*".

Disa komentues kanë thënë se fjala "*akdun*" ka një kuptim më të ngushtë se fjala "*ahdun*" sepse fjala "*el akdu*" përdoret për

¹ Tefsiri "Burhan", vëllimi 1, faqe 430.

fjalë e për premtimet që zbatohen plotësisht dhe nuk përdoret për të gjitha premtimet. Nëse në disa transmetime apo në thëniet e komentuesve përmendet se këto dy fjalë kanë të njëjtin kuptim, kjo nuk bie në kundërshtim me atë që thamë, sepse qëllimi në këto transmetime apo thënie është komentimi i përgjithshëm i këtyre dy fjalive dhe jo sqarimi i pjesëve të tjera të këtyre dy fjalëve.

Duke vërejtur fjalën "*ukud*", që do të thotë marrëveshje ose premtim, ka ardhur në numrin shumë dhe para saj gjendet *elifi* dhe *lami* shques, për të treguar gjithpërfshirje. Fjalja në të cilën përmendet kjo fjalë është fjali e përgjithshme dhe absolute.

Për këtë, ajeti në fjalë konsiderohet argument për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të cilat i lidhin njerëzit me njëri-tjetrin. Apo ato marrëveshje e premtim që bëhen me All'llahun e Lartësuar.

Në këtë mënyrë, ky ajet përfshin të gjitha premtimet dhe marrëveshjet hyjnore, njerëzore, politike, ekonomike, shoqërore, tregtare dhe marrëveshjet e kurorëzimeve me martesë, e të tjera si këto. Ky ajet ka kuptim të gjerë që përfshin të gjitha anët e jetës së njeriut, të besimit dhe të veprimit.

Në tefsirin "*Ruhul Meanij*" është përcjellë nga Ragib El Asfahani, se fjala "*akd*" - e vërejtur në dy këndvështrimet e saj - ndahet në tri lloje. Nganjëherë është premtim dhe marrëveshje mes robit dhe Zotit të tij. Herë tjetër, premtim dhe marrëveshje mes robit dhe vetes së tij. Dhe herë tjetër është premtim dhe marrëveshje mes personit dhe pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë.¹

Është e natyrshme se secila nga këto tre lloje marrëveshjesh është e dyanshme dhe qëllimi i çështjes është se njeriu që bën marrëveshje me veten e tij e konsideron atë sikur të jetë një person i dytë apo një palë tjetër i marrëveshjes.

¹ Tefsiri "*Ruhul Meanij*".

Sido që të jetë, kuptimi i gjerë i këtij ajeti përfshin deri edhe premtimet dhe marrëveshjet që bëjnë myslimanët me jomyslimanët.

Dy hulumtime

Në këtë ajet ka disa çështje të cilave u duhet kushtuar vëmendja:

1- Ky ajet konsiderohet nga ajetet të cilat me të argumentojnë të gjithë librat e jurisprudencës islame në kërkime të veçanta për të drejtat islame dhe prej tij nxirret një bazë e rëndësishme e jurisprudencës që është: "Vërtetësia e domosdoshmërisë në marrëveshje", që do të thotë se: çdo premtim apo marrëveshje që bëhet mes dy personave, rreth çështjeve apo veprave të ndryshme, duhet të zbatohet.

Një grup studiuesish mendojnë se të gjitha llojet e bashkëpunimeve, marrëveshjeve dhe partneriteteve që gjenden në kohën e sotme të cilat nuk gjendeshin më përpara, apo ato të cilat do të ekzistojnë në të ardhmen mes arsyes dhe që bazohen mbi etalone të shëndosha, përfshihen në këtë rregull, sepse ky ajet dëshmon dhe përforcon vërtetësinë e të gjitha atyre (Është më se e natyrshme se rregullat e përgjithshme, të cilat i ka vendosur Islami për marrëveshjet dhe premtimet duhet të ruhen në këtë fushë). Argumentimi me këtë ajet si bazë juridike, nuk do të thotë se nuk përfshin premtimet dhe marrëveshjet mes njerëzve dhe All'Ilahut të Lartësuar, apo çështjet e veçanta të udhëheqjes dhe drejtimin e Islamit, për të cilat Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mori premtimin dhe lidhi besën

me umetin. Porse, ajeti ka një kuptim të gjerë ku përfshin të gjitha këto çështje.

Është e vlefshme që këtu të tregohet se e vërteta e marrëveshjes mes dy palëve dhe obligimi i zbatimit të kësaj marrëveshjeje është e vazhdueshme përderisa njëra palë nuk e prish atë. Nëse njëra palë e prish këtë marrëveshje, atëherë pala tjetër nuk është e obliguar që ta zbatojë atë , sepse me këtë prishje marrëveshja del nga e vërteta e saj.

2- Me të vërtetë, çështja e zbatimit të marrëveshjeve dhe kontratave që ka parashtruar ky ajet konsiderohet si një nga obligimet më të rëndësishme të jetës shoqërore, sepse pa të nuk do të mund të arrihet asnjë lloj bashkëpunimi shoqëror. Nëse njerëzit e humbisni apo edhe do ta humbasin këtë veçori, kanë humbur jetën e tyre shoqërore dhe gjithashtu gjurmët e saj.

Për këtë, burimet e legjislacionit Islam, në një formë që nuk ka të ngjashëm në të – dëshmojnë dhe mbrojnë çështjen e marrëveshjeve, të cilat mund të jenë nga çështjet e rralla që mund të dallohen për nga gjërësia dhe përfshirja e saj. Sepse, nëse moszbatimi i marrëveshjeve dhe i premtimeve do të zhdukej në mesin e pjesëtarëve të shoqërisë, atëherë do të shfaqeshin trazira e dëshpërimi dhe besimi do të humbasë mes njerëzve. Kjo konsiderohet prej katastrofave të mëdhaja e të rrezikshme.

Në librin “Nehxhul Belaga”, në një nga thëniet e Imam Ali ibn Ebi Talibit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ku i drejtohet Malik El Eshterit, thuhet: *“E nëse bën marrëveshje me armikun e hyn në traktate me të, zbatoi me korrektesë kushtet e saj dhe mbaji zotimet që ke marrë. Bëje veten peng të premtimit, sepse asnjë nga detyrimet që na ka vënë Zoti nuk i bëjnë njerëzit aq të ndjeshëm sa thyerja e premtimit, pavarësisht dallimeve në pikëpamje. Jo më myslimanët, por edhe të pafetë*

i respektojnë marrëveshjet, sepse dhe ata i kuptojnë rreziqet që sjell shkelja e tyre...”¹

Transmetohet nga prijësi i myslimanëve Ali ibn Ebi Talibi se ai ka thënë: *“Me të vërtetë, All'llahu nuk pranon vetëm veprat e mira dhe nuk pranon vetëm zbatimin e kritereve dhe të marrëveshjeve.”²*

Transmetohet nga Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) se ai ka thënë: *“Nuk ka fe ai i cili nuk e zbaton marrëveshjen.”³*

Të gjithë këto dëshmi e përforcime tregojnë se tematika e zabtimimit të marrëveshjeve nuk kanë ndryshim tek njerëzit, qofshin ata mysliman apo jomysliman. Kjo tematikë konsiderohet në përgjithësi prej të drejtave të njeriut dhe nuk ë shtë absolutisht tematikë që i përket vetë m përkrahësve të një feje të vetme.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Sadiku (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) thuhet: *“Tri gjërave All'llahu nuk i ka vendosur leje; kthimi i amanetit, të mirit dhe të keqit, zbatimi i marrëveshjes me të mirin dhe të keqin si dhe respekti ndaj prindërve qofshin të mirë apo të këqinj.”⁴*

Transmetohet nga Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) se marrëveshja, edhe nëse bëhet me shenjë, duhet që të zbatohet.

Pasi ky ajet foli për çështjen e zbatimit të marrëveshjes dhe traktateve, qofshin ato hyjnore apo njerëzore, ai shpjegon edhe disa prej proceduarve të një grupi tjetër prej rregulave islame. I pari prej këtyre rregullave është lejimi i mishit të disa kafshëve. Ajeti thotë: **“Ju është lejuar ngrënia e kafshëve”** Fjala *"en n'am"*,

¹ “Nehxhul Belaga”, Letra 53.

² “Sefijnetul Bihar”, vëllimi 2, faqe 294.

³ “Biharul Enuar”, vëllimi 69, faqe 198.

⁴ “Usulul Kafij”, vëllimi 2, faqe 162.

që përmendet në ajet, është shumësi i fjalës "*ni'am*", që ka për qëllim bagëtitë ose kafshët si: delet, dhitë, devetë dhe lopë t.¹

E ndërsa fjala "*behijmetu*" rrjedh nga fjala "*behmetu*", që do të thotë *gur i fortë*. Po ashtu, çdo gjëje që është e vështirë të kuptohet i thuhet "*mubhem*". Dhe të gjitha kafshët, të cilat nuk flasin, quhen "*behijmetu*", sepse zërat e tyre janë të paqartë dhe të pakuptueshë m për njeriun. Është bërë zakon që fjala "*behijmetu*" të përdoret vetëm për bagëtitë e buta dhe nuk përfshin as kafshët e egra dhe as shpendët.

Nga ana tjetër, edhe embrionit të bagëtisë i thuhet "*behijmetu*" sepse ai është i paqartë. Bazuar në këtë, rregulli i lejueshmërisë së ngrënies së bagëtive i përfshin të gjitha bagëtitë, përveç atyre që ka veçuar ajeti pasardhës, ose fjalia ka kuptimin e embrioneve të bagëtive që u lejohet ngrënia (ato embrione zhvillimi i të cilëve është plotësuar në barkun e nënave të tyre dhe u është mbushur lëkura me qime apo me lesh).

Meqenëse rregulli i lejimit të ngrënies së bagëtive si lopët, devetë dhe të imtat, iu sqarua njerëzve në ajetin parardhës, atëherë ajeti në fjalë tregon për lejimin e embrionit (të vegjlit në barkun e këtyre kafshëve).

Në aparence të ajetit duket se ai ka një kuptim të gjerë. Pra, ai sqaron lejimin e ngrënies së mishit të këtyre bagëtive duke përfshirë edhe ngrënien e mishit të të vegjëlve që mbarten në barkun e tyre. Mirëpo, ky rregull është shpjeguar edhe më përpara, por në këtë ajet është përsëritur si parantezë për të veçantat e rregullit që ka ardhur në këtë ajet.

Për atë çfarë paraqiten, na qartësohet se lidhja e fjalisë së fundit dhe rregulli i saj i përgjithshëm, i cilë është:

¹ Nëse fjala "*ni'am*" vjen në numrin njëjës, qëllimi i saj është për devenë. Nëse vjen në shumës, atëherë ka për qëllim ato që u përmendën. Mufredatu Ragib, lënda "*neime*".

domosdoshmëria e zbatimit të marrëveshjes, është një përforcim se rregullat hyjnore janë një lloj marrëveshje mes All'Ilahut dhe robëve të Tij, ku lejimi i ngrënies së mishit të disa kafshëve dhe ndalimi i ngrënies së mishit të disa kafshëve të tjera, konsiderohet një pjesë prej atyre rregullave.

Në mbyllje, ajeti sqaron dy gjëra të cilat i veçon nga rregulli i lejimit të ngrënies së bagëtive.

E para: Mishi i disa kafshë ve të cilëve do t'u sqarohet ndalimi i ngrënies më pas ku All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Përveç atyre që do t’ju njoftohen.”**

E dyta: Kur personi ka veshur rrobën e Ihramit për të kryer Haxhin apo Umren, atij i ndalohet gjuetia. Ajeti thotë: **“Derisa të gjendeni në Ihram gjatë Haxhit, nuk lejohet gjuetia.”**

Në fund të ajetit vjen përforcimi se në të vërtetë, nëse All'Ilahu dëshiron të bëjë diçka apo dëshiron një rregull, Ai bën dhe e sjell rregullin, sepse me të vërtetë Ai është i Gjithëdijshtëm për çdo gjë dhe se Ai është Poseduesi i gjithçkaje. Nëse Ai e shikon se në sjelljen e një rregulli ka dobi për robtë e Tij dhe bazohet në urtësi, e shpall këtë rregull. Ajeti thotë: **“Vërtet, All'Ilahu vendos çfarë të dëshirojë.”**

Ajeti 2

يَتَأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَحْلُوا شَعِيرَ اللَّهِ وَلَا الشَّهْرَ الْحَرَامَ وَلَا الْهَدْيَ وَلَا
الْقَلْبِدَ وَلَا ءَامِينَ الْبَيْتِ الْحَرَامِ يَبْتَغُونَ فَضْلًا مِّن رَّبِّهِمْ وَرِضْوَانًا وَإِذَا
حَلَلْتُمْ فَاصْطَادُوا وَلَا تَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ قَوْمٍ أَن صَدُّوكُمْ عَنِ الْمَسْجِدِ
الْحَرَامِ أَن تَعْتَدُوا وَتَعَاوَنُوا عَلَى الْبِرِّ وَالتَّقْوَىٰ ۖ وَلَا تَعَاوَنُوا عَلَى الْإِثْمِ
وَالْعُدْوَانِ ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۖ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ ﴿٢﴾

“O ju që keni besuar! Mos e cënoni shenjtërinë e simboleve të All’Ilahut, as të muajit të shenjtë, as të kurbanit të Qabesë , as të kurbaneve të shënuara me gjerdan, as (mos i pengoni) ata që janë nisur të vizitojnë Shtëpinë e Shenjtë, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Zotit të vet. Pas heqjes së Ihramit, gjuani. Dhe, të mos ju nxisë urrejtja ndaj disa njerëzve, që ju pengojnë të vizitoni Qabenë, pra, kurrsesi të mos ju nxisë që t’i sulmoni! Ndhimoheni njëri-tjetrit në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni All’Ilahut, sepse Ai dënon ashpër.”

Komentimi

Tetë rregulla dhe procedura në një ajet të vetëm

Ky ajet sqaron disa prej rregullave të rëndësishme islame, të cilat janë prej rregullave të fundit që i janë shpallur Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Të gjitha këto, apo shumica e tyre, kanë lidhje me Haxhin në shtëpinë e All'llahut të Lartësuar (Qabenë). Ato rregulla janë sikurse vijojnë:

1- Ajeti u kërkon besimtarëve që të mos i përcmojnë simbolet e All'llahut të Lartësuar dhe i ndalon ata që të prekin këto simbole të shenjta. Ajeti thotë: **“O ju që keni besuar! Mos e cënoni shenjtërinë e simboleve të All'llahut...”** Komentuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme rreth qëllimit të fjalës "*sheáir*", *simboleve* që ka ardhur në këtë ajet. Duke parë pjesët e tjera të këtij ajeti dhe vitin në të cilin ka zbritur ky ajet, që është viti i dhjetë i hixhrit, në të cilin Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka kryer Haxhin në Mekën e bekuar dhe që është Haxhi i lamtumirës, sqarohet se qëllimi me këtë fjalë janë ritualet e Haxhit, të cilat myslimanët janë të obliguar që t'i respektojnë të gjitha ato. Këtë mendim e përforcon ardhja e kësaj fjalie "*sheáir*", *simboleve*, në Kur'anin Famëlartë e shoqëruar gjithmonë me thënien rreth Haxhit.¹

2- Ajeti fton në respektimin e muajve të shenjtë, të cilët janë muaj të vitit sipas kalendarit hënor. Gjithashtu, ka ndaluar luftën në këto muaj. Ajeti thotë: **“... as të muajit të shenjtë...”**

¹ Sure, “El Bekare”, ajeti 158. Sure “El Haxhxh”, ajetet 32 dhe 36.

3- Ajeti ka ndaluar që të mos preken kurbanet që janë caktuar për therje në kohën e Haxhit, qofshin këto kurbane me shenja dhe që emërtohen me “hedji”¹, apo janë pa shenja të cilat emërtohen me “kalaid”.² Ajeti e ndalon therjen që të bëhet kurban dhe ngrënia e mishit të tyre derisa të arrijnë në vendin e kurbanit për haxh dhe të bëhen kurban në të (Qabenë), ku All’llahu i Lartësuar thotë: **“... as kurbanit të Qabesë, as kurbanëve të shënuar me gjerdan...”**

4- Ajeti ka obliguar garantimin e lirisë së plotë për haxhinjtë që vizitojnë shtëpinë e All’llahut të Lartësuar gjatë kohës së Haxhit, në të cilën largohen të gjitha ndryshimet fisnore, gjuhësore, të kombësisë dhe të shtresave njerëzore. Ajeti e ka ndaluar shqetësimin e të pranishmëve që kanë shkuar të vizitojnë shtëpinë e All’llahut të Lartësuar dhe për të fituar kënaqësinë e Tij. Jo vetëm vizitorët por edhe ata të cilët kanë shkar për vizitë, mirëpo kanë qëllime të tjera, si tregtia, pa dallim mes shokut apo kundërshtarit, përderisa të gjithë janë myslimanë e qëllimi i tyre është vizita e shtëpisë së All’llahut. Ata gëzojnë të drejtën e mbrojtjes siç thotë ajeti: **“... as (mos i pengoni) ata që janë nisur të vizitojnë Shtëpinë e Shenjtë, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Zotit të vet...”**

Disa komentues e juristë besojnë se fjalia kur’anore e larpërmendur ka kuptim të përgjithshëm ku përfshin edhe jomyslimanët, pra, edhe idhujtarët, nëse ata kanë shkuar për të vizituar Shtëpinë e shenjtë të All’llahut të Lartësuar që të mos shqetësohen nga myslimanët.

¹ Fjala "el hedji" është shumësi i fjalës "hedijetun". Këtu ka kuptimin e atyre bagëtive që cilat dhurohen për kurbane në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut.

² Fjala "el kalaidu" është shumësi i fjalës "kiladetu" e cila ka kuptimin e varësës që varet në qafën e njeriut apo të kafshës. Këtu ka kuptimin e varësve të bagëtive të cilat me anë të kësaj varëse njihen që janë për t'u therur në Haxh.

Por duke parë zbritjen e ajetit të ndalimit të hyrjes së idhujtarëve në Xhaminë e shenjtë (Qabenë) në suren “Teube”, e cila ka zbritur në vitin e nëntë të hixhretit, dhe zbritjen e sures “El Maide”, e cila ka zbritur në fund të jetës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pra, në vitin e dhjetë të hixhrit, dhe ajo është sure që nuk ka abrogim të rregullave të saj, sipas transmetimeve të të dyja grupeve (palëve), shiitë dhe sunitë, atëherë është e largët që ky komentim të jetë i saktë. E vërteta është se rregulli i lartpërmendur është i posaçëm vetëm për myslimanët.

5- Ky ajet ka veçuar rregullin e ndalimit të gjuetisë në kohën kur është veshur rroba e Ihramit. Ai njofton se kur hiqet Ihrami myslimanëve u lejohet gjuetia. Ajeti thotë: “... pas heqjes së Ihramit, gjuani...”

6- Ky ajet u ka ndaluar myslimanëve që të shqetësojnë apo të persekutojnë atë grup myslimanësh, që përpara se të pranonin Islamin, i kanë shqetësuar dhe i kanë persekutuar myslimanët e parë në vizitën e shtëpinë së All'llahut dhe i kanë ndaluar ata që të kryenin ritet e Haxhit. Kjo ka ndodhur në ngjarjen e Hudejbijes, ku myslimanëve iu ndalua që të urrejnë e të shqetësojnë ata njerëz në kohën e Haxhit. Ajeti thotë: “... të mos ju nxisë urrejtja ndaj disa njerëzve, që ju penguan që të vizitonin Qabenë, pra kursesi të mos ju nxisë që t'i sulmoni!...”

Megjithëse ky rregull ka ardhur për tematikën e vizitës së shtëpisë së All'llahut të Lartësuar, por në të vërtetë konsiderohet si rregull dhe ligj i përgjithshëm, që u bën thirrje myslimanëve të largojnë urrejtjen dhe të mos ringjallin ndodhitë e mëparshme në mendjet e veta, me qëllim që të hakmerren ndaj tyre.

Përderisa urrejtja është një ndër elementët e shfaqjes së hipokrizisë dhe përçarjes në shoqëri, neve na qartësohet fare mirë

vlera e madhe e këtij rregulli islam në parandalimin dhe në ndalimin e ndezjes së zjarrit të hipokrizisë në mesin e myslimanëve, veçanërisht në kohën kur Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ishte në prag të largimit dhe të ndarjes nga kjo jetë.

7- Ky ajet u garanton myslimanëve se në vend që të bashkohen për t'u hakmarrë për urrejtjet e mëparshme ndaj atyre që e kanë pranuar Islamin – dhe janë bërë miq me këtë rregull të pranimit të Islamit - ata duhet të bashkohen për të kryer vepra të mira, për t'iu përkushtuar devotshmërisë dhe të mos bashkëpunojnë në vepra të këqija dhe armiqësore. Ajeti thotë: **“... Ndhimoheni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi!...”**

8- Për t'i forcuar rregullat e mëparshme, në fund ajeti u bën thirrje myslimanëve që të ndjekin devotshmërinë dhe t'u largohen gjynaheve dhe thyerjes së rregullave të All'lahut. Ai i paralajmëron ata me një ndëshkim të rreptë të All'lahut të Lartësuar ku thotë: **“... Frikësojuni All'lahut, sepse Ai dënon ashpër.”**

Hulumtime

Bashkëpunimi në vepra të mira

Me të vërtetë, thirrja që bën ky ajet në bashkëpunim për vepra të mira konsiderohet si rregull i përgjithshëm islam, që përfshin të gjitha sferat, si ato shoqërore, morale, politike, legislative dhe të tjera si këto. Ai i obligon të gjithë myslimanët që të bashkëpunojnë në kryerjen e veprave të mira e të dobishme, dhe i ndalon ata që të

bashkëpunojnë në vepra të këqija dhe mëkate, ku përfshihet padrejtësia me të gjitha llojet e saj, shtypja dhe devijimi.

Ky parim islam është në kundërshtim të plotë me parimin që mbizotëronte në kohën e injorancës (përpara ardhjes së Islamit) dhe vazhdon të zbatohet edhe në këtë kohë. Ai parim thotë: “Ndihmoje vëllanë tënd nëse i është bërë padrejtësi ose ka bërë padrejtësi.”¹ Në kohën e injorancës, nëse një grup i një fisi sulmonte një grup të një fisi tjetër, pjesëtarët e fisit sulmues ngriheshin të gjithë për përkrahjen e sulmuesve, pa marë parasysh se a është i drejtë sulmi apo i padrejtë. Edhe në kohët e sotme i shikojmë ndikimet e këtij parimi të injorancës në marrëdhëniet ndërshtetërore dhe veçanërisht vendet aleate të cilat ngrihen për të mbrojtur njëra-tjetrën dhe bashkëpunojnë së bashku për çështjeve ndërkombëtare, pa ruajtur parimin e drejtësisë dhe pa dalluar drejtësinë nga padrejtësia. Islami e anuloi këtë parim të xhahilijetit dhe u bën thirrje myslimanëve që të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në vepra të mira, në planprograme të dobishme dhe që sjellin zhvillim dhe progres. Ai e ka ndaluar bashkëpunimin në vepra të këqija, në padrejtësi dhe në armiqësi.

Argumenti për këtë është ardhja e dy fjalëve “punë të mira” dhe “në të ruajtur” bashkarisht në këtë ajet. Vërtet, fjala e parë mbart kuptimin pozitiv, tregon për nxitjen në bërjen e veprave të dobishme dhe fjala e dytë mbart kuptimin e ndalimit të bërjes së punëve të këqija dhe të ruajtjes prej tyre. Bazuar në këtë parim, bashkëpunimi dhe përkrahja duhet që të kryhet si në thirrjen për të bërë vepra të mira e të dobishme ashtu edhe në luftimin e veprave të këqija.

¹ Tefsiri *Et Tilhan*, vëll. 1, f. 216. Tefsiri *Mexhmaul Bejan*, vëll. 1, f. 200.

Këtë ligj, jurisprudenca islame e ka përdorur në çështjet e të drejtave civile. Jurisprudenca islame i ndalon ato marrëdhënie dhe marrëveshje tregtare, në të cilat ka natyrë për të ndihmuar në përhapjen e veprave të këqija apo të ndaluara, si shitja e rrushit në fabrikat e alkoolit apo shitja e armëve armiqve të Islamit, apo armiqve të së vërtetës dhe të së drejtës, apo marrja me qera e vendeve për të ushtruar vepra që nuk janë të lejuara në Islam.

Me të vërtetë, ringjallja e këtij parimi në shoqëritë islame, bashkëpunimi i myslimanëve në vepra të mira dhe planprograme të dobishme e progresive, pa i dhënë rëndësi lidhjes që ka personi nga ana e fisit, origjinës a e prejardhjes, ndalimi i dhënies së çdo lloj ndihme personave që praktikojnë padrejtësinë dhe armiqësinë, pa marrë parasysh se kë grup ndjek dhe kujt rryme të padrejtë i përket, të gjitha këto largojnë shumë mosmarrëveshje shoqërore. Ndërsa marrëdhëniet ndërshtetërore, nëse të gjitha shtetet e botës do të ndalonin bashkëpunimin me çdo shtet armiqësor, cilido qoftë, do të shkatërroheshin të gjitha rrënjët e armiqësisë, pushtimit e shfrytëzimit në botë. Por, kur gjendja ndryshon dhe shtetet bashkëpunojnë me agresorët dhe të padrejtët me argumentin se dobitë e tyre ndërshtetërore i detyrojnë ata që të bashkëpunojnë, atëherë nuk mund të mendohet asnjëherë mirësi nga gjendja siç është ajo që mbizotëron sot në mbarë botën. Këtë çështje e kanë trajtuar hadithe e transmetime të shumta islame. Këtu po përmendim disa prej tyre.

1- Transmetohet nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai ka thënë: “Kur të ndodhë Dita e Kiametit thërret thirrësi: ‘Ku janë të padrejtët, ndihmuesit e të padrejtëve dhe të ngjashmëve me të padrejtët, deri dhe ata që mprehën

*lapsat?" Pastaj ka thënë: "Ata do të tubohen në një tabut prej hekuri dhe do të hidhen në Xhehennem"*¹

2- Në një hadith të ardhur nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku ai i është drejtuar Aliut (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) duke i thënë: "O Ali, nga ky umet, dhjetë persona do ta mohojnë All'llahun e Madhëruar, prej tyre është edhe ai i cili u shet armë armiqve."²

¹ "Vesailu Shiia", vëllimi 12, faqe 131.

² "Vesailu Shiia", vëllimi 12, faqe 131.

Ajeti 3

حُرِّمَتْ عَلَيْكُمْ أَلْمَيْتَةُ وَالْدَّمُ وَلَحْمُ الْخَنزِيرِ وَمَا أُهِلَّ لِغَيْرِ اللَّهِ بِهِ
وَالْمُنْخَنِقَةُ وَالْمَوْقُوذَةُ وَالْمُتَرَدِّيَةُ وَالنَّطِيحَةُ وَمَا أَكَلَ السَّبْعُ إِلَّا مَا
ذَكَّيْتُمْ وَمَا ذُبِحَ عَلَى النُّصُبِ وَأَنْ تَسْتَقْسِمُوا بِالْأَزْلَمِ ۚ ذَٰلِكُمْ فِسْقٌ
الْيَوْمَ يَيسَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنَ دِينِكُمْ فَلَا تَحْشَوْهُمْ وَاخْشَوْنَ ۚ
الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ
الْإِسْلَامَ دِينًا ۚ فَمَنِ اضْطُرَّ فِي مَخْمَصَةٍ غَيْرِ مُتَجَانِفٍ لِإِثْمِهِ ۚ فَإِنَّ اللَّهَ

غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿٢﴾

"Është e ndaluar për ju ngrënia e cofëtinës, e gjakut, e mishit të derrit, e mishit të kafshës që është therur jo në emër të All'llahut, e mishit të kafshës së mbytur lidhur në fyt, e mishit të kafshës që është rrahur dhe ka ngordhur, e mishit të kafshës që është vlarë nga rrëzimi apo nga brirët e kafshëve të tjera, e mishit të asaj që është kafshuar nga egërsirat - përveç atyre që i therni ju para se të ngordhin. Gjithashtu, është e ndaluar për ju edhe ngrënia e mishit të kafshëve që janë therur për nder të idhujve apo për të kërkuar fatin në fall. Të gjitha këto që u përmendën, janë gjynah. Sot, dëshpërohen ata që nuk besojnë dhe kanë humbur çdo shpresë, që t'ju largojnë prej fesë suaj. Mos u frikësoni prej tyre, por kini frikë prej Meje! Sot jua

përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj. Por kushdo që është i shtrënguar nga uria (dhe ha çfarë është e ndaluar), pa pasur qëllim të bëjë gjynah, do ta shohë se All'llahu është Falës e Mëshirëplotë."

Komentimi

Në fillim të kësaj sureje u fol për mishin e lejuar të kafshëve. Gjithashtu, u tha se ka përjashtime të cilat ndalojnë ngrënien e mishit të bagëtive, ku ajeti në fjalë përmend njëmbëdhjetë raste. Disa prej tyre përmenden edhe në ajete të tjera të Kur'anit për përforcim.

Të ndaluarat që kanë ardhur në këtë ajet: **"Është e ndaluar për ju"**, sipas renditjes që janë përmendur janë si vijon:

E para: "cofëtinës."

E dyta: "e gjakut."

E treta: "mishit të derrit."

E katërta: Ato kafshë të cilat theren në emër të idhujve dhe jo në emër të All'llahut, sikurse është vepruar në kohën para Islamit, për të cilat All'llahu i Lartësuar thotë: **"E mishit të kafshëve që është therur jo në emër të All'llahut."**

Për këto katër lloje mishi të ndaluar kemi folur në xhuzin e parë të këtij tefsiri.

E pesta: Kafshët e mbytura, qoftë kjo mbytje përshkak të rënies në kurth, apo me ndërmjetësimin e njeriut apo kafsha mbyt veten e saj. Kë kohën e injorancës (para Islamit) në disa raste njerëzit injorantë i mbytnin kafshët për të përfituar nga mishi i tyre. Këtë

lloj mbytteje e tregon ajeti ku thotë: **“e mishit të kafshës së mbytur e lidhur në fyt.”**

Tregohet në disa transmetime se zjarrputistët (ata që adhurojnë zjarrin) e kanë pasur zakon që t'i mbysin kafshët që donin t'i hanin. Për këtë, ka mundësi që ky ajet t'i përfshijë edhe ata.”¹

E gjashta: Kafshët të cilat ngordhin për arsye të keqtrajtimit apo të torturimit. Apo ato që ngordhin nga ndonjë sëmundje, të cilat janë quajtur në ajet: **“e mishit të kafshës që është rrahur dhe ka ngordhur.”**

Tregon Kurtubiu në tefsirin e tij, se arabët e kanë pasur zakon që t'i godisnin kafshët e tyre derisa ata të ngordhnin, për respekt të idhujve të tyre dhe për t'u afruar tek ata.²

E shtata: Kafshë të cilat ngordhin për arsye të rrëzimit nga një vend i lartë. Për këtë ajeti thotë: **“e mishit të kafshëve që janë vrarë nga rrëzimi”.**

E teta: Kafshët të cilat ngordhin për shkak të goditjes me kokë apo me brirë nga një kafshë tjetër. Për këtë ajeti thotë: **“apo nga goditjet (me kokë ose me brirë) e kafshëve të tjera”.**

E nënta: Kafshët të cilat ngordhin për arsye të mësymjes së egërsirës, për të cilat ajeti thotë: **“e mishit të asaj që është kafshuar nga egërsira”.**

Ka mundësi që filozofia e ndalimit të ngrënies së mishit të këtyre lloj kafshëve të jetë mosdalja e mjaftueshme e gjakut kur ato ngordhin apo vriten, sepse nëse nuk i priten të gjitha damarët e qafës, atëherë gjaku nuk del aq sa duhet. Meqenëse gjaku është vendi i përshtatshëm për rritjen e mikrobeve të ndryshme dhe kur ngordh kafsha ky gjak shpërbëhet para pjesëve të tjera të trupit,

¹ “Uesailu Shiia”, vëllimi 16, faqe 273.

² Tefsir “Kurtubij”, vëllimi 6, faqe 48.

atëherë mishi i kafshës helmohet dhe nuk mund të jetë i rregullt dhe i shëndetshëm.

Në të shumtën e rastëve ky helmim ndodh kur kafsha ngordh nga një sëmundje, apo nga keqtrajtimi, apo nga mësymja e një kafshe të egër.

Nga ana tjetër, tek ato kafshë nuk realizohet një prej kushteve të therjes që është kushti i përmendjes së All'llahut dhe drejtimi i kafshës nga ana e kiblës kur ajo theret.

Ky ajet ka treguar vetëm një kusht, që nëse do të realizohej ky mish do të lejohej për t'u ngrënë dhe kushti është që kafsha të theret përpara se të ngordhë, sipas zakonit dhe rregullave islame dhe prej saj të dalë gjaku i mjaftueshëm. Atëherë ky mish është i lejuar. Për këtë, thënia **“përveç atyre që i therni ju para se të ngordhin”** ka ardhur pas atyre rasteve të ndalimit.

Disa komentues janë të mendimit se ky përjashtim është vetëm për llojin e fundit, pra, lloji për të cilin ajeti thotë: **“e mishit të asaj që është kafshuar nga egërsirat.”**

Por, shumica e komentuesve kanë mendimin se përjashtimi përfshin të gjitha llojet e treguara më sipër. Mendimi i fundit është më afër së vërtetës.

Këtu disa mund të pyesin: Përse nuk janë përfshirë në këtë ajet të gjitha llojet e kafshëve të cilave u ndalohet ngrënia e mishit nën emërtimin “të ngordhura”, i cili është përmendur si lloji i parë nga njëmbëdhjetë llojet në këtë ajet? A nuk është kuptimi i fjalës ngordhësirë për të gjitha llojet e përmendura?

Përgjigja është se ngordhësira në jurisprudencën islame ka një kuptim të gjerë. Çdo kafshë që nuk theret sipas mënyrës legjislative islame, hyn në kornizën e kuptimit të ngordhësirës apo cofëtinës.

Ndërsa, kuptimi gjuhësor i ngordhësirës përfshin vetëm atë kafshë që ka ngordhur në mënyrë natyrore. Për këtë arsye, llojet e treguara në këtë ajet – përveç të ngordhurës – nuk përfshihen në kuptimin e ngordhësirës nga ana gjuhësore. Ajo ka nevojë të shpjegohet e të qartësohet.

E dhjeta: Idhujtarët në kohën e injorancës vendosnin gurë rreth Qabesë, që nuk kishin forma të caktuara, dhe i emërtonin këto gurë me emrin "nasb", "idhuj". Ata i thernin kurbanat e tyre para këtyre idhujve dhe me gjakun e kurbaneve fshinin gurët, ku kanë bërë kurban përpara tyre në shenjë adhurimi dhe respekti. Ndryshimi mes statujës dhe idhujve është se "nasbi" nuk ka formë dhe paraqitje, ndryshe nga idhulli. Islami e ka ndaluar ngrënien e mishit të atyre kafshëve që theren për këto idhuj e statuja. Dispozita e ndalimit ka ardhur në ajet, për të cilën All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Gjithashtu është e ndalur për ju ngrënia e mishit të kafshëve që janë therur për nder të idhujve."** Është e qartë se ndalimi i ngrënies së këtij lloji mishi mbart natyrë shpirtërore dhe jo atë materiale. Në të vërtetë, ky lloj konsiderohet nga ato kurbane, të cilat i përfshin thënia e Kur'anit Famëlartë, ku thotë: **"e mishit të kafshës që është therur jo në emër të All'Ilahut."** Ky lloj është përmendur specifikisht në ajet për arsye se ishte e përhapur në mesin e arabëve në kohën para Islamit.

E njëmbëdhjeta: Gjendet një lloj tjetër prej mishit të ndaluar. Ai ë shtë mishi, i cili theret e ndahet si mënyrë bixhozi. Qartësimi i tij është: Dhjetë persona vënë bast ndërmjet tyre. Ata blejnë një kafshë dhe e therin. Pastaj sjellin dhjetë shigjeta ku në shtatë prej tyre shkruajnë "fitues" dhe në tre të tjera shkruajnë "humbës". Këto i vendosin në një qese dhe tërhiqen një e nga një me emrin e çdo personi, njësoj si hedhja e shortit apo e zarit. Atyre personave që u del emri fitues e marrin pjesën e mishit pa paguar vlerën e

saj. Kurse tre personat e tjerë, të cilëve u del emri "humbës", paguajnë vlerën e kafshës në mënyrë të barabartë dhe gjithsecili paguan një të tretën e kafshës, por pa marrë asnjë pjesë nga ai mish. Arabët në kohën e injorancës i kanë quajtur këto shigjeta "el ezlamu", falle. Islami e ka ndaluar këtë lloj mishi jo me kuptimin e pranisë së origjinës së ndalimit të këtij lloji, por sepse kafsha është therur me metodën e ngjashme me atë të bixhozit, ku All'illahu i Lartësuar thotë: **"për të kërkuar fatin në fall."**

Është obligim që të thuhet se ndalimi i bixhozit dhe të ngjashmet me të nuk kufizohen vetëm te mishi, por bixhozi është i ndaluar në çdo gjë dhe në çdo formë.

Në mbyllje, ky ajet përforcon rreptësisht ndalimin e ngrënies së këtyre lloje të mishit, ku thotë: **"të gjitha këto që u përmendën janë gjynah."**

Ekuilibrimi në përdorimin e mishit

Ajo çfarë nxjerrim si konkluzion nga ky kërkim dhe nga burimet e tjerat islame është se Islami ka ndjekur në çështjen e përdorimit të mishit rrugën e mesme dhe shqyrtohet në një mënyrë të veçantë nga procedurat dhe rregullat e tjera të tij.

Mënyra e Islamit ka një ndryshim të madh në atë çfarë ka qenë zakon në kohën e injorancës në ngrënien e mishit që është therur për idhujt, mishin e ngordhur, gjakun dhe të tjera të ngjashme me këto. Po ashtu, ndryshon me mënyrën që përdorin në kohën e sotme perëndimorët në ngrënien e këtyre llojeve të mishit, të cilët hanë edhe krimbat, breshkat, bretkosat e të tjera.

Gjithashtu, mënyra e Islamit ndryshon me atë të hinduve, të cilët ia ndalojnë vetvetes të gjitha llojet e mishit.

Islami e lejon ngrënien e mishit të atyre kafshëve, që ushqehen me gjëra të pastra dhe ndalon mënyrën e ekzagjerimit dhe të neglizhencës. Islami ka përcaktuar kushte, me të cilat kanë sqaruar llojet e mishit që i lejohen njeriut t'i përdorë ato. Ato kushte janë:

1- Mishi i kafshëve që ushqehen me bar. Islami nuk e lejon mishin e kafshëve që ushqehen me mish, të cilat përgjithësisht hajnë mishin e kafshëve të ngordhura dhe kjo mund të bëhet shkak për të përcjellë lloje të ndryshme sëmundjesh kur ky mish konsumohet. Ndërsa, kur kafshët ushqehen vetëm me bar, mishi i tyre është i shëndetshëm dhe nuk përmban sëmundje.

Në komentimin e ajetit 72 të sures "El Bekare" thamë se kafshët i trashëgojnë cilësitë e tyre, gjithashtu nëpërmjet përdorimit të mishit të tyre. Ai që ushqehet me mishin e kafshëve të egra, trashëgon cilësitë e ashpra si ngurtësimi dhe dhuna. Duke u bazuar në këtë argument, gjithashtu, është e ndaluar ngrënia e mishit të kafshëve "*xhel'laleh*", që janë kafshë që ushqehen me mbeturinat e kafshëve të tjera.

2- Nuk duhet që mishi i këtyre kafshëve të jetë neveritës nga njeriu.

3- Mishi i këtyre kafshëve të mos lërë ndikim ose dëm të keq në trupin e njeriut.

4- Janë ndaluar ato kafshë që bëhen kurban (theren) në rrugën e idhujtarisë, për idhujt e tjerë , e të ngjashme me to, që në vetvete mbajnë papastërti shpirtërore.

5- Islami ka caktuar rregulla të veçanta për therjen e çdo kafshe, të cilat kanë ndikim shëndetësor dhe moral te njeriu.

Pasi ky ajet shpjegon rregullat, të cilat i treguam më lart, vazhdon me dy fjali që kanë një kuptim të thellë. Në fjalinë e parë thuhet: **"Sot, dëshpërohen ata që nuk besojnë dhe kanë humbur çdo**

shpresë, që t'ju largojë prej fesë suaj. Mos u frikësoni prej atyre, por kini frikë prej Meje!"

Kurse në fjalinë e dytë thuhet: **"Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha Islamin të jetë feja juaj."**

Hulumtime

Kur e ka plotësuar All'llahu fenë e myslimanëve

Me të vërtetë, hulumtimi më i rëndësishëm që parashetrojnë këto dy paragrafe kur'anore, përqendrohet në të vërtetën e fjalës *"el jeum"*, që do të thotë *sot*, e cila ka ardhur në këto dy fjali.

Cila është ajo ditë, në të cilën janë bashkuar këto katër ndodhi: dëshpërimi i jobesimtarëve, plotësimi i fesë, plotësimi i dhuntisë, pranimi i All'llahut Islamin si fe e fundit për mbarë njerëzimin?

Për këtë çështje, komentuesit e Kur'anit kanë folur shumë. Ajo që nuk ka dyshim është se ajo është një ditë madhështore në historinë e jetës së Profetit. Një ditë e tillë nuk mund të jetë ditë e zakonshme si të gjitha ditët e tjera. Nëse themi se ajo është një ditë e zakonshme, nuk do të mbetet asnjë arsyetim për të pohuar rëndësinë e madhe të saj siç përmendet në ajet.

Thuhet se disa jehudinj dhe të krishterë, për rëndësinë e kësaj dite, kanë thënë se nëse do të kishte ardhur kjo ditë e shënuar në librat e tyre, do ta kishin caktuar festë për ata dhe do t'i jepnin një rëndësi të madhe.¹

¹ Tefsiri "El Menar", vëllimi 6, faqe 155.

Dhe tani le të hulumtojmë në argumentet, në historinë e zbritjes së këtij ajeti, historinë e jetës së Profetit dhe transmetimet e ndryshme nga burimet e shumta islame, për të mësuar se cila ditë është kjo ditë e madhëruar.

Vallë, a është ajo ditë në të cilën All'llahu i Lartësuar ka zbritur këto rregulla që përmenden në këtë ajet, veçanërisht të lejuarat dhe të ndaluarat e këtyre llojeve të mishit për t'u ngrënë? Është e natyrshme se nuk është ajo, sepse zbritja e këtyre rregullave nuk obligon për t'i dhënë këtë rëndësi kaq të madhe kësaj dite dhe këto rregulla nuk mund të jenë shkak i plotësimit të fesë, sepse ato nuk janë rregullat e fundit që janë zbritur për Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Argument i kësaj thënieje janë rregullat që janë shpallur më pas. Gjithashtu, nuk mund të thuhet se këto rregulla ishin shkak për dëshpërimin e jobesimtarëve, por ajo çfarë i dëshpëron jobesimtarët është ekzistenca e një mbështetjeje dhe argumenti të fortë dhe të palëvizshëm për të ardhmen e Islamit. Thënë ndryshe: zbritja e rregullave të lejimit apo të ndalimit të ngrënies së mishit të kafshëve nuk lë ndonjë ndikim tek jobesimtarët. Atëherë, çfarë dëmi do t'u vijë atyre nëse disa lloje mishi janë të lejuar dhe disa janë të ndaluar?!

Pyetje: A është qëllimi në këtë ditë, dita e Arafatit prej Haxhit të lamtumirës, Haxhi i fundit që ka bërë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sikurse kanë thënë disa komentues të Kur'anit?

Përgjigje: Përgjigjja e kësaj pyetjeje është përsëri mohuese, sepse argumentet e treguara nuk përputhen me këtë komentim, për shkak se nuk ka ndodhur asnjë ngjarje e rëndësishme në një ditë të tillë që të dëshpërohen jobesimtarët. Nëse qëllimi i kësaj dite është për t'u treguar numrin e madh të myslimanëve, të cilët

e shoqëruan Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në ditën e Arafatit, ë shtë po ky numër i madh i myslimanëve që e rrethonte Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) edhe në Mekë përpara kësaj dite. Nëse qëllimi me këtë ditë është zbritja e rregullave të përmendura, atë herë ato rregulla nuk kanë qenë të rëndësishme dhe të frikshme për jobesimtarët.

Pastaj, a është qëllimi me këtë "ditë" dita e çlirimit të Mekës, siç mendojnë disa? Dihet se surja "El Maide" ka zbritur pas një periudhe të gjatë nga çlirimi i Mekës!

Apo është qëllimi me ditën në të cilën janë shpallur ajetet e sures "Et Teube". Mirëpo ajetet e kësaj sureje janë shpallur shumë më përpara sures "El Maide".

Ajo që është më e çuditshmja e të gjitha thënieve, është thënia se kjo ditë është dita e ardhjes së Islamit dhe e dërgimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), edhe pse këto dy ngjarje nuk kanë asnjë lloj lidhjeje kohore ndërmjet tyre dhe ditës së zbritjes së këtij ajeti. Ndërmjet këtyre dy ngjarjeve dhe zbritjes së këtij ajeti ka një periudhë kohore shumë të largët.

Kështu na qartësohet se asnjë nga këto gjashtë mendimet e përmendura nuk përshtatet me përmbajtjen e këtij ajeti.

Neve na mbetet një mendim i fundit, të cilin e kanë përmendur të gjithë komentuesit shiit në komentimet e tyre dhe e kanë përkrahur atë sugjerim. Gjithashtu, e kanë përforcuar transmetime të shumta. Ky mendim përshtatet plotësisht me kontekstin e këtij ajeti, i cili e konsideron ditën e Gadijr Khumit, "*jeum gadijr khum*", ditën në të cilën Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka caktuar Aliun (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) prijës të myslimanëve në mënyrë legjitime, të hapur dhe e

ka shpallur khalife të tij. Në këtë ditë jobesimtarët janë frikësuar dhe janë dëshpëruar. Ata hamendësonin se me vdekjen e Profetit do të mbarojë dhe çdo gjë do të kthehej siç ishte më përpara në kohën e injorancës (para Islamit). Por kur ata panë se Profeti caktoi për khalif (zëvendës dhe prijës), pas tij një burrë që ishte i vetëm në mesin e myslimanëve për veprat, devotshmërinë, forcën dhe drejtësinë e tij dhe ai është Ali ibn Ebi Talibi (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) dhe kur panë Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që i dha besën Aliut, ata i mbuloi dëshpërim nga të gjitha anët dhe i humbën shpresat për atë çfarë kishin parashikuar për t'i bërë keq në të ardhmen Islamit. Atëherë, ata e mësuan se kjo fe do të qëndrojë përherë e fortë.

Në ditën e "*Gadijr Khum-it*", feja është plotësuar sepse po të mos caktohej zëvendës pas Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk do të ishte përcaktuar e ardhmja e ummetit islam, nuk do të plotësohej sheriatu pa atë dhe nuk do të plotësohej as feja.

Po, Në ditën e "*Gadijr Khum-it*", All'llahu e plotësoi dhuntinë e Tij me caktimin e Aliut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), këtë personalitet të përshtatshëm, udhëheqës dhe prijës të umetit, pas vdekjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në këtë ditë, All'llahu e ka përsosur fenë islame, jo vetëm kaq, Ai i ka vulosur të gjitha fetë me Islamin, pasi u plotësuan legjislacionet e kësaj feje.

Më poshtë po paraqesim argumente të tjera që e përforcojnë dhe e përkrahin këtë komentim:

1- Komentimet e "*Raziut*", "*Ruhul Meanij*" dhe "*El Menar*" në komentimin e këtij ajeti përmendin se Profeti (*Paqja dhe*

bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk ka jetuar më shumë se 81 ditë pas zbritjes së këtij ajeti.¹ Në këtë çështje në vetevete është shumë tërheqëse sepse kur vërejmë që Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka vdekur në ditën e dymbëdhjetë të Rabiul Evelit², (sipas transmetimeve që kanë ardhur në burimet e dijetarëve të Ehli Sunetit, madje edhe në disa transmetime të ardhura nga Shiat, sikurse e ka treguar Kulejni në librin e tij të njohur “El Kafij), konkludojmë se zbritja e këtij ajeti ka ndodhur saktësisht në ditën e tetëmbëdhjetë të muajit Dhul Hixheh që është edhe dita e “*Gadijr Khum-it*”³.

2- Kanë ardhur shumë transmetime nga burimet e librave të Ehli sunetit dhe të shiave se ky ajet është shpallur në ditën e “*Gadijr Khum-it*” pasi Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i informoi myslimanët se Ali ibn Ebi Talibi është prijësi i myslimanëve (velij). Prej atyre transmetimeve përmendim:

1- Dijetari i shquar suni, ibn Xherir Et Tabarij ka transmetuar në librin e tij “El Vilajetu” nga **Zejd ibn Erkam**, sahabij i njohur, se ky ajet ka zbritur ditën e “*Gadijr Khamit*” për Ali ibn Ebi Talibin.

2- El Hafidhu, “**Ebu Naim El Isfahani**” ka transmetuar në librin e tij “*Ma nuzile fil Kur'ani bi she'ni Ali*”, nga **Ebi Said El Khuderij**”, një sahabij i njohur, se Profeti (*Paqja dhe bekimet e*

¹ Tefsir El Kebir, vëll. 11, f. 139

² Usulul Kafij, vëll. 1, f. 439.

³ Sigurisht, kjo llogaritje është e saktë nëse ditën e vdekjes së Profetit dhe ditën e Gadijr Khum-it nuk i fusim në llogaritje dhe në të tre muajt pandërprerë numri i ditëve të tyre të jetë 29 ditë një muaj, si dhe duke marrë parasysh që as para dhe as pas ndodhisë së Gadijrit nuk ka ndodhur asnjë ndodhi tjetër historike. Është më e vërtetë që dita e përmendur në ajet është dita e Gadijr Khum-it.

All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i ka dhënë Aliut ditën e *Gadijr Khumit* postin e prijësit. Në të vërtetë, në këtë ditë njerëzit nuk u larguan derisa zbriti ajeti: **“Sot, jua përsosa fenë tuaj...”**. Në atë moment, Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha: *“All'llahu është më i Madhi që e përsosi fenë, e plotësoi dhuntinë e Tij, që është i kënaqur me mesazhin tim dhe me vilajetin e Aliut prijës pas meje.”* Pastaj tha: *“Për kë kam qenë prijës i tij, Aliu është prijës i tij. O All'llah, duaje atë që e don atë (Aliun) dhe luftoje atë që e lufton atë (Aliun), ndihmoje atë që ndihmon atë (Aliun) dhe poshtëroje atë që e poshtëron atë (Aliun)!”*

3- Khatijbul Bagdadi transmeton në historinë e tij nga **“Ebu Hurejra”** se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë se ajeti **“Sot jua përsosa fenë tuaj...”** ka zbritur pas ngjarjes së *Gadijr Khum-it* dhe besëlidhjes për udhëheqje Aliut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe pas thënies së Umer ibn Khatabit: *“Urime, urime për ty o ibn Ebi Talibi, u bëre udhëheqësi im dhe i çdo myslimani.”*¹

Në librin *“El Gadijr”*, përveç këtyre tri transmetimeve, janë përmendur edhe trembëdhjetë transmetime të tjera për këtë çështje.

Në librin *“Ihkakul Hak”*, marrë nga vëllimi i dytë i tefsirit të **Ibn Kethirit** në faqen 14, dhe nga libri *“Maktal El Khavarizmi”* në faqen 47, është përmendur thënia e ardhur nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili ka thënë se ky ajet ka zbritur në ngjarjen e *Gadijr Khum-it*.

¹ Eruditi El Emijni i ka përmendur këto tre transmetime me detaje në librin e tij *“El Gadijr”*, vëll. 1, 230, 231 dhe 232. Po ashtu në *“Ihkakul Hak”*, vëll. 6, f. 353, është përmendur se ky ajet ka zbritur në ndodhinë e *Gadijr Khum-it*, përcjellë nga Ebu Hurejra nga të dy grupet (sunitët dhe shiitët). Gjithashtu, ato i përcjell edhe Ebi Said el Khuderij në disa variante.

Në tefsirin “*El Burhan*” dhe në tefsirin “*Nurul Thakalejn*” vërejmë dhjetë transmetime të transmetuar në rrugë të ndryshme rreth zbritjes së ajetit për të drejtën e Aliut (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!) në ditën e *Gadijr Khum-it*. Transmetimi i të gjitha këtyre haditheve kërkon një libër të veçantë.¹

Dijetari i shquar **Sejd Abdul Husejn Sherefu Dijn** në librin e tij “*El Muraxheat*” ka përmendur se transmetimet e sakta të ardhura nga dy Imamët, Imam Bakiri dhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi ta!*), thonë se ky ajet ka zbritur në ditën e *Gadijr Khum-it*. Gjithashtu, dijetarët e sunetit kanë transmetuar gjashtë hadithe me zinxhir transmetimi të ndryshëm, të cilat tregojnë se ky ajet ka zbritur në ndodhinë e *Gadijr Khum-it*.²

Nga të gjithë ato që u thanë më lart sqarohet se të gjitha transmetimet që tregojnë se ky ajet ka zbritur në ndodhinë e “*Gadijr Khum-it*” nuk janë prej transmetimeve “*ehaad*”, të cilat mund të konsiderohen transmetime të dobëta për nga zinxhirët e transmetimit. Por, këto transmetime edhe nëse nuk arrijnë gradën (*mutevetir*), e pakëta janë “*ekhhbarun mustefijdh*” të cilat i kanë përcjellë burime të njohura islame.

Me gjithë këto, shohim disa dijetarë fanatikë nga dijetarët e Ehli Sunetit, si Alusij në tefsirin e tij “*Ruhul Meanij*”, i cili nuk i njeh këto hadithe që kanë ardhur në këtë fushë për shkak se kanë zinxhir transmetimi të dobët. Ata dijetarë thonë se këto transmetime janë të pabaza ose të pavërteta, sepse nuk janë në përshtatje me shijen e tyre personale. Disa e kanë parë këtë ajet kalimthi, pa ndaluar në të, sikurse është në tefsirin “*El Manar*”. Ndoshta autori i këtij tefsiri e ka gjetur vetveten e tij në një dilemë përballë këtyre transmetimeve dhe i ka quajtur të dobëta. Me këtë

¹ Shih Tefsijru Thekalejn dhe tefsijrul Burhan, fundi i ajetit në fjalë.

² Shih: El Muraxheat, letra 12, f. 38

veprim ai ka kundërshtuar logjikën e drejtësisë sepse nëse do t'i pranonte, do të vepronte në kundërshtim me animin e tij dhe shijen e tij.

Në suren “En Nur”, në ajetin 55 përmendet diçka shumë e rëndësishme, ndaj së cilës duhet treguar kujdes. Ajeti thotë: **“All’llahu u ka premtuar atyre prej jush që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira se do të bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t’ua forcojmë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t’ua shndërrojmë në siguri...”** Në këtë ajet All’llahu i Lartësuar tregon, se Ai vetë ka premtuar se do t’i forcojë dhe do t’i mbrojë parimet dhe mëkëmbësit e kësaj feje, të cilën Ai e ka dashur në këtë tokë për besimtarët. Duke vërejtur këtë sure, që është shpallur përpara sures “El Maide” dhe duke shikuar fjalinë që ka ardhur në këtë ajet **“Sot jua përsosa fenë tuaj”**, e cila ka zbritur për Ali ibn Ebi Talibin, nxjerrim si konkluzion se rregullat islame forcohen në tokë nëse shoqërohen me udhëheqjen, sepse Islami është feja të cilën e ka dashur All’llahu dhe ka premtuar për forcimin dhe ruajtjen e tij. Thënë ndryshe: Nëse duhet që Islami të përfshijë të gjithë botën, ai nuk duhet që të ndahet nga udhëheqja e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!).

Ndërsa çështja e dytë, të cilën e konkludojmë në përmbajtjen e ajetit të sures “En Nur” dhe të këtij ajeti në fjalë, është se ajeti i parë u ka dhënë besimtarëve tri premtime, të cilat janë:

I pari: Khilafeti (udhëheqja) në tokë.

I dyti: Realizimi i sigurisë dhe i qëndrueshmërisë me qëllim që të adhurohet vetëm All’llahu.

I treti: Qëndrueshmësia e kësaj feje, të cilën e ka dashtë vetë All’llahu i Lartësuar në tokë.

Këto tre premtime janë realizuar në ditën e ndodhisë së *Gadijr Khum-it* me zbritjen e këtij ajeti: **“Sot jua përsosa fenë tuaj”**. Shembulli i një njeriu besimtar e të singertë është Aliu, të cilin Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ka caktuar zëvendës. Këtë e tregon shprehja e ajetit që thotë: **“Sot dëshpërohen ata që nuk besojnë dhe kanë humbur çdo shpresë, që t'ju largojnë prej fesë suaj”**, pra, siguria është realizuar në një formë relative të besimtarët. Ndërsa shprehja e këtij ajeti **“dhe zgjedha që Islami të jetë feja juaj”** sqaron se me të vërtetë, All'llahu e ka zgjedhur fenë me të cilën Ai është i kënaqur dhe e ka vendosur atë në mesin e robëve të tij myslimanë.

Ky komentim nuk bie në kundërshtim me transmetimin, i cili tregon se me të vërtetë ajeti i sures “En Nur” ka zbritur për çështjen e Mehdiut të shumëpritur (All'llahu e shpejtoftë ardhjen e tij)¹. Kjo për faktin se fraza: **“atyre prej jush që besojnë”** ka një kuptim të gjerë, ku njëra prej atyre kuptimeve është realizuar ditën e *Gadijr Khum-it* dhe do të realizohet më gjerë në kohën e ardhjes së Mehdiut të premtuar.

Pyetja që shtrohet

Në fund ka mbetur një pyetje e rëndësishme:

Së pari: Argumentet e këtij ajeti dhe argumentet e tjera, të cilat do të vijnë në komentimin e ajetit 67 të sures “El Maide”, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **“O i dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt!”**, nëse janë të veçantë për një ngjarje të vetme, atëherë përse Kur'ani i ka ndarë këto dy ajete dhe nuk kanë ardhur njëri pas tjetrit në të njëjtin vend?

¹ Mexhmaul Bejan, vëll. 7, f. 267.

Së dyti: Nuk ka lidhje tematike ndërmjet pjesës së këtij ajeti, e cila flet për ndodhinë e *Gadijr Khumit* dhe pjesës tjetër të ajetit, e cila bën fjalë për lejimin dhe ndalimin e ngrënies së mishit. Cili është shkaku i këtij ndryshimi në aparence?

Përgjigje:

E para: Ne e dimë se ajetet e Kur'anit, gjithashtu edhe suret, nuk janë grumbulluar të gjitha dhe nuk janë renditur sipas zbritjes së tyre kohore, por vërejmë se shumë sure që kanë zbritur në Medine, kanë ajete që kanë zbritur në Mekë, siç vërejmë edhe ajetet medinase ndërmjet sureve që kanë zbritur në Mekë gjithashtu.

Duke u bazuar në këtë të vërtetë, atëherë nuk është e habitshme prania e kësaj ndarjeje në Kur'an ndërmjet dy ajeteve. (Duhet pohuar se renditja e ajeteve të Kur'anit dhe të sureve në atë formë që shohim sot, është bërë me urdhrin e vetë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).) Nëse ajetet e Kur'anit do të ishin të renditura sipas zbritjes kohore, kundërshtimi do të ishte me vend në këtë çështje.

Së dyti: Një supozim mund të jetë se shkaku i përzierjes së ndodhisë së "*Gadijr Khum-it*" në këtë ajet përfshin një temë që nuk ka asnjë lidhje me këtë përzierje, njësoj si tematika e rregullave të lejimit dhe të ndalimit të ngrënies së mishit, e cila është për të ruajtur tematikën për të mos ndodhur në të devijimi apo ndryshimi dhe humbja.

Me të vërtetë, në kohët e fundit të jetës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kanë ndodhur shumë ngjarje. Një prej tyre ka qenë kundërshtimi i qartë me të cilin u përball Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kur kërkoi të shkruajë porosinë e tij. Ky kundërshtim arriti deri në atë gradë, sa që e cilësuan Profetin

(*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për kërkesën e tij në këtë çështje, se ai flet fjalë përçart, (All'llahu na ruajttë!). Të tilla ngjarje përmenden në librat e shquar islamë, si nga ato të dijetarëve të Ehlil sunetit dhe të shijave. Kjo tregon qartë për delikatesën e madhe të një grupi njerëzish për çështjen e khilafetit pas vdekjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku nuk lanë mënyrë pa përdorur për ta mohuar këtë çështje.¹

Nuk është e largët - në këtë gjendje - që masat mbrojtëse për të ruajtur argumentet dhe dokumentet e veçanta për khilafetin (udhëheqjen) për të arritur te brezat që vijnë më pas, të mos preken nga duart e ndryshimit apo devijimit. Prej atyre masave ruajtëse është përzierja, bashkimi i tematikës së udhëheqjes, që është shumë i rëndësishëm, në Kur'an mes ajeteve dhe rregullave legislative, me qëllim largimin e syve dhe të duarve të kundërshtarëve dhe sharlatanëve që të luajnë me to.

Në shtesë të kësaj, siç thamë edhe më lart, argumentet e veçanta për zbritjen e këtij ajeti: **"Sot jua përsosa fenë tuaj"**, i cili ka zbritur ka ardhur për ndodhinë e "*Gadijr Khum-it*" dhe për çështjen e udhëheqjes pas Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk përmenden vetëm në librat e shijave, por atë e kanë përcjellë dhe e përmendin edhe shumë libra të Ehlil sunetit me rrugë të ndryshme nga tre sahabë të njohur.

¹ Këtë ndodhi e përmendin librat më të njohur të sunitëve që është Sahihu i Bukharit në disa kapituj prej tyre kapitulli i të sëmureve, vëll. 4, kapitulli i dijes, vëll.1, f. 22. Xheuaz Uafid prej kapitullit të xhihadit, vëll. 2, 118. Po ashtu përmendet edhe në Sahih Muslim, vëll. 2, f. 14 në fund të testamenteve. Përveç këtyre ka edhe libra të tjerë të cilët i ka përmendur i ndjeri Sejjid Abdul Husejn Sherefudijn në librin e tij "El Muraxheat" në tematikën "Rrazijetu Jeumil Khamijs".

Në fund, ajeti kthehet e tregon ndalimin e ngrënies së mishit që është i ndaluar dhe ka qartësuar rregullin kur mund të përdoren llojet e ndryshme të mishit të ndaluar: në rast se njeriu vuan nga uria me kusht që mos të jetë qëllimi i personit për të bërë mëkat. Ajeti tregon mëshirën dhe faljen e All'Ilahut të Lartësuar kur robtë e Tij janë në vështirësi dhe nuk i ndëshkon ata në këto raste. Ajeti thotë: **"Por kushdo që është i shtrënguar nga uria (dhe ha çfarë është e ndaluar), pa pasur qëllim të bëjë gjynah, do ta shohë se All'Ilahu është Falës e Mëshirëplotë."**

Qëllimi i fjalës "*mukhasamet*" në këtë ajet është për urinë e madhe e të fortë, e cila shkakton dhimbje të stomakut, sido që të jetë rasti i urisë së përgjithshme apo e veçantë nga gjërat e ndaluara.

Ndërsa thënia **"pa pasur qëllim të bëjë gjynah"**, ka kuptimin e mosanimimit për të bërë mëkat dhe mund të ketë ardhur në këtë ajet për të përforcuar kuptimin e të domosdoshmes dhe të nevojës për ta ngrënë këtë mish. Ose qëllimi i kësaj thënie këtu është ndalimi apo neglizhenca në ngrënien e mishit të ndaluar në rastet e domosdoshme dhe personi të mos hamendësojë se ajo është e lejuar në këtë rast njësoj si në rastet e zakonshme. I ndalohet personit që të mundohet të përgatisë premiset për t'u ndjerë ngusht ose të ndodhë që të ngushtohet, dhe ai të niset për udhëtim me qëllim që të kryejë vepra të ndaluara.

Të gjitha këto kuptime përfshihen në thelbin e shprehjes së fundit të këtij ajeti. Për të mësuar më shumë sqarime në këtë fushë shih vëllimin e parë të këtij tefsiri.

Ajeti 4

يَسْأَلُونَكَ مَاذَا أُحِلَّ لَهُمْ قُلْ أُحِلَّ لَكُمُ الطَّيِّبَاتُ وَمَا عَلَّمْتُم مِّنَ الْجَوَارِحِ
مُكَلِّبِينَ تَعْمَوْنَ مِمَّا عَلَّمَكُمُ اللَّهُ فَكُلُوا مِمَّا أَمْسَكَنَّ عَلَيْكُمْ وَاذْكُرُوا اسْمَ
اللَّهِ عَلَيْهِ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ سَرِيعُ الْحِسَابِ ﴿٤﴾

"Të pyesin ty ç'është e lejueshme që të hanë. Thuaju (o Muhammed): 'Ju lejohet juve çdo gjë që është e dëlirë dhe atë që jua gjuajnë shtazët që i keni stërvitur e i përdorni në gjueti, ashtu siç ju ka mësuar All'illahu. Pra, hani atë që jua sjellin, e përmendni emrin e All'illahut! Frikësojuni All'illahut! All'illahu është i shpejtë në llogari.'"

Shkaku i zbritjes

Komentuesit e Kur'anit kanë përmendur shkaqe të shumta për zbritjen e këtij ajeti, shumica e të cilave janë në përshtatje me kontekstin e këtij ajeti. Shkaku është se Zejdul Khajr dhe Uduj ibn Hatim, të cilët kanë qenë prej shokëve të afërt të Profetit, shkuan te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'illahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e lajmëruan se populli i tyre bën gjueti me ndërmjetësimin e qenve dhe të skifterëve gjuetarë. Këta qen gjuajnë për ta kafshë të egra, që e kanë mishin e lejuar dhe nganjëherë kafshët e gjuajtura i sjellin të gjalla dhe i therin. Herë

tjetër i sjellin të vrara dhe të ngordhura përpara se të arrijnë tek i zoti i tyre, pa u dhënë mundësi që ata t'i therin. Ata e pyetën Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për rregullin e gjuetisë dhe të vrasjes me ndërmjetësim e qenve e skifterëve gjuetarë, a konsiderohet ngordhësirë dhe e ndaluar apo jo. Ky ajet ka zbritur duke iu përgjigjur pyetjes së këtyre dy sahabëve.

Komentimi

Gjuetia e lejuar

Ky ajet vjen pas dy ajeteve të mëparshëm që trajtuan rregullat e lejimit dhe të ndalimit të ngrënies së mishit.

Ajeti në fjalë sqaron një lloj tjetër mishi apo kafshësh, që u lejohen njeriut për t'i përdorur. Ai ka ardhur në formën e përgjigjes së pyetjes që e përmend po vetë ajeti ku thotë: **“Të pyesin ty ç’është e lejueshme që të hamë.”**

Së pari ajeti e urdhëron Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'i lajmërojë ata se çdo gjë që është e pastër dhe e dëlirë është e lejuar, ku thotë: **“Thuaju (o Muhammed): Ju lejohet juve çdo gjë që është e dëlirë”**. Kjo tregon se çdo gjë që e ka ndaluar Islami, konsiderohet e shpifur, e papastër. Me të vërtetë ligji hyjnor nuk i ndalon absolutisht gjërat e pastra, të cilat i ka krijuar All'llahu që njerëzimi të përfitojë prej tyre, ku sistemi legjislativ vepron gjithmonë në koordinim të plotë me sistemin e krijimit në çdo vend.

Pastaj ajeti sqaron llojet e gjuetisë së lejuar dhe tregon gjuetinë që e sjell apo e gjuan kafsha e trajtuar që të gjuajë dhe e përforcon se kjo gjueti është e lejuar, ku thotë: **“Atë që jua gjuajnë shtazët që i keni stërvitur e i përdorni në gjueti ashtu siç ju ka mësuar All’l-lahu”**. Fjala "*xheuarah*" rrjedh nga fjala "*xherah*", e cila ka dy kuptime, përfitim dhe plagë me të cilën goditet trupi. Për këtë, është përdorur edhe për kafshët e stërvitura për gjueti, sido që të jenë, shpendë apo shtazë.

Emri "*xharihetu*", shumësi i së cilës është "*xhevarih*", ka kuptimin e kafshës e cila e plagos gjahun. Ose, me një kuptim tjetër, kafshë e cila i sjell përfitime të zotit të saj. Ndërsa të quajturit e pjesëve të trupit me emrin "*xhevarih*", është se njeriu me ndërmjetësimin e tyre kryen punë dhe përfitime.

Fjalja **“dhe atë që jua gjuajnë shtazët që i keni stërvitur e i përdorni në gjueti”**, përfshin të gjitha kafshët e stërvitura për gjueti. Mirëpo fjala "*mukelibijnë*", e cila do të thotë përgatitja dhe stërvitja e qenve për gjueti, rrjedh nga fjala "*kelebe*"-kelbun-, që do të thotë qen, e kushtëzon këtë fjali dhe e veçanton për qentë e gjuetisë. Për këtë, ajo nuk përfshin gjuetinë e kafshëve, përveç të qenve, skifterët dhe shqiponjat që janë stërvitur për gjueti.

Për këtë, juristët (fukahatë) shiitë kanë mendimin se lejimi i gjuetisë është vetëm me qen të stërvitur për gjueti. Kurse dijetarët e Ehlil sunetit dhe komentuesit e tyre kanë mendimin se lejimi i gjuetisë është me të gjithë qentë. Ata i kanë dhënë një komentim të gjerë fjalës "*mukelibijn*" dhe nuk e kanë veçuar vetëm me qentë e gjuetisë.

Është e natyrshme se gjahu që e sjell kafsha tjetër e trajnuar konsiderohet e lejuar në rastin kur ajo ta sjell të gjallë dhe theret sipas rregullave islame.

Ndërsa fjalia tjetër **“që i kemi stërvitur e i përdorni në gjueti, ashtu siç iu ka mësuar All’llahu”** tregon disa çështje, si:

1) Me të vërtetë, stërvitja e këtyre kafshëve duhet të jetë e vazhdueshme. Nëse ato harrojnë gjërat që kanë mësuar dhe e vrasin kafshën, siç veprojnë qentë e rrugëve, në këtë rast kjo nuk konsiderohet gjueti dhe nuk lejohet ngrënia e mishit të këtyre kafshëve që janë vrarë në këtë mënyrë. Argument për këtë është se folja *"tualimunehunne"* ka ardhur në kohën e tashme dhe folja në kohën e tashme (*mudaria*), në gjuhën arabe, tregon të tashmen dhe të ardhmen.

2) Stërvitja e këtyre qenve duhet të bëhet sipas rregullave dhe parimeve të drejta që përshtaten me kuptimin e frazës kur'anorë që thotë: **“Ashtu siç ju ka mësuar All’llahu”**.

Në të vërtetë, burimi i të gjitha dijeve, të lehta apo të ndërlikuara, burimin e kanë te All’llahu i Lartësuar dhe njeriu nuk zotëron asnjë gjë, përveç asaj që All’llahu i Lartësuar ia ka mësuar.

Përveç asaj që u përmend, qentë e gjuetisë duhet të stërviten në atë mënyrë që të zbatojnë urdhërat e të zotit të tyre, pra, të shkojë e të kthehet me urdhrin e tij.

Është e natyrshme se kafshët të cilat i gjuajnë qentë e gjuetisë, nëse sillen të gjalla, duhet të theren sipas mënyrës së lejuar nga Sheriati. Nëse gjahu ka ngordh përpara se qentë ta arrijnë atë, mishi i tij është i lejuar, edhe nëse nuk theret.

Në fund, ky ajet tregon dy kushte të tjera nga kushtet e lejimit të kësaj lloji gjuetie.

E para: Qeni të mos hajë asgjë nga gjuetia, ku thotë: **“Pra hani atë që ju sjellin”**. Për këtë, nëse qentë hanë diçka nga gjahu përpara se t’ia çojnë të zotit dhe lënë një pjesë tjetër nga gjahu, atëherë pjesa e mbetur nuk lejohet të hahet dhe ngrënia e tij futet në grupin e mishit të ndaluar, ku All’llahu i Lartësuar thotë: **“e**

mishit të asaj që është kafshuar nga egërsirat", i cili u përmend në ajetin e mëparshëm. Ky lloj qeni që ha gjahun nuk konsiderohet qen i stërvitur. Po ashtu, pjesa që ka lënë nga gjuetia, nuk konsiderohet vërtetësi për shprehjen: **"Atë që jua sjellin"**, sepse në këtë rast qeni konsiderohet se ka gjuajtur për veten e tij. Me fjalë përmbledhëse: Qentë e gjuetisë duhen që të stërviten në atë mënyrë që të mos të hanë asnjë gjë nga gjahu që kapin.

E dyta: Domosdoshmëria e përmendjes së emrit të All'Ilahut për kafshën, pasi ta ketë lënë atë qeni ku ajeti thotë: **"e përmendni emrin e All'Ilahut."**

Për të siguruar ruajtjen e të gjitha këtyre rregullave hyjnore, në fund ajeti përforcon duke thënë: **"Frikësojuni All'Ilahut! All'Ilahu është i shpejtë në llogari."** Ajeti bën thirrje për ta pasur frikë All'Ilahun e Lartësuar e të Plotfuqishëm, sepse Ai është i shpejtë në përlllogaritjen e veprave tona.

Ajeti 5

الْيَوْمَ أُحِلَّ لَكُمْ الطَّيِّبَاتُ وَطَعَامُ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ حِلٌّ لَكُمْ وَطَعَامُكُمْ
 حِلٌّ لَهُمْ وَالْمُحْصَنَاتُ مِنَ الْمُؤْمِنَاتِ وَالْمُحْصَنَاتُ مِنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ
 مِنْ قَبْلِكُمْ إِذَا آتَيْتُمُوهُنَّ أَجُورَهُنَّ مُحْصِنِينَ غَيْرَ مُسْفِحِينَ وَلَا مُتَّخِذِي
 أَخْدَانٍ ۚ وَمَنْ يَكْفُرْ بِالْإِيمَانِ فَقَدْ حَبِطَ عَمَلُهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنْ
 الْخَسِرِينَ ﴿٥﴾

"Sot ju janë lejuar gjërat e mira e të pastra. Ju janë lejuar edhe
 ushqimet e ithtarëve të Librit; po ashtu, edhe ushqimet tuaja
 janë të lejuara për ata. Të lejuara për ju janë femrat e ndershme
 besimtare dhe femrat e ndershme të atyre që u është dhënë Libri
 para jush, nëse ju u jepni pajën e kurorëzimit, duke u martuar
 me ato, e jo duke bërë kurvëri, as duke i marrë për dashnore.
 Kushdo që mohon besimin, veprat e tij do të zhvlerësohen dhe
 në Jetën Tjetër ai do të jetë i dështuar."

Komentimi

Rregulli i ushqimit të ithtarëve të Librit dhe rregulli i martesës me ta

Ky ajet, i cili ka ardhur si plotësues i ajeteve të mëparshëm, trajton një lloj tjetër të ushqimeve që janë të lejuara (hallall). Ai ka sqaruar se çdo ushqim i pastër është i lejuar dhe ushqimi i ithtarëve të Librit (jehudinjëve dhe të krishterëve) është i lejuar për myslimanët dhe ushqimi i myslimanëve është i lejuar për ithtarët e Librit. Ajeti thotë: **“Sot ju janë lejuar gjërat e mira, të mira e të pastra, ju janë lejuar edhe ushqimet e ithtarëve të Librit; po ashtu, edhe ushqimet tuaja janë të lejuara për ata.”** Ky ajet përmbledh disa çështje, të cilat duhen patur parasysh. Ato janë:

1 - Fjala "*el jeum*" dita, e cila ka ardhur në këtë ajet, është për ditën e Arafatit, bazuar në atë çfarë mendojnë disa komentues të Kur'anit. Disa të tjerë thonë se qëllimi i fjalës "*ditë*" është dita e çlirimit të Hajberit. Nuk është e largët që të jetë e njëjta ditë me ditën e "*Gadijr Khum-it*", në të cilën u realizuar triumfi i plotë i myslimanëve ndaj jobesimtarëve (këtë temë do ta trajtojmë në vijim).

2- Ky ajet trajton çështjen e lejimit të të mirave, që kanë qenë të lejuara përpara zbritjes së këtij ajeti. Qëllimi i kësaj çështjeje është qartësimi i rregullit të ushqimit të ithtarëve të Librit.

3- Cili është qëllimi i shprehjes **“ushqimi i ithtarëve të Librit”**, të cilin ky ajet e ka konsideruar të lejuar për myslimanët?

Shumica e komentuesve të Kur'anit dhe dijetarët e Ehlil sunetit besojnë se "**ushqimi i ithtarëve të Librit**" në këtë ajet përfshin të gjitha llojet e ushqimit, qoftë mish i therur nga vetë ata, apo ushqime të tjera. Kurse shumica e komentuesve dhe e juristëve shiit thonë se qëllimi me "**ushqimet e ithtarëve të Librit**" nuk është për mishin që theret nga duart e tyre. Por, një pakice e tyre gjithashtu, thonë për rregullsinë e teorisë që pasojnë dijetarët sunit.

Mendimin e shumicës së dijetaqrëve shiit e përforcojnë hadithet e shumta të ardhura nga Imamët e Ehlill Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Ka ardhur në tefsirin e Ali ibn Ibrahim nga Imam Sadiku (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), se ai ka thënë për këtë ajet: "*Këtu e kam qëllimin për ushqimin e tyre, drithërat, frutat dhe ato që nuk theren, se me të vërtetë ata nuk e përmendin emrin e All'llahut kur therin.*"¹

Transmetime të shumta në këtë fushë kanë ardhur në vëllimin e 16 të librit "*Uesailu Shia*", në kapitullin 51, ku flitet për ushqimet dhe pijet, faqe 371.

Duke e hedhur vështrimin në ajetet e mëparshme, qartësohet se komentimi i dytë, në të cilin kanë anuar shumica e komentuesve dhe e dijetarëve të shijave është më afër së vërtetës se sa komentimi i parë. Dhe kjo, sikurse e ka shpjeguar Imam Sadiku (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në transmetimin e mësipërm, sepse ithtarët e Librit nuk i zbatojnë rregullat islame në therjen e bagëtive të tyre. Ata nuk e përmendin emrin e All'llahut kur therin, nuk e drejtojnë kafshën drejt kiblës kur e therin, sikurse nuk i zbatojnë kushtet e tjera. A është e logjikshme që ajeti i mëparshëm ta ndalojë në formë të prerë ngrënien e mishit të

¹ Tefsiri "Ali ibn Ibrahim Kumi", vëllimi 1, faqe 163. "Biharul Enuar", vëllimi 16, faqe 21.

kafshëve të therura në këtë formë dhe ajeti tjetër të vijë në kundërshtim me të dhe ta lejojë atë?!

Për këtë çështje në mendje lindin pyetje të cilat po i përkufizojmë si vijon:

1- Nëse është qëllimi për ushqimin janë të gjitha ushqimet, përveç mishit të therur nga ithtarët e Librit, atëherë këto ushqime kanë qenë të lejuara edhe më përpara dhe nuk ka ndryshim mes ekzistencës së tyre në duart e ithtarëve të Librit apo në duart e të tjerëve. A ka qenë blerja e frutave dhe e perimeve nga ithtarët e Librit para se të zbriste ky ajet në kundërshtim me Sheriatin, ndërkohë që myslimanët gjithmonë kanë bashkëpunuar me ithtarët e Librit në shitblerjet e këtyre gjërave?!

Nëse i drejtohem pikës themelore të këtij ajeti, na qartësohet përgjigjja e kësaj pyetjeje. Ky ajet ka zbritur në kohën kur Islami ka pasur pushtet të plotë në Gadishullin Arabik dhe Islami e konstatoi praninë e tij në të gjitha fushat e këtij Gadishulli. Ndërkohë, armiqtë e Islamit i kaploi frika dhe dëshpërimi i plotë për shkak të paaftësisë së tyre për t'i mposhtur myslimanët. Për këtë ishte e domosdoshme që në këto rrethana të përshtatshme për myslimanët, t'i heqin kushtet dhe kufijtë e imponuara më parë në fushën e përzierjes së myslimanëve me të tjerët, të cilët kanë qenë shkak për mosshkëmbimin e vizitave të myslimanëve me të tjerët.

Për këtë arsye ka zbritur ky ajet kur'anor, i cili ka lajmëruar lehtësimin e këtyre kushteve dhe kufijve të bashkëpunimit dhe të bashkëjetesës me ithtarët e Librit, pasi u forcuan shtyllat dhe bazat e udhëheqjes islame. Për këtë nuk gjendej asgjë negative që të frikësoheshin jomyslimanëve. Ajeti lejoi shkëmbimin e vizitave ndërmjet myslimanëve dhe

jomyslimanëve, ushqimin e njëri-tjetrit, si dhe ka lejuar martesën me ta (por në bazë të disa kushteve, të cilat do t'i shpjegojmë).

Është e vlefshme të thuhet se ata që nuk e shohin të pastër ushqimin e ithtarëve të Librit, kanë vendosur kushte për ushqimin e tyre ndër to është që të mos jetë i lagësht apo i njomë. Nëse ushqimi i tyre është i lagësht, është kusht që ithtarët e Librit të mos e prekin me duart e tyre, sepse myslimanët mund ta përdorin këtë ushqim. Ngrënia e ushqimit të ithtarëve të Librit nuk lejohet nëse nuk plotësohen këto kushte.

Me përjashtim të një grupi tjetër dijetarësh, të cilët e konsiderojnë të pastër ushqimin e ithtarëve të Librit dhe nuk shohin ndonjë arsye për të mos u ushqyer me ushqimin e tyre, me kusht që ushqimi i tyre të mos jetë nga mishi i therur nga ata dhe të sigurohet bindje se ushqimi nuk është ndyrë nga papastërtitë anësore (të mos jetë ndyrë me përzierien me pije alkoolike apo me preken e pijeve alkoolike).

Përmbledhja e kësaj fjalie, me të vërtetë është se ajeti ka ardhur për të hequr kufirin dhe kushtet e mëparshme të posaçme për bashkëjetesën me ithtarët e Librit. Argument për këtë është tregimi i ajetit për lejimin e ushqimit të myslimanëve për ithtarët e Librit, pra, lejimin e myslimanëve që t'i mirëprësin ata. Pas kësaj, ajeti, në mënyrë të drejtpërdrejtë, flet për rregullën e martesës së myslimanëve me ithtarët e Librit (martesa me gratë e ithtarëve të Librit).

Është e natyrshme se sistemi i cili zotëron pushtet të plotë ndaj gjendjes së shoqërisë, është i vetmi system i aftë për të nxjerrë këto rregulla për dobi të ndjekësve të tij, pa u shkaktuar asnjë shqetësim e asnjë armiqësi. Në të vërtetë, kjo gjendje është shfaqur në ndodhinë e ditës së *Gadijru Khum* apo në ditën e *Arafit* të Haxhit

të lamtumirës, siç besojnë disa, ose pas çlirimit të Hajberit, megjithëse dita e Gadijr Khum-it është më afër kësaj tematike.

Autori i tefsirit “El Menar” ka përmendur një kundërshtim tjetër në librin e tij në komentimin e këtij ajeti. Ai thotë se fjala "ushqim" (taamun) ka ardhur në shumë ajete të Kur'anit, me kuptimin e të gjitha llojeve të ushqimit, ku përfshin edhe mishin. Si është e mundur që ajeti të kufizohet me frutat e drithërat e të tjera si këto? Pastaj thotë se e ka shprehur këtë kundërshtim dhe në një tubim ku kanë qenë një grup prej shiave dhe askush nuk ju përgjigj pyetjes.

Në bindjen tonë, përgjegjësia e kundërshtimit të autorit të librit “El Menar” është e qartë. Ne nuk e mohojmë se fjala ushqim përmban një kuptim të gjerë. Mirëpo, ajo që ka ardhur në ajetet e mëparshme, si shpjegimi i llojeve të mishit të ndaluar dhe në veçanti mishi që theret pa u përmendur emri i All'llahut, e veçon kuptimin e fjalës ushqim dhe në këtë ajet e kufizon pa përmendur mishin. Askush nuk e mohon se çdo rregull i përgjithshme apo i pakufizuar pranon veçim dhe kufizim. Siç e dimë, ithtarët e Librit nuk interesohen për përmendjen e emrit të All'llahut, kur i therin kafshët e tyre, sikurse nuk i ruajnë kushtet që kanë ardhur në sunet, kur therin bagëtitë.

Rreth komentimit të këtij ajeti në librin “Kenzul Urfan” ka ardhur një kundërshtim tjetër, përkufizimi i së cilit është se fjala *tajjibat*, që do të thotë *gjërat e mira e të pastra*, ka një kuptim të gjerë dhe është e përgjithshme, sipas terminologjisë. Kurse, fjalia: **“...edhe ushqimet e ithtarëve të Librit”**, është e posaçme. Është e natyrshme se përmendja e të veçantës pas të përgjithshmes duhet që të ketë një shkak, por shkakun në këtë rast është i paqartë. Pastaj,

autori i këtij libri i lutet All'Ilahut të Lartësuar që t'ia zgjidhë këtë çështje komplekse.¹

Me të vërtetë, përgjigjja e këtij kundërshtimi, gjithashtu, qartësohet edhe nga ajo çfarë thamë më lart, sepse ajeti ka përdorur frazën: **“ju janë lejuar gjërat e mira e të pastra”**, si parathënie (premisë) për të larguar kushtet për t'u afruar me ithtarët e Librit.

Ky ajët thotë se çdo gjë e mirë dhe e pastër është e lejuar për myslimanët. Bazuar në këtë, ushqimi i ithtarëve të Librit (nëse është i pastër e i mirë), gjithashtu, është i lejuar për myslimanët. Kufijtë dhe kushtet që pengonin afrimitetin e myslimanëve me ithtarët e Librit u hoqën apo u lehtësuan në këtë ditë, pas fitoreve që korrrën myslimanët.

Rregulla e martesës me jomyslimanet

Pasi sqaroi lejimin e ngrënies së ushqimit të ithtarëve të Librit, ky ajët flet për martesën e femrave të ndershme myslimane dhe atyre të ithtarëve të Librit. Ajeti thotë se myslimanët mund të martohen me femra të ndershme të myslimanëve dhe të ithtarëve të Librit, me kusht që t'u japin atyre dhuratën ose prikën e martesës (mehrini) ku thotë: **“të lejuara për ju janë femrat e ndershme besimtare dhe femrat e ndershme të atyre që u është dhënë Libri para jush, nëse ju u jepni pajën e kurorëzimit.”** Duhet që kjo lidhje martesore të jetë e ligjshme dhe jo të jetë kurvëri (zina) dhe as bashkëjetesë e fshehur. Ajeti thotë: **“duke u**

¹ Tefsiri “Kenzul Urfan”, vëllimi 2, faqe 312.

martuar me ato, e jo duke bërë kurvëri, as duke i marrë ato për dashnore.”¹

Kjo pjesë e këtij ajeti në të vërtetë pakëson kufijtë që kanë qenë të obliguar në martesën ndërmjet myslimanëve dhe të tjerëve (ithtarëve të Librit). Kjo qartëson lejimin e martesës së myslimanit me femrën e ithtarëve të Librit, sipas kushteve të posaçme.

Juristët myslimanë (fukahatë) kanë mendime të ndryshme në lejimin e martesës së myslimanit me femrën e ithtarëve të Librit.

Ata thonë se: A kufizohet (martesa) me një periudhë të përkohshme apo i përfshin të dy llojet e martesës, të përkohshmen dhe të përhershmen?

Dijetarët suni nuk bëjnë dallim ndërmjet këtyre dy llojeve të martesës në këtë rast. Ata besojnë se ajeti është i përgjithshëm. Ndërsa një grup dijetarësh shiit mendojnë se ajeti është i kufizuar në martesën e përkohshme. Këtë mendim e mbështesin transmetimet e ardhura nga Imamët e Ehlil Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Treguesit që ekzistojnë në këtë ajet mund të jenë argument për këtë mendim.

Argument i parë është fjala e All'Ilahut: **“nëse ju u jepni pajën e kurorëzimit”**. Edhe pse fjala *"el exher"* përdoret për mehrin në të dy llojet e martesës: të përkohshme dhe të përhershme; por, në të shumtën e rasteve vjen për të shpjeguar mehrin në martesën e përkohshme, pra, kjo fjalë është në përshtatje më shumë me martesën e përkohshme.

Ndërsa argument i dytë është fjala e All'Ilahut të Lartësuar: **“e jo duke bërë kurvëri, as duke i marrë për dashnore.”** Kjo përshtatet

¹ Në komentimin e ajetit 25 të këtij xhuzi sqaruam se fjala "اخذان" "akhdan", në origjinalitet ka kuptimin e shokut. Në disa raste përdoret për shoqëri të fshehtë jo ligjore me gjininë tjetër.

më shumë me martesën e përkohshme, sepse në martesën e përhershme nuk ka asgjë të ngjashme me kurvërinë, imoralitetin apo dashnoren e fshehtë që të ndalojë atë. Disa njerëz mendjelehtë, nganjëherë e ngatërrojnë martesën e përkohshme me kurvërinë dhe dashnoren e fshehtë të jashtëligjshme.

Në të gjithë këtë, shtojmë përmendjen e këtyre frazave në ajetin 25 të sures “En Nisa”. Siç e dimë ai ajet ka zbritur për çështjen e lejimit të martesës së përkohshme.

Me gjithë këto, ka shumë dijetarë që e lejojnë martesën me ithtaret e Librit në formë të prerë dhe nuk i konsiderojnë të njaftueshme argumentet e cekura për veçimin e këtij ajeti. Po ashtu, e argumentojnë këtë gjë me disa transmetime (për më tepër sqarime në këtë fushë është e vlefshme që t’u referoheni librave të jurisprudencës islame).

Nuk është e fshehur ajo çfarë është e përhapur sot në botë nga traditat e injorancës në forma të ndryshme. Prej atyre është zgjedhja haptazi e femrës për dashnore nga mashkulli. Njeriu sot ka shkuar më larg se njeriu në kohën e injorancës në lejimin e lakuriqësisë dhe çmendurisë seksuale. Në kohën e injorancës njeriu e zgjidhte dashnoren fshehtë, ndërsa sot nuk e ka për turp që ta prezantojë këtë çështje dhe të krenohet për këtë gjë me mburrje dhe pa pikën e turpit. Kjo traditë barbare dhe e fëlliqur është nga veprat e këqija dhe të shpifura, e cila u transportua nga Perëndimi në Lindje dhe është bërë burim i shumë katastrofave.

Nuk duhet të harrojmë pa qartësuar këtë pikë se: Ajeti e ka lejuar përdorimin e ushqimit të ithtarëve të Librit, sikurse e ka lejuar ushqimin e tyre, sipas kushteve që treguam, ndërsa në çështjen e martesës ka lejuar vetëm martesën me femrat e ithtarëve të Librit, ndërsa femrës myslimane nuk i lejohet që të martohet me burrat e ithtarëve të Librit.

Filozofia në këtë çështje është e qartë dhe nuk ka nevojë për shpjegim, sepse femrat, për shkak të ndjenjave të brendshme të dobëta, kanë më shumë gjasa që të ndikohen nga mendimet e bashkëshortit të tyre.

Me qëllim që ajeti të mbyllë rrugën e shfrytëzimit dhe të keqpërdorimit të afrimitetit me ithtarët e Librit dhe të martesës me femrat e tyre, të disa zemrave të sëmura, në fund i paralajmëron myslimanët duke thënë: **“Kushdo që mohon besimin, veprat e tij do të zhvlerësohen, në Jetën Tjetër ai do të jetë i dështuar.”**

Kjo tregon se lehtësimi që ka ardhur në këtë ajet dhe se ajeti largon pengesat dhe vështirësitë në jetën e myslimanëve, këto lehtësira duhet të jenë shkak që të depërtojë Islami në shpirtrat e jomyslimanëve dhe myslimanët të mos bien pre e ndikimeve të tjerëve dhe të lenë fenë e tyre, gjë që do t'i çojë ata drejt ndëshkimit të rreptë të All'llahut.

Gjendet supozim tjetër në komentimin e kësaj pjese të ajetit, bazuar në disa transmetime që kanë ardhur për shkakun e zbritjes së përmendur. Ai është se një grup myslimanësh, pasi ka zbritur ky ajet dhe pas lejimit të ushqimit të ithtarëve të Librit dhe martesës me femrat e ithtarëve të Librit, e kanë shprehur haptazi shqetësimin e tyre për zbatimin e këtyre rregullave. Ky ajet u ka hequr vërejtjen për kundërshtimin e rregullës së All'llahut dhe mohimit të këtij rregulli. Ai u tërheq vërejtjen se veprat e tyre nuk do të kenë vlerë dhe përfundimi i tyre do të jetë në humbje të plotë.

Ajeti 6

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ
وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ^ج
وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَاطَّهَّرُوا^ج وَإِنْ كُنْتُمْ مَرْضَى أَوْ عَلَى سَفَرٍ أَوْ جَاءَ
أَحَدٌ مِّنْكُمْ مِّنَ الْغَايِطِ أَوْ لَمَسْتُمُ النِّسَاءَ فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا
صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا بِوُجُوهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ مِنْهُ^ج مَا يُرِيدُ اللَّهُ
لِيَجْعَلَ عَلَيْكُمْ مِّنْ حَرَجٍ وَلَٰكِنْ يُرِيدُ لِيُطَهِّرَكُمْ وَلِيُتِمَّ نِعْمَتَهُ
عَلَيْكُمْ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٦﴾

"O ju që keni besuar! Kur doni të falni namaz, lani fytyrën dhe duart deri në bërryla dhe fshijeni kokën me dorë të lagët dhe këmbët deri në nyje. Nëse jeni të papastër pastrohuni. Por, në qoftë se jeni të sëmurë ose gjendeni në udhëtim, ose ndonjëri nga ju vjen pas kryerjes së nevojës natyrore, ose nëse keni pasur marrëdhënie me bashkëshortet e nuk gjeni ujë, atëherë gjeni dhë të pastër dhe fshini fytyrat e duart me të. All'llahu nuk dëshiron t'ju krijojë ndonjë vështirësi, por dëshiron t'ju pastrojë dhe t'i plotësojë dhuntitë e Tij ndaj jush, që të jeni falënderues."

Pastrimi i trupit dhe i shpirtit

Ajetet e mëparshme kanë trajtuar tematika të shumta për mirësitë trupore dhe të mirat materiale, ndërsa ky ajet bën fjalë për të mirat shpirtërore dhe që janë shkak për të pastruar shpirtin e njeriut. Ky ajet ka qartësuar rregullat, si të abdesit, guslit dhe të tejemumit, të cilat janë shkak në pastërtinë dhe në pastrimin e shpirtit të njeriut.

Në fillim, ajeti u drejtohet besimtarëve duke u sqaruar rregullat e abdesit, për të cilat All'llahu i Lartësuar thotë: **"O ju që keni besuar! Kur doni të falni namaz, lani fytyrën dhe duart deri në bërryla dhe fshijeni kokën me dorë të lagët dhe këmbët deri në nyje..."** Ajeti nuk ka qartësuar pjesët që duhen larë kur merret abdes, por transmetimet që kanë ardhur nga Imamët e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), e kanë shpjeguar në mënyrë të detajuar mënyrën se si Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka marrë abdes.

1- Me të vërtetë, kufiri i fytyrës për së gjati është nga rrënja e flokëve mbi ballë, deri në përfundim të mjekrës dhe për së gjeri është distanca ndërmjet gishtit të mesëm dhe gishtit të madh. Kjo është ajo çfarë quhet dhe kuptohet në mesin e njerëzve për fytyrën, sepse fytyra është ajo pjesë e trupit që njeriu shfaq kur takohet me njerëzit e tjerë.

2- Ajeti ka treguar kufirin se deri ku duhet të lahen duart kur të merret abdes. Ai tregon se duhet të lahen duart deri te bërrylat. Në ajet ka ardhur qartë deri te bërrylat, që të mos e hamendësojnë se larja duhet të bëhet deri te kyçet, sikurse është zakon kur lahen duart. Nga ky shpjegim qartësohet se fjala "*ila*", që do të thotë *deri*, që ka ardhur në këtë ajet, ajo është vetëm për të sqaruar cakun e larjes së duarve dhe jo për të sqaruar mënyrën e

larjes, sikurse e kanë keqkuptuar disa të cilët kanë menduar se qëllimi në këtë ajet është për larjen e duarve duke filluar te majat e gishtërinjve e deri te bërrylat (kjo mënyrë është e njohur te Ehlil Suneti).

Për të qartësuar këtë çështje themi: Kur një njeri kërkon nga bojaxhiu që të lyejë murin e dhomës nga bazamenti i tokës deri në lartësinë një metër, nga kjo kuptohet se nuk kërkohet nga bojaxhiu që ta bëjë punën nga poshtë deri lart. Përmendja e këtyre kufinjve është vetëm për të qartësuar sipërfaqen që duhet të lyhet, as më pak dhe as më shumë. Duke u bazuar në këtë, me të vërtetë, ajeti nëpërmjet përmendjes së kufinjve të dorës sqaron pjesët që duhen larë dhe jo mënyrën se si të lahen. Transmetimet e ardhura nga Ehlil Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) kanë sqaruar mënyrën e larjes sipas sunetit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe ajo është larja e duarve nga bërrylat e deri te majat e gishtërinjve. Duhet që të kemi kujdes gjithashtu se edhe bërrylat duhen të lahen gjatë abdesit, se qëllimi në këto raste përfshihet në kontekstin e përgjithshëm, pra kufiri përfshihet në rregullën e të kufizuarit.¹

3- Me të vërtetë, germa "be" që do të thotë *me*, që ka ardhur në fjalinë "kurse kokën fshijeni me dorë" (*bi-rru-usikum*), në këtë ajet ka për qëllim që të fshihet një pjesë e kokës, siç e kanë qartësuar disa transmetime dhe e kanë miratuar atë disa dijetarë të gjuhës. Qëllimi është sigurisht fshirja e një pjese të kokës, siç e kanë përforcuar transmetimet shiite se një pjesë e kokës do të

¹ Sibeuejhi, i cili është prej dijetarëve të shquar të gjuhës arabe, ka përmendur se ajo gjë që përmendet pas frazës "ila" dhe ajo që përmendet para saj, nga një lloj i përbashkët, ajo që përmendet pas përfshihet në rregull. Ndërsa, kur janë dy lloje të ndryshme, ajo që përmedet pas nuk përfshihet në rregull. Nëse thuhet: mbaje agjërimin deri në orën e fundit të ditës, kuptimi i kësaj fjalie është se imsaku (mbajtja e agjërimin) përfshin edhe orën e fundit të ditës. Kurse, nëse thuhet: Mbaje që në fillim të natës, atëherë fillimi i natës nuk përfshihet në rregullën e imsakut. (Tefsijrul Menar, vëll. 6, f. 223.)

thotë një e katërta e saj nga pjesa e përparme e kokës. Duhet të fshihet me dorë një pjesë e kësaj një të katërtës, qoftë edhe e pakët. Ajo çfarë është e përhapur te disa grupacione të Ehlil sunetit, që është fshirja e të gjithë kohës derisa edhe veshët, nuk është e përshtatshme me kuptimin e këtij ajeti.

4- Me të vërtetë, lidhja e frazës "erxhulekum", *këmbët tuaja*, me frazën "ruusekum", *kokat tuaja*, është argument se edhe këmbët duhen fshirë gjithashtu, dhe jo të lahen. Zanorja "e" që ka ardhur mbi germën "lam" te fraza "erxhulekum", këmbët tuaja, tregon se ajo është e lidhur me frazën "ruusikum", *kokat tuaja* dhe nuk është e lidhur me frazën "dhe fytyrat tuaja, uuxhuhekum."

5- Fjala "k'ab" në gjuhësi do të thotë të fryrën pas këmbës. Gjithashtu do të thotë kyçi që lidh shputën e këmbës me kërcellin. Pas të gjithave këtyre, ajeti sqaron rregullën e pastrimit nga papastërtia (*xhunubi*), ku thotë: **"...Nëse jeni të papastër, pastrohuni..."** Është e qartë se qëllimi me fjalën "pastrohuni" është që të pastrohet i tërë trupi, por nëse do të ishte qëllim që të lahet një pjesë e veçantë e trupit, sepse po të ishte qëllimi për një pjesë të caktuar nga trupi do të përmendej ajo pjesë e trupit. Duke u bazuar në këtë të vërtetë, fjalia e mësipërme ka kuptimin që të lahet e të pastrohet i gjithë trupi. I njëjti rregull ka ardhur në ajetin 43 të sures "En Nisa", ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"derisa të laheni."**

Me të vërtetë, fjala "*xhunub*" që do të thotë *i papastër*, sikurse e kemi shpjeguar në vëllimin e tretë të këtij komentimi, kur kemi komentuar ajetin 43 të sures "En Nisa", në rrënjën e saj do të thotë *të largohesh*, sepse rrënja e saj është papastërtia (*xhenabetu*), që do të thotë largim. Shkaku i përdorimit të kësaj fjalie për njeriun e papastër është se ky njeri duhet të largohet nga

namazi (sigurisht nuk i lejohet që të falë namaz, kur është i papastër) dhe i ndalohej që të hyjë në xhami dhe të tjera si këto.

Kjo fjalë, "*xhunub*", përdoret për njëjësin e shumësin për gjininë femërore e mashkullore. Mund të argumentojmë me këtë ajet, i cili i bën thirrje atij që është i papastër nga *xhunubi* për t'u pastruar përpara se të falet, se larja nga papastërtia (guslul *xhenabeh*) e zëvendëson edhe abdesin. Pra, kur njerui merr guslin e *xhunubit* nuk është nevoja të marrë abdes.

Pastaj ajeti vazhdon e shpjegon rregullën e *tejemumit*, ku thotë: **"...Por në qoftë se jeni të sëmure, ose gjendeni në udhëtim, ose ndonjëri nga ju vjen pas kryerjes së nevojës natyrore, ose nëse keni pasur marrëdhënie me bashkëshortët e nuk gjeni ujë, atëherë gjeni dhë të pastër..."**

Këtu duhet patur parasysh se fjalia **"...ose ndonjëri nga ju vjen pas kryerjes së nevojës natyrore"**, dhe fjalia: **"ose keni pasur marrëdhënie me bashkëshortët..."**, sikurse e kemi treguar edhe më përpara, këto dy fjali janë të lidhura (nga ana gjuhësore), me fillimin e këtij ajeti, pra me fjalinë: **"Kur doni të falni namaz"**.

Nëse këto dy fjali i lidhim me fjalinë **"ose gjendeni në udhëtim"**, do të përballemi me problemin se: kthimi i njeriut pas kryerjes së nevojës natyrore nuk mund të jetë si gjendja e sëmundjes apo udhëtimit. Këto nuk kanë ngjashmëri me njëra-tjetrën. Për këtë jemi detyruar që të marrim pjesëzën "*eu*", që ka ardhur në këtë ajet, me kuptimin e "*uauit*" lidhëz (këtë çështje e kanë përforcuar një grup komentuesish) dhe kjo është në kundërshtim me aparcencën e ajetit.

Ndërsa çështje tjetër është përsëritja e tematikës së papastërtisë (*xhunubit*) dy herë në këtë ajet. Ka mundësi që qëllimi i përsëritjes mund të jetë përforcim i kësaj çështjeje. Ose mund të jetë kuptimi i fjalës papastërti (*xhunub*), që ka ardhur në

këtë ajet, me kuptimin e papastërtisë (xhunubit) që shkaktohet gjatë gjumit ose gjatë ëndërrimit. Ndërsa qëllimi me fjalën **“ose nëse keni pasur marrëdhënie me bashkëshortet”**, është për papastërtinë (xhunubin) që ndodh si rezultat i kontaktit seksual midis burrit dhe gruas. Nëse e komentojmë fjalën *"kumtum"* çoheni, që ka ardhur në këtë ajet, me kuptimin e *ngritjes nga gjumi* (sikurse ka ardhur në transmetimet e Imamëve të Ehlil Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), gjithashtu, ky ajet përfshin argumentet për këtë veçim specifik, ky komentim i jonë është përforcues për kuptimin që e përmendëm në veçorinë e përsëritjes së tematikës së xhunubit.

Pas kësaj, ajeti ka qartësuar mënyrën e marrjes së tejemumit në një formë përmbledhëse, ku thotë: **“...fshini duart dhe fytyrën me të...”**. Këtu është e qartë se qëllimi nuk është të marrësh diçka nga dheu dhe të fshish fytyrën dhe duart me të. Por qëllimi është të prekësh me pëllëmbët e dy duarve tokën e pastër, pastaj të fshish fytyrën dhe dy duart me të. Mirëpo, disa dijetarë kanë argumentuar me fjalën **“me të”** që gjendet në këtë ajet dhe kanë thënë se është e domosdoshme që të ngjitet diçka qoftë edhe sado pak prej dheut.¹

Në këtë fushë ka mbetur edhe çështja e fundit, e cila është kuptimi i dy fjalëve: **“dhë të pastër”**. Shumica e dijetarëve të gjuhës kanë thënë se fjala *"saijd"*, që do të thotë *dhë*, ka dy kuptime: e para është tokë ose çdo gjë që mbulon sipërfaqen e tokës; e dyta, dhë, apo gurë, apo shkëmb, e të tjera si këto. Kjo ka çuar në lindjen e mendimeve të ndryshme tek dijetarët rreth asaj

¹ Në komentimin e ajetit 43 të sures "Nisa" i kemi sqaruar në formë të detajuar rregullat e tejemumit dhe filozofinë e tij islame se tejemumi ka anë mbrojtëse për shëndetin. Po ashtu kemi sqaruar kuptimin e fjalës "gait" dhe çështje të tjera. Për këtë kthehuni te komentimi i ajetit 43 të sures "Nisa".

me të cilën lejohet marrja e tejumit me të, se a është vetëm dhëu, apo guri, apo rëra apo diçka tjetër e ngjashme me këto?

Po të kthehemi në rrënjën e fjalës nga ana gjuhësore që do të thotë *gjë e ngritur dhe e lartë dhe mbi sipërfaqen e tokës*, atëherë, kuptimi i dytë i kësaj fjale është më i afërt e më i pranueshëm në mendje.

Fjala *të pastër, tajjib*, përdoret për gjërat që janë të përshtatshme me natyrën dhe shijen e njeriut. Kur'ani Famëlartë e ka përdorur në shumë vende këtë fjalë, si *qytet i pastër, vendbanime të pastra, erë e mirë dhe e pastër, jetë e pastër e begatë*, etj. Në të vërtetë, çdo gjë e pastër konsiderohet e mirë, sepse natyra e njeriut largohet nga gjërat e pista dhe të ndyta. Nga kjo argumentojmë se edhe dhëu me të cilin merret *tejemumi*, duhet të jetë gjithashtu i pastër. Këtë e përforcojnë edhe transmetimet që na kanë ardhur nga imamët e Islamit. Po sjellim një nga këto transmetime, i cili thotë: "*Prijësi i besimtarëve, (Aliu), ka ndaluar që një njeri të marrë tejum nga dheu i rrugës.*"¹

Duhet theksuar se fjala *tejumum*, që ka ardhur në Kur'an dhe në hadith, me kuptimin e obligimit legjislativ, për të cilin folëm më parë, në gjuhësi kjo fjalë vjen me kuptimin e qëllimit "*kasd*". Kur'ani Famëlartë ka cakuar që kur njeriu ka për qëllim të marrë *tejumum*, duhet të zgjedhë një pjesë toke të pastër nga pjesët e ndryshme të saj. Duhet të jetë ajo pjesë toke që i përputhet kuptimit "*të pastër*", të cilën e kap shiu, dielli dhe era. Atë pjesë toke nuk duhet ta kenë shkelur këmbët dhe të ketë cilësitë që përfitohen nga fjala "*tajjib*", *të pastër*. Në këtë mënyrë, kjo pjesë toke jo vetëm që nuk dëmton shëndetin, por, sikurse e kemi shpjeguar në komentimin e ajetit 43 të sures "En Nisa", ajo ndikon

¹ Uesailu Shiia, vëll. 2, f. 969.

edhe në vrasjen e mikrobeve, siç thonë edhe dijetarët e specializuar në këtë fushë.

Dy hulumtime

1- Filozofia e abdesit dhe e tejemumit

E kemi trajtuar filozofinë e tejemumit në një mënyrë të plotë kur kemi komentuar ajetin 43 të sures “En Nisa”. Për sa i përket filozofisë së abdesit, është një çështje që nuk ka asnjë kundërshtim sepse abdesi ka dy dobi të qarta:

E para është dobia shëndetësore, kurse *e dyta* është dobia morale dhe shpirtërore. Larja e fytyrës dhe e duarve pesë herë në ditë, ose më e pakta tre herë në ditë, ka dobi në pastërtinë e njeriut dhe në shëndetin e tij. Kurse dobia morale dhe shpirtërore qëndron në ndikimin edukativ si pasojë e qëllimit të afrimit të All'llahu. Ky qëllim ndikon shumë në shpirtin e njeriut kur bën nijet marrjen e abdesit. Ne e dimë se kuptimi i brendshëm i nijetin do të thotë lëvizjet e njeriut gjatë abdesit duke filluar nga koka dhe përfundon te këmbët, të cilat janë lëvizje të bindjes ndaj All'llahut. Pra, kur merr abdes, njeriu i bindet urdhrit të All'llahut dhe e zbaton atë.

Në transmetimin e Imam Ali ibn Musa Rida (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) lexojmë thënien e tij: “Me të vërtetë jami urdhëruar për abdes dhe ta zbatojmë atë, që robi të jetë i pastër kur ngrihet (për të falur namazin) para All'llahut të Plotfuqishëm dhe kur t'i drejtohet me lutje Atij; të jetë i bindur ndaj Tij në atë çfarë e ka urdhëruar, i pastër nga papastërtitë. Me këtë, ai largon edhe përtacinë

dhe plogështinë e gjumit dhe pastron zemrën për të dalë para të Gjithfuqishmit.”¹

2- Filozofia e guslit

Disa mund të pyesin: Përse ka ardhur Islami që të lahet i gjithë trurin pasi personi bëhet *khunub*, ndërkohë që vetëm një organ i caktuar bëhet i papastër e i ndytë në këtë rast? A ka ndryshim mes urinës që del nga ky organ dhe spermës që del po nga ky organ nga kontakti seksual, ku në rastin e urinimit duhet të lahet e të pastrohet vetëm organi gjenital e të merret abdes, ndërsa në rastin e rrjedhjes së spermës duhet që të lahet i gjithë trupi, të bëhet gusl?

Për këtë pyetje ka dy përgjigje përmbledhëse dhe detajuese që janë si vijon: Përgjigjja përmbledhëse është se dalja e spermës nga njeriu, nuk kufizohet nga ndikimi i saj në organin që del prej tij. Pra, sperma nuk është si urina dhe si jashtëqitjet e tjera. Argument për këtë thënie është ndikimi i të gjithë trupit gjatë daljes së spermës nga organi gjenital. Kur del sperma, në të gjitha qelizat e trupit ndodh gjendja e plogështisë. Kjo gjendje është argument i ndikimit të xhynybit në të gjitha pjesët e trupit. Studimet e shkencëtarëve specialistë rreth kësaj çështjeje kanë treguar se në trurin e njeriut janë të vendosura dy seri nervash: Nervat lëvizëse dhe nervat frenuese. Këto shtrihen në të gjitha pjesët e trupit dhe në organet e tij. Nervat lëvizëse udhëheqin motivin e pjesëve të trupit për të punuar dhe ndikojnë në shpejtësinë e veprimit të tyre. Ndërsa nervat frenuese veprojnë të kundërtën e nervave të para. Këto bëjnë kufizimin e veprimit të organeve dhe ngadalësimin e tyre në veprim. Seria e nervave ë

¹ Uesailu Shiia, vëll. 1, f. 257. Biharul Anuar, vëll. 6, f. 64.

shtë se ata luajnë rolin e aparatit të shtyrjes së benzinës tek makina me qëllim që ta vënë në lëvizje atë, kurse seria e dytë e nervave luan rolin e frenave që e ndalon atë nga lëvizja. Nga ballancimi që arrihet nga këto dy seri nervash veprojnë të gjitha organet e trupit të njeriut në formë të ekuilibruar.

Nga një herë në trupin e njeriut ndodhin reagime që e pengojnë këtë balancë. Atëherë një nga këto dy seri nervore sundon veprimin e tjetrës. Prej këtyre reagimeve është arritja e njeriut në pikën e lartë të kënaqësisë seksuale, e cila quhet "orgazëm" që shoqërohet me daljen e spermës nga organi gjenital.

Në këtë rast sistemi nervor frenues mbizotëron mbi veprimin e sistemit nervor lëvizës dhe prishet balancimi në mënyrë negative në trupin e njeriut. Eksperimentet kanë konstatuar se mbërritja e ujit në trupin e njeriut mund të kthejë balancën ndërmjet këtyre dy sistemeve nervore. Meqenëse gjendja e "orgazmës" në të cilën arrijnë njerëzit kur bëhen xhynyb (i papastër), ndikon në formë të prekshme në organet e trupit të njeriut dhe prish balancën e këtyre dy sistemeve nervore, për këtë, Islami ka urdhëruar që njeriu të lajë të gjithë trupin e tij pas kryerjes së marrëdhënieve seksuale dhe në momentin kur të dalë sperma. Me anë të larjes së plotë rikthehet balanca e të vepruarit mes dy sistemeve nervore në të gjitha pjesët e trupit të njeriut dhe kthehet gjendja e natyrshme në lëvizje dhe në gjallëri.

Është e natyrshme se dobia e guslit nuk kufizohet vetëm në atë që thamë më lart, por në të vërtetë, gusli konsiderohet gjithashtu një lloj adhurimi, i cili ka një ndikim në moralin e njeriut. Për këtë arsye, gusli nuk pranohet nëse nuk është bërë nijeti për t'iu afruar dhe për t'iu bindur All'llahut të Lartësuar, sepse e vërteta është se si trupi ashtu edhe shpirti ndikohen në momentin kur del sperma nga njeriu dhe kur kryhet marrëdhënie

seksuale. Në këto momente shpirti shkon pas epsheve materiale dhe e çon trupin në plogështi e qetësi.

Larja nga papastërtia nënkupton larjen e të gjithë trupit, e cila përfshin procesin e arritjes së ujit në të gjitha pjesët e trupit. Konsiderohet pastrim edhe për shpirtin, sepse përmban nijetin për t'u afruar dhe për t'iu bindur All'llahut të Lartësuar. Pra, gusli ka dy ndikime: material dhe shpirtëror. Ndikimi material bën që trupi të rikthejë aktivitetin dhe energjinë kurse ndikimi shpirtëror e nxit shpirtin e njeriut për t'u afruar tek All'llahu i Lartësuar dhe te ana shpirtërore.

Në shtesë të atyre që u tha duhet shtuar se obligimi i pastrimit nga (*xhunubi*) në Islam, gjithashtu, ka si qëllim që trupi i myslimanit gjithmonë të jetë i pastër. Po ashtu ai ruan anën shëndetësore të njeriut. Ka shumë njerëz që nuk i japin rëndësi pastrimit të trupit, mirëpo ky urdhër dhe obligim islam i detyron ata që të lajnë trupat e tyre herë pas here.

Mos larja e trupit nuk është e kufizuar vetëm me kohët e shkuara sepse edhe sot ka shumë njerëz që nuk i japin rëndësi larjes së trupit të tyre nga *xhunubi* dhe neglizhojnë në këtë çështje (është e natyrshme se rregulla e pastrimit nga *xhunubi* (papastërtia) është një rregull i përgjithshëm dhe ligj gjithpërfshirës që përfshin edhe personin i cili është larë përpara se të bëhet xhynyb).

Në të vërtetë, këto tri anët e përmendura më parë, qartësojnë shkakun e obligimit të guslit në momentin që del sperma nga trupi i njeriut, qoftë në gjumë, apo zgjuar, gjithashtu, edhe pas marrëdhënies seksuale, (edhe nëse nuk del sperma).

Në mbyllje, ajeti qartëson se në urdhrat e All'llahut nuk ka vështirësi për njeriun, por në të vërtetë këta urdhra e obligime janë vënë për t'u sjellë dobi njerëzve. Ajeti thotë: "**... All'llahu nuk**

dëshiron t'ju krijojë ndonjë vështirësi, por dëshiron t'ju pastrojë dhe t'i plotësojë dhuntitë e Tij ndaj jush, që të jeni falënderues."

Kjo thënie e fundit e ajetit të Kur'anit përforcon se të gjitha rregullat dhe urdhrat e All'llahut si dhe dispozitat islame janë në dobi të njeriut dhe mbrojnë dobitë e tyre dhe nuk kanë qëllim tjetër. Me rregullat e përmendura në fund të ajetit, All'llahu dëshiron që njeriu të realizojë si pastërtinë e tij shpirtërore ashtu edhe atë trupore.

Duhet patur vëmendja se fjalia: **"All'llahu nuk dëshiron t'ju krijojë ndonjë vështirësi"**, edhe pse është përmedur në fund të ajeteve që përfshijnë rregullat e guslit, abdesit dhe të tejemumit, ajo sqaron një rregull të përgjithshëm, kuptimi i së cilës është se rregullat e All'llahut të Lartësuar nuk janë kurrë detyra dhe obligime të vështira. Nëse në ndonjë rregull islam do të kishte vështirësi për cilindo person, do të binte përgjegjësia dhe obligimi për atë person, bazuar te përjashtimi në fjalinë e fundit në këtë ajet. Për shembull, nëse agjërimi i krijon problem dhe vështirësi të mëdha dikujt për arsye të sëmundjes apo pleqërisë dhe të ngjashme si këto, ky person nuk e ka për obligim që të agjërojë duke u bazuar në këtë argument.

Nuk mund të fshihet gjithashtu se ka obligime dhe rregulla hyjnore, që shfaqin vështirësi në vetvete, si rregulla e xhihadit (lufta në rrugë të All'llahut). Mirëpo, duke bërë krahasimin e dobive me atë të vështirësive të xhihadit, mbizotëron ana e dobive dhe rëndësia e tij. Ligji që ka konstatuar fjalia e fundit në këtë ajet kur'anor është quajtur ligji "*la harexh*", jo vështirësi, i cili është parim bazë të cilin e përdorin jurstët në kapituj dhe tematika të ndryshme, për të nxjerrë sa më shumë rregulla.

Ajeti 7

وَاذْكُرُوا نِعْمَةَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَمِيثَاقَهُ الَّذِي وَاتَّخَذْتُمْ بِهِ إِذْ قُلْتُمْ
سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا ۖ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۚ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ﴿٧﴾

"Kujtoni mirësinë e All'llahut ndaj jush dhe besëlidhjen me të cilën ju ka vënë detyrimet, kur thatë: 'Dëgjuam dhe u bindëm!' Frikësojuni All'llahut. Vërtet, All'llahu di ç'keni në zemrat tua.".

Komentimi

Besëlidhja hyjnore

Ajeti i mëparshëm trajtoi një grup rregullash islame si dhe tematikën e plotësimit të mirësisë së All'llahut të Lartësuar ndaj myslimanëve. Ky ajet ka ardhur për të plotësuar vazhdimësinë tematike të ajeteve të mëparshme dhe i ka tërhequr vëmendjen myslimanëve për kureshtjë n, rëndësinë dhe madhështinë e mirësive të All'llahut, ku më e madhja dhe më e rëndësishmja e tyre është besimi, udhëzimi dhe Islami. Ajeti thotë: **"Kujtoni dhuntinë e All'llahut ndaj jush..."**. Edhe pse fjala "ni'mete", që do të thotë *mirësi*, në këtë ajet ka ardhur në numrin njëjës, por ajo është përmendur si emër lloji nga i cili përfitohet përgjithësim dhe nënkupton të gjitha mirësitë. Po ashtu, supozohet që të ketë për

qëllim mirësinë e Islamit në veçanti për të cilën tregoi edhe ajeti i mëparshëm në mënyrë përmbledhëse, ku thotë: **“dhe t'i plotësojë mirësitë e Tij ndaj jush.”** A ka mirësi më të madhe që nën hijen e Islamit njeriu të ketë të gjitha dhuntitë hyjnore, krenaritë dhe mundësitë potenciale të kësaj bote, pasi njerëzit përjetuan në kohën e injorancës përçarjen, injorancën dhe humbjen dhe mes tyre mbizotëronte ligji i xhunglës, shkatërrimi e mizoria? Falë mirësisë së Islamit ata u shndërruan në një shoqëri në të cilën sundonte uniteti, bashkimi dhe dituria dhe ecnin në rrugën e dhuntive, mirësive dhe të potencialit të lartë material dhe shpirtëror.

Pas kësaj, ajeti risjell në mendje besëlidhjen mes njerëzve dhe All'llahut të Lartësuar duke thënë: **“... dhe besëlidhjen me të cilën ju ka vënë detyrimet, kur thatë: ‘Dëgjuam dhe u bindëm...’”**.

Ka dy alternativa rreth kuptimit të fjalës "el ahd" dhe tematikës së saj që përmendet në ajet.

E para: Ka mundësi që të bëhet fjalë për besëlidhjen që bënë myslimanët në fillim të ardhjes së Islamit në ndodhinë e "Hudejbijes", apo në ndodhinë e "Haxhit të lamtumirës", apo besëlidhjes në "akabeh" bërë me All'llahun. Në mënyrë të përgjithshme është ajo besëlidhje që kanë bërë të gjithë myslimanët në një formë të sigurt e premtuese me All'llahun e Lartësuar në momentin kur ata e kanë pranuar Islamin.

E dyta: Qëllimi me besëlidhje në këtë ajet është besëlidhja që bën çdo person, bazuar në rregullën e krijimit dhe në natyrën e tij, me All'llahun, për të cilën thuhet se ajo është lidhur që përpara se me ardhur në këtë jetë.

Shpjegim i kësaj është se kur All'llahu i Lartësuar e ka krijuar njeriun ka vendosur në të shumë aftësi dhe dhunti dhe nga

këto mirësi është mirësia e dijes me të cilën zbulon sekretet e krijimit dhe me anë të saj realizohet njohja e së vërtetës. Po ashtu, edhe mirësi të tjera si mirësia e mendjes, e zgjuarsisë dhe e perceptimit, me qëllim që njeriu të njohë Profetët e All'llahut dhe të zbatojë urdhrat e tyre. All'llahu i Lartësuar kur i vendosi këto mirësi te njeriu, ka marrë nga ai besën se do t'i shfrytëzojë këto dhunti dhe mirësi në të mirë, nuk do t'i neglizhojë dhe nuk do t'i keqpërdorë dhe njeriu i përgjigjet duke thënë: **"Dëgjuam dhe u bindëm."**

Kjo besëlidhje konsiderohet si besëlidhja më e madhe, më konstante dhe më e përgjithshme që ka marrë All'llahu nga robtë e Vet.

Kjo është besëlidhja për të cilën Imam Ali ibn Ebu Talibi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) në fjalimin e tij të parë në librin "Nehxhul Belaga", thotë: *"Do t'i kërkojë atyre besën e natyrshmërisë që u mori prej tyre dhe zbatimin e saj."* Është e natyrshme që kjo besëlidhje e gjerë të përfshijë të gjitha çështjet dhe rregullat e fesë. Absolutisht, nuk është e mohueshme që ky ajet të tregojë për të gjitha besëlidhjet krijimtare dhe legjislative, të cilat i ka marrë All'llahu i Lartësuar dhe Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga myslimanët, bazuar në natyrën e tyre krijuese (*el fitratu*) në periudha të ndryshme.

Këtu na qartësohet hadithi që ka thënë se qëllimi me këtë besëlidhje është besëlidhja që ka marrë Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga myslimanët në Haxhin e lamtumirës, veçanërisht për prijësinë e Ali ibn Ebu Talibit si prijës të myslimanëve.¹ Ky komentim përputhet me atë që u përmend më lart. E kemi përsëritur shumë herë që komentimet që u bëhen ajeteve të Kur'anit nuk janë veçse një

¹ Tefsirul Burhan, vëll.1, f. 454.

shpjegim për një nga të vërtetat e qarta e kuptimplota në çdo ajet dhe, absolutisht, nuk do të thotë që të kufizohet kuptimi në një komentim të ardhur.

Është e vlefshme që të tregohet se fjala *mijthak* që rrjedh nga rrënja e fjalës *uithakatu* ose *uuthuk*, do të thotë *shtërngim i fortë i litarit* dhe të ngjashme me të. Sikurse përdoret për çdo vepër që të çon në qetësimin e mendjes dhe të ruan nga rreziku.

Në të vërtetë, besëlidhja është si lidhja që lidh dy persona apo dy grupe me njëri-tjetrin. Për këtë quhet "*mijthak*", *lidhje e fortë* apo *besëlidhje*.

Në përfundim, ajeti përforcon domosdoshmërinë e zbatimit të frikës dhe të devotshmërisë, duke paralajmëruar se All'llahu i di të fshehtat e njerëzve dhe çfarë kanë ata në zemrat e tyre duke thënë: **"...frikësojuni All'llahut. Vërtetë, All'llahu di ç'keni në zemrat tuaja."**

Shprehja "*në zemrat tuaja*" tregon se All'llahu i Lartësuar i di të fshehtat më të vogla të njerëzve që gjenden në thellësinë e zemrave të tyre, të cilat nuk mund t'i dijë askush përveç të Zotit. Sigurisht, All'llahu është i ditur në atë çfarë kanë njerëzit në zemrat e tyre.

Në vëllimin e parë të këtij komentimi kemi shpjeguar shkakun që dhemshuria, ndjenjat, qëllimet dhe vendosmëritë kanë lidhje me zemrën.

Ajetet 8 - 10

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ لِلَّهِ شُهَدَاءَ بِالْقِسْطِ ۚ وَلَا
يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ قَوْمٍ عَلَىٰ ءَلَّا تَعْدِلُوا ۚ اَعْدِلُوا هُوَ اَقْرَبُ
لِلتَّقْوَىٰ ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۚ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿٨﴾ وَعَدَ
اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ هُمْ مَغْفِرَةٌ وَّاجْرٌ عَظِيمٌ ﴿٩﴾
وَالَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا اُولَٰئِكَ اَصْحَابُ الْجَحِيمِ ﴿١٠﴾

"O ju që keni besuar. Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e All'Ilahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi. Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe jini të devotshëm ndaj All'Ilahut. Pa dyshim, All'Ilahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju."

"All'Ilahu u ka premtuar falje (të gjynaheve) dhe shpërblim të madh atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira."

"Sa për ata që nuk besojnë dhe mohojnë shpalljet Tona - ata do të jenë banorë të zjarrit."

Komentimi

Thirrja që bazohet në drejtësi

Ajeti i parë nga këto tri ajete bën thirrje për zbatimin dhe për realizimin e drejtësisë. Kjo thirrje është e ngjashme me atë që ka ardhur në ajetin 135 të sures "En Nisa". Ky ajet u drejtohet besimtarëve duke u thënë: **"O ju që keni besuar. Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e All'Ilahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi..."**

Më pas, ajeti tregon një nga shkaqet e devijimit nga drejtësia dhe i paralajmëron myslimanët nga ky devijim, duke u thënë se zënkat, armiqësitë farefisnore dhe luftërat personale nuk duhet të pengojnë realizimin e drejtësisë. Këto mosmarrëveshje nuk duhet që të jenë shkak për shkelur të drejtat e të tjerëve, sepse drejtësia është gjëja më e lartë dhe më e çmuar. Ajeti thotë: **"...Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi..."**

Ajeti përsërit për të dytën herë fjalën *drejtësi* për të përforcuar rëndësinë e madhe që ka drejtësia, ku sërish thotë: **"...Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë..."**

Përderisa drejtësia konsiderohet si një nga shtyllat më të rëndësishme të devotshmërisë dhe, për herë të tretë, ky ajet garanton edhe një herë duke thënë: **"...dhe jini të devotshëm ndaj All'Ilahut. Pa dyshim, All'Ilahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju."**

Ndryshimi i kuptimit të këtij ajeti dhe i ajetit 135, që ka ardhur i ngjashëm në suren "En Nisa", është si vijon:

Së pari: Në të vërtetë, ajeti i sures "En Nisa" bën thirrje për vendosjen e drejtësisë dhe të dhënies së dëshmisë për hir të

All'lahut. Ndërsa ajeti në fjalë bën thirrje që të jemi të qëndrueshëm në urdhrat e All'lahut, të dëshmojmë të vërtetën dhe drejtësinë. Ndoshta prania e ndryshimit mes dy ajeteve është se qëllimi i ajeti të përmendur në suren "En Nisa" ishte shpjegimi i domosdoshmërisë që dëshmia të jetë për All'lahun dhe jo për të afërmit e dëshmuesit. Ndërsa ky ajet, megjithëse flet për armiqhtë, ka përmendur edhe shprehjet si dëshmia e vërtetë dhe e drejtë, që do të thotë mos dhënie të dëshmisë së padrejtë dhe armiqësore.

Së dyti: Ajeti i sures "En Nisa" tregon për një nga faktorët e devijimit nga drejtësia. Ndërsa ajeti në fjalë tregon një faktor tjetër në këtë fushë. Ajeti i sures "En Nisa" përmend faktorin e dashurisë së ekzagjeruar, e cila nuk mbështetet në asnjë argument, ndërsa ky ajet përmend urrejtjen e ekzagjeruar, e cila nuk asnjë argument. Por këto dy ajete kanë një të përbashkët që bashkohen dhe ai është faktori i ndjekjes së egos, qejfeve dhe të tekave, për të cilat flet ajeti i parë, ku thotë: **"mos shkoni pas epsheve tuaja dhe të shtrembëroni drejtësinë"**¹, sepse epshi është burimi i çdo padrejtësie që lind nga nxitja e verbër, që është pas epshit dhe dobive personale.

Bazuar në këtë, burimi i vërtetë i devijimit nga drejtësia është ndjekja e epshit dhe e egos. Ka ardhur në fjalën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Imam Ali ibn Ebu Talibit (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*), të cilët kanë thënë: *"Ndjekja e epshit ndalon të vërtetën."*²

¹ Sure "En Nisa", ajeti 135.

² "Usulul Kafij", vëllimi 1, faqe 44.

Hulumtime

Drejtësia, shtylla më e rëndësishme e Islamit

Rrallë mund të gesh një çështje që i ka dhënë rëndësi aq të madhe feja islame dhe Kur'ani Famëlartë, sa çështja e drejtësisë dhe çështja e Njësimit të All'llahut, që janë të njëjta dhe rrënjët e së cilave degëzohen në të gjitha çështjet legislative të Islamit. Thënë ndryshe: Sikurse të gjitha çështjet e besimit, e veprave, ato shoqërore, individuale, morale dhe legislative, absolutisht nuk ndahen kurrë nga e vërteta e Njëshmërisë së All'llahut, "Teuhidit", po ashtu, të gjitha këto çështje nuk janë të zbrazëta nga shpirti i drejtësisë.

Nuk është e çuditshme që drejtësia të jetë një nga parimet e besimit e të fesë dhe një nga themelet bazë të mendimit islam. Ajo është një nga atributet e All'llahut të Lartësuar dhe përfshihet në esencën e parimeve të njohjes së All'llahut. Ajo ka kuptime të gjera në specifikat e saj. Për këtë kërkimet shoqërore në Islam i japin një rëndësinë shumë të madhe drejtësisë dhe mbështetjes në të. Për të mësuar rëndësinë e kësaj të vërtete, mjafton që të tregojmë disa hadithe të transmetuara:

1- Transmetohet nga i Dërguari i All'llahut , se ai ka thënë: *"Mjerë ju dhe padrejtësia sepse, me të vërtetë padrejtësia tek All'llahu do të jetë errësira në Ditën e Kijametit."*¹

Është e natyrshme se çdo gjë e mirë, e begatë janë prej dritës dhe në dritë. Vërtet, errësira është burimi i mospërfundimit.

¹ Sefinetul Bihar, vëllimi 1, faqe 105. Lënda "dhaleme".

2- Përsëri transmetohet nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai ka thënë: “Me drejtësi janë ngritur qiejt dhe toka”¹

Këto thënie konsiderohen nga thëniet më të qarta në çështjen e drejtësisë. Kuptimi i këtyre thënieve është se jo vetëm jeta njerëzore e kufizuar në sipërfaqen e tokës është e bazuar në drejtësi, porse jeta, ekzistenca e gjithësisë, qiejt e toka janë të ngritura të gjitha me drejtësi. Të gjitha janë nën hijen e ekuilibrit të fuqive që veprojnë në to. Ekzistenca e qëndrueshmërisë së çdo gjëje është si pasojë e këtyre fuqive. Nëse ato fuqi devijojnë nga ky ekuilibër vetëm për një moment, e gjithë ekzistenca do të shkatërrohej.

Këto fjalë i përforcon hadithi tjetër, kur thotë: “Udhëheqja qëndron me mosbesimin, por nuk qëndron me padrejtësinë.”² Sepse padrejtësia ka një ndikim të shpejtë në këtë botë dhe prej rezultateve të saj janë luftërat, shqetësimet, çoroditjet dhe krizat politike, shoqërore, morale dhe ekonomike që kanë kapluar sot mbarë botën.

Duhet theksuar fakti se interesimi i Islamit nuk është vetëm në drejtësinë si drejtësi, por ai i kushton rëndësi të madhe realizimit të drejtësisë. Është e natyrshme se vetëm leximi i këtyre ajeteve në tubime, në minbere apo shkrimi i tyre nëpër libra nuk sjellin dobi në rikthimin e drejtësisë së humbur dhe as në shërimin e dallimit shtresor dhe të shkatërrimit shoqëror të përhapur në shoqërinë islame. Por madhështia e këtyre ajeteve dhe rregullave qartësohen në ditën kur zbatohet drejtësia në jetën e myslimanëve. Pas këtij përforcimi të fortë që mbart ajeti rreth çështjes së drejtësisë dhe domosdoshmërisë së zbatimit të saj, ajeti pasardhës,

¹ Tefsir Safij, vëllimi 5, faqe 107.

² Biharul Enuar, vëllimi 72, faqe 331.

në përputhje me metodologjinë e Kur'anit, rikujton edhe një herë atë çfarë u ka premtuar All'Ilahu i Lartësuar besimtarëve që bëjnë vepra të mira nga falja dhe mirësitë e Tij të mëdhaja ku thotë: **“All'Ilahu u ka premtuar falje (të gjynaheve) dhe shpërblim të madh atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira”.**

Po ashtu, ajeti flet për ndëshkimin e jobesimtarëve, të cilët i përgënjeshtrojnë dhe i mohojnë shenjat dhe argumentet e All'Ilahut, ku thotë: **“Sa për ata që nuk besojnë dhe mohojnë shpalljet tona, ata do të jenë banorët e zjarrit”.**

Ajo që tërheq vëmendjen këtu është fakti se ky ajet e ka vendosur faljen dhe shpërblimin e madh në kornizën **“All'Ilahu u ka premtuar”**, ndërkohë ka përmendur se ndëshkimi me Xhehennem është si rezultat i mosbesimit dhe i përgënjeshtërimit të shenjave dhe argumenteve të All'Ilahut. Kjo nuk është gjë tjetër veçse tregues për mirësitë dhe mëshirën e All'Ilahut për robtë e Vet në Botën Tjetër, të cilat nuk mund të krahasohen me veprat e njeriut, sado të mëdhaja dhe madhështore qofshin ato. Gjithashtu, ajeti tregon se ndëshkimi në Botën Tjetër nuk ka kurrë natyrë hakmarrjeje. Por ai ndëshkim është rezultati i drejtë i atyre veprave të këqija që ka bërë njeriu në këtë botë.

Ndërsa, për sa i përket kuptimit të frazës **“banorëve të zjarrit”**, edhe pse fjala "es'hab" ka kuptimin e *mulazemitit*, (ndjekjes, mosndarjes), pra, ata të cilët mohuan dhe përgënjeshtruan argumentet e All'Ilahut, do të hyjnë në Xhehennem. Por ky ajet më vete, nuk mund të jetë argument për çështjen e “përjetësisë” në zjarr të Xhehennemit, sikurse ka ardhur shpjegimi i kësaj çështjeje në tefsiret: “Tibjan”, “Mexhmeul Bejan” dhe në tefsirin e “Fahru Raziut”, sepse ndjekja ndoshta mund të jetë e përhershme dhe mund që të vazhdojë për një periudhë të gjatë dhe të ndërpritet. Këtë e argumenton fraza kur'anore që flet për çështjen e

udhëtarëve të anijes së Nuhut (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), për të ka ardhur shprehja “*es'habu sefineh*” dhe ata nuk kanë qenë shoqërues dhe ndjekës të asaj anijeje.

Për të larguar dyshimin e përjetësisë së jobesimtarëve në zjarr të Xhehennemit, ky ajet kur'anor nuk tregon ndonjë gjë për këtë “përjetësi” apo banim të përhershëm, por kjo konkludohet nga ajetet e tjera të Kur'anit Famëlartë.

Ajeti 11

يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ ءَامَنُوْا اذْكُرُوْا نِعْمَتَ اللّٰهِ عَلَيْكُمْ اِذْ هُمْ قَوْمٌ اَنۡ
يَبۡسُطُوْا اِلَيْكُمْ اَيۡدِيَهُمْ فَكَفَّ اَيۡدِيَهُمْ عَنْكُمۡ ۖ وَاتَّقُوا اللّٰهَ ۚ وَعَلَى
اللّٰهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُؤۡمِنُوْنَ ﴿١١﴾

"O ju që keni besuar! Kujtoni mirësinë që ju dha All'Ilahu ditën, kur Ai pengoi duart e një grupi njerëzish që i kishin zgjatur ato për t'ju dëmtuar juve. Frikësojuni All'Ilahut. Besimtarët le të mbështeten vetëm tek All'Ilahu."

Komentimi

Ajetet e mëparshme përmendën disa nga mirësitë e All'Ilahut. Ky ajet u drejtohet myslimanëve dhe u kujton atyre disa lloje të tjera prej dhuntive dhe mirësive të All'Ilahut me qëllim që ata të falë nderojnë nëpërmjet bindjes dhe përpjekjes për të realizuar parimin e drejtësisë. Ajeti thotë: **"O ju që keni besuar! Kujtoni mirësitë që ju dha All'Ilahu ditën, kur Ai pengoi duart e një grupi njerëzish që i kishin zgjatur ato për t'ju dëmtuar juve..."**

Kur'ani Famëllartë në shumë ajete u kujton myslimanëve mirësitë e ndryshme me të cilat All'Ilahu i ka mirësuar. Këtë e bën

për të forcuar besimin e tyre, si dhe për t'i nxitur për falënderim dhe të përballojnë problemet që mund të hasin në jetë. Ky ajet është nga kategoria e këtyre ajeteve.

Komentuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme rreth ngjarjes që tregon ky ajet. Disa kanë thënë se ky ajet tregon për ngjarjen e shpëtimit të myslimanëve nga fisi i jehudinëve "Beni Nedhijr", i cili kishte vendosur që të vriste Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanët në Medine.

Disa të tjerë kanë thënë se ky ajet tregon ngjarjen e "Batn Nakhl", e cila ka ndodhur në vitin e gjashtë të hixhrit në ngjarjen e "Hudejbijes", ku idhujtarët, me në krye Khalid ibn Velijd, vendosën të sulmonin myslimanët gjatë kryerjes së namazit të ikindisë. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e mori vesh këtë intrigë dhe e fali namazin e frikës, të shkurtuar. Ky veprim i çoi në dështimin e komplotit të tyre.

Disa komentues të tjerë kanë përmendur ngjarje të tjera nga jeta e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e myslimanëve. Ata kanë thënë se ky ajet tregon për këto ngjarje.

Disa komentues të tjerë mendojnë se ky ajet tregon për të gjitha ngjarjet dhe ndodhitë që kanë ndodhur përgjatë gjithë historisë islame e deri më sot.¹

Nëse vështrojmë fjalën "*kaumun*" që do të thotë, *një grup njerëzish, popull*, e cila ka ardhur në këtë ajet në trajtë të pashquar dhe që tregon vetëm për një grup të caktuar njerëzish, atëherë ky komentim mund të konsiderohet ndër më të mirët në këtë fushë.

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëllimi 3, f. 293. Fundi i komentimit të ajetit në fjalë.

Sido që të jetë, ky ajet u tërheq vëmendjen myslimanëve për rreziqet me të cilat u përballën dhe këto rreziqe mund të çonin në zhdukjen e Islamit. Mirëpo mirësia e All'llahut dhe begatia e Tij i përfshiu ata dhe e shpëtoi Islamin dhe myslimanët prej atyre rreziqeve.

Po ashtu, ajeti i paralajmëron myslimanët dhe u tërheq vëmendjen që të zbatojnë domosdoshmërinë e devotshmërinë dhe të mbështeten tek All'llahu, si argument për ta falënderuar Atë për të gjitha ato mirësi. Gjithashtu, që ta dinë se me devotshmërinë ata do t'i garantojnë vetave të veta mbështetjen dhe mbrojtjen e All'llahut në këtë botë. Për këtë ajeti thotë: **"...Frikësojuni All'llahut. Besimtarët le të mbështeten vetëm tek All'llahu."** Është më se e qartë se mbështetja tek All'llahu i Lartësuar nuk do të thotë shmangie e përgjegjësi apo dorëzim përpara ngjarjeve të kohës, por do të thotë se kur njeriu përdor fuqitë dhe potencialet e tij që gjenden në të, duhet të ketë kujdes në përdorimin e tyre, sepse këto fuqi dhe potenciale nuk janë nga ai, por burimi i tyre është All'llahu i Lartësuar. Nëse arrihet kjo, atëherë njeriu është i aftë që të eliminojë faktorët që nxisin për mashtrim dhe egoizëm dhe nuk gjendet vend për shqetësim dhe frikë në brendinë e tij kur përballët me probleme të ndryshme, sado të mëdha të jenë ato, sepse ai e di se Përkrahësi dhe Mbrojtësi e tij është All'llahu, i Cili është i Plotfuqishëm mbi gjithçka.

Në shtesë të asaj që u përmend, themi se përmendja e devotshmërisë përpara mbështetjes, zbulon se mbrojtja e All'llahut përfshin gjendjen e të devotshmeve. Duhet ditur se fjala "tekua", që do të thotë devotshmëri, rrjedh nga fjala "uikajetu" që do të thotë ruajtja e shpirtit dhe largimi i tij nga faktorët e këqinj dhe shkatërrues.

Ajeti 12

﴿ وَلَقَدْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ بَنِي إِسْرَءِيلَ وَبَعَثْنَا مِنْهُمُ اثْنَيْ عَشَرَ نَقِيبًا ^ط وَقَالَ اللَّهُ ^ط إِنِّي مَعَكُمْ ^ط لَئِنْ أَقَمْتُمُ الصَّلَاةَ وَآتَيْتُمُ الزَّكَاةَ وَآمَنْتُمْ بِرُسُلِي وَعَزَّرْتُمُوهُمْ وَأَقْرَضْتُمُ اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا لَأُكَفِّرَنَّ عَنْكُمْ سَيِّئَاتِكُمْ وَلَأُدْخِلَنَّكُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ ^ج فَمَنْ كَفَرَ بَعْدَ ذَلِكَ مِنْكُمْ فَقَدْ ضَلَّ سَوَاءَ السَّبِيلِ



"Me të vërtetë, All'Ilahu mori besëlidhjen e bijve të Izraelit dhe nga mesi i tyre caktoi dymbëdhjetë mbikëqyrës dhe u tha: 'Unë jam me ju! Në qoftë se do të kryeni namazin, do të jepni zekatin, do të besoni të dërguarit e Mi, do t'i ndihmoni ata dhe do t'i jepni vullnetarisht hua All'Ilahut, atëherë, patjetër që Unë do t'ju shlyej gjynahet dhe do t'ju shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Por, kushdo nga ju që mohon pas kësaj, me të vërtetë, e ka humbur rrugën e drejtë.'"

Komentimi

Në fillim, ky ajet tregon çështjen e mbajtjes dhe zbatimit të besëlidhjes. Kjo është përsëritur në disa ajete kur'anore. Ka mundësi që një nga filozofitë e përsëritjes është rëndësia e mbajtjes dhe e zbatimit të besëlidhjes dhe mospëlqimi i thyerjes së besës. Kjo ka të bëjë me rëndësinë e madhe të besëlidhjes në *Gadijr Khum*, për të cilën do të flasim në ajetin 67 të kësaj sureje.

Së pari, ajeti tregon për besën që ka marrë All'llahu nga bijtë e Izraelit, që të veprojnë e të punojnë sipas rregullave të Tij dhe pas kësaj besëlidhjeje atyre iu dërguan dymbëdhjetë udhëheqës, që të jetë secili prej tyre udhëheqës për grupin e vet nga dymbëdhjetë grupet e bijve të Izraelit. Ajeti thotë: **“Me të vërtetë, All'llahu mori besëlidhjen e bijve të Izraelit dhe nga mesi i tyre caktoi dymbëdhjetë mbikëqyrës...”** Në origjinalitet, fjala "*nakijb*" do të thotë *vrinë e madhe dhe e gjerë*. Ajo përdoret veçanërisht për rrugët e gërrmuara në tokë. Shkak i përdorimit të fjalës "*nakijb*" për të treguar udhëheqësinë është se udhëheqësi i çdo grupi të jetë i ditur për të fshehtat e popullit të vet. Pra, sikur të ketë hapur një vrinë të madhe nëpërmjet së cilës shikon të fshehtat e tyre. Nganjëherë, fjala "*nakijb*" përdoret për personin i cili është i njohur për grupin. Kur përdoret me kuptimin e mirësisë dhe virtyteve të mira, kjo përshkak se të mirat dhe virtytet nuk njihen vetëm me mënyrën e kërkimit dhe gërmimit në jetën e një personi.

Disa komentues kanë thënë se fjala "*nakijb*", e cila përmendet në ajetin në fjalë, ka vetëm kuptimin e *të njohurit të të fshehtave*. Por, ne nuk e pranojmë këtë çështje, duke u bazuar në atë çfarë na tregon historia dhe hadithi se mbikëqyrësit e bijve të Izraelit janë udhëheqësit e grupeve të izraelitë ve.

Ka ardhur në tefsirin “Ruhul Meanij” nga Ibn Abasi, se ai ka thënë: *“Ata kanë qenë ministra, pastaj janë bërë Profetë”*, pra, ata kanë qenë ministra të Profetit Musa (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) dhe pas tij kanë arritur gradën e profetësisë.¹

Lexojmë në historinë e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se kur banorët e Medines natën e Akabesë e pranuan ftesën e tij për të shkuar në zonën e Akabes, i Dërguari i All’llahut i urdhëroi që të zgjedhin nga mesi i tyre dymbëdhjetë mbikëqyrës apo udhëheqës, sa numri i mbikëqyrësve të bijve të Izraelit. Është e natyrshme se misioni i tyre ka qenë mbikëqyrja e popullit të tyre dhe jo vetëm lajmërimi i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për gjendjen e tyre.²

Janë transmetuar shumë transmetime nëpërmjet Ehli Sunetit, të cilat tregojnë për dymbëdhjetë udhëheqësit e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke sqaruar se numri i tyre është i barabartë me numrin e mbikëqyrë sve, udhëheqësve të bijëve të Izraelit. Po përcjellim disa nga këto transmetime.

1- Transmeton imam Ahmed ibn Hanbel, i cili është një nga katër imamët e Ehli Sunetit, nga Mesruku i cili e ka pyetur Abdullah ibn Mes'udin: *“Sa do të jetë numri i atyre që do ta udhëheqin këtë umet?”* Ibn Mesudi i është përgjigjur duke i thënë: *“Ne e kemi pyetur të dërguarin e All’llahut dhe ai ka thënë: “Vërtet, numri i pasardhësve pas meje do të jetë dymbëdhjetë, sa numri i udhëheqësve të bijve të Izraelit.”*³

¹ Tefsiri “Ruhul Meanij”, vëllimi 6, faqe 78.

² “Sefijnetul Bihar”, vëllimi 2, faqe 607.

³ “Musned Imam Ahmed”, vëllimi 1, faqe 78.

2- Ka ardhur në historinë e Ibn Asakir, transmetuar nga ibn Mes'udi, se e kanë pyetur Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për numrin e prijësve që do të udhëheqin këtë umet dhe ai ka thënë: *"Me të vërtetë, numri i udhëheqësve pas meje do të jetë sa numri i udhëheqësve të Musait."*¹

3- Transmetohet në "Muntekhab Kenzul Ummal", nga Xhabir ibn Semretu, i cili ka thënë: *"Do ta udhëheqin këtë umet dymbëdhjetë khalifa (prijësa), sa numri i udhëheqësve të bijve të Izraelit."*² I njëjti hadith ka ardhur gjithashtu në librin "Jenabiul Meuedeh", në faqen 445 dhe po kështu në librin "El Bidaje uen Nihaje", vëllimi 6, faqe 247.

Pas kësaj, ajeti tregon premtimin e All'llahut për bijtë e Izraelit, ku ai thotë: **"...dhe u tha: "Unë jam me ju..."**

Me të vërtetë, këto premtime do të realizohen nëse bijtë e Izraelit zbatojnë kushtet e mëposhtme:

1- Të zbatojnë kryerjen e namazit, sikurse thotë ajeti: **"Në qoftë se do të kryeni namazin."**

2- Të japin zekatin e pasurisë së tyre: **"do të jepni zekatin."**

3- Të besojnë në të dërguarit e All'llahut, t'i respektojnë dhe t'i ndihmojnë ata të dërguar: **"do të besoni te të dërguarit e mi dhe t'i ndihmoni ata."**

4- Në shtesë të këtyre tre kushteve të lartpërmendura, bijtë e Izraelit të mos pengojnë kryerjen e disa veprave të pëlqyeshme të cilat konsiderohen si huadhënie vullnetare: **"dhe do t'i jepni vullnetarisht hua All'llahut."**

Pastaj, ky ajet sqaron rezultatin e plotësimit të këtyre kushteve duke thënë: **"...atëherë, patjetër që Unë do t'jua shlyej gjynahet dhe do t'ju shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin**

¹ "Fejdul Kadijr fi Sherh Xhamia Sagjir", vëllimi 2, faqe 459.

² "Muntekhab Kenzul Ummal, fi Hashijeti Musned Ahmed", vëllimi 5, faqe 312.

lumenj...". Po ashtu, ajeti sqaron të ardhmen e atyre që mohojnë dhe nuk zbatojnë atë që ka urdhëruar All'llahu, ku thotë: **"...Por, kushdo nga ju që mohon pas kësaj, me të vërtetë, e ka humbur rrugën e drejtë."**

E kemi shpjeguar në vëllimin e dytë të këtij komentimi se përse Kur'ani e përmend "infakun", *shpenzim e dhënie*, se ajo është hua për All'llahun e Lartësuar.

Në këtë fushë gjithashtu mbetet pyetja e fundit: Përse namazi dhe zekati i kanë paraprirë besimit të Musasë (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ndërkohë që besimi duhet t'i paraprijë veprës?

Disa komentues i janë përgjigjur kësaj pyetjeje duke thënë se: Fjala "er rusul", të dërguarit, që ka ardhur në këtë ajet, nënkupton Profetët të cilët kanë ardhur pas Profetit Musa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe nuk është vetëm Musai. Për këtë, urdhri që ka ardhur këtu për besimin e të dërguarve mund të jetë urdhër për një të ardhme. Kjo nuk bie në kundërshtim me përmendjen e tij pas urdhrit për namaz dhe zekat. Gjithashtu, ka mundësi që qëllimi i fjalës "të dërguarit" të jetë për mbikëqyrësit dhe udhëheqësit e bijve të Izraelit, nga të cilët All'llahu mori besën. (Në tefsirin "Mexhmaul Bejan" lexojmë se disa komentues të shkuar supozonin se mbikëqyrësit e bijëve të Izraelit kanë qenë Profetë të All'llahut. Këtë alternativë e mbështet edhe mendimi i fundit i yni.)

Ajeti 13

فَبِمَا نَقْضِهِمْ مِيثَاقَهُمْ لَعَنَّاهُمْ وَجَعَلْنَا قُلُوبَهُمْ قَاسِيَةً يُحَرِّفُونَ الْكَلِمَ
عَنْ مَوَاضِعِهِ ۖ وَنَسُوا حَظًّا مِمَّا ذُكِّرُوا بِهِ ۚ وَلَا تَزَالُ تَطَّلِعُ عَلَى خَآئِنَةٍ
مِّنْهُمْ إِلَّا قَلِيلًا مِّنْهُمْ ۖ فَاعْفُ عَنْهُمْ وَاصْفَحْ ۚ إِنَّ اللَّهَ يَحِبُّ الْمُحْسِنِينَ ﴿١٣﴾

"Për shkak se ata e thyen besëlidhjen e tyre, Ne i mallkuam ata dhe ua bëmë zemrat të ashpra. Ata i kanë shtrembëruar fjalët e Shkrimeve të shenjta dhe kanë harruar një pjesë të mirë nga ato këshilla. Ti (Muhammed) përherë do ta vështrish tradhtinë e tyre, përveç një pakice të tyre; pra, falua fajet dhe mos i qorto! Se, All'Ilahu i do bamirësit."

Komentimi

Në të vërtetë, ky ajet ka ardhur për të treguar thyerjen e besëlidhjes që All'Ilahu i Lartësuar mori nga bijtë e Izraelit, për të cilën foli ajeti i mëparshëm. Po ashtu, ky ajet tregon rezultatin dhe ndëshkimin e thyerjes së kësaj besëlidhjeje, ku thotë: "Për shkak se ata e thyen besëlidhjen e tyre, Ne i mallkuam ata dhe ua bëmë zemrat të ashpra..."¹

¹ Fjala "leane", në gjuhësi do të thotë largim". Kur mallkimi i dedikohet All'Ilahut, kjo ka kuptimin e privimit nga mëshira e Tij. Kurse fjala "kasijetun", të ashpra, në origjinalitet e ka prejardhjen nga "kasauetu", ashpërsi, e cila përdoret posaçërisht për gurin e fortë. Për këtë kjo fjalë është përdorur edhe për ata që nuk shfaqin asnjë butësi para të vërtetave që u zbulohen atyre.

E vërteta është se ata u ndëshkuan me këto dy lloj ndëshkimesh për shkak të thyerjes së besëlidhjes së tyre. Atyre iu ndalua mëshira e All'llahut. Mendjet dhe zemrat e tyre u ngurtësuan dhe nuk shfaqnin butësi përpara të vërtetave.

Ajeti tregon shenjat e këtij ngurtësimi e ashpërsie, ku thotë: **“Ata i kanë shtrembëruar fjalët e shkrimeve të shenjta dhe kanë harruar një pjesë të mirë nga ato këshilla.”**

Nuk është e largët që shenjat e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilat i ka treguar ky ajet dhe ajetet e tjera të Kur'anit, të jenë pjesë e atyre çështjeve të cilat bijtë e Izraelitëve i kishin harruar. Gjithashtu, ka mundësi që kjo shprehje kur'anore të jetë treguese për ato që i ndryshuan apo i harruan dijetarët jehudinj gjatë rishkrimit të Teuratit, pas humbjes së Teuratit original. Në të vërtetë, çfarë u mbërriti jehudinjve nga libri i vërtetë i Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ka qenë pjesë e atij libri që e rishkruan dhe e mbushen me shumë devijime dhe shtrembërime.

Pastaj, ajeti tregon një dukuri të shëmtuar që dukej te jehudinjtë në mënyrë të përgjithshme te ata, me përjashtim të një pakice prej tyre, dhe ajo është tradhtia, të cilën e zbulonin myslimanët kohë pas kohe. Ajeti thotë: **Ti (Muhammed) përherë do ta vëresh tradhtinë e tyre, përveç një pakice të tyre...”**

Në përfundim, ajeti kërkon nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'i falë ata, duke përforcuar se All'llahu i Lartësuar i do bamirësit. Ajeti thotë: **“...pra, falua fajet dhe mos i qorto, se, All'llahu i do bamirësit.”**

Le të shikojmë se qëllimi në këtë ajet është që Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) t'u falë fajet e mëparshme pakicës punëmirë prej jehudinjëve apo ka për qëllim faljen e shumicës punëkeqe prej tyre?

Aparenca e këtij ajeti përkrah dhe përforcon alternativën e dytë, sepse punëmirë t nuk kanë bërë mëkate apo tradhti ndaj Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për këtë Profeti duhet të kërkojë falje për ta. Hamendësia më e madhe është se falja e kërkuar në këtë ajet përfshin vetëm ato raste ku jehudinjtë i drejtoheshin Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për t'i bërë keq dhe për ta përçmuar. Ajo nuk përfshin gabimet dhe krimet e tyre ndaj qëllimeve dhe parimeve të Islamit, sepse në këtë rast falja nuk ka asnjë kuptim.

Dy hulumtime

1- Veprimet devijuese të jehudinjëve

Ajo që konkludohet nga ajetet kur'anore që përmendin veprimet devijuese të jehudinjëve është se ata praktikonin lloje të ndryshme devijimi në librat e tyre qiellorë.

Nganjëherë, devijimi i tyre kishte natyrë kuptimor që do të thotë se ata i komentonin shprehjet e atyre librave në mënyrë kundërshtuese me kuptimin e tyre të vërtetë. Ata memorizonin fjalët ashtu siç ishin, por ndryshonin kuptimin e tyre (ky është devijim kuptimor). Gjithashtu, nganjëherë ata devijonin shprehjet, ku në vend që të thonin "dëgjuam dhe u bindëm", thonin "dëgjuam dhe kundërshtuam". Nganjëherë i fshihnin disa ajete hyjnore. Ato fraza që ishin në përputhje me dëshirën e tyre, i shfaqnin. Kurse ato që nuk përputheshin me dëshirën dhe egon e tyre, i fshihnin (ky është "devijim frazeologjik").

Paturpësia e tyre arriti deri në atë gradë ku me gjithë praninë e librit qiellor në duart e tyre, ata i mashtronin njerëzit

duke i mbuluar me duart e tyre të vërtetat që gjendeshin në libër me qëllim që askush të mos i lexonte ato. Sqarimi i kësaj teme do të vijë në komentimin e ajetit 41 të po kësaj sureje, në tregimin e “Ibn Suraja”.

2- A e bën All’llahu zemrën e njeriut të ashpër?

Në këtë ajet lexojmë se All’llahu i Lartësuar ia dedikon Vetes së Tij vendosjen e ashpërsisë në zemrat e një grupi jehudinjsh! Ajo që ne dimë është se ashpërsia dhe dhe ngurtësimi nuk janë gjë tjetër vetëm se rezultat i kryerjes së gjynaheve dhe i devijimit. Atëherë, si është e mundur që All’llahu t’ia dedikojë Vetes së Tij vendosjen e ashpërsisë në zemrat e jehudinjëve? Nëse kjo vepër është prej All’llahut, si mund të jenë ata përgjegjës për veprat e tyre? A nuk konsiderohet ky si një lloj imponimi?

Nëse i vërejmë me kujdes ajetet e ndryshme të Kur’anit, nga këto ajete edhe ajeti në fjalë, na qartësohet se njerëzit privohen nga mëshira dhe udhëzimi i All’llahut për shkak të gabimeve dhe gjynaheve të tyre. Në të vërtetë, veprat e tyre të këqija janë burim i devijimit mendor dhe moral dhe si pasojë, nganjëherë, njeriu e ka të pamundur që ta largojë veten e tij nga këto rezultate e përfundime.

Përderisa shkaqet ndikojnë me lejen e All’llahut, për këtë këto ndikime në Kur'anin e Shenjtë i dedikohen All'llahut. Në ajetin në fjalë lexojmë se jehudinjtë, për shkak të thyeres së besës, All’llahu ua bëri zemrat të ashpra, siç thuhet në ajetin 27 të sures "Ibrahim": **"kurse të padrejtët i shpie në humbje"** dhe në ajetin 77 të sures “Et-Teube”: **“Prandaj, Ai ua lidhi hipokrizinë në zemrat e tyre, deri në Ditën kur do të dalin para Tij, sepse e shkelën premtimin e dhënë All’llahut dhe për gënjeshtat që thonin.”**.

Është më se e qartë se këto ndikime të këqija burojnë nga punët e njeriut dhe kjo çështje nuk e kundërshton lirinë dhe zgjedhjen. Sepse premisat e atyre ndikimeve janë prej veprave të njeriut dhe të kryera me dijen dhe zgjedhjen e tij. Ndikimet e veprës së tij janë rezultat i veprës së tij. Për shembull, nëse njeriu konsumon pije alkoolike dhe arrin deri në shkallën e dehjes dhe në këtë gjendje kryen një krim të caktuar, megjithëse ai nuk e zotëron dëshirën e tij në gjendjen e dehur, porse ai me dëshirë dhe me vetëdije konsumoi alkool dhe arriti të bëjë krimin. Kështu që ai ia parapërgatiti vetes së vet veprën kriminale. Ai e ka ditur se po të dehet do të bëjë krim, për këtë ai mban përgjegjësinë e kësaj vepre.

Përmbledhja e thënies: Çdo lloj udhëzimi apo humbjeje e të tjera si këto, të cilat Kur'ani ia dedikon All'Ilahut të Lartësuar, ndodhin si rezultat i veprave që burojnë nga vetë njeriu. Sipas punëve dhe veprave që bën, njeriu meriton ose udhëzimin, ose humbjen. Nga ana tjetër, drejtësia dhe urtësia e All'Ilahut kurrë nuk lejojnë që njeriu të shkojë në rrugë të drejtë pa asnjë arsye, ose të shkojë në rrugë të humbur pa pasur asnjë shkak.

Ajeti 14

وَمِنَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّا نَصْرِي أَخَذْنَا مِيثَقَهُمْ فَنَسُوا حَظًّا
مِمَّا ذُكِّرُوا بِهِ فَأَغْرَيْنَا بَيْنَهُمُ الْعَدَاوَةَ وَالْبَغْضَاءَ إِلَى يَوْمِ
الْقِيَمَةِ ۚ وَسَوْفَ يُنَبِّئُهُمُ اللَّهُ بِمَا كَانُوا يَصْنَعُونَ ﴿١٤﴾

"Dhe prej atyre që thanë ne jemi të krishterë, Ne kemi marrë besëlidhjen prej atyre, por edhe ata kanë harruar një pjesë të mirë nga ato që u është përmendur, prandaj ua shtiem armiqësinë dhe urrejtjen midis tyre deri në Ditën e Kiametit. All'llahu do t'i lajmërojë ata për veprat që kanë bërë."

Komentimi

Armiqësi e përjetshme

Ajeti i mëparshëm trajtoi çështjen e thyerjes së besëlidhjes nga bijtë e Izraelit, të cilën All'llahu ua kishte marrë atyre. Ndërsa ky ajet flet për thyerjen e besëlidhjes nga të krishterët, të cilët harruan një pjesë të urdhrave të All'llahut me të cilat ata ishin të obliguar. Për këtë, ajeti thotë: **"Dhe prej atyre që thanë ne jemi të krishterë, Ne kemi marrë besëlidhjen prej atyre, por edhe ata kanë harruar një pjesë të mirë nga ato që u është përmendur..."**.

Ky ajet tregon qartë se të krishterët, gjithashtu, kanë bërë marrëveshje me All'llahun, që të mos devijojnë nga e vërteta e

Njehsimit (Teuhijdi), të mos harrojnë urdhrat dhe rregullat e All'llahut dhe të mos fshehin shenjat e Profetit të fundit. Por ata u implikuan po në të njëjtën gjë që u implikuan jehudinjtë, veçse me një ndryshim të vetëm që Kur'ani Famëlartë flet qartë për jehudinjtë se një pakicë prej tyre janë punëmirë. Ndërsa për sa u përket të krishterëve, Kur'ani përmend se një grup prej tyre zgjodhën rrugën e devijimit. Nga kjo thënie nënkuptohet se të devijuarit nga jehudinjtë kanë qenë më të shumtë në numër se sa të devijuarit nga të krishterët.

Vërtet, historia e shkrimit të ungjijve që sot janë në qarkullim, tregon se ata janë shkruar pas shumë vitesh nga të krishterët pas Mesihut (Isait) (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Ky është një argument për ekzistencën e shumë mospërputhjeve dhe kundërshtimeve të qarta në to. Gjithashtu, kjo na tregon se shkruarit e ungjijve kanë harruar në mënyrë të plotë pjesë jo të pakta nga ungjilli origjinal. Prania e legjendave në ungjijtë që sot janë në qarkullim, si për shembull historia e prodhimit të alkoolit nga Mesihu (Isai) (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*)¹, të cilën e kundërshton logjika e shëndoshtë dhe që bie në kundërshtim me disa vargje të Teuratit dhe Ungjillit që ë shtë e përhapur sot.

Gjithashtu, edhe tregimi i Merjem Mexhdi² e të tjera tregime që tregojnë mospërputhjet që gjenden në ungjijtë e sotëm. Ndërsa fjala "*Nesara*", që do të thotë *të krishterë*, që ka ardhur në këtë ajet, është shumësi i fjalës "*Nesrani*", *i krishterë*. Rreth kësaj fjale kanë ardhur komente të ndryshme. Prej tyre është se Mesihu, në fëmijërinë e tij, është rritur në qytetin *Nasirah*. Gjithashtu thuhet se kjo fjalë i atribuohet fjalës "*Nasran*" që është një fshat (vend) të cilin të krishterët e respektojnë. Po ashtu, supozohet se

¹ "Ungjilli sipas Gjonit" kapitulli 2, fraza 2-12.

² "Ungjilli sipas Lukës", kapitulli 8, fraza 36-47.

shkaku i emërtimit vjen edhe nga thënia e Mesihut (*Paqja qoftë mbi të!*), sikurse thotë ajeti kur'anor: **"...ashtu siç u tha dishepujve Isai, i biri i Merjemes: 'Kush janë ndihmësit e mi për çështjen e All'llahut?' Dishepujt u përgjigjën: 'Ne jemi ndihmësit e All'llahut...'"**.¹ Për këtë, janë quajtur të krishterët *Nesara*.

Megenëse ishte një grup prej të krishterëve që thonin atë që nuk e vepronin dhe pretendonin se ishin prej përkrahësve të Mesihut (*Paqja qoftë mbi të!*), në këtë ajet Kur'ani thotë: **"Dhe prej atyre që thanë ne jemi të krishterë..."**. Ata nuk ishin të sinqertë në pretendimin e tyre dhe për këtë ajeti shpjegon rezultatin e këtij pretendimi të rremë, që është përhapja e armiqësisë së përhershme ndërmjet tyre deri në Ditën e Kijametit, siç thotë ajeti: **"...prandaj ua shtiem armiqësinë dhe urrejtjen midis tyre deri në Ditën e Kiametit..."**.

Po ashtu, ajeti përmend një lloj tjetër ndëshkimi për këtë grup të krishterë, që është se ata do ta mësojnë rezultatin e veprave të tyre dhe do ta shohin atë me sytë e tyre: **"...All'llahu do t'i lajmërojë ata për veprat që kanë bërë."**

¹ Sure "Es Saff", ajeti 14.

Hulumtime

Këtu është e vlefshme të tregohen disa çështje:

1- Shprehja "*egrejna*" që përmendet në këtë ajet, rrjedh nga rrënja e fjalës "*igrá*", që do të thotë *ngjitja e diçkaje me diçka tjetër*. Po ashtu, do të thotë *nxitje* apo *të urdhërosh* një person të kryejë një punë të caktuar ku personi nxitet për t'u lidhur me qëllime të caktuara. Bazuar në këtë, kuptimi i ajetit në fjalë është se thyerja e besëlidhjes nga të krishterët dhe bërja e gjynaheve çuan në përhapjen e armiqësisë, divergjencave dhe hipokrizisë ndërmjet tyre. Ato konflikte që i shohim sot mes shteteve të shumta të krishtera, ishin shkak për të filluar dy luftërat botërore.

Disa komentues të Kur'anit kanë thënë se qëllimi i vazhdimësisë së armiqësisë dhe i urrejtjes është armiqësia dhe urrejtja që ekziston ndërmjet jehudinjëve dhe të krishterëve, deri në përfundimin e kësaj bote. Por, nga aparenca e ajetit kuptohet për vazhdimësinë e armiqësisë mes të krishterëve.¹

Është e vlefshme të shpjegohet se si ky ndëshkim nuk është vetëm për të krishterët. Nëse myslimanët vazhdojnë të njëjtën rrugë si të krishterët, atëherë e ardhmja e tyre do të jetë si e ardhmja e të krishterëve.

2- Fjala "*el adauetu*" rrjedh nga rrënja e fjalës "*aduun*", e cila ka kuptimin *e tejkalimit dhe të përdhosjes*. Ndërsa fjala "*el bagdaa*", rrjedh nga fjala "*bugdun*", që do të thotë *largim e urrejtje e fortë për diçka të caktuar*. Ndryshimi midis këtyre dy fjalëve mund të jetë se fjala "*bugdun*" ka më shumë natyrë të brendshme se sa veprimi. Kurse fjala "*adauetun*", e cila ka më shumë natyrë veprimi. Mundet

¹ Bazuar në këtë thënie, përemri pronor në thënien "*bejnehum*", mes tyre, që përmendet në fillim të ajetit, është për të krishterët.

që fjala "*bugdun*" apo "*bagda*" të ketë kuptim më të gjerë dhe përfshin si anën shpirtërore ashtu dhe anën veprorë.

3- Nga ky ajet argumentohet se të krishterët, si grupim fetar (apo jehudinjtë dhe të krishterë së bashku) do të jenë të pranishëm në këtë botë deri në Ditën e Kiametit.

Ka mundësi që një kundërshtues të thotë: Vërtet, nga transmetimet islame përfitohet se një e vetme do të përfshijë të gjithë botën pas ardhjes së Mehdiut dhe nuk do të ketë fe të tjera përveç kësaj feje që është Islami i pastër. Atëherë si mund t'i bashkojmë këto dy mendime dhe të largojmë mospajtueshmërinë e dukshme?

Përgjigjja: Ka mundësi që një pakicë shumë e vogël prej jehudinjtë dhe të krishterëve të qëndrojnë deri pas ardhjes së Mehdiut (All'Ilahu ia shpejtoftë ardhjen!). Ne e dimë se liria e zgjedhjes për njerëzit qëndron deri në kohën e Mehdiut dhe në atë kohë feja islame nuk do të marrë natyrë imponimi edhe pse shumica e njerëzve do të ndjekin rrugën e vërtetë. Më e rëndësishmja e të gjitha këtyre është se atëhere udhëheqja në tokë do të jetë vetëm sipas Islamit.

Ajetet 15 - 16

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولُنَا يُبَيِّنُ لَكُمْ كَثِيرًا مِمَّا
 كُنْتُمْ تُخْفُونَ مِنَ الْكِتَابِ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ قَدْ جَاءَكُمْ
 مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ ﴿١٥﴾ بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ
 سُبُلَ السَّلَامِ وَيُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِهِ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى
 صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ﴿١٦﴾

"O ithtarët e Librit! Juve ju erdhi i Dërguari Ynë, i cili ju shpjegon gjëra nga ato që i keni fshehur ju prej Librave (Teuratit dhe Ungjillit) dhe ju fal shumë. Juve ju erdhi prej All'Ilahut dritë dhe Libër i qartë,

"me të cilin All'Ilahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësirat në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë."

Komentimi

Ajetet e mëparshme folën për thyerjen e besëlidhjes së jehudinjëve dhe të krishterëve. Ky ajet u drejtohet ithtarëve të Librit në mënyrë të përgjithshme dhe i fton ata për të pranuar Islamin, i cili pastron dy fetë, jehudizmin dhe krishterimin. Islami i pastron ata nga përrallat dhe legjendat që iu mveshën atyre dhe ai (Islami) i udhëzon ata në rrugën e drejtë në të cilën nuk ka asnjë devijim.

Në fillim, ajeti sqaron se Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familje e tij!*) është dërguar tek ata që t'u tregojë shumë të vërteta të veçanta që gjenden në librat qiellorë, të cilët ata (ithtarët e Librit) i kanë fshehur dhe nuk ua kanë treguar njerëzve. Ajeti thotë: **"O ithtarët e Librit! Juve ju erdhi i Dërguari Ynë, i cili ju shpjegon gjëra nga ato që i keni fshehur ju prej Librave (Teuratit dhe Ungjillit) dhe ju fal shumë..."**.

Kjo fjali kur'anore tregon se ithtarët e Librit kishin fshehur shumë të vërteta, por Profeti i Islamit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shfaqti prej atyre të vërtetave ato të cilat përmbushin nevojat e njerëzve në kohën e Islamit, siç ishte sqarimi i të vërtetës së Njëtimimit, dë lirësia e Profetëve dhe pastërtia e tyre prej shpifjeve që gjenden në Teuratin dhe në Inxhilin e falsifikuar. Po ashtu, ka shpjeguar ndalimin e kamatës, të alkoolit dhe të tjera si këto.

Gjithashtu, ajeti shpjegon rëndësinë e madhe që ka Kur'ani Famëlartë dhe ndikimin e tij të thellë në udhëzimin dhe në edukimin e njerëzimit, ku thotë: **"...Juve ju erdhi prej All'Ilahut dritë dhe Libër i qartë..."**. Ai është drita me të cilën All'Ilahu udhëzon të gjithë ata që përpiqen për të fituar kënaqësinë e

All'llahut në rrugën e shpëtimit, sikurse thotë ajeti tjetër: **"me të cilin All'llahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit..."**. I shpëton ata nga llojet e errësirësirave, si errësira e idhujtarëve, e injorancës, e përçarjes, e hipokrizisë etj, dhe i udhëzon ata në dritën e *Teuhidit* (Njëtitimit), ditorisë dhe unitetit. Ajeti thotë: **"...i nxjerr nga errësirat në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet..."**. Përveç të gjitha këtyre, All'llahu i Lartësuar i udhëzon në rrugë të drejtë, e cila nuk ka devijime as në anën e besimit e as në atë të praktikimit e të veprimit, sikurse thotë ajeti: **"...dhe i shpie në rrugën e drejtë."**

Komentuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme rreth kuptimit të fjalës *"nur"*, që ka ardhur në këtë ajet. Disa kanë thënë se kuptimi i saj është për Profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të tjerë kanë thënë se kuptimi i saj është për Kur'anin Famëlartë.

Po të shohim ajetet e Kur'anit që e ngjasojnë atë me *dritën*, na qartësohet që fjala *"nur"*, që ka ardhur në këtë ajet, ka për qëllim Kur'anin. Bazuar në këtë, lidhja e frazës *"libër i qartë"* me fjalën *"nur"* konsiderohet si lidhje sqaruese, siç lexojmë në suren "El-Araf" në ajetin 157, ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Prandaj, ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit."** Gjithashtu, edhe në suren "Et-Tegabun" ajeti 8, i cili thotë: **"Prandaj besoni në All'llahun, në të Dërguarin e Tij dhe në dritën (Kur'anin), që ju kemi zbritur."**

Ka ajete të tjera që tregojnë po këtë kuptim dhe nuk kemi hasur asnjë ajet që fjala *"nur"*, *dritë*, të jetë përdorur për Profetin

Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Në shtesë të asaj që përmendëm, përemri pronor njëjës që ka ardhur në frazën "bihi", *me të*, në ajetin e dytë prej ajeteve në fjalë, gjithashtu, e përforcon këtë temë se fjala dritë dhe libër i qartë, janë dy tregues për një të vërtetë.

Edhe pse gjejmë transmetime të shumta që e komentojnë fjalën "*nur*", se tregon për prijësin e besimtarëve, Ali ibn Ebi Talibin dhe dymbëdhjetë Imamët e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), por është e qartë se ky komentim i transmetimeve konsiderohet prej tematikës së sqarimit të përmbajtjes së thellë të ajeteve të Kur'anit. Sepse, ne e dimë që ajetet e Kur'anit, përveç kuptimit të tyre të jashtëm, kanë edhe kuptimi të brendshëm, që konsiderohen si "brendia e Kur'anit" ose "brenditë e Kur'anit". Argument i thënies sonë është se imamët nuk kanë ekzistuar në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që Kur'ani të ftojë itharët e Librit që t'u besojnë atyre.

Ndërsa çështja e dytë që ka ardhur në ajetin e dytë prej dy ajeteve në fjalë, është se Kur'ani i përgëzon ata të cilët garojnë për të fituar kënaqësitë e All'llahut dhe se ata do të fitojnë tri mirësitë e mëdha që janë :

1- Udhëzimi në rrugën e shpëtimit, e cila përfshin shpëtimin e individit dhe të shoqërisë, shpirtit, trupit, familjes dhe moralit. Të gjitha këto çështje përfshijnë anën veprore dhe atë të besimit.

2- Mirësia e shpëtimit nga errësirat e mosbesimit dhe e ateizmit.

3- Udhëzimi në dritë. Në këtë ka argument për natyrshmërinë e besimit. Kjo plotësohet me ndjekjen e rrugës më

të shkurtër e më të afërt, sikurse tregon Kur'ani në këtë ajet ku thotë: **“rruga e drejtë.”**

Është mëse e natyrshme se këto mirësi nuk i dhurohen askujt, përveç atij i cili i është dorëzuar All'llahut dhe i përulet Atij me adhurim dhe bindje. Në këtë mënyrë, ky njeri është vërtetues i shprehjes së Kur'anit, ku thotë: **“Ata që ndjekin pëlqimin e Tij”**. Ndërsa hipokritët dhe armiqtë e së vërtetës, absolutisht nuk përfitojnë asnjë dobi, sikurse tregojnë për këtë shumë ajete kur'anore.

Gjithashtu, është mëse e natyrshme se të gjitha këto rezultate dhe ndikime ndodhin me dëshirën e All'llahut të Vetëm, sikurse tregon edhe shprehja e Kur'anit, ku thotë: **“me lejen dhe vullnetin e Vet”** e ardhur në këtë ajet.

Ajeti 17

لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ هُوَ الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ ۚ قُلْ فَمَنْ يَمْلِكُ مِنَ اللَّهِ شَيْئًا إِنْ أَرَادَ أَنْ يُهْلِكَ الْمَسِيحَ ابْنَ مَرْيَمَ وَأُمَّهُ ۚ
وَمَنْ فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا ۚ وَلِلَّهِ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا ۚ
يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ ۚ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٧﴾

"Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë: 'All'Ilahu është Mesihu, i biri i Merjemes!' Thuaj: 'Kush mund ta pengojë All'Ilahun, nëse Ai dëshiron ta zhdukë Mesihun, të birin e Merjemes dhe nënën e tij, si dhe gjithçka që gjendet në Tokë?' Vetëm All'Ilahut i takon sundimi i qiejve, Tokës dhe i çdo gjëje që gjendet midis tyre. Ai krijon çfarë të dojë dhe është i Plotfuqishëm për çdo gjë."

Komentimi

Si mundet të jetë Mesihu (Isai) Zot?!

Ky ajet ka ardhur për të plotësuar tematikën e ajeteve të mëparshme. Ajeti e kundërshton fort thirrjen e të qenit *hyjnor* të Mesihut. Ai ka qartësuar se kjo thirrje nuk është gjë tjetër veçse një

mosbesim i qartë: **"Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë: 'All'llahu është Mesihu, i biri i Merjemes...'"**

Që të na qartësohet kuptimi i kësaj shprehjeje, duhet të dimë se të krishterët kanë disa supozime të kota për sa i përket All'llahut të Lartësuar.

Së pari: Ata besojnë në trinitet dhe këtë gjë e tregon ajeti 171 i sures "En-Nisa" që thotë: **"Mos thoni tre Zota! Hiqni dorë, se është më mirë për ju! All'llahu është vetëm Një Zot qoftë lavdëruar Ai."**¹

Së dyti: Ata thonë se Krijuesi i gjithësisë dhe i ekzistencës është një nga ato tre zota dhe e quajnë "zoti Atë"². Kur'ani Famëlartë e kundërshton dhe nuk e pranon këtë besim. Në ajetin 73 të sures "El-Maide", All'llahu i Lartësuar thotë: **"Pa dyshim janë jobesimtarët ata që thonë: 'All'llahu është njëri prej trinisë. Nuk ka veçse një Zot të Vetëm të vërtetë."** Me lejen e All'llahut, së shpejti do të vijë komentimi i këtij ajeti.

Së treti: Të krishterët thonë se tre zotat në numrin e tyre të vërtetë janë një. Një herë e konsiderojnë këtë me "njësimi në trinitet" dhe këtë e ka treguar ky ajet, ku për supozimin e të krishterëve thotë: **"All'llahu është Mesihu, i biri i Merjemes!"**. Ata kanë thënë se i biri i Merjemes është vetë All'llahu! Këto të dyja (atë e bir) së bashku me shpirtin e shenjtë formojnë një të vërtetë të përbashkët në tri gjëra të ndara!

Të gjitha gjërat rreth besimit të trinitetit, i cili konsiderohet nga devijimet më të mëdha të krishterëve janë përmendur në

¹ Komentimi i këtij ajeti ndodhet në fillim të këtij xhuzi i komentimit tonë.

² Në burimet krishtere lexojmë se "zoti Atë" është krijuesi i krijesave (Kamusul Mukades, f. 345.) Po ashtu lexojmë se Zoti është qenie e vetëvetishme dhe ky është emri i Krijuesit të të gjitha krijesave dhe sunduesi i gjithçkaje. Ai është shpirti i parë pa fillim dhe i fundit pa mbarim... (Kamusul Mukades, f. 344.)

komentimin e ajetit 171 të sures “En-Nisa” të komentimit tonë në të cilin është sqaruar e pavërteta e trinitetit.

Ajo që thamë më lart sqarohet se disa komentues, si “Fahri Razij”, kanë komentuar se nuk ekziston asnjë prej të krishterëve në besimin ose njësimin e Mesihut me All’llahun. Kjo ndodh se ata komentues nuk janë thelluar mjaftueshëm në literaturën e krishterë edhe pse literaturat e sotme të krishtera flasin qartë për çështjen e "njëshmërisë së trinitetit". Ka mundësi që këto libra nuk gjendeshin në kohën e Fahri Raziut ose nuk i kanë mbërritur atij apo të tjerëve që kanë të njëjtin mendim.

Pas kësaj, për të mos pranuar doktrinën e hyjnizmit të Mesihut, ajeti thotë: **“...Kush mund ta pengojë All'llahun, nëse Ai dëshiron ta zhdukë Mesihun, të birin e Merjemes dhe nënën e tij, si dhe gjithçka që gjendet në Tokë?...”**

Ky ajet tregon se Mesihu nuk është gjë tjetër veçse njeri si nëna e tij dhe si të gjithë njerëzit. Duke u bazuar në këtë ai është i krijuar si të gjitha krijesat dhe ka kohë të caktuar qëndrimi në këtë jetë. Përderisa gjendja është e tillë, si është e mundur që ai të jetë Zot, i përhershëm pa fillim dhe pa mbarim?!

Thënë ndryshe: Nëse Mesihu do të ishte zot, a do të ishte e mundur që Krijuesi i gjithësisë ta zhdukte atë ? Atëherë rezultati do të ishte që fuqia e këtij Krijuesi do të ishte e kufizuar dhe ajo qenie që ka fuqi të kufizuar nuk është Zot sepse fuqia e All’llahut është absolute dhe e pakufizuar.

Përmendja e shprehjes **“Mesihu i biri i Merjemes”** në një formë të përsëritur në këtë ajet mund të jetë tregues për këtë të vërtetë: pranimi i profetësisë së tij nga ana e të krishterëve. Pra, ai ka lindur nga nëna, ka qenë embrion në barkun e nënës së tij para se të lindte dhe pasi ka lindur, ka pasur nevojë për zhvillim që të bëhet i madh. A është e mundur që të qëndrojë Zoti në një vend

aq të vogël siç është mitra e nënës dhe të përballet me të gjitha ndryshimet në mitër e pastaj të lindë e të ketë nevojë për nënën e tij kur ka qenë në barkun e saj dhe po ashtu edhe gjatë ushqyerjes me gjí?!

Është e vlefshme të vërejmë me kujdes se ajeti i fundit në shtesë të emrit të Mesihut përmend edhe emrin e nënës së tij me frazën "ummuhu", nëna e tij. Në këtë mënyrë, ajeti e dallon nënën e Mesihut nga të gjithë njerëzit e tjerë. Ka mundësi që kjo shprehje të jetë për shkak se të krishterët gjatë praktikimit të adhurimit të tyre e adhurojnë gjithashtu edhe nënën e Mesihut dhe në kishat e tyre gjenden fotografi dhe ikona të nënës së Mesihut, ku të krishterët qëndrojnë përpara saj dhe e adhurojnë.

Për këtë çështje tregon edhe ajeti 116 i sures "El-Maide", ku All'Ilahu i Lartësuar thotë: **"Pastaj All'Ilahu do të thotë në Ditën e Gjykimit: O Isa i biri Merjemes. Ti ishe ai që u the njerëzve: 'Adhuromëni mua dhe nënën time si zota krahas All'Ilahut?!'"**

Ky ajet tregon dialogun që do të ndodhë Ditën e Gjykimit.

Në mbyllje ajeti u përgjigjet thënieve të atyre që e konsideruan lindjen e Mesihut pa baba si argument të hyjëzimit të tij, ku thotë: **"...Vetëm All'Ilahut i takon sundimi i qiejve, Tokës dhe i çdo gjëje që gjendet midis tyre. Ai krijon çfarë të dojë dhe është i Plotfuqishëm për çdo gjë."**

All'Ilahu i Lartësuar është i Plotfuqishëm që të krijojë njeriun pa baba dhe pa nënë, sikurse e krijoi Ademin (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*). Gjithashtu, Ai është në gjendje të krijojë njeriun pa baba sikurse e krijoi Isain (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*).

Kjo fuqi e All'Ilahut është si fuqia e Tij në krijimin e njerëzimit nga nënat e baballarët e tyre. Kjo llojshmëri në krijim është argument i fuqisë së Tij dhe nuk është argument për asgjë tjetër.

Ajeti 18

وَقَالَتِ الْيَهُودُ وَالنَّصْرَىٰ نَحْنُ أَبْنَاءُ اللَّهِ وَأَحِبُّهُ رَبِّ قُلْ فَلِمَ يُعَذِّبُكُم بِذُنُوبِكُمْ بَلْ أَنْتُمْ بَشَرٌ مِّمَّنْ خَلَقَ يَغْفِرُ لِمَن يَشَاءُ وَيُعَذِّبُ مَن يَشَاءُ وَلِلَّهِ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ ﴿١٨﴾

“Hebrenjtë dhe të krishterët thonë: ‘Ne jemi bijtë e All’liahut dhe të dashurit e Tij’. Thuaj: ‘Atëherë, përse Ai ju dënon për shkak të gjynaheve tuaja? Jo! Ju jeni njerëz nga ata që Ai ka krijuar. Ai fal kë të dojë dhe dënon kë të dojë. Vetëm All’liahut i përket sundimi i qiejve, i Tokës dhe i çdo gjëje që gjendet midis tyre. Dhe vetëm tek Ai kthehen të gjithë.’”

Komentimi

Për të plotësuar kërkimet e mëparshme të cilat trajtuan disa devijime të jehudinjëve dhe të krishterëve, ky ajet tregon për një nga thëniet e kota të jehudinjëve dhe të krishterëve. Ajeti thotë: "Hebrenjtë dhe të krishterët thonë: ‘Ne jemi bijtë e All’liahut dhe të dashurit e Tij...’”.

Kjo përzgjedhje hamendësuese, të cilën pretendojnë jehudinjtë dhe të krishterët, nuk ka qenë e vetme, sepse Kur’ani

Famëlartë ka treguar në shumë ajete shembuj të ngjashëm me këtë pretendim.

Në ajetin 111 të sures “El-Bekare”, Kur’ani Famëlartë tregon pretendimin e tyre duke thënë se nuk hyn në Xhennet askush tjetër përveç tyre dhe thanë se Xhenneti është monopol i jehudinjëve dhe i të krishterëve. Kur’ani e ka kundërshtuar këtë pretendim.

Po ashtu, në ajetin 80 të sures “El-Bekare” përmendet një pretendim tjetër i jehudinjëve ku thonë se Zjarri i Xhehennemit nuk do t’i kaplojë ata vetëm se disa ditë të caktuara. Edhe për këtë thënie Kur’ani i ka qortuar ata.

Ky ajet tregon për pretendimin e tyre se ata janë fëmijët e Zotit dhe pretendojnë se janë të dashurit e Tij. Nuk ka dyshim se ata nuk e kanë njohur veten si fëmijët e vërtetë të All’llahut të Lartësuar, por, me të vërtetë, vetëm të krishterët thonë se Mesihu (Isai) është biri i vërtetë i All’llahut dhe këtë ata e thonë haptazi.¹ Kur kanë përzgjedhur për veten e tyre cilësinë “bijtë e All’llahut”, e bënë për të shfaqur se ata kanë lidhje të veçantë me All’llahun. Me këtë sikur duan të thonë se cilido që është pjesë e tyre qoftë në kombësi apo besim, ai bëhet prej bijëve të All’llahut dhe prej të dashurve të Tij edhe nëse nuk bën asnjë punë të mirë.²

Për ne është e qartë se Kur’ani Famëlartë i lufton të gjitha këto pretendime, thirrje dhe dallime hamendësuese. Sipas Kur'anit njeriu dallohet me besimin, punën e mirë dhe devotshmërinë. Për të hedhur poshtë pretendimet e tyre, ajeti thotë: **“...Thuaj: ‘Atëherë, përse Ai ju dënon për shkak të gjynaheve tuaja?...’”** Sipas pohimit të tyre, ata i përfshin

¹ Burimet e krishtera thonë se thënia "ibnull'lah", i biri i All'llahut, është emërtim vetëm për shpëtimtarin e të krishterëve dhe flijuesin e tyre. Ky emërtim nuk përdoret për askënd tjetër përveç tij, me përjashtim kur ka argument që tregon se nuk është qëllimi për fëmijët e vërtetë të Zotit. (Kamusul Mukades, f. 345.)

² Kohët e fundit kemi zbuluar një grup të krishterësh që ftojnë në kristianizëm dhe i quajnë vetat e tyre bijtë e All'llahut.

ndëshkimi i All'llahut edhe pse thanë se nuk i prek dënimi vetëm se disa ditë. Si mund të përputhet ky pretendim me atë pohim? Si mund t'i përfshijë dënimi i All'llahut bijtë e Tij dhe të dashurit e Tij? Nga këtu vërtetohet se ky pretendim nuk ka asnjë bazë. Historia dëshmon se ata janë sprovuar që në këtë botë me ndëshkime nga ana e All'llahut. Kjo konsiderohet një tjetër argument për parregullsinë e pretendimit të tyre mashtrues. Për ta përforcuar këtë pretendim të rremë e mashtrues, ajeti kur'anor thotë: **"...Jo! Ju jeni njerëz nga ata që Ai ka krijuar..."** Ky është një ligj i përgjithshëm hyjnor, ku vetë All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Ai fal kë të dojë dhe dënon kë të dojë..."**

Në shtesë të kësaj që u tha, të gjithë njerëzit janë krijesë e All'llahut dhe janë rob të Tij. Duke u bazuar në këtë, nuk është e logjikshme që asnjë njeri të quhet "ibnull'Allah", bir i Zotit sepse ajeti kur'anor thotë: **"...Vetëm All'llahu i përket sundimi i qiejve, i Tokës dhe i çdo gjëje që gjendet midis tyre..."** Në fund, të gjitha krijesat do të kthehen tek All'llahu. Këtë e përforcon edhe ajeti ku thotë: **"...Dhe vetëm tek Ai kthehen të gjithë..."**

Pyetje: Disa mund të pyesin: Ku dhe kur kanë pretenduar jehudinjtë dhe të krishterët se janë bijtë e All'llahut dhe sikur të jetë kuptimi i bijëve në këtë ajet me kuptim figurativ dhe jo të vërtetë?

Përgjigje: Në të vërtetë, ungjijtë që qarkullojnë sot e përmendin këtë shprehje në mënyrë të vazhdueshme. Në ungjillin e Gjonit, në kapitullin 8, frazën 41 dhe më pas, lexojmë fjalën e Isait që iu drejtohet jehudinjëve: *"Ju bëni veprat e babait tuaj."* Jehudinjtë i thanë: *"Ne s'kemi lindur nga kuroëria dhe se babai ynë është një dhe ai është All'llahu."* Isai u tha: *"Po të ishte Ati juaj All'llahu, do të më donit mua."*

Ka ardhur në transmetimet islame në hadithin e transmetuar nga ibn Abasi se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ftoi një grup prej jehudinjëve në fenë islame dhe i paralajmëroi ata nga ndëshkimi i All'llahut. Jehudinjtë i thanë: "Si po na frikëson ne me ndëshkimin e All'llahut ndërkohë që ne jemi bijtë dhe të dashurit e Tij?!"¹

Ka ardhur në tefsirin "Mexhmaul Bejan" në komentimin e këtij ajeti, një hadith i njëjtë me hadithin e lartpërmendur, se kur Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ka kërcënuar një grup prej jehudinjëve me dënimin e All'llahut, jehudinjtë i janë përgjigjur duke thënë: "Mos na kërcëno neve. Ne jemi bijtë e All'llahut dhe të dashurit e Tij. Nëse Ai zemërohet me ne, ky zemërim i Tij është si zemërimi i njeriut ndaj fëmijës së vet, i cili është zemërim që largohet shpejt."²

¹ Tefsijrul Kebijr, vëll. 11, f. 192.

² Tefsijr Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 304

Ajeti 19

يَا هَلْ أَلِكْتُبِ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولُنَا يُبَيِّنُ لَكُمْ عَلَىٰ فِتْرَةٍ مِّنَ الرُّسُلِ أَن
تَقُولُوا مَا جَاءَنَا مِن بَشِيرٍ وَلَا نَذِيرٍ ۖ فَقَدْ جَاءَكُمْ بَشِيرٌ وَنَذِيرٌ ۗ وَاللَّهُ عَلَىٰ
كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٩﴾

"O ithtarë të Librit! Ju ka ardhur i Dërguari Ynë, që jua qartëson gjërat pas ndërprerjes së (vargut të) të dërguarve, për të mos thënë ju (kur të dënoheni), se nuk na ka ardhur asnjë që sjell lajme të mira e as ndonjë paralajmërues. Ja, ju erdhi ai që sjell lajme të mira dhe paralajmërime. All'llahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë."

Komentimi

Ky ajet u drejtohet përsëri ithtarëve të Librit, jehudinjëve dhe të krishterëve. Ai u qartëson atyre se Profeti që është dërguar tek ata, është dërguar nga ana e All'llahut të Lartësuar. All'llahu e ka dërguar atë në kohën ku para saj kishte kaluar kohë e gjatë që njerëzve nuk iu dërgua Profet. Ky Profet u qartëson atyre të vërtetat me qëllim që më pas të mos thonë se All'llahu nuk u ka dërguar atyre askënd që t'i udhëzojë në rrugë të drejtë, t'i përgëzojë ata me mëshirën e All'llahut, t'i paralajmërojë nga

devijimi dhe ndëshkimi i All'llahut. Për këtë, ajeti thotë: **"O ithtarë të Librit! Ju ka ardhur i Dërguari Ynë, që jua qartëson gjërat pas ndërprerjes së (vargut të) të dërguarve, për të mos thënë ju (kur të dënoheni), se nuk na ka ardhur asnjë që sjell lajme të mira e as ndonjë paralajmërues..."**

Sigurisht, përgëzuesi dhe paralajmëruesi është Profeti islam, Muhammedi (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili i përgëzon besimtarët që kryejnë vepra të mira me rahmetin dhe shpërblimin e All'llahut, dhe i paralajmëron e u të rheq vërejtje atyre që nuk besojnë dhe që kryejnë vepra të këqija me ndëshkimin e All'llahut. Ai ka ardhur për t'i përgëzuar dhe për t'u të rhequr vërejtje ithtarëve të Librit dhe të gjithë njerëzimit. Këtë e përforcon edhe ky ajet i cili thotë: **"...Ja, ju erdhi ai që sjell lajme të mira dhe paralajmërime..."**

E ndërsa fjala "fetretu" që ka ardhur në këtë ajet do të thotë qetësi dhe prehje sikurse përdoret për një shkëputje kohore ndërmjet dy lëvizjeve, apo dy luftëtarëve, apo dy zhvillimeve, apo dy revolucioneve .

Periudha kohore midis Musait dhe Isait (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qoftë mbi ta!*) dëshmon për një numër të madh Profetësh e të dërguarish. Ndërsa, periudha kohore midis Profetit Isa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi ta dhe mbi familjet e tij!*) nuk ka qenë e tillë. Për këtë, Kur'ani thotë: **"...pas ndërprerjes së (vargut të) të dërguarve..."** Është e njohur se kjo periudhë (ndërmjet Isait dhe Muhammedit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi ata të dy!*)) ishte përafërsisht gjashtëqind vjet.¹

¹ Disa mendojnë se kjo periudhë ka qenë më shumë se gjashtëqind vjet. Disa të tjerë kanë mendimin se ka qenë më pak duke u mbështetur në thënien e disave që thonë se koha mes

Ndërsa ajo çfarë ka ardhur në Kur'an, në suren "Jasin", ajeti 14, dhe ajo çfarë kanë treguar komentuesit e Kur'anit janë dërguar të paktën tre të dërguar në periudhën kohore ndërmjet Isait dhe Profetit Islam (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Disa të tjerë kanë thënë se janë dërguar katër të dërguar në këtë periudhë. Sido që të jetë, ka ekzistuar një periudhë kohore, pa praninë e të dërguarve, nga vdekja e atyre të dërguarve dhe Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kur'ani këtë periudhë të shkëputur nga të dërguarit e ka përshkruar me thënien e tij: **"...pas ndërprerjes së (vargut të) të dërguarve..."**

Pyetje: Ka mundësi që dikush të thotë: Si është e mundur që të thuhet se ekziston një periudhë e tillë kohore, ndërkohë që besimi i përhapur mes nesh thotë se shoqëria njerëzore nuk mund të mbetet as edhe një moment pa të dërguar apo imam të caktuar nga ana e All'Ilahut të Lartësuar?

Përgjigje: Me të vërtetë, Kur'ani Famëlartë thotë: **"...pas ndërprerjes së (vargut të) të dërguarve..."** mohon ekzistencën e të dërguarve në atë periudhë. Kjo çështje nuk bien ndesh me ekzistencën e zëvendësve të Profetëve në atë periudhë. Thënë ndryshe: Të dërguarit kanë qenë persona të cilët e kanë praktikuar thirrjen në një hapësirë më të gjerë. Ata i përgëzonin dhe i paralajmëronin njerëzit. Nxitnin lëvizjet dhe zellshmërinë në shoqëri duke i zgjuar njerëzit nga gjumi me një qëllim që thirrja e tyre të arrinte te të gjithë, ndërkohë që nuk kanë qenë të gjithë zëvendësit e Profetëve të gatshëm për të mbajtur këtë mision të rëndësishëm. Jo vetëm kaq, supozohet se sipas kushteve dhe

lindjes së Isait dhe hixhretit të Profetit të Islamit dhe sipas historisë gregoriane arrin në 621 vjet e 90 ditë. (Tefsîr, Ruhul Meanij, vëll. 4, f. 154.)

rrethanave të posaçme shoqërore, ata jetonin në mesin e njerëzve dhe nuk shfaqeshin se janë zëvendës të Profetëve.

Prijësi i besimtarëve, Ali ibn Ebi Talibi, në një nga fjalimet e tij në librin “Nehxhul Belaga”, thotë: *“Po! O All'llahu im! Toka kurrë nuk mbetet pa caktues nga All'llahu e me argumente, qofshin të dushkshëm e të njohur, apo të frikësuar e të fshehtë me qëllim që të mos mohohen argumentet e Zotit dhe shenjat e qarta të Tij...”*¹

Është e qartë se nëse shoqëria njerëzore do të ishte e zbrazët nga prania e të dërguarve revolucionarë dhe thirrës, kjo shoqëri do të mbushej me legjenda, me paganizma, me vesveset e shejtanit, me devijime dhe me padituri për mësimet e All'llahut. Kjo gjendje e tillë do të ishte argumenti më i mirë për ata të cilët dëshirojnë të largohen nga përgjegjësitë. Për këtë, All'llahu e prish këtë argument me anë të dërgimit të burrave që janë të lidhur me Të dhe të pranishëm gjithmonë në mesin e njerëzve.

Në mbyllje ky ajet dëshmon dhe përforcon fuqinë e All'llahut të Lartësuar ku thotë: **“...All'llahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.”** Kjo qartëson se dërgimi i Profetëve dhe caktimi i zëvendësve të tyre është një çështje e lehtë për sa i përket fuqisë absolute të All'llahut të Lartësuar.

¹ “Nehxhul Belaga” fjalë të urta dhe deklarata të zgjedhura 147.

Ajetet 20 - 26

وَإِذْ قَالَ مُوسَىٰ لِقَوْمِهِ ۖ يَنْقُومِ أَذْكُرُوا نِعْمَةَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ جَعَلَ فِيكُمْ
 أَنْبِيَاءَ وَجَعَلَكُمْ مُلُوكًا وَءَاتَاكُمْ مَا لَمْ يُوْتِ أَحَدًا مِّنَ الْعَالَمِينَ يَنْقُومِ ﴿٢٠﴾
 أَدْخُلُوا الْأَرْضَ الْمُقَدَّسَةَ الَّتِي كَتَبَ اللَّهُ لَكُمْ وَلَا تَرْتَدُّوا عَلَىٰ أَدْبَارِكُمْ
 فَتَنْقَلِبُوا خَاسِرِينَ ﴿٢١﴾ قَالُوا يَمُوسَىٰ إِنَّ فِيهَا قَوْمًا جَبَّارِينَ وَإِنَّا لَن
 نَدْخُلُهَا حَتَّىٰ تَخْرُجُوا مِنْهَا فَإِن تَخْرُجُوا مِنْهَا فَإِنَّا دَاخِلُونَ قَالَ ﴿٢٢﴾
 رَجُلَانِ مِنَ الَّذِينَ يَخَافُونَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمَا ادْخُلُوا عَلَيْهِمُ الْبَابَ فَإِذَا
 دَخَلْتُمُوهُ فَإِنَّكُم غَلِبْتُمُوعَلَى اللَّهِ فَتَوَكَّلُوا إِن كُنْتُمْ مُّؤْمِنِينَ قَالُوا ﴿٢٣﴾
 يَمُوسَىٰ إِنَّا لَن نَدْخُلُهَا أَبَدًا مَا دَامُوا فِيهَا فَادْهَبْ أَنْتَ وَرَبُّكَ فَقَتِلَا
 إِنَّا هَاهُنَا قَاعِدُونَ قَالَ ﴿٢٤﴾ رَبِّ إِنِّي لَا أَمْلِكُ إِلَّا نَفْسِي وَأَخِي ۖ فَافْرُقْ
 بَيْنَنَا وَبَيْنَ الْقَوْمِ الْفَاسِقِينَ قَالَ ﴿٢٥﴾ فَإِنَّهَا مُحَرَّمَةٌ عَلَيْهِمْ أَرْبَعِينَ سَنَةً
 يَتِيهُونَ فِي الْأَرْضِ ۖ فَلَا تَأْسَ عَلَى الْقَوْمِ الْفَاسِقِينَ ﴿٢٦﴾

“Kujto kur Musai i tha popullit të vet: ‘O populli im! Kujtoni mirësinë e All'llahut ndaj jush, kur prej jush bëri Profetë, ju bëri sundimtarë dhe ju dha atë që nuk ia kishte dhënë asnjë populli para jush.’”

“O populli im! Hyni në Tokën e shenjtë që All'llahu e ka caktuar për ju dhe mos u ktheni prapa, se atëherë do të ktheheni të humbur.”

“Ata thanë: ‘O Musa! Në atë tokë gjendet një popull i fortë dhe ne nuk do të hyjmë pa dalë ata e, nëse ata dalin, ne atëherë, me siguri do të hyjmë në të.’”

“Dy burra nga ata që i frikësoheshin All'llahut dhe që Ai i kishte pajisur me mirësi, thanë: ‘Hyni në portën e qytetit. Kur të kaloni nëpër të, me siguri do të jeni fitues. Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek All'llahu.’”

“Ata thanë: ‘O Musa! Kurrresi nuk do të hyjmë atje, derisa aty të gjenden ata. Kështu që shko ti dhe Zoti yt e luftoni, se ne do të rrimë këtu.’”

“Musai tha: ‘O Zoti im! Unë nuk kam fuqi për askënd tjetër veç vetes dhe vëllait, prandaj na veço neve prej këtij populli të pabindur.’”

“All'llahu tha: ‘Ajo (toka e shenjtë) u është ndaluar atyre për dyzet vjet. Ata do të bredhin të çoroditur nëpër tokë, por ty mos të të vijë keq për atë popull të pabindur.’”

Komentimi

Bijtë e Izraelit dhe Toka e Shenjtë

Këto ajete kanë ardhur së pari për t'i nxitur jehudinjtë që të drejtohen për tek e vërteta dhe të përpiqen për ta njohur atë të vërtetë. Së dyti, për t'u zgjuar atyre ndërgjegjen përballë gabimeve dhe gjynaheve që ata kanë bërë, për t'i nxitur ata që të largohen nga gabimet e tyre dhe t'i kompensojnë ato gabime me bërjen e veprave të mira. Në ajetin e parë Kur'ani u kujton atyre atë çfarë u ka thënë Profeti Musa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) shokëve të tij, ku thotë: **"Kujto kur Musai i tha popullit të vet: 'O populli im! Kujtoni mirësinë e All'llahut ndaj jush...'"**

Shprehja *"mirësitë e All'llahut"* përfshin të gjitha mirësitë e All'llahut, por ky ajet ka sqaruar tri mirësitë më të rëndësishme:

Mirësia e parë: Ardhja e shumë Profetëve dhe udhëheqësve nga mesi i jehudinjëve dhe kjo konsiderohet ndër mirësitë më të mëdha që u ka dhuruar All'llahu i Lartësuar atyre, ku thotë: **"...kur prej jush bëri Profetë..."**

Transmetohet se në kohën e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) ka pasur në mesin e jehudinjëve shtatëdhjetë Profetë dhe se shtatëdhjetë burrat, të cilët shkuan me Musain në malin "Tur", të gjithë kanë qenë në gradën e Profetëve.

Falë kësaj mirësie (mirësia e ekzistencës së Profetëve), jehudinjtë shpëtuan nga idhujtaria, adhurimi i viçit dhe u larguan nga llojet e ndryshme të paganizmave, legjendave, ndytësive dhe veprave të këqija. Për këtë arsye, kjo mirësi u bë një nga mirësitë më të mëdha shpirtërore dhe morale që u ka dhuruar All'llahu bijve të Izraelit.

Mirësia e dytë: Pas kësaj, ajeti tregon mirësinë më të madhe materiale që u ka dhuruar All'llahu jehudinjëve, ku thotë: **"...ju bëri sundimtarë..."** Kjo mirësi konsiderohet, gjithashtu, premisë e mirësisë shpirtërore sepse bijtë e Izraelit kanë përjetuar me vite të tëra poshtërimin e robërisë nën hijen e sundimit të Faraonit. Në këtë periudhë nuk kanë poseduar asnjë lloj lirie dhe dëshire në veprim, por kanë punuar si kafshë të lidhura me pranga. Por All'llahu i Lartësuar i shpëtoi nga ajo lloj mizorie e lidhur pranguese me mirësinë e dërgimit të Profetit Musa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe u dha atyre lirinë dhe fuqinë.

Disa komentues kanë thënë se qëllimi me fjalën "*muluk*", që do të thotë *sundimtarë*, që ka ardhur në këtë ajet – është për mbretërit dhe sundimtarët, të cilët kanë ardhur nga gjeneza e bijve të Izraelit. Ndërkohë dihet se bijtë e Izraelit nuk kanë sunduar vetëm se në një periudhë të shkurtër dhe të paktë kanë qenë ata prej bijve të Izraelit që kishin pozitën e mbretit. Kurse ky ajet thotë: **"...ju bëri sundimtarë..."** Kjo tregon se atë gradë e gëzonin të gjithë bijtë e Izraelit. Me këtë qartësohet se qëllimi me fjalën "*muluk*", që do të thotë *sundimtarë*, të ardhur në këtë ajet është se bijtë e Izraelit kanë sunduar vetë vendet dhe potencialin e tyre pasi kanë qenë të prangosur nën robërinë e mizorisë së Faraonit. Në shtesë të asaj që u tha, fjala "*melikun*" nga ana gjuhësore ka kuptim të gjerë si *Sulltan*, të prijësit që ka në dorë çështjen e drejtimit. Gjithashtu ka kuptimin e pronarit të një robi të caktuar.

Ka ardhur në tefsirin "*Durul Menthur*" nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili ka thënë: *"Ishte e njohur te bijtë e Izraelit se nëse ndonjëri prej tyre kishte*

*shërbëtorë, kafshë dhe grua është quajtur sundimtarë, mbret, pronar (meliken)."*¹

Në mbyllje ajeti tregon se All'llahu i Lartësuar u ka dhuruar bijve të Izraelit mirësi në atë kohë që nuk ia ka dhuruar askujt prej njerëzve, ku thotë: **"...dhe ju dha atë që nuk ia kishte dhënë asnjë populli para jush."**

Këto mirësi kanë qenë të shumta, prej tyre: shpëtimi i bijve të Izraelit nga kthetrat mizore të Faraonit, çarja e detit vetëm për ata, zbritja e ushqimit të posaçëm për ata si "mana dhe thëllëza", pra një rrëshirë të ëmbël si mjalti dhe thëllëza. E kemi shpjeguar me detaje këtë gjë në xhuzin e parë të këtij komentimi kur kemi komentuar ajetin 57 të sures "El-Bekare".

Ajeti në vazhdim shpjegon realitetin e hyrjes së bijve të Izraelit në Tokën e Shenjtë, duke e shprehur këtë gjë me fjalën e Profetit të tyre Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ku thotë: **"O populli im! Hyni në Tokën e shenjtë që All'llahu e ka caktuar për ju dhe mos u ktheni prapa, se atëherë do të ktheheni të humbur."**

Komentuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme rreth kuptimit të frazës "në Tokën e Shenjtë", që ka ardhur në këtë ajet, gjithashtu, dhe rreth pozicionit të saj gjeografik në këtë Tokë. Disa thonë se qëllimi me Tokën e Shenjtë është "Bejtul Makdis" ku në të gjendet "Kudsi Sherif". Disa të tjerë thonë se ajo është "Toka e Shamit". Grupi i tretë ka mendimin se është "Jordania dhe Palestina". Kurse një grup tjetër thotë se ajo është toka e "Tur-it".²

¹ Tefsiri "Mijzan", vëllimi 5, faqe 295.

² Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëllimi 3, faqe 308.

Por nuk është e largët që qëllimi me këtë shprehje të jetë e gjithë toka e Shomit, e cila i përfshin të gjitha alternativat e lartpërmendura, sepse kjo tokë – sikurse dëshmon historia – është djepi i të gjithë Profetëve dhe vendi i zbritjes së Revelatave hyjnore dhe vendi i shfaqjes së feve qiellore. Gjithashtu, për një periudhë të gjatë të historisë ka qenë epiqendra e Njëtimimit dhe e adhurimit të një Zoti të Vetëm dhe e përhapjes së mësimave Profeti ke. Për të gjitha këto arsye është quajtur “Tokë e Shenjtë”, edhe pse me këtë emër ndonjëherë quhet zona e “Bejtul Makdes” në mënyrë të veçantë.

Nga fjalia **“që All’llahu ka caktuar për ju”** argumentohet se All’llahu i Lartësuar ka vendosur që bijtë e Izraelit të jetojnë në Tokën e Shenjtë me mirësi, bereqet e siguri, me kusht që të ta mbrojnë këtë tokë nga papastërtia e idhujtarisë e paganizmit dhe të mos devijojnë nga mësimet e Profetëve. Nëse nuk e zbatojnë këtë çështje, ata do t’i rrethojë ndëshkim i rëndë nga ana e All’llahut.

Duke u bazuar në këtë, nuk ka kundërshtim ndërmjet dështimit të një brezi të bijve të Izraelit, të cilëve u është drejtuar ky ajet që të hyjnë në Tokën e Shenjtë, dhe sprovës së humbjes së tyre në shkretëtirë për një periudhë kohore dyzetvjeçare, derisa pas tyre brezi tjetër ishin të sukseshëm në hyrjen në atë Tokë. Nuk ka asnjë papajtueshmëri mes asaj që përmend ajeti **“që All’llahu e ka caktuar për ju”**, sepse ky caktim i All’llahut dhe vendim i Tij është kusht që brezi i parë nga bijtë e Izraelit nuk e zbatoi. Këtë çështje e sqarojnë ajetet e mëpasshme.

Thirrjen e Musait (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) për të hyrë në Tokën e Shenjtë bijtë e Izraelit e pritën si të dobëtit e të paditurit, të cilët mendojnë e shpresojnë se do t’i arrijnë fitoret me anë të rastësisë e mrekullisë pa përpjekje e sakrificë nga ana e tyre.

Ata iu kundërpërgjigjen kërkesës së Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me thënien e tyre, siç thotë ajeti: **"Ata thanë: 'O Musa! Në atë tokë gjendet një popull i fortë¹ dhe ne nuk do të hyjmë pa dalë ata e, nëse ata dalin, ne atëherë, me siguri do të hyjmë në të.'"**

Përgjigjja e bijve të Izraelit tregon shenjën e pesimizmit në shpirtrat e tyre, të cilin ia trashëgoi sundimi i Faraonit. Në të vërtetë, fjala "*len*" që do të thotë *nuk, asnjëherë, kurrë*, tregon frikën e thellë që këtë grup e ka pushtuar dhe kjo frikë i detyroi që të mos hyjnë në asnjë konflikt për të çliruar Tokën e Shenjtë dhe për ta pastruar atë. Ishte obligim për bijtë e Izraelit që ta çlironin atë tokë me luftë dhe me sakrificë.

Ndërsa qëllimi me shprehjen "popull i fortë", sikurse tregon historia, ata janë populli "gjigand"², të cilët kanë pasur një strukturë trupore të madhe dhe shpatulla të jashtëzakonshme. Shumë e kanë ekzagjeruar madhësinë e trupave të tyre dhe kanë ndërtuar e thurur legjenda me ta dhe kanë shkruar për ta libra që i përçmojnë ata dhe që nuk mbështeten në asnjë argument shkencor në këtë gjë. Më shumë bie në sy veçanërisht çfarë kanë shkruar për të ashtëquajturin "Auxh" në historitë e manipuluar e të mbushura me legjenda e paganizme.

¹ Duhet patur parasysh se fjala "xhebbarijne rrjedh nga fjala "xhebr" që do të thotë ndreqje e diçkaje me imponim e me forcë. Për këtë edhe ndreqja e thyerjes së kockës quhet "texhbijr". Pra, kjo fjalë nga njëra anë përdoret për çdo lloj thyerje dhe ndreqjeje dhe nga ana tjetër përdoret edhe për të gjitha llojet e sundimit me dhunë e me forcë. Ndërkohë që kjo fjalë përdoret edhe si një nga emrat e Allahu të Madhëruar për arsye se Ai është Sunduesi i gjithçkaje dhe se Ai është Rregulluesi i gjithçkaje që ka nevojë për rregullim.

² "El Amalikatu", gjigandët, janë populli me prejardhje nga Sai. Ata jetojnë në veri të gjirit arabik afër shkretëtirës Sina. Ata sulmuan Egjiptin dhe e pushtuan atë për një kohë të gjatë ku qeverisja e tyre zgjati rreth 500 vjet nga viti 2213 para lindjes së krishtit e deri në 1703 para lindjes së krishtit.

Duket qartë se të tilla legjenda, të cilat gjenden edhe në disa libra islam, me të vërtetë ato janë produkt i bijëve të Izraelit, të cilat zakonisht quhen me termin "*Israilijat*". Argument për këtë është thënia që ka ardhur në Teurat, i cili është në duart e tyre sot, në fund të kapitullit të trembëdhjetë, në Sefrerul l'dad, ku thuhet: *'Toka që ne vrojtuaam i përpin banorët e vet. Të gjithë ata që banojnë aty janë njerëz të gjatë dhe ndër ta ka edhe gjigandë prej bijëve "Anak". Bijtë e Izraelit, të cilët shkuan për spiunazh atje dukeshin si karkaleca në krahasim me ata gjigandë.'*

Pas këtij tregimi, Kur'ani Famëlartë tregon për dy burra, të cilët All'llahu i Lartësuar i mirësoi me besimin, devotshmëri në, largpamësinë dhe i përfshiu ata në mirësitë e mëdhaja të Tij. Tek ata ishin grumbulluar cilësitë e fisnikërisë, trimërisë, të rezistencës dhe i njihnin mirë çështjet sociale dhe ushtarake që gjë i shtyu ata të mbrojnë sugjerimin e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) duke iu drejtuar (ata të dy) bijve të Izraelit me thënien: 'Hyni tek ata nga porta e qytetit, ndërkohë që ata do t'ju mësyjnë, e kjo do të ndodhë, e ju do të jeni fitues.' All'llahu i Lartësuar për këtë gjë thotë: **"Dy nga ata që i frikësohen All'llahut dhe që Ai i ka pajisur me mirësi thonë: 'Hyni në portën e qytetit! Kur të kaloni nëpër të me siguri do të jeni fitues.'" Ky ajet përforcon domosdoshmërinë e mbështetjes te All'llahu në çdo hap dhe të furnizimit me shpirtin e besimit. Për këtë ajeti thotë: "Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek All'llahu".**

Shumica e komentuesve të Kur'anit thonë se këta dy persona kanë qenë "Jusha ibn Nun" dhe "Kalib ibn Johana". Ata kanë qenë prej dymbëdhjetë delegatëve të bijve të Izraelit, sikurse kemi treguar më sipër¹.

¹ Në kapitullin e parë të Seferu Tethnijeh që gjendet sot i përhapur, tregohet se emri i këtyre dy personave është "Jusha" dhe "Kalib".

Me gjithë alternativat e shumta që kanë ardhur në komentimin e fjalisë **“nga ata që i frikësohen All’llahut”**, është e qartë dhe e dukshme në këtë fjali se ata dy burra që përmenden në ajet janë prej atij grupi që i frikësohen vetëm All’llahut dhe askujt tjetër. Këtë komentim e përforcon ajo çfarë ka ardhur në fjalinë **“dhe Ai i kishte pajisur me mirësi”**. A ka mirësi më të madhe se sa njeriu t’i frikësohet vetëm All’llahut dhe askujt tjetër përveç Atij?

Pyetje: Dikush mund të pyesë rreth burimit të dijës së këtyre dy burrave. Si është e mundur që këta të dy e dinin se bijtë e Izraelit do të fitonin nëse hyjnë në qytet apo në Tokën e Shenjtë në mësymjen e armikut?

Përgjigje: Ndoshta dituria e këtyre dy personave buronte nga besimi i atyre të dyve në fjalët e Profetit Musa (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*). Ose ata të dy u bazuan në rregullën e përgjithshme në luftëra nga i cili përfitohet se grupi që mësyn, nëse ka mundësi që të arrijë në qendër të armikut, arrin ta luftojë armikun në shtëpinë e vet, atëherë ai grup zakonisht triumfon¹. Të shënjestruarit në këtë luftë ka qenë populli *gjigant*. Përshkak të gjatësisë së tyre, ata e kishin më të lehtë për të luftuar në hapësirë e shkretëtirë se sa në qytet, i cili zakonisht ka shtëpi të ngjeshura, rrugica, rrugë lakuese etj. Përveç këtyre, është transmetuar, se edhe pse ishin gjigandë, ata ishin frikacakë dhe tmerroheshin nga sulmet e papritura. Të gjitha këto shkaqe janë argument i fortë për ata dy burra që të thonë se bijtë e Izraelit sigurisht do të fitojnë. Ajo çfarë ndodhi në të vërtetë është se bijtë e Izraelit nuk u bindën me asnjë nga këto sugjerime të përmendura. Për shkak të dobësisë

¹ Këtë e tregon edhe imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) në një prej fjalimeve të tij në librin Nehxhul Belaga i cili thotë: "Betohem në Allahun. Çdo popull që sulmohet në brendi të shtëpisë së tij, poshtërohet." (Nehxhul Belaga, fjalimi 27.)

dhe frikës që i kishte pushtuar shpirtrat e tyre, ata iu drejtuan Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) dhe lajmëruan se nuk do të hyjnë në atë qytet përderisa gjigantët ndodhen në të. Ata kërkuan nga Musai që të shkojë ai dhe Zoti i tij të luftojnë kundër tyre. I kërkuan atij që t'i lajmërojë ata në momentin që do të triumfojnë, ndërkohë që ata janë duke ndejtur. Për këtë ajeti thotë: **"Ata thanë: 'O Musa! Kurrresi nuk do të hyjmë atje derisa aty të gjenden ata kështu që shko ti dhe Zoti yt luftoni se ne do të rrimë këtu'."**

Ky ajët tregon poshtërsinë e madhe të bijve të Izraelit kur iu drejtuan Profetit të tyre Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me fjalët e tyre *nuk* dhe *kurrë*. Ata e dëshmuuan dhe e përforcuan refuzimin e tyre për të hyrë në Tokën e Shenjtë. Gjithashtu, ata e tallën dhe e përgënjeshtrovan thirrjen e Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me fjalën e tyre: **"...kështu që shko ti e Zoti yt e lufton, se ne do të rrimë këtu..."** Gjithashtu, nuk e morëm për bazë as sugjerimin e atyre dy burrave besimtarë që përmenden në ajët dhe nuk treguan asnjë reagim.

Ajo çfarë është interesante në këtë çështje ë shtë se në Teuratin që gjendet në duart e jehudinjëve sot, ka pjesë të rëndësishme për këtë tregim. Në kapitullin e katërmbëdhjetë të "*Seferul I'dad*" thuhet: "Të gjithë bijtë e Izraelit e fajësuan Musain dhe vëllanë e tij Harunin duke thënë: Ah sikur të gjithë ne të kishim vdekur në tokën e Egjiptit apo në shkretëtirë? Përse zoti na solli në këtë Tokë që të vritemi me tehun e shpatës e të shtypen e të skllavërohen fëmijët dhe familjet tona pas nesh... ? Musai dhe vëllai i tij Haruni u çoroditën para popullit. Çfarë të bënin? Kurse

Jusha ibn Nun dhe Kalijb ibn Jeteh, të cilët ishin prej grupit të burrave që shkuan për spiunim në atë tokë, nuk ishin të këtij mendimi..."

Pastaj lexojmë ajetin në vijim se Musain (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) e goditi mërzitja për kombin e tij dhe ngriti dy duart dhe i kërkoi Zotit duke thënë se ai nuk zotëron lirinë e veprimit vetëm për veten dhe vëllanë e tij. I kërkoi All'lahut të Lartësuar që t'i ndante ata të dy nga populli i shthurur dhe zullumqar, që ata të merrnin ndëshkimin e veprave të veta ose të përshpejtonin për të rregulluar vetat e tyre. Për këtë, ajeti thotë: **“Musai tha: ‘O Zoti im! Unë nuk kam fuqi për askënd tjetër veç meje dhe vëllait pastaj na veço neve prej këtij populli të pabindur.’”**

Është e natyrshme se refuzimi i prerë nga bijtë e Izraelit i urdhrat të Profetit të tyre është në gradën e mosbesimit. Edhe fjala që ka përdorur Kur'ani për ata, që është "*fasik*", i pabindur, ka kuptim të gjerë dhe përfshin këdo që del apo devijon nga rruga e adhurimit të All'lahut. Për këtë lexojmë se Kur'ani Famëllartë kur flet për devijimin e shejtanit, përdor fjalën "*fisk*", siç thuhet në suren "*Kehf*", ajeti 50: **“dhe nuk iu bind urdhrat të Zotit të vet.”**

Është e vlefshme që të thuhet se fjalia: **“nga ata që i frikësoheshin All'lahut”**, që ka ardhur në ajetet e mëparshme, tregon se një pakicë e jehudinjeve i frikësoheshin All'lahut dhe prej tyre ishin dy burrat e përmendur në një nga ajetet e fundit të cilët ishin "*Jusha*" dhe "*Kalijb*". Ndërkohë vërejmë se Musai (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) nuk tregon tjetër kënd përveç vetes dhe vëllait të tij. Po ashtu, nuk tregon askënd tjetër prej asaj pakice qoftë edhe kalimthi. Shkaku për këtë mund të jetë se Haruni ishte këshilltari i vëllait të vet Musait dhe ai ishte personaliteti më i shquar i bijve të Izraelit pas Musait. Për këtë është përmendur vetëm emri i tij dhe i askujt tjetër.

Rezultati i mohimit dhe i mosbindjes së bijve të Izraelit ishte se ata morën ndëshkimin e All'lahut sepse, Ai iu përgjigj lutjes së Profetit Musa (*Paqja e All'lahut qoftë mbi të!*) dhe ua ndaloi

atyre që për dyzet vjet të mos hyjnë në Tokën e Shenjtë, e cila ishte e mbushur me mirësi të shumta. Për këtë ajeti kur'anor thotë: **“Ajo (Toka e Shenjtë) u është ndaluar atyre për dyzet vjet.”**

Ai ua shtoi ndëshkimin kur u caktoi që të humbasin në shkretëtirë gjatë gjithë asaj periudhe. Ajeti për këtë thotë: **“ata do të bredhin të çoroditur nëpër tokë”**. Shkretëtira në të cilën humbën dhe brodhën bijtë e Izraelit, është quajtur me emrin *"tejh"*, e cila ka qenë pjesë prej Saharasë Sina, sikurse e kemi treguar në vëllimin e parë të këtij komentimi.

Pas kësaj, ajeti tregon se ndëshkimi që morën bijtë e Izraelit në atë periudhë ka qenë në përshtatje me atë që vepruan. Ajeti i kërkon Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) që të mos shqetësohet për atë që ata i goditi duke thënë: **“Por ty mos të të vijë keq për atë popull të pabindur”**.

Ndoshta shkaku i ardhjes së kësaj fjalie të fundit mund të ketë qenë se Musai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) mund të ketë ndier keqardhje, pasi mësoi për ndëshkimin që iu caktua bijve të Izraelit nga All'llahu dhe i kërkoi Atij që ta falë popullin e vet, sikurse ka ardhur në Teuratin që gjendet në duart e tyre, dhe iu është përgjigjur me një përgjigje të shpejtë e të qartë se ata e merituan këtë ndëshkim. Ata nuk e meritojnë faljen e All'llahut, sepse janë popull i pabindur, të shthurur dhe kryeneçë. Kush i ka këto cilësi, sigurisht, do të ketë këtë përfundim të rëndë.

Duhet të vërejmë me kujdes se ndalimi (dhe ndëshkimi) i bijve të Izraelit nuk ka qenë për shkak të hakmarrjes (sikurse të gjitha ndëshkimet hyjnore nuk kanë natyrë hakmarrjeje), por ka patur ose qëllim përsosjeje e përmirësimi të personalitetit të njeriut, ose ka qenë si rezultat i gjynaheve dhe i gabimeve të tyre. Ndoshta ky privim përfshin një filozofi të veçantë, ku bijtë e Izraelit, pas vuajtjeve të shumta, përçmimit dhe shtypjes faraonite,

u çliruan. Pas çlirimit nga Faraoni dhe nën udhëheqjen e Profetit Musa, ata nuk shfaqën gadishmërinë e pastrimit të vetave të tyre e të shpirtërave të tyre. Gjithashtu, nuk kanë qenë të përgatitur për atë kapërcim të brendshëm (shpirtëror) për të filluar një jetë të re të ngjyrosur me krenari e fuqi. Përgjigjja e tyre ndaj Musait (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), e cila përfshin refuzimin e tyre për të hyrë në fushëbetejë , për të çliruar Tokën e Shenjtë, është argumenti më i qartë për këtë të vërtetë.

Prandaj ka qenë e domosdoshme që bijtë e Izraelit të vuajnë me humbje dhe sorollatje nëpër shkretëtirë, për të eliminuar një brez të dobët e të pafuqishëm dhe për ta zëvendësuar atë në mënyrë graduale me një brez të ri në atmosferën e lirisë dhe nën urdhrat e mirësive hyjnore.

Shpirtrat e tyre u kalitën nga jeta e vështirë në shkretëtirën e ashpër. Ajo jetesë u dha atyre fuqi e forcë dhe i përgatiti për xhihad me qëllim që të ndërtojnë qeveri të drejtë në atë Tokë të Shenjtë!

Ajetet 27 - 29

﴿وَاتْلُ عَلَيْهِمْ نَبَأَ ابْنِ آدَمَ بِالْحَقِّ إِذْ قَرَّبَا قُرْبَانًا فَتُقْبِلَ مِنْ أَحَدِهِمَا
 وَلَمْ يُتَقَبَّلْ مِنَ الْآخَرِ قَالَ لَأَقْتُلَنَّكَ ۖ قَالَ إِنَّمَا يَتَقَبَّلُ اللَّهُ مِنَ الْمُتَّقِينَ
 ﴿٢٧﴾ لَئِنْ بَسَطْتَ إِلَيَّ يَدَكَ لِتَقْتُلَنِي مَا أَنَا بِبَاسٍ بِإِذَىٰ إِلَيْكَ لِأَقْتُلَنَّكَ ۚ إِنَّي
 أَخَافُ اللَّهَ رَبَّ الْعَالَمِينَ ﴿٢٨﴾ أُرِيدُ أَنْ تَبُوءَ بِإِثْمِي وَإِثْمِكَ فَتَكُونَ مِنْ
 أَصْحَابِ النَّارِ ۚ وَذَلِكَ جَزَاءُ الظَّالِمِينَ ﴿٢٩﴾

"Lexoju (o Muhammed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit: 'Ty gjithsesi do të të vras'. Tjetri tha: 'All'lahu pranon vetëm prej të devotshmit.'"

"Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të të vras, sepse, në të vërtetë, unë i frikësohem All'lahut, Zotit të gjithësisë."

"Unë parapëlqej të marrësh barrën e gjynahut tim dhe të gjynahut tënd e kështu të bëhesh ndër banorët e zjarrit. Ky është ndëshkimi i keqbërësve."

Komentimi

Vrasja e parë që ka ndodhur mbi sipërfaqen e tokës

Këto ajete trajtojnë historinë e dy bijve të Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe se si vëllai vrau vëllanë e tij. Ndoshta ana e lidhshmërisë së këtyre dy ajeteve me ajetet e mëparshme që flisnin për bijtë e Izraelit, është instinkti i “smirës”, i cili ka qenë gjithmonë burim i shumë kundërshtimeve dhe i mosmarrëveshjeve të bijtë të Izraelit. Në këto ajete All’llahu i Lartësuar i paralajmëron për fatkeqësitë dhe përfundimin e keq të smirës vrasëse, e cila në disa raste çon që vëllai të vrasë vëllanë e tij! Ky ajet i thotë Profetit të All’llahut që t’ia lexojë popullit të vet tregimin e dy bijve të Ademit, ku thotë: **“Lexoju (o Muhammed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit...”**

Ndoshta përdorimi i fjalës “*bil hak*”, *saktësisht*, në këtë ajet ka ardhur për të treguar se në këtë tregim janë shtuar e thurur legjenda e trillime të ndryshme dhe për të qartësuar se Kur’ani Famëlartë ka ardhur me një tregim të saktë e të vërtetë për atë çfarë u ka ndodhur dy bijve të Ademit.

Nuk ka dyshim është se fjala *Adem*, që ka ardhur në këtë ajet, ka për qëllim babanë e të gjithë njerëzimit. Ajo çfarë kanë sugjeruar disa se fjala *Adem* tregon për një person prej bijve të Izraelit që është quajtur *Adem*, nuk është e vërtetë, sepse kjo fjalë është përsëritur disa herë në Kur’an për të argumentuar emrin e babait të të gjithë njerëzimit. Nëse do të ishte e vërtetë alternativa e fundit, do të obligonte që ajeti, ose ajetet pas saj, të kishin si argument emrin jo në përputhje me të emërtuarin e vërtetë.

Ajeti vazhdon e tregon rrjedhën e ngjarjes, ku thotë: **“...kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo...”** Kjo

ndodhi çoi në kërcënimin e vëllait, të cilit nuk ia pranua kurbanin tek All'llahu, me vrasje të vëllait që iu pranua kurbanin dhe betohet se patjetër do ta vrasë, sikurse ka ardhur në këtë ajet: **"...Njëri i tha tjetrit: 'Ty gjithsesi do të të vras...'".** Ndërsa vëllai tjetër e këshilloi vëllanë e vet duke i thënë se refuzimi i kurbanit të tij është përshkak të punëve të tij dhe se ai (vëllai) nuk ka asnjë faj që nuk iu pranua kurbanin duke dëshmuar se All'llahu pranon vetëm veprat e devotshmëve, ku thotë: **"...Tjetri tha: 'All'llahu pranon vetëm prej të devotshmëve'..."**. Pastaj, vëllai të cilit iu pranua kurbanin i drejtohet vëllait që donte ta vriste, se nëse do të zbatojë kërcënimin e tij për ta vrarë, ai nuk do të mbante zgjaste dorën për të vrarë vëllanë e vete sepse i frikësohej All'llahut dhe kurrë nuk do t'i njolloshte duart e tij me të njëjtin mëkat. Ajeti thotë **"Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të vras, sepse në të vërtetë unë i frikësohem All'llahut, Zotit të gjithësisë."**

Pastaj, vëllai punëmirë, i drejtohet vëllait që donte ta vriste, se ai nuk don që të mbartë gjynahet e të tjerëve duke thënë: **"Unë parapëlqej të marrësh barrën e gjynahut tim dhe të gjynahut tënd..."**. Pra, nëse ti zbaton kërcënimin tënd, do të mbartësh gjithashtu edhe mëkatet e mia të mëparshme, sepse ti më rrëmbeve të drejtën e jetës dhe është obligim që ta kompensosh këtë gjë. Përderisa nuk zotëron punë të mira për kompensim, atëherë do të mbartësh mëkatet e mia. Është e natyrshme se po e more përgjegjësinë e rrezikshme të vrasjes, ti do të jesh prej banorëve të zjarrit sepse zjarri është ndëshkimi për të padrejtët, siç thotë ajeti: **"...E kështu të bëhesh ndër banorët e zjarrit ky është ndëshkimi i keqbërësve."**

Hulumtime

1. Në të vërtetë, Kur'ani Famëlartë nuk ka përmendur në këtë ajet dhe as në ajetet e tjera asnjë emër të bijve të Ademit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Por transmetimet islame tregojnë se dy bijtë e Ademit të përmendur në këtë ajet quheshin "Habijl" dhe "Kabijl". Në Seferu Tekuin të Teuratit, në kapitullin e katërt thuhet se dy bijtë e Ademit quheshin "Kain" dhe "Habijl".

Komentuesi i njohur islam "Er-Razij" ka thënë se këta dy emra kanë ardhur me fjalë të ndryshme. Emri i parë ka qenë "Habijl", "Hábil" dhe "Hábin", ndërsa emri i dytë ka qenë "Kabijl", "Kajijn" dhe "Kábil", "Kábin" ose "Kubn". Në çdo formë që të jenë këta emra, mospajtueshmëria në transmetimet islame dhe veçanërisht në tregimet e Teuratit për emrin e Kabijlit, burojnë nga ndryshimet gjuhësore dhe kjo nuk përbën ndonjë gjë të rëndësishme në këtë çështje.

E habitshme në këtë çështje është se një shkrimtar i krishterë e ka sjellë ndryshimin e latpërmendur si argument për kundërshtimin e Kur'anit dhe ka thënë: 'Vërtet, Kur'ani e ka përmendur me fjalën "Kabijl" në vend të fjalës "Kain"!'.

Përgjigjja është se ky ndryshim gjuhësor është i përhapur, veçanërisht në fushën e emrave. Për shembull, fjala "Ibrahim" që gjendet në Kur'an, në Teurat kjo fjalë ka ardhur në formën "Abraham". Sikurse Kur'ani Famëlartë nuk i përmend këta dy emra "Kabijl" dhe "Habijl", por ata përmenden vetëm në transmetimet islame.

2. Në të vërtetë është e njohur se fjala "kurban" tregon çdo gjë që bëhet për t'u afruar tek All'llahu i Lartësuar. Por në të vërtetë, Kur'ani nuk ka treguar asgjë nga lloji i kurbanit të dy djemve të Ademit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Kurse

transmetimet islame dhe Teutrati në Seferu Tekuin në kapitullin e katërt, transmetohet se “Habijli” kishte bagëti dhe zgjodhi bagëtitë më të mira dhe prodhimin më të mirë për kurbanin e përmendur. Ndërsa “Kabijli”, i cili kishte bujqësinë, ai zgjodhi për kurban llojet më të këqija të prodhimeve të tij.

3. Në Kur'anin Famëlartë nuk përmendet asnjë sqarim se si bijtë e Ademit mësuan se njërit iu pranua kurbanin te All'llahu kurse tjetrit jo. Ajo çfarë ka ardhur në transmetimet islame është se këta dy persona e kanë lënë kurbanin e tyre në majën e një mali dhe vetëtimat e ka djegur kurbanin e Habijlit, i cili ishte argument i pranimit të tij. Ndërsa kurbanin e Kabijlit qëndroi në formën e tij të paprekur.

Mirëpo disa komentues besojnë se pranimi dhe refuzimi i kurbanit i është lajmëruar Ademit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) me anë të inspirimit. Shkak ishte se Habijli ishte shpirtpastër, e pëlqente sakrificën dhe faljen në rrugën e All'llahut dhe për këtë All'llahu ia pranoi kurbanin. Ndërsa Kabijli nuk ka patur zemër të pastër. Ka qenë smirak, kokëfortë dhe për këtë All'llahu ia refuzoi kurbanin.

Ajetet në vazhdim qartësojnë të vërtetën se çfarë kanë bërë këta dy vëllezër nga veprat e mira dhe të këqija.

4. Nga këto dy ajete konkludohet qartë se burimi i të gjithë mosmarrëveshjeve dhe krimeve të para që ndodhën në botën njerëzore ka qenë “smira”. Kjo tematikë tregon rrezikun e madh të këtij morali të ulët në mesin e njerëzve.

Ajetet 30 - 31

فَطَوَّعَتْ لَهُ نَفْسُهُ قَتْلَ أَخِيهِ فَقَتَلَهُ فَأَصْبَحَ مِنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٣٠﴾
فَبَعَثَ اللَّهُ غُرَابًا يَبْحَثُ فِي الْأَرْضِ لِيُرِيَهُ كَيْفَ يُورِي سَوَاءَ
أَخِيهِ ۚ قَالَ يَوَيْلَتَى أَعْجَزْتُ أَنْ أَكُونَ مِثْلَ هَذَا الْغُرَابِ فَأُورِيَ
سَوَاءَ أَخِي ۖ فَأَصْبَحَ مِنَ النَّادِمِينَ ﴿٣١﴾

"Vetja e tij e nxiti në vrasjen e të vëllait dhe e vrau. Kështu, ai u bë nga të humburit."

"All'llahu dërgoi një sorrë që rrëmihte në tokë, për t'i treguar sesi ta mbulonte kufomën e të vëllait. (Kabili) tha: 'Mjeri unë, a nuk qenkam i zoti të bëhem si kjo sorrë e ta mbuloj trupin e tim vëllai?!' E u bë nga të penduarit."

Komentimi

Këto dy ajete vazhdojnë të flasin për ngjarjen që ndodhi ndërmjet dy bijve të Ademit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*). Ajeti i parë qartëson se egoja e Kalibit ishte ajo që e nxiti atë për ta vrarë vëllanë e tij, ku thotë: "**Vetja e tij e nxiti në vrasjen e të vëllait dhe e vrau...**"

Duke vërejtur fjalën "*teue'a*", e cila rrjedh nga fjala "*ta'at*", që do të thotë bindje dhe nënshtrim, argumentohet se në zemrën e

“Kabijlit”, pasi ia pranoi All’llahu kurbanin vëllait të tij Habijlit, filluan të lëviznin ndjenjat e këqija dhe filloi të vlonte zjarri i smirës e cila e nxiste që të hakmerrej ndaj vëllai të vet “Habijlit”. Nga ana tjetër qëndronin ndjenjat e tij njerëzore dhe ndjenja se mëkati dhe padrejtësia dhe vrasja e njeriut të pafajshëm janë të shëmtuara, të cilat e pengonin që ai të kryente krimin. Mirëpo egoja dashkeqëse e tij, pak e nga pak, mbizotëroi mbi ndjenjat e tij të dobëta dhe e nxitën ndërgjegjen e tij armiqësore për të vrarë vëllanë e vet.

Fjala "*teue'at*", me gjithë kuptimet që ne i përmendëm, tregon se procesi i bindjes dhe i nxitjes, sikurse dihet, nuk arrihet menjëherë, por arrihet gradualisht dhe me konflikte të ndryshme brenda njeriut.

Në fund, ajeti tregon për rezultatin e veprës së Kabijlit, ku thotë: **"...Kështu, ai u bë nga të humburit."** A ka dëm më të madh se ai që njeriu i bën vetes së tij duke blerë vetë ndëshkimin, i cili do ta ndjekë atë deri Ditën e Kiametit dhe ky dënim përfshin ndëshkimin e ndërgjegjes, atë të All’llahut dhe turpin e përhershëm?!

Disa mundohen të argumentojnë me fjalën "*asbaha*", "ai u bë", se krimi i vrasjes ka ndodhur natën, ndërkohë që fjala "*asbaha*" nga ana gjuhësore nuk përkufizohet me një kohë të caktuar natë apo ditë, por tregon për ndodhinë e diçkaje, sikurse ka ardhur në ajetin 103 të sures "Ali-Imran", që thotë: **"Në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër"**.

Nga disa transmetime islame të ardhura nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) përfitohet se kur Kabili e vrau vëllanë e vet e la trupin e tij në qiell të hapur u çorodit dhe nuk dinte se çfarë të bënte me të. Nuk kaloi shumë kohë derisa kufomën e tij (Habijlit) e sulmuan kafshët e egra. "Kabili", (ndoshta kjo ka qenë si rezultat

i presionit të ndëgjegjes), u detyrua ta mbartë kufomën e vëllait të tij për njëfarë kohe për ta shpëtuar nga shqyerja e egërsirave. Gjatë kësaj kohe, All'llahu i Lartësuar ka dërguar një sorrë (siç tregon ajeti), që filloi të germonte tokën për të groposur një sorrë tjetër të ngordhur apo për të fshehur një pjesë të ushqimit të saj, siç e kanë zakon sorrat. Gjithashtu, t'i tregonte Kabijlit se si ta varroste trupin e vëllait të tij. Për këtë ajeti thotë: **"All'llahu dërgoi një sorrë që rrëmihte në tokë, për t'i treguar sesi ta mbulonte kufomën e të vëllait..."**

Nuk është e çuditshme që njeriu të mësojë nga një shpend. Historia dhe përvoja kanë treguar se njeriu ka mësuar shumë nga instiktet e kafshëve dije dhe njohuri. Disa libra mjekësie tregojnë se njeriu i është borxhli kafshëve në një pjesë të të dhënave mjeksore.

Më pas, ajeti tregon se Kabijli u zemërua nga padituria dhe pakujdesia e tij filloi të qortonte veten se si u bë më i dobët sesa një sorrë dhe nuk ishte në gjendje ta varroste vëllanë e vet. Ajeti thotë: **"(Kabijli) tha: 'Mjeri unë, a nuk qenkam i zoti të bëhem si kjo sorrë e ta mbuloj trupin e tim vëllai?!...'"**

Fundi i veprës së tij të shëmtuar ishte se ai u pendua për këtë vepër të shëmtuar që bëri siç thotë ajeti: **"...U bë nga të penduarit."**

A ka qenë pendimi i tij për krimin e bërë nga frika se kur të zbulohet çështja përpara prindërve të tij dhe ndoshta vëllezërit e tjerë do ta fyenin e qortonin për atë çfarë ka bërë? Apo ka qenë nga keqardhja për veten e tij, sepse ai e mbarti trupin e vëllait të tij të vrrarë për një periudhë kohe pa e ditur se çfarë ka bërë me të ose si ta varrosë atë? Apo shkak i pendimit të tij ka qenë ajo çfarë ndjen njeriu zakonisht nga keqardhja, prekja dhe zemërimi pasi bën një vepër të turpshme?

Cilëtdo, të kenë qenë shkaqet e pendimit të Kabijli, kjo nuk do të thotë se ai u pendua për atë çfarë ka bërë. Kuptimi i pendimit është që njeriu mos t'i kthehet përsëri gjynahut nga frika ndaj All'llahut dhe ta quajë të shëmtuar mëkatin. Kur'ani Famëlartë nuk tregon se ai është penduar. Ndoshta ajeti pasardhës tregon për mospendimin e tij.

Ka ardhur në hadith nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ai ka thënë: *"Mos vrisni njeri padrejtësisht, përndryshe biri i parë i Ademit do të ishte garant i gjakut të të vrarit sepse ai ka qenë njeriu i parë që bëri vrasjen."*¹

Gjithashtu, nga ky hadith argumentohet se ai që sjell një vepër të keqe, do ta mbartë mëkatin e saj përderisa ajo vepër vazhdon të behet në këtë jetë.

Ajo çfarë nuk ka dyshim është se tregimi i dy bijve të Ademit është i vërtetë. Atë e vërteton aparenca e këtyre ajeteve të Kur'anit dhe transmetimet islame. Gjithashtu, fraza "*bil kah*", që do të thotë saktësisht, që ka ardhur në këtë tregim kur'anor konsiderohet dëshmitar për këtë çështje. Bazuar në këtë, të gjitha thëniet e supozuara për këtë tregim që kanë natyrë figurative, apo metaforike apo se është tregim i fantazuar, nuk kanë asnjë bazë.

Nuk është pengesë që ky tregim i vërtetë të jetë shembull për luftërat e vazhdueshme që bëhen padrejtësisht në shoqëritë njerëzore, ku në njërin anë qëndrojnë njerëz, të cilët janë të pastër, të çiltër, besimtarë dhe punëmirë të pranuar nga All'llahu, dhe, në anën tjetër qëndrojnë njerëz të ndotur (moralisht dhe shpirtërisht) që mbartin urrejtje, smirë dhe janë punëkeq.

¹ "Musned Imam Ahmed", vëllimi 1, faqe 383, tefsiri "Fi Dhilalul Kur'an", vëllimi 2, faqe 703.

Sa të shumtë janë ata punëmirë që e kanë shijuar ëmbëlsinë e martirizimit nga duart e zullumqarëve, të cilët - në fund - do të shohin veprat e tyre të turpshme dhe mëkatare. Ata do të përpiqen t'i fshehin ato që kanë kryer por në ato momente atyre do t'u shfaqen shpresat e zeza si sorra e përmendur në ajetin e fundit të ajeteve në fjalë. Kjo shpresë e zezë do t'i nxisë ata që t'i fshehin mëkatet e tyre por në fund ata nuk do të vjelin veçse zhgënjim dhe humbje.

Ajeti 32

مَنْ أَجَلَ ذَلِكَ كَتَبْنَا عَلَىٰ بَنِي إِسْرَءِيلَ أَنَّهُ مَن قَتَلَ نَفْسًا
 بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِي الْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ النَّاسَ جَمِيعًا
 وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَا أَحْيَا النَّاسَ جَمِيعًا ۚ وَلَقَدْ جَاءَتْهُمْ
 رُسُلُنَا بِالْبَيِّنَاتِ ثُمَّ إِنَّ كَثِيرًا مِّنْهُمْ بَعَدَ ذَلِكَ فِي الْأَرْضِ
 لَمُسْرِفُونَ ﴿٣٢﴾

"Për këtë gjë, Ne i urdhëruam bijtë e Izraelit se kush vret ndokënd, që s'ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve. Të dërguarit tanë u sollën shenja të qarta, por shumë nga ata, edhe pas kësaj, i kaluan tërë kufijtë me të këqija në Tokë."

Komentimi

Uniteti njerëzor dhe respektimi i saj

Në të vërtetë, ky ajet, pas ajeteve që folën për historinë e dy bijve të Ademit, përmbledh një konkluzion të përgjithshëm human.

Në fillim, ajeti tregon një të vërtetë të rëndësishme edukativo-shoqërore që është se; vrasja e çdo njeriu, nëse nuk është fjala për ndëshkimin e vrasjes e një njeriu tjetër, apo nuk është shkak krimi për të bërë shkatërrim në tokë, atëherë kjo vrasje është sikurse të vrasësh të gjithë gjininë njerëzore. Po ashtu, shpëtimi i çdo njeriu nga vdekja konsiderohet sikur ke shpëtuar të gjithë njerëzimin nga zhdukja. Ajeti thotë: **"Për këtë gjë, Ne i urdhëruam bijtë e Izraelit se kush vret ndokënd, që s'ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve.**

Këtu lind pyetja: Si mund të jetë e barabartë vrasja e një njeriu me vrasjen e të gjithë njerëzimit dhe si mund të jetë shpëtimi i një njeriu nga vdekja me shpëtimin e të gjithë njerëzimit nga zhdukja?

Nga ana e komentuesve të Kur'anit kanë ardhur përgjigje të shumta. Për këtë pyetje në Tefsirin "Tibjan" kanë ardhur gjashtë përgjigje, në tefsirin "Mexhmeul Bejan" pesë përgjigje dhe në tefsirin "Kenzul Urfan" katër përgjigje, por disa prej përgjigjeve janë shumë larg kuptimit të këtij ajeti.¹

¹ Tefsiret: Et Tibjan, vëll. 3, f. 502. Mexhmeul Bejan, vëll. 3, f. 322. Kenzul Urfan, vëll. 2, f. 353.

Sikurse e thamë edhe në fillim të komentimit të këtij ajeti, ky ajet bën fjalë për një të vërtetë edukativo-shoqërore. Kjo sepse:

Së pari: Kush vret një njeri të pafajshëm dhe i përlyen duart me gjakun e pafajshëm, në të vërtetë, ai është i gatshëm për të vrarë të tjerë të pafajshëm. Në realitet ky njeri është vrasës. Porë në këtë këndvështrim, këtu nuk ka dallim mes të pafajshmëve.

Gjithashtu, çdo njeri, me dëshirën për ta ruajtur llojin njerëzor, që shpëton një njeri tjetër nga vdekja, është i përgatitur për ta kryer këtë vepër për çdo njeri tjetër. Ky njeri është shpëtimtar dhe dëshiron të shpëtojë njerëz të pafajshëm dhe për këtë tek ai nuk ka ndryshim mes tij dhe një njeriu tjetër të pafajshëm.

Duke vënë re frazën "*fe ke en-nema*", që do të thotë "*sikur të ketë*", të cilën e ka përdorur Kur'ani në këtë çështje, ne argumentojmë me këtë se vdekja dhe jeta e njeriut është një, edhe pse nuk është e barabartë me jetën dhe vdekjen e shoqërisë.

Së dyti: Me të vërtetë, shoqëria përbën një strukturë të vetme dhe pjesëtarët e saj janë të ngjashëm me gjymtyrët e një trupi të vetëm. Çdo e keqe që e godet një gjymtyrë, ndikimi i saj, në një formë apo në një formë tjetër, do të jetë i qartë te të gjithë gjymtyrët e trypit. E tillë është shoqëria, sepse ajo përbëhet nga individë. Për këtë, humbja e një individi të shoqërisë konsiderohet humbje e madhe për shoqërinë njerëzore, pasi kjo humbje lë gjurmë për aq sa ndikonte ky individ në shoqëri. Prandaj, dëmi i humbjes së individit përfshin të gjithë shoqërinë.

Nga ana tjetër shpëtimi i një individi prej individëve të shoqërisë, sikurse e thamë edhe më parë, është njëlloj sikur të shpëtosh të gjithë individët e shoqërisë, sepse çdo njeri ka ndikimin për aq sa është prania e tij në ndërtimin e shoqërisë dhe

në përmbushjen e nevojave të saj. Ky ndikim për disa është i vogël dhe për disa të tjerë është i madh.

Kur lexojmë në transmetimet islame se ndëshkimi i vrasësit të një njeriu të pafajshëm është si ndëshkimi i vrasësit të të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë, kjo tregon kuptimin e asaj që e thamë më lart. Por kjo nuk do të thotë se të gjithë njerëzit janë të barabartë me njërin-tjetrin në të gjitha aspektet. Për këtë, në komentin e këtyre transmetimeve lexojmë se ndëshkimi i vrasësit është në përshtatje me numrin e njerëzve që ai ka vrarë, të shumtë apo të paktë.¹

Ky ajet tregon shumë qartë rëndësinë e jetës dhe të vdekjes së njeriut në këndvështrimin e Kur'anit Famëlartë. Madhështia e këtij ajeti duket edhe më qartë kur mësojmë se ai ka zbritur në një mjedis që nuk interesohej për gjakderdhjen e njeriut.

Ajo që tërheq vëmendjen këtu është se shumë transmetime përmendin se ky ajet flet apo tregon, edhe pse në aparençë për jetën dhe vdekjen materiale, mirëpo, më e rëndësishme se kjo është vdekja dhe jeta shpirtërore, pra humbja e njerëzve dhe shpëtimi i tyre nga humbja.²

Kuptimi i thënies së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) në këtë transmetim është shpëtimi nga djegia apo mbytja pastaj vazhdon pas heshtjes dhe qartëson se komentimi më i madh në këtë ajet është thirrja e një tjetri në rrugë të drejtë e të vërtetë, apo në rrugë të shtrembër e të keqe...³

Pyetja tjetër që mund të bëhet këtu është shkaku i ardhjes së emrit të bijëve të Izraelit në këtë ajet, ndërkohë që ajeti përmban rregull që nuk është i posaçëm për këtë grup.

¹ “Usulul Kafij”, vëllimi 7, faqe 271.

² Shih “Usulul Kafij”, vëllimi 7, faqe 211.

³ Tefsiri Nuru Thakalejn, vëll.1, f. 620. Për këtë çështje kanë ardhur transmetime të tjera me të njëjtën përmbajtje.

Përgjigjja: Në përgjigjen e kësaj pyetjeje mund të thuhet se shkak i ardhjes së emrit të bijve të Izraelit në këtë ajet ka qenë se në mesin e këtij grupi ishte e përhapur vrasja dhe gjakderdhja veçanërisht vrasjet dhe gjakderdhjet që ndodhnin përshkak të smirës, egoizmit dhe dashurisë për sundim. Edhe sot ka njerëz që vriten nga duart e këtij grupi e ata njerëz të vrarë janë të pafajshëm. Për këtë shkak ka ardhur ky ligj hyjnor për herë të parë në historinë e bijve të Izraelit.

Në fund, ajeti tregon për nëpërkëmbjet e bijve të Izraelit dhe përforcon se ky grup edhe pse në mesin e tyre kanë dalë Profetë që mbartin argumentet e qarta për t'i udhëzuar ata, shumë prej tyre e thyen besëlidhjen, nëpërkëmbën ligjet hyjnore dhe ndoqën rrugën e devijimit në jetët e tyre. Ajeti thotë: **"Të dërguarit tanë u sollën shenja të qarta, por shumë nga ata, edhe pas kësaj, i kaluan tërë kufijtë me të këqija në Tokë."**

Duhet patur parasysh se fjala "*israf*" ka kuptime të gjera dhe ku përfshijnë çdo shkelje dhe tejkalim të kufijve, edhe pse në të shumtën e rasteve kjo fjalë përdoret në fushën e dhënieve dhe të shpenzimeve.

Ajetet 33 -34

إِنَّمَا جَزَاءُ الَّذِينَ يُحَارِبُونَ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَسْعَوْنَ فِي الْأَرْضِ فَسَادًا أَنْ يُقَتَّلُوا أَوْ يُصَلَّبُوا أَوْ تُقَطَّعَ أَيْدِيهِمْ وَأَرْجُلُهُمْ مِّنْ خَلْفٍ أَوْ يُنْفَوْا مِنَ الْأَرْضِ ۚ ذَٰلِكَ لَهُمْ خِزْيٌ فِي الدُّنْيَا وَلَهُمْ فِي الْآخِرَةِ عَذَابٌ عَظِيمٌ إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا مِن قَبْلِ أَنْ تَقْدِرُوا عَلَيْهِمْ ۖ فَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٣٣﴾

"Pa dyshim se ndëshkimi i atyre që luftojnë kundër All'Ilahut dhe të Dërguarit të Tij dhe që bëjnë shkatërime në Tokë, është të vriten ose të gozhdohen, ose t'u këputen duart dhe këmbët tërthorazi, ose të dëbohen nga vendi. Ky ndëshkim është poshtërim për ata në këtë jetë, ndërsa në Jetën Tjetër, për ata do të ketë dënim shumë të madh."

"Përjashtim bëjnë ata që pendohen pa i zënë ju. Ta dini se All'Ilahu është Falës e Mëshirëplotë."

Shkaku i Zbritjes

Për shkakun e zbritjes së këtyre dy ajeteve është transmetuar se një grup prej idhujtarëve shkuan te Profeti Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi

familjen e tij!) dhe shprehën Islamin e tyre. Por duke qenë se nuk ishin të mësuar me klimën e Medines, u goditën nga disa sëmundje. Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i këshilloi që të shkonin në vende që ka klimë të mirë, në shkretëtirë, larg nga Medina, në të cilën ndodheshin barinj që ruanin devetë e zeqatit. Profeti ua lejoi të përfitonin nga qumështi i atyre deveve për aq sa u nevojitej. Ata e bënë këtë gjë dhe u shëruan nga ato sëmundje që ishin goditur. Mirëpo, në vend që ta falënderonin për atë çfarë bëri Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ata i vranë qëllimisht barinjtë e myslimanëve, i varën, i masakruan, ua nxorën sytë, plaçkitën devetë e zeqatit, e braktisën Islamin dhe u kthyen në idhujtari. Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) urdhëroi që të kapeshin dhe të dënoheshin po me masën e veprës që ata kishin bërë ndaj barinjve të pafajshëm. Atyre iu nxorën sytë, iu prenë gjymtyrët dhe u ekzekutuan me qëllim që të ishte mësim për të tjerët ku askush të mos guxonte të bënte një vepër të tillë të shëmtuar. Për këtë arsye kanë zbritur këto dy ajete që shpjegojnë rregullin e Islamit për këtë grup njerëzish.¹

Komentimi

Ndëshkimi i atij që kryen agresion

Ajeti i parë, prej dy ajeteve në fjalë, plotëson hulumtimin që trajtuan ajetet e mëparshme rreth vrasjes së njeriut. Ai sqaron

¹ Tefsiri “El Menar”, vëll. 6, faqe 353. Tefsiri “Kurtubij”, vëll. 3, faqe 2145.

dënimin e atij që drejton armën e vet drejt myslimanëve dhe grabit pasuritë e tyre nëpërmjet kërcënimit për vrasje apo me vrasje. Ajeti thotë: **"Pa dyshim se ndëshkimi i atyre që luftojnë kundër All'lahut dhe të Dërguarit të Tij dhe që bëjnë shkatërrime në Tokë, është të vriten ose të gozhdohen, ose t'u këputen duart dhe këmbët tërthorazi, ose të dëbohen nga vendi..."**

Kuptimi i prerjes së duarve dhe këmbëve ka të bëjë me prerjen e dorës së djathtë dhe të këmbës së majtë. Këtu është e vlefshme që të vërehen disa çështje:

1. Vërtet, qëllimi i fjalisë **"i atyre që luftojnë kundër All'lahut dhe të Dërguarit të Tij"** që ka ardhur në këto ajete, siç tregojnë hadithet e Ehlil Bejtit dhe siç tregon shkakun e zbritjes së këtij ajeti, është kryerja e veprës agresive ndaj shpirttrave të pafajshëm dhe pasurisë së njerëzve duke përdorur armën dhe duke kërcënuar me të, qoftë kjo mësymje nga grabitqarët jashtë qytetit apo brenda tij. Bazuar në këtë, ajeti përfshin, gjithashtu, edhe ata të këqinj që sulmojnë njerëzit, pasuritë dhe nderet e tyre.

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë ajet është se ai e ka konsideruar agresivitetin kundër njerëzimit njësoj si të shpallësh luftë dhe agresivitet kundër All'lahut dhe të Dërguarit të Tij. Kjo shpjegon rëndësinë e madhe që i jep Islami të drejtave të njeriut, ruajtjes, sigurisë dhe paqes së tyre.

2. Qëllimi i prerjes së dorës dhe këmbës që tregohet në këtë ajet, siç thuhet edhe në librat e jurisprudencës islame, është e njëjta prerje që i bëhet atij që vjedh, pra prerja e katër gishtërinjve të dorës ose të këmbës.¹

¹ Tefsiri "Kenzul Urfan", vëllimi 2, faqe 352.

3. A përmbajnë katër ndëshkimet e përmendura në ajet natyrë zgjedhjeje? Pra, a është shteti islam zgjedhës në përdorimin e njërës prej tyre ndaj një personi që e meriton ndëshkimin? Apo ndëshkimi duhet të jetë në përshtatje me llojin e krimit që ka bërë individi? Që do të thotë se nëse një njeri agresor kryen krim kundër individëve të pafajshëm, për atë a zbatohet ndëshkimi i ekzekutimit? Nëse kryen veprën e vjedhjes me kërcënimin me armë, a zbatohet ndëshkimi i prerjes së gishtave të dorës ose të këmbës. Nëse i kryen të dy krimet së bashku, a ndëshkohet me ekzekutim dhe gozhdim për një periudhë të caktuar që njerëzit të marrin mësim? Nëse personi paraqet armën përpara njerëzve pa vrrarë ose derdhur gjak, ose pa vjedhur ndonjë gjë, atëherë si formë ndëshkimi a dëbohet ky njeri dhunues në një vend tjetër?

Nuk ka dyshim se supozimi i dytë, që është zbatimi i ndëshkimit të përshtatshëm me krimin, është më afër realitetit dhe këtë kuptim, gjithashtu, e kanë mbështetur edhe hadithet e ardhura nga Imamët e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Edhe pse disa hadithe thonë se shteti islam ka të drejtë të zgjedhë cilindo ndëshkim nga këta katër ndëshkime, por ne, bazuar në hadithet e Ehli Bejtit, mendojmë se qëllimi i përzgjedhjes nuk do të thotë që shteti islam të përzgjedhë një nga ndëshkimet në mënyrë arbitrare pa marrë parasysh llojin e krimit. Është shumë e largët që ndëshkimi me vdekje dhe kryqëzim të jenë të barabartë me dënimin e dëbimit apo të jenë në një shkallë të dy!

Këtë e shohim qartë edhe në legjislacionet e vendosura nga njerëzit në kohët e sotme ku për një krim caktohet një dënim. Për shembull, ne shohim se disa krime ndëshkohen me 3-10 vite burg dhe gjykatësi në këtë fushë vepron sipas asaj që shikon ai se është më e përshtatshme me ngjarjen e ndodhur dhe jo sipas dëshirës së

tij. Ngandonjëherë, gjykimi mund të jetë më i rreptë se krimi dhe herë tjetër gjykimi mund të jetë më i lehtë, duke parë shkaqet dhe rrethanat në rastin e kryerjes së krimi.

Ky ligj islam që ka ardhur për agresorët, ndryshon në të mënyra e ndëshkimit dhe lloji i tij me ndryshimin e krimi të cilin e kryen individit agresor apo një grup agresorësh.

Është e tepërt të thuhet se ndëshkimi që ka sjellë islami ë shtë i rreptë për agresorët dhe grabitqarët. Filozofia e tyre sqarohet në rëndësinë e madhe që i kushton feja islame ruajtjes së gjakderdhjes së njerëzve të pafajshëm dhe me qëllim që të pengojë agresorët e këqinj që të mos mësyjnë njerëz të pafajshëm si dhe pasurinë dhe nderin e tyre.

Në mbyllje ajeti tregon se këto ndëshkime bëhen për të skandalizuar kriminelët në këtë botë dhe se ndëshkimi i këtyre nuk do të ndalojë me këto ndëshkime, por ata do të marrin ndëshkim më të rëndë në Ditën e Gjykimit. Ajeti thotë: **"...Ky ndëshkim është poshtërim për ata në këtë jetë, ndërsa në Jetën Tjetër, për ata do të ketë dënim shumë të madh."**

Nga kjo fjali kura'nore argumentohet se ndëshkimet islame në këtë botë, të cilat zbatohen ndaj kriminelëve nuk e pengojnë ndëshkimin në Botën Tjetër. Rruga e kthimit dhe e pendimit nuk është e mbyllur për ata kriminelë të rrezikshëm që ka treguar ajeti. Nëse ata kthehen në rrugën e drejtë dhe shpejtojnë për të ndrequr vetat e tyre dhe që të mbesë hapësirë kompensimi për gabimet, ajeti thotë: **"Përrjashtim bëjnë ata që pendohen pa i zënë ju. Ta dini se All'illahu është Falës e Mëshirëplotë."**

Ajo çfarë vihet re në këtë ajet është se ndëshkimi legjislativ i këtyre kriminelëve është i falur nëse largohen me dëshirën e tyre nga kryerja e krimi dhe pendohen vetëm përpara se të kapen nga organet përkatëse.

Është e natyrshme se pendimi i tyre nuk e hedh poshtë ndëshkimin nëse kanë kryer krimin e vrasjes apo të vjedhjes, përveçse në rastin e kryerjes së krimit me anë të kërcënimit me armë, atëherë ndëshkimi ndaj tyre bie nëse ata pendohen përpara se ata të kapen nga autoritetet përkatëse.

Thënë ndryshe: Vërtet, pendimi në shembullin e kryerjes së këtyre krimeve ka ndikim vetëm në atë çfarë është specifike vetëm për All'llahun e Lartësuar, ndërsa e drejta që u takon njerëzve nuk bie me pendim nëse nuk është pëlqimi i të zotit të së drejtës.

Pyetje: Këtu ngrihet pyetja se si është e mundur të vërtetohet pendimi, pasi ai zakonisht është proces i fshehtë i zemrës?

Përgjigje: Mënyrat dhe rrugët për ta vërtetuar pendimin në këtë fushë janë të shumta: e para, të dëshmojnë dy persona të drejtë e të sinqertë, në një vend të caktuar, se e kanë dëgjuar pendimin e kriminelit dhe atë nuk e ka detyruar askush që të pendohet. E dyta, kriminelin të ndryshojë mënyrën e jetesës së tij në atë formë që te ai të duken shenjat e qarta të pendimit të sinqertë.

Ajeti 35

يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَابْتَغُوا إِلَيْهِ الْوَسِيلَةَ وَجَاهِدُوا
فِي سَبِيلِهِ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٣٥﴾

"O ju që keni besuar! Kini frikë All'Ilahun, përpikuni që t'i afroheni Atij me vepra të mira dhe luftoni në rrugën e Tij për të shpëtuar!"

Komentimi

Rëndësia e ndërmjetësimit (teuasulit) te All'Ilahu

Ky ajet u drejtohet besimtarëve. Ai përmban tri detyra kryerja e të cilave çojnë në arritjen e fitores. Këto tri detyra janë:

1. Pasimi i ruajtjes dhe i devotshmërisë siç thotë ajeti: "O ju që keni besuar! Kini frikë All'Ilahun..."

2. Përzgjedhja e mënyrës dhe e rrugës për t'u afruar tek All'Ilahu i Lartësuar, ku thotë: "...përpikuni që t'i afroheni Atij me vepra të mira..."

3. Lufta në rrugën e All'Ilahut, ku ajeti thotë: "...dhe luftoni në rrugën e Tij..."

Dhe rezultati i zbatimit të këtyre detyrave të All'llahut është përfitimi i shpëtimit me kusht realizimin e islamit dhe të imanit. Ky ajet në këtë fushë thotë: **"...për të shpëtuar..."**

Tematika më e rëndësishme që do të trajtojmë në këtë ajet është thirrja që i drejtohet njeriut besimtar për të përzgjedhur rrugën që të çon tek All'llahu i Lartësuar.

Fjala "uesilje" e ardhur në këtë ajet, në rrënjën e saj do të thotë kërkim i diçkaje, e cila të shtyn për t'u afruar te dikush me dëshirë dhe anim. Bazuar në këtë, fjala "uesijletu" në këtë ajet ka kuptim të gjerë dhe përfshin çdo vepër që të afron tek All'llahu i Lartësuar. Rrugët dhe mënyrat më të rëndësishme për t'u afruar tek Ai është besimi në All'llahun e Lartësuar, në Profetin e Tij, lufta në rrugën e Tij dhe kryerja e adhurimeve si: namazi, zekati, agjërimi, haxhi për në shtëpinë e All'llahut dhe marrëdhëniet farefisnore, dhënia në rrugën e All'llahut haptazi apo fshehuarazi dhe bërja e veprave të mira. Prijësi i besimtarëve, Imam Ali ibn Ebi Talib (*Paqja qoftë mbi të!*) në hytben e tij që ka ardhur në librin "Nehxhul Belaga" thotë: *"Rrugët më të mira, që zgjedh kërkuesi i afisë me Zotin për t'u futur në mbretërinë e Tij, janë besimi te Zoti e te Profeti i Tij e lufta për çështjen e Tij, që është maja e Islamit; besimi dhe rikthimi i shpeshtë te shprehjet e Dëlirësisë Hyjnore, që kanë konceptet bazë e më të natyrshme të fesë së ymetit Islam; kryerja rregullisht çdo ditë e faljeve, që është vet shpirti i fesë; pagesa e Zekatit, që është detyrë e pashmangshme e myslimanëve; agjërimi gjatë muajit të Ramazanit, që të pajis me mburojë ndaj ndëshkimeve të rënda të Zotit; kryerja e Haxhit në shtëpinë e Zotit dhe Umreja e Tij, që janë dy akte që shmangin varfërinë dhe lajnë shpirtin nga mëkatet; respektimi i farefisit dhe ndihma për të afërmit e skamur, që shtojnë pasurinë dhe zgjasin jetën; dhënia e lëmoshës pa bujë, që të ruan nga të këqijat; dhënia e lëmoshës publikisht, që të shpëton nga vdekja e keqe dhe e mundimshme; si dhe qenia i sjellshëm, i gjindshëm e i dobishëm ndaj krijesave të tjera të Zotit, që të mbron nga rënia në mjerim dhe në sy të keq."*¹

¹ "Nehxhul Belaga", fjalimi 110.

Sikurse edhe ndërmjetësimi i Profetëve, imamëve dhe njerëzve të mirë gjithashtu është qasje tek All'llahu i Lartësuar, sikurse e ka treguar Kur'ani Famëlartë. Ajo hyn në kuptimin e gjerë të fjalës "*uesijletu*". Gjithashtu, ndjekja e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e imamëve dhe përshkrimi i rrugës së tyre, të gjitha këto çojnë në afrimin të All'llahu. Edhe kur ne betohemi në pozitën e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Imamëve të drejtë, në të vërtetë, kjo tregon dashurinë tonë që kemi për ata dhe për interesimin për fenë që ata ftuan. Ky betim, gjithashtu, konsiderohet një nga kuptimet e gjera të fjalës "*uesijletu*".

Ata të cilët e kanë specifikuar këtë ajet dhe e kanë kufizuar me disa nga këto kuptime, në të vërtetë nuk kanë asnjë argument për këtë specifikim a veçantim, sepse fjala "*uesijletu*", nga ana gjuhësore, përdoret për çdo gjë që të çon në afrimitet.

Këtu është e vlefshme që të përmendet se qëllimi i "*teuasulit*", ndërmjetësimit, nuk do të thotë të kërkoj diçka nga vetë Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) apo nga vetë Imamët, por kuptimi i saj është që njeriu besimtar nëpërmjet bërjes së veprave të mira dhe ndjekjes së rrugës së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamëve, të kërkojë prej tyre shifat (ndërmjetësim) tek All'llahu i Lartësuar.

Ose duke u betuar në pozitën e tyre të lartë dhe në fenë e tyre (dhe kjo konsiderohet një respekt në shkallën më të lartë të tyre dhe kjo është një lloj adhurimi) dhe për hirë të pozitës së tyre të lartë të All'llahu t'i kërkoj Atij përmbushja e nevojave. Në këtë kuptim nuk gjendet asnjë gjurmë shirku (idhujtarie) sikurse nuk bie në kundërshtim me ajetet e tjera të Kur'anit.

Ndërmjetësimi (teuasuli) në Kur'an

Ka ajete të tjera që tregojnë me qartësi se teuasuli me pozitën e një njeriu të mirë e të singertë tek All'llahu dhe kërkimi i diçkaje nga All'llahu nëpërmjet teuasulit për hir të pozitës së këtij personi punëmirë, nuk konsiderohet çështje e ndaluar dhe nuk e mohon teuhidin (Njëtimin).

Ne lexojmë në ajetin 64 të sures "El-Nisa", thënien e All'llahu të Lartësuar: **"Kurdo që ata ta ngarkonin veten (me gjynah) të vinin e t'i kërkonin falje All'llahut dhe t'i luteshin atij për shfajësimin e tyre, do ta vërenin se All'llahu në të vërtetë është pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë."**

Sikurse lexojmë në ajetin 17 të sures "Jusuf" se me të vërtetë, vëllezërit e Jusufit kërkuan që babai i tyre të kërkonte falje te All'llahu i Lartësuar dhe Jakubi (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) e pranoi kërkesën e tyre dhe e zbatoi.

Ajetin 114 i sures "Et-Teube" tregon tematikën e kërkesës së Ibrahimit për faljen e babait të tij. Ky është argument i ndikimit të lutjes së Profetëve të njerëzimit të tjerë.

Ndërmejtësimi (teuasuli) në transmetimet islame

Nga transmetimet e shumta që kanë ardhur nga burimet e shijave dhe të synive, përftohet qartë se kuptimi i ndërmjetësimit, me atë kuptim që përmendëm, nuk ka dyshim në të. Jo vetëm kaq, ai (teuasuli) konsiderohet, gjithashtu, vepër e mirë. Këto transmetime janë të shumta dhe gjenden në libra të ndryshëm. Më poshtë po sjellim disa nga ato që janë transmetuar në burimet e librave të Ehli Synnetit:

Ka ardhur në librin “Uefaul Uefa”, i dijetarit të shquar synij “Es Semhedij” se kërkimi i ndihmës dhe i ndërmjetësimit te All’llahu me pozitën e Profetit dhe personalitetin e tij, ka qenë e lejuar përpara se të lindte, pas lindjes së tij, pas vdekjes, në botën e Berzahut (vend ku qëndrojnë shpirtat pas vdekjes) dhe në Ditën e Gjykimit.

Më pas Es Semhedij transmeton në këtë fushë nga Umer ibn Khatabi transmetimin e njohur, i cili flet për teuasulin (ndërmjetësimin) e Ademit (*Paqja e All’llahut qoftë mbi të!*) tek All’llahu i Lartësuar me Profetin islam, Muhammedin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Këtë e bëri se Ademi e dinte që ky Profet do të vijë në të ardhmen. Po ashtu, ai e dinte pozitën e lartë që gëzon Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tek All’llahu i Lartësuar. Ademi i drejtohet All’llahut e thotë: “O Zot, me të vërtetë, të drejtohem Ty që për hak të Muhammedit të më falësh mua.”¹

Pastaj, Semhedij transmeton një hadith tjetër nga një grup transmetuesish, si Nisai dhe Termidhij, të cilët janë dijetarë të shquar të Ehli Syneetit, si argument i lejimit të teuasulit me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në jetën e tij. Përkufizimi i këtij hadithi është se një person i kërkoi Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të lutej për shërimin e një të sëmuri të tij. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e urdhëroi që të lexonte këtë lutje: “O Zoti im, të lutem Ty dhe drejtohem te Ti për hak të Profetit Tënd Muhammedit, Profetit të mëshirës. O Muhammed,

¹ “Uefaul Uefa”, vëll. 3, f. 1371, “Tauasul ila hakikatu't Teueasul”, f. 215.

unë i drejtohem Zoti tim për hakun tënd që të më plotësohet nevoja ime. O All'llah. Pranoje ndërmjetësimin e tij për mua.”¹

Pas këtij hadithi, Semhedij sjell një hadith të tretë për lejimin e teuasulit me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) pas vdekjes së tij. Ai thotë se në kohën e Othmanit një person nevojtarë shkoi te varri i Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), u ul pranë varrit dhe iu drejtua All'llahut me këtë lutje: *“O Zoti im, të lutem Ty dhe drejtohem te Ti me ndërmjetësimin e Profetit Tënd Muhammedit, Profetit të mëshirës. O Muhammed, me të vërtetë të jam drejtuar ty për tek Zoti yt që të ma kryesh nevojën time”*. Pastaj Semhedij shton se nuk kaloi shumë kohë dhe atij personi iu plotësua kërkesa.²

Ndërsa autori i librit “Teuasul ile Hakikatul Teuasul”, i cili e kundërshton me forcë çështjen e ndërmjetësimit (teuasulit) ka sjellë 27 hadithe nga librat dhe burimet e ndryshme të cilët thonë të kundërtën e lejimit të teuasulit. Edhe pse është përpjekur të hedhë dyshim mbi zinxhirin e transmetimit të këtyre haditheve, mirëpo është e qartë se kur transmetimet për një tematikë të veçantë janë të shumta dhe arrijnë gradën e teuatur³, nuk mbetet vend për hedhje dyshimesh. Hadithet e transmetuara në burimet islame rreth teuasulit e kanë kaluar cakun e teuaturit.

Nga ato hadithe që ka transmetuar autori i librit të përmendur, është hadithi i mëposhtëm: “Ibn Haxher El Mekij”, autori i librit “Seuaik”, ka transmetuar nga imam “Shafiiu”, që

¹ “Uefaul Uefa”, vëll. 3, f. 1372.

² “Tauasul ila Hakikatu't Teuesul”, f. 329.

³ Hadith i transmetuar me varg transmetuesish të pandërprerë (Fjalori arabisht- shqip, Isa Memushi, Botim i Logos.)

është një nga katër Imamët të Ehli Syneetit, i cili bënte ndërmjetësim me Elhi Bejtin e Profetit dhe thoshte:

*Familja e Profetit janë ndërmjetësimi
ata tek Ai janë ndërmjetësuesit e mi.
Shpresoj që ata nesër të më japin
me dorën e djathtë librin tim.*

Autori i librit “Teuasul”, gjithashtu, transmeton nga El Bejhekij se një vit në kohën e kalifes së dytë Umerit, myslimanët u goditën nga thatësira. Bilali dhe një grup sahabësh shkuan te varri i Profetit dhe thanë: “O i Dërguari i All’llahut. Kërko shi për ymetin tënd, se me të vërtetë ata po vdesin.”¹

Gjithashtu, ka transmetuar nga “Ibn Haxheri”, nga libri “Khijaratul Hisan” se kur imam Shafiiu ishte në Bagdad e vizitonte Ebu Hanifen e ndërmjetësonte atë për nevojat e tij.² Nga Sahihu e “Ed Darimij”, autori i librit “Teuasul”, gjithashtu, transmeton se disa sahabë në Medinë u ankuan tek Aishja, për vështirësitë që kalonin nga thatësira e madhe që kishte goditur vendin në një vit. Ajo iu tregoi që të hapnin një vrimë në çatinë e xhamisë mbi varrin e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me qëllim që All’llahu të zbresë shi për hir të mirësisë së varrit të Profetit. Ata vepruan sipas porosisë së Aishes dhe zbriti një shi i madh!

“Alusij” transmeton në tefsirin e tij shumë hadithe dhe transmetime të ngjashme me hadithet që përmendëm më lart. Por, pasi i ka analizuar dhe pas një diskutimi të gjatë rreth këtyre haditheve, derisa i ashpërsoi kritikën ndaj tyre, u detyrua që ti pranojë. Pas kësaj ai tha se nuk shikon ndonjë kundërshtim në

¹ “Tauasul ila Hakikatu't Teuesul”, f. 253.

² “Tauasul ila Hakikatu't Teuesul”, f. 331.

ndërmjetësimin e Profetit tek All'llahu për hir të pozitës së tij të lartë, qoftë ndërmjetësimi në jetën e tij apo pas vdekjes së tij. Më pas e ka vazhduar hulumtimin në këtë fushë dhe ka thënë se ndërmjetësimi tek All'llahu i Lartësuar me pozitën e jo vetëm të Profetit, gjithashtu, nuk është i ndaluar – me kusht që ndërmjetësuesi të ketë pozitë të lartë tek All'llahu i Lartësuar.¹ Ndërsa burimet e shijave e kanë trajtuar këtë temë në formë të qartë dhe nuk e shohin të nevojshme për t'i transmetuar hadithet e ardhura për këtë temë.

Hulumtime

Këtu e vërejmë të domosdoshme të trajtojmë disa çështje.

1. Më përpara thamë se ndërmjetësimi (teuasuli) nuk ka kuptimin e kërimit të nevojës nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) apo Imamët, por qëllimi është bërja e Profetit apo Imamëve ndërmjetësues të All'llahu për kryerjen e nevojës. Në të vërtetë, ky lloj ndërmjetësimi është t'i drejtohesh All'llahut të Lartësuar, sepse ai (Profeti) është i Dërguari i All'llahut për të udhëzuar të gjithë njerëzit. Është e habitshme se disa mendojnë që ky lloj ndërmjetësimi është idhujtari (shirk), ndërkohë dihet se idhujtaria (shirku) ka të bëjë me praninë e një krijese që ka cilësi dhe attribute të njëjta me ato të All'llahut të Lartësuar. Ndërsa ndërmjetësimi që përmendëm nuk ka lidhje fare me atë shirk (idhujtari).

2. Disa këmbëngulin se ka dallim mes jetës dhe vdekjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e*

¹ Tefsiri “Rruhul Meanij”, vëll. 4, f. 114-115.

tij!) dhe Imamëve. Sikur u pa edhe më lart shumica e haditheve të mëparshme veçonin kohën pas vdekjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në shtesë të kësaj, myslimani beson se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), dhe njerëzit e mirë pas vdekjes së tyre kanë jetë të ndërmjetme (Barzakhijeh) më të gjerë se jeta e kësaj bote. Këtë e ka qartësuar edhe Kur'ani, i cili përmend dëshmorët që kanë rënë në rrugën e All'llahut dhe pohon se ata nuk janë të vdekur, por janë të gjallë te Zoti i tyre.¹

3. Disa të tjerë këmbëngulin se ka një ndryshim ndërmjet kërimit lutje nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe betimit në All'llahun me pozitën e Profetit. Ata e lejojnë kërkesën në lutje dhe nuk lejojnë gjë tjetër, ndërkohë që nuk ekziston ndërmjet këtyre dy çështjeve asnjë ndryshim i logjikshëm.

4. Disa shkrimtarë dhe dijetarët të Ehli Synetit, në veçanti "Vehabijtë" me kokëforcinë e tyre, përpiqen që të gjitha hadithet që flasin për "teuasulin" t'i quajnë të dobta apo i injorojnë me argumente të pabaza.

Ata e hulumtojnë këtë çështje me mënyra të veçanta dhe çdo personi neutral në fillim i duket se ata e kanë zgjedhur për veten e tyre këtë besim, por më pas sqarohet se ata përpiqen ta kundërshtojnë duke u mbështetur në transmetimet islame dhe në metodologjinë e mbushur plot me fanatizëm dhe me një logjikë të papranueshme që nuk e pranon absolutisht asnjë kërkesë.

5. Shpjegojmë se hadithet e ndërmjetësimit (teuasulit) janë të shumtë dhe kanë arritur deri në gradën e teuaturit që do të thotë se ky teuatur është i mjaftueshëm për një hulumtues që të

¹ Sure "Al-Imran" ajeti 169.

verifikojë zinxhirët e transmetimit të tyre. Në shtesë të kësaj, ka shumë hadithe prej tyre që janë të sakta dhe nuk mbetet hapësira për ata që dëshirojnë t'i kundërshtojnë këto transmetime.

6. Nga ajo çfarë thamë sqarohet se nuk ka kundërshtim ndërmjet këtyre transmetimeve që kanë ardhur në komentimin e këtij ajeti, i cili thotë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), u ka bërë thirrje njerëzve për t'u afruar tek All'llahu i Lartësuar me vepra të mira që është mjete (uesijletu) më i mirë i afrimit. Ajo çfarë ka ardhur nga Imam Ali (*Paqja qoftë mbi të!*) në librin "El Kafijj" se ai ka thënë: "El uesiletu është shkalla më e lartë në Xhennet" nuk e mohon atë çfarë thamë në komentimin e këtij ajeti sepse uesiletu ë shtë (mjete) për t'u afruar tek All'llahu i Lartësuar.

Ajetet 36 - 37

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا لَوْ أَنَّهُمْ مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا وَمِثْلَهُ مَعَهُ
لَيَفْتَدُوا بِهِ مِنْ عَذَابِ يَوْمِ الْقِيَمَةِ مَا تُقْبَلُ مِنْهُمْ ^ط وَلَهُمْ
عَذَابٌ أَلِيمٌ يُرِيدُونَ ﴿٣٦﴾ أَنْ تَخْرُجُوا مِنَ النَّارِ وَمَا هُمْ
بِخَارِجِينَ مِنْهَا ^ط وَلَهُمْ عَذَابٌ مُّقِيمٌ ﴿٣٧﴾

"Me të vërtetë, sikur të kenë jobesimtarët tërë pasurinë që gjendet në tokë, madje edhe një herë aq, e ta sakrifikojnë për të shpëtuar nga dënimi i Ditës së Kiametit, nuk do të pranohet prej tyre dhe për ata do të ketë dënim pikëllues."

"Ata do të dëshirojnë të dalin nga zjarri, por s'do të mund të dalin dot. Ata i pret dënimi i përhershëm."

Komentimi

Ne pamë vazhdimësinë e ajetit të mëparshëm, i cili i obligonte myslimanët për devotshmëri, për xhihad në rrugën e All'Ilahut dhe për përgatitjen e uesiletu {(mjeti) për t'u afruar tek All'Ilahu i Lartësuar}. Ndërsa këto dy ajete në fjalë tregojnë për të ardhmen e jobesimtarëve dhe përforcojnë se sado që ata të

mundohen për të shpëtuar vetveten nga ndëshkimi Ditën e Gjykimit, nuk do të shpëtojnë dhe do të marrin një ndëshkim të rreptë. Për këtë ajeti thotë: **"Me të vërtetë, sikur të kenë jobesimtarët tërë pasurinë që gjendet në tokë, madje edhe një herë aq, e ta sakrifikojnë për të shpëtuar nga dënimi i Ditës së Kiametit, nuk do të pranohet prej tyre dhe për ata do të ketë dënim pikëllues."**

Po i njëjti kuptim ka ardhur edhe në ajetin 47 të sures "Er-Rrad". Kjo metodologji kur'anore qartëson në shkallën më të lartë ndëshkimin e All'llahut, të Cilit absolutisht askush nuk i shpëton sado që të ketë fuqi dhe pasuri. Rruga e vetme e shpëtimit qëndron vetëm tek zbatimi i devotshmërisë, xhihadi në rrugën e All'llahut dhe kryerja e veprave të mira.

Pas kësaj, ajeti në vazhdim tregon vazhdimësinë e ndëshkimit të All'llahut duke sqaruar se jobesimtarët sado që të përpiqen për të dalë nga zjarri i Xhehennemit kurrë nuk do të kenë mundësi për ta bërë një gjë të tillë, dhe se ndëshkimi i tyre është i vazhdueshëm dhe nuk do të ndryshojë, sikurse thotë ajeti: **"Ata do të dëshirojnë të dalin nga zjarri, por s'do të mund të dalin dot. Ata i pret dënimi i përhershëm."** Shpjegimet më të shumta për ndëshkimin e përhershëm dhe qëndrimin e jobesimtarëve në zjarr të Xhehennemit do t'ua paraqesim në komentimin e ajetit 108 të sures "Hud", me lejen e All'llahut të Madhëruar.

Ajetet 38 - 40

وَالسَّارِقُ وَالسَّارِقَةُ فَاقْطَعُوا أَيْدِيَهُمَا جِزَاءً بِمَا كَسَبَا نَكَالًا مِّنَ
 اللَّهِ ^ق وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٣٨﴾ تَابَ مِنْ بَعْدِ ظُلْمِهِ وَأَصْلَحَ
 فَإِنَّ اللَّهَ يَتُوبُ عَلَيْهِ ^ق إِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٣٩﴾ تَعْلَمَ أَنَّ
 اللَّهَ لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ يُعَذِّبُ مَن يَشَاءُ وَيَغْفِرُ لِمَن
 يَشَاءُ ^ق وَاللَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٤٠﴾

"Vjedhësit dhe vjedhëses ua pritni duart, si ndëshkim për atë që kanë bërë dhe si dënim nga ana e All'llahut. All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."

"Ndërsa atij që pendohet pas të këqijave të tij dhe përmirësohet, All'llahu ia pranon pendimin, sepse Ai është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë."

"A nuk e di ti se vetëm All'llahut i takon sundimi i qiejve dhe i Tokës?! Ai dënon kë të dojë dhe fal kë të dojë. All'llahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë."

Komentimi

Ndëshkimi i vjedhjes

Ajetet e mëparshme treguan ndëshkimin dhe rregullin e “vrasësit dhe të kusarit”, i cili u merr shpirtin, pasurinë dhe nëpërkëmb nderin e njerëzve nëpërmjet kërcënimit me armë. Kurse këto tre ajete tregojnë rregullën e hajdutit dhe hajdutes që vjedhin pasurinë e njerëzve. Ajeti i parë thotë: **“Vjedhësit dhe vjedhëses prituani duart...”**

Ky ajet në fillim përmend vjedhësin mashkull e pastaj përmenden vjedhësen. Ndërsa ajeti që flet për rregullin e ndëshkimit të kurvërisë në fillim përmend gruan lavire më pas përmend burrin lavir. Ka mundësi që ky ndryshim të jetë ngaqë vjedhja, në të shumtën e rasteve, kryhet nga burrat, ndërsa femrat e zhveshura e të pasjellshme përbëjnë faktorin dhe elementin nxitës për degjenerimin e kurvërinë!

Më pas, ajeti qartëson ndëshkimin e caktuar, i cili është ndëshkimi nga ana e All'Ilahut për krimin e vjedhjes që kryhet nga ana e mashkullit dhe e femrës. Ajeti thotë: **“...si ndëshkim për atë që kanë bërë dhe si dënim nga ana e All'Ilahut...”**

Në të vërtetë, kjo fjali kur'anore tregon:

Së pari: Ndëshkimi i përmendur është rezultat i veprës së personit, qoftë femër apo mashkull dhe kjo është diçka që ata të dy (mashkull apo femër) e kanë vepruar.

Së dyti: Qëllimi i zbatimit të këtij ndëshkimi është ruajtja e shoqërisë dhe zbatimi i drejtësisë në të, sepse fjala "*nekal*" do të thotë ndëshkim, i cili zbatohet për të realizuar ruajtjen dhe largimin nga mëkati. Kjo fjalë në rrënjën e saj do të thotë *fre*.

Gjithashtu, përdoret për çdo vepër që pengon shthurjen dhe devijimin.

Me qëllim që njerëzit të mos hamendësojnë se ka padrejtësi në këtë ndëshkim, në mbyllje ajeti përforcon se All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Aftë për çdo gjë dhe nuk ka nevojë të hakmerret ndaj individëve. Gjithashtu, Ai është i Urtë dhe nuk është e mundur që t'i ndëshkojë njerëzit pa pasur arsye. Ajeti thotë: **"...All'llahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."**

Ndërsa ajeti tjetër hap derën e kthimit e të pendimit për ata që e kanë kryer këtë vepër duke thënë: **"A nuk e di ti se vetëm All'llahut i takon sundimi i qiejve dhe i Tokës?! Ai dënon kë të dojë dhe fal kë të dojë. All'llahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë."**

Këtu shtrohet pyetja: A mjafton vetëm pendimi për t'u falur mëkati? A e rrëzon pendimi dënimin e vjedhjes?

Përgjigje: Ajo çfarë është e njohur te juristët e shiiave, është se ai që ka kryer veprën e vjedhjes nëse pendohet përpara se të vërtetohet vjedhja e tij në gjykatën islame, bie poshtë ndëshkimi i vjedhësit. Ndërsa, nëse dëshmojnë dy dëshmitarë të drejtë për vjedhjen e tij, në këtë rast pendimi nuk e rrëzon gjykimin për këtë vepër.

E vërteta është se pendimi në këtë rast, që e ka cekur ajeti, është ai pendim që bëhet para se të konstatohet krimi në gjykat. Sikur të mos ishte kështu, çdo hajdut do të shfaqte pendimin e tij kur konstatohej krimi me qëllim për të shpëtuar veten e tij nga ndëshkimi. Atëherë, në këtë rast nuk mbetet arsye për t'u dënuar pas pendimit!

Thënë ndryshe: Pendimi i vullnetshëm është ai që kryhet përpara se të konstatohet krimi në gjykatë. Ndërsa pendimi i detyruar

është ai pendim që bëhet nga njeriu mëkatar kur dëshmon ndëshkimin e All'llahut, ose kur është në prag të vdekjes. Ky lloj pendimi absolutisht nuk ka asnjë lloj vlere. Ajeti thotë: **“A nuk e di ti se vetën All'llahut i takon sundimi i qiejve dhe i Tokës?! Ai dënon dhe fal kë të dojë. All'llahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.”**

Hulumtime

Është e vlefshme që këtu të kihen parasysh disa pika. Ato janë:

a) Kriteret e ndëshkimit të vjedhësit

Në ajetet e lartpërmendura Kur'ani sqaroi bazën e rregullit të Sheriatit për çështjen e vjedhjes. Si zakonisht edhe në çështje të tjera, shpjegimin e ka lënë në dorën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ajo çfarë tregohet nga transmetimet e shumta islame është se zbatimi i këtij gjykimi islam (prerja e dorës), është i lidhur me shumë kushte e kriteret dhe nuk lejohet ekzekutimi i vendimit pa u plotësuar ato kushte e kriteret. Prej atyre kushteve janë:

1- Të jetë caku më i ulët i vlerës së gjësë së vjedhur se një çerek dinar.

2- Të kryhet vjedhja në vend të ruajtur, pra, të jetë kryer vjedhja në shtëpi, në dyqan apo në xhepa.

3- Të mos jetë vjedhja në kohë thatësire apo urie ku njerëzit vuajnë nga uria se nuk kanë ushqime.

4- Vjedhësi, gjatë kryerjes së vjedhjes, të jetë i rritur në moshën madhore (balig) i vetëdijshëm dhe i lirë.

5- Nuk zbatohet dënimi i vjedhjes ndaj babait nëse vjedh nga pasuria e djalit të tij dhe as e ortakut kur vjedh nga pasuria e ortakut që është e posaçme në ortakëri.

6- Frutat e vjedhura nga kopshti janë përjashtuar nga ndëshkimi i vjedhjes.

7- Po ashtu është përjashtuar paqartësia se ato që ka vjedhësi janë të vetat apo të një tjetri.

Ka edhe kushte të tjera, të cilat i kanë cekur librat e jurisprudencës islame në kapitullin e vjedhjes.

Duhet pohuar se vjedhja është e ndaluar (haram), u plotësuan apo nuk u plotësuan kushtet e përmendura. Ato kushte janë të posaçme për kufirin e dënimit të posaçëm për vjedhjen.

Vjedhja, në çfarëdolloj forme apo mënyre qoftë dhe sado që të jetë vlera e sendit të vjedhur, është e ndaluar rreptësisht (haram) në Islam.

b) Sasia që duhet prerë nga dora e vjedhësit

Te juristët shiit, të cilët bazohen në transmetimet e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!), është e njohur se ndëshkimi i vjedhësit realizohet me prerjen e katër gishtave të dorës së djathtë të tij e jo më tepër. Ndërsa juristët e Ehli Syneetit thonë më shumë se kjo.

c) Ndëshkimi i vjedhësit dhe thëniet e armiqve të Islamit

Shumë herë armiqtë e Islamit apo edhe disa myslimanë të cilët janë të paditur ndaj të fshehtave të legjislacionit Islam, thonë se ky ndëshkim karakterizohet nga një dhunë e rreptë. Sikur ajo të zbatohet në kohët e sotme, atëherë duhet të priten shumë duar njerëzish dhe do të çonte në privimin e njerëzve në humbjen e një

pjesë të ndjeshme të gjymtyrëve të trupit, siç është dora. Kjo do ta turpëronte individin gjatë gjithë jetës së tij për shkak të shenjës së qartë të lënë pas ndëshkimit të vjedhjes.

Për t'ju përgjigjur atyre duhet t'i kushtohet vëmendje të vërtetave të mëposhtme.

E para: Më lart sqarua se rregulli i vjedhjes, sipas kushteve që përmendëm, nuk përfshin çdo vjedhës, por përfshin vetëm atë grup vjedhësish, të cilët përbëjnë rrezik në shoqërinë njerëzore.

E dyta: Në të vërtetë, sugjerimi i zbatimit të ndëshkimit të vjedhjes duhet të vërehet në kushtet e veçanta, të cilat duhen plotësuar derisa të verifikohet krimi mbi të akuzuarin për vjedhje.

E treta: Kundërshtimet e shumta, të cilat i parashtrojnë personat që nuk i njohin shumë rregullat dhe ligjet islame, burojnë nga pikëpamja e njëanshme rreth një rregulli, e cila është larg Islamit. Sikur të dihet se Islami nuk është vetëm një rregull, por përfshin në brendësi shumë rregulla, dhe, sikur të zbatohen rregullat e tij në shoqëri, do të çonte në realizimin e drejtësisë shoqërore dhe luftimin e varfërisë dhe të injorancës. Gjithashtu, do të çonte në realizimin e edukimit të drejtë dhe do të përhapte urtësi dhe devotshmëri në mesin e njerëzve.

Kjo thënie nuk duhet që të na tërheqë në iluzion se ky rregull islam nuk duhet të zbatohet në shoqëritë e sotme. Por qëllimi i thënies sonë është që të merren në konsideratë të gjitha kushtet gjatë dhënies së gjykimit në këtë fushë.

Konkluzioni i kësaj thënieje: Qeveria islame është e detyruar t'i plotësojë çdo individ të këtij ymeti nevojat e tij të domosdoshme dhe parësore. T'u sigurojë atyre mësimin e domosdoshëm, t'i kultivojë tek ata vlerat dhe virtytet e larta dhe t'i përgatisë ata moralisht. Është e natyrshme se nëse arrihet kjo,

nuk do të kishte në mesin e shoqërisë fenomene negative dhe do të ishin shumë të pakët vepruesit e vjedhjes e të krimit.

E katërta: Ajo çfarë vërejmë sot është rritja e numrit të vjedhjeve si rezultat i moszbatimit të këtij rregulli islam. Ndërsa në ato vende ku zbatohet ky rregull janë të rralla këto ndodhi. Ato vende gëzojnë qetësi të plotë për sa i përket ruajtjes së pasurisë së njerëzve. Vizitorët e shtëpisë së All'llahut shumë herë i kanë lënë bagazhet e tyre në rrugë pa i ruajtur askush dhe askush nuk e shtrin dorën tek ato bagazhe derisa të vijë personeli i zyrave të gjërave të humbura që i mbart ato në zyrat e ruajtjes dhe ua dorëzojnë pronarëve të tyre pasi paraqesin veçoritë e bagazheve. Ajo që tërheq vëmendjen është se ky rregull islam, megjithë zbatimin e tij për disa shekuj, ku myslimanët që në fillim të Islamit kanë jetuar të sigurt e të qetë në hijen e tij, ky rregull nuk është zbatuar gjatë gjithë asaj periudhe vetëm ndaj një numëri të paktë njerëzish.

d- Kundërshtime të tjera

Disa thonë se zbatimi i dënimit të vjedhjes ndaj vjedhësit për një çerek dinari konsiderohet si mosrespektim i madh që i bën Islami jetës së njeriut mysliman dhe mbrojtjes së saj nga çdo rrezik. Islami ka vendosur si detyrim një gjobë shumë të rëndë në këmbim të prerjes së katër gishtave të dorës së njeriut.

Ajetet 41 - 42

﴿يَأْتِيهَا الرَّسُولُ لَا تَحْزُنَكَ الَّذِينَ يُسْرِعُونَ فِي الْكُفْرِ مِنَ الَّذِينَ
 قَالُوا ءَامَنَّا بِأَفْوَاهِهِمْ وَلَمْ تُؤْمِنْ قُلُوبُهُمْ ۚ وَمِنَ الَّذِينَ هَادُوا ۚ
 سَمَّعُونَ لِلْكَذِبِ سَمَّعُونَ لِقَوْمٍ ءَاخِرِينَ لَمْ يَأْتُوكَ تَحْرِفُونَ
 ۚ أَلَكَلِمَ مِنْ بَعْدِ مَوَاضِعِهِ ۚ يَقُولُونَ إِنْ أُوتِيتُمْ هَذَا فَخُذُوهُ وَإِنْ لَمْ تُؤْتَوْهُ
 فَاحْذَرُوا ۚ وَمَنْ يُرِدِ اللَّهُ فِتْنَتَهُ فَلَنْ تَمْلِكَ لَهُ مِنْ اللَّهِ شَيْئًا ۚ أُولَٰئِكَ
 الَّذِينَ لَمْ يُرِدِ اللَّهُ أَنْ يُطَهِّرَ قُلُوبَهُمْ ۚ لَهُمْ فِي الدُّنْيَا خِزْيٌ ۚ وَلَهُمْ فِي الْآخِرَةِ
 عَذَابٌ عَظِيمٌ سَمَّعُونَ ﴿٤١﴾ لِلْكَذِبِ أَكْكُلُونَ لِلْسُّحْتِ ۚ فَإِنْ
 جَاءُوكَ فَاحْكُم بَيْنَهُمْ أَوْ أَعْرِضْ عَنْهُمْ ۚ وَإِنْ تُعْرِضْ عَنْهُمْ فَلَنْ يَضُرُّوكَ
 شَيْئًا ۚ وَإِنْ حَكَمْتَ فَاحْكُم بَيْنَهُم بِالْقِسْطِ ۚ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ ﴿٤٢﴾

"O i Dërguari i All'Ilahut! Mos u brengos për ata që zhyten
 shpejt në mosbesim, qofshin nga ata që me gojën e tyre thonë:
 'Besojmë', ndërkohë që zemrat e tyre nuk besojnë apo prej
 hebrenjve, të cilët trillimet i dëgjojnë shumë, (madje) dëgjojnë
 edhe ata që s'kanë ardhur te ti. Ata i ndryshojnë vendet e fjalëve

(në tekstet e shenjta) dhe thonë: 'Nëse (shpallja) ju është dhënë kështu, pranojeni e, nëse nuk ju është dhënë kështu, atëherë, ruhuni e mos e pranoni'. Kur All'Ilahu dëshiron ta lërë dikë në humbje, ti nuk mund të bësh asgjë për ta penguar Atë. Këta janë të asaj dore të cilët All'Ilahu nuk dëshiron t'ua pastrojë zemrat. Për ata, në këtë jetë ka poshtërim, kurse në Jetën Tjetër ka ndëshkim të rëndë."

"Ata janë dëgjues të gënjeshtres dhe e hanë me kënaqësi të madhe atë që është e ndaluar. Nëse vijnë tek ti, gjykoji ata ose shmangu prej tyre! Nëse shmangesh nga ata, nuk mund të të dëmtojnë aspak. E, nëse i gjykon, gjykoji me drejtësi! Vërtet, All'Ilahu i do të drejtët."

Shkaku i zbritjes

Kanë ardhur transmetime të ndryshe për shkakun e zbritjes së këtyre dy ajeteve dhe më e qarta e tyre është ajo çfarë është transmetuar nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*). Përkufizimi i ndodhisë është se një prej të njohurve jehudinë në zonën e Khajberit ka qenë i martuar dhe ka kryer një vepër që është në kundërshtim me pastërtinë (ka kryer veprën e kurvërisë) me një grua të martuar nga një familje e shquar nga Khajberi. Jehudnjtë u brengosën se si do të zbatojnë rregullën e Teuratit (gurëzimin) ndaj këtij personalitetit të tyre të njohur dhe ndaj ortakes së tij në mëkat. Ata filluan të kërkojnë rrugëzgjdhje për këtë problem që t'i shpëtonin ata të dy nga dënimi dhe në të njëjtën kohë të dukeshin se ishin zbatues të rregullave të All'Ilahut. Kjo çështje i

shtyu ata që t'u kërkojnë ndihmë jehudinje të tyre që banonin në Medinen e Ndritur. Ata u thanë atyre që të pyesnin Profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për rregullin e kësaj çështjeje. (Nëse rregulli do të ishte i lehtë do ta zbatonin dhe nëse do të ishte i ashpër do ta injoronin e do ta harronin. Ndoshta ata me këtë pyetje donin që t'i tërhiqnin vëmendjen Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kah ata dhe se gjoja ata ishin miq me myslimanët).

Për këtë qëllim disa nga personalitet jehudinj iu drejtuan Medines për të takuar Profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Profeti i pyeti ata se a do të pranonin çdo rregull që ai do tu jepte. Ata iu përgjigjën se prandaj kishin ardhur! Në ato momente zbriti rregulli i gurëzimit për atë që kryen kurvëri me grua të martuar. Por jehudinjtë nuk paraqitën gadishmëri që ta pranonin këtë gjykim, me propozimin se në fenë e tyre nuk ndodhet ky gjykim. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) iu përgjigj se ky është i njëjti rregull që ndodhet në librin e tyre "Teuratin". Ai i pyeti ata se a pranojnë që t'i sjellin ndonjë dijetar të tyre që t'ua lexonte këtë rregull të Teuratit që ata ta zbatonin atë. Ata pranuan. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i pyeti ata se cili ishte mendimi i tyre për dijetarin e jehudinjëve ibn Surja, i cili jetonte në zonën e Fedekut. Ata iu përgjigjën se me të vërtetë, ai është më i miri nga jehudinjtë që e njeh Teuratin. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i çoi lajm dijetarit që të vinte. Kur erdhi, Profeti i tha që të betohet në All'llahun e Vetëm, i Cili ia zbriti Teuratin Musait (*Paqja qoftë mbi të!*), që e hapi detin për të shpëtuar bijtë e Izraelit dhe i mbyti armiqtë e tyre dhe Faraonin, si

dhe iu zbriti mirësitë e Tij në shkretëtirën Sina, që të pohojë e të vërtetojë se rregulli e vrasjes me gurë ka zbritur në Teurat si në shembullin e kësaj ngjarjeje. Dijetari jehudi (ibn Surja) iu përgjigj së është i detyruar për shkak të betimit që i bëri Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se do të thoshte të vërtetën dhe të pohojë praninë e rregullit të gurëzimit në Teurat.

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i pyeti jehudinjtë për shkakun e moszbatimit të këtij rregulli. Ibn Surja iu përgjigj se ata e kanë zbatuar këtë rregull ndaj masës së njerëzve dhe jo ndaj të pasurve dhe personaliteteve të njohura. Ky veprim i padrejtë bëri që të përhapet mëkati i kurvërisë mes të pasurve jehudinj derisa këtë e kreu djali i xhaxhait të njërit prej udhëheqësve jehudinj. Për atë nuk u zbatua dënimi i kurvërisë. Po në të njëjtën kohë ndodhi që një njeri i zakonshëm bëri të njëjtin mëkat dhe donin të zbatonin rregullin e gurëzimit ndaj tij por të afërmit e tij kundërshtuan dhe thanë: Nëse duhet patjetër të zbatohet ky rregull, atëherë duhet të zbatohet për të dy (të njohurin jehudi dhe për njeriun e thjeshtë.)

Për këtë arsye, dijetarët jehudinj përpiluan një rregull më të lehtë se goditja me gurë dhe ajo është goditja me 40 kamxhikë e atij që bën kurvëri, duke ia nxirë fytyrën dhe duke e hipur në një kafshë duke e shëtitur nëpër rrugët dhe tregjet e zonës!

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) menjëherë urdhëroi që të vritet me gurë si burri i shquar ashtu dhe gruaja e pasur përpara Xhamisë. Me këtë

dëshmoi para All'llahut se ai ishte personi i parë që ringjalli ligjin e All'llahut pasi e kishin mohuar jehuditët.¹

Në ato momente zbritën këto dy ajete që e shpjegojnë këtë çështje në mënyrë të kufizuar.²

Komentimi

Gjykimi ndërmjet triumfuesve dhe armiqve

Këto dy ajete dhe ajetet që vijnë në vazhdim tregojnë se për gjykatësin mysliman – në bazë të kritereve të veçanta-, ka të drejtën e gjykimit të krimeve të grupeve të tjera jomyslimane. Shpjegimi i kësaj tematike do të vijë në komentimin e po këtyre ajeteve.

Ajeti i parë i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me shprehjen: **"O i Dërguari i All'llahut!..."** Kjo shprehje ka ardhur në dy vende në Kur'an, e para në këtë ajet dhe e dyta në ajetin 67 të po kësaj sureje, e cila trajton çështjen e udhëheqjes dhe të (hilafetit). Ndoshta përdorimi i kësaj shprehjeje ka ardhur për të nxitur ndjenjat e përgjegjësisë së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për të përforcuar vulletin e tij. Thënia se është i Dërguari i All'llahut do të thotë se duhet të jetë i vendosur në rrugën e drejtë dhe të durojë në predikimin e detyrës së ngarkuar.

¹ "Sunen Bejhakij", vëll. 8, f. 266. Hadithet e përmendura në këtë Sunen thonë se kur jehudinjtë shkuan në Medine për të takuar Profetin, kishin marrë me vete edhe burrin edhe gruan që kishin bërë kurvëri.

² Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëllimi. 3, f. 333-334.

Pas kësaj, ajeti e qetëson Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) si parathënie për të qartësuar rregullin në vazhdim, ku thotë: **"...Mos u brengos për ata që zhyten shpejt në mosbesim, qofshin nga ata që me gojën e tyre thonë: 'Besojmë', ndërkohë që zemrat e tyre nuk besojnë..."**

Disa mendojnë se shprehja **"ata që zhyten shpejt në mosbesim"** ndryshon nga shprehja "ata, që garojnë për në mosbesim". Kjo sepse, shprehja e parë thuhet për individët jobesimtarë, të cilët janë zhytur në mosbesimin e tyre dhe garojnë ndërmjet tyre për të arritur deri në pikën e fundit të mosbesimit. Ndërsa shprehja e dytë thuhet për ata, të cilët jetojnë jashtë kufijve të mosbesimit, por që garojnë për të arritur tek ai.¹

Pasi flet për tejkalimin e kufirit nga ana e hipokritëve dhe armiqve të brendshëm, ajeti trajton gjendjen e armiqve të jashtëm dhe të jehudinjëve, të cilët kanë qenë shkak i shqetësimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku thotë: **"...apo prej hebrenjve..."**

Pastaj ajeti tregon një pjesë të veprimeve të tyre të mbushura me hipokrizi e me mburrje dhe përforcon se ata e dëgjojnë fjalën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), jo për t'iu bindur atij, por për ta marrë informacion për të përgënjeshtuar Profetin dhe për të shpifur kundër tij. Ajeti thotë: **"...të cilët trillimet i dëgjojnë shumë..."**

Për këtë shprehje kur'anore ka një komentim tjetër që është se jehudinjtë i dëgjojnë shumë trillimet e udhëheqësve dhe drejtuesve të tyre, por ata nuk janë të gatshëm për të dëgjuar fjalën e vërtetë e për t'iu bindur asaj.

¹ Tefsir "El-Menar", vëllimi 6, faqe 388.

Pastaj ajeti demaskon cilësinë e tretë të jehudinjëve, ku shpjegon se me të vërtetë ata i spiunojnë myslimanët për interes të një populli tjetër të cilët nuk marrin pjesë në tubimet islame, të cilat zhvillohen në prani të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ku thotë: “...(madje) **dëgjojnë edhe ata që s’kanë ardhur te ti...**”

Në një komentim tjetër të kësaj fjalie thuhet se ata jehudinjë dëgjonin vetëm urdhrat e grupit të tyre dhe populli i tyre i ngarkuan që të pranojnë nga fjalët e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ato që përputhen me dëshirat e tyre dhe të refuzojnë ato fjalë që janë kundër dëshirave të tyre. Duke u bazuar në këtë sjellje, ajo që dukej prej tyre si bindje ndaj disa thënieve të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk ishte vetëm se bindje ndaj prijësve të tyre, të cilët i urdhëruan që të ndjekin këtë sjellje. Për këtë, ky ajet i është drejtuar Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të mos brengoset për kundërshtimin e tyre sepse, ata nuk shkojnë tek ai për të dëgjuar të vërtetën e për ta ndjekur atë!

Më pas, ajeti tregon një shthurje tjetër të jehudinjëve ku tregon devijimin e fjalëve të All'llahut të Lartësuar nëpërmjet ndryshimit të shprehjeve apo të kuptimeve të ardhura me këto fjalë. Nëse në fjalën e All'llahut gjenin rregull që binte në kundërshtim me interesat e tyre e ndryshonin ose e refuzonin plotësisht, siç thotë ajeti: “**...Ata i ndryshojnë vendet e fjalëve** (në tekstet e shenjta)...”.

Më e habitshme se kjo është se përpara se të paraqiten tek Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) merrnin vendimet nga të mëdhenjtë e tyre se nëse dëgjojnë një rregull nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut*

qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që është në përshtatje me dëshirat dhe egot e tyre, ta pranonin atë dhe nëse ishte në mospërputhje me dëshirat e tyre ta refuzonin dhe të largoheshin prej saj. Ajeti thotë: **"...Nëse (shpallja) ju është dhënë kështu, pranojeni e, nëse nuk ju është dhënë kështu, atëherë, ruhuni e mos e pranoni..."**

Vërtet, ata janë zhytur në humbje dhe atyre u janë ngurtësuar mendjet e zemrat sepse, refuzuan çdo gjë që binte në kundërshtim me rregullat e tyre të devijuara, pa bërë asnjë përpjekje për të menduar e për t'u njohur me të vërtetën. Kjo gjendje i ka larguar ata nga rruga e udhëzimit dhe nga rruga e vërtetë, ku nuk mbeten aspak shpresa për t'u udhëzuar dhe për këtë gjë ata kanë merituar ndëshkimin e All'Ilahut. Për ta nuk ka dobi ndërmjetësimi dhe për këtë gjë ajeti thotë: **"...Kur All'Ilahu dëshiron ta lërë dikë në humbje, ti nuk mund të bësh asgjë për ta penguar Atë..."** Zemrat e tyre janë ndotur deri në atë shkallë saqë nuk pastrohen dhe për këtë gjë All'Ilahu ua ka privuar pastrimin e zemrave. Ajeti thotë: **"...Këta janë të asaj dore të cilët All'Ilahu nuk dëshiron t'ua pastrojë zemrat..."** Veprat e All'Ilahut gjithmonë janë të shoqëruara me urtësi. Ai që e kalon jetën në devijim dhe praktikon hipokrizinë e mashtrimin, e kundërshton të vërtetën, e refuzon drejtësinë dhe i shmang ligjet e All'Ilahut, atij nuk i mbetet hapësirë për pendim dhe kthim tek e vërteta. All'Ilahu i Lartësuar në këtë ajet thotë: **"...Për ata, në këtë jetë ka poshtërim, kurse në Jetën Tjetër ka ndëshkim të rëndë."**

Ndërsa ajeti i dytë, përsëri përforcon se ata kanë veshë dëgjues që dëgjojnë fjalët e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) jo për t'iu bindur atij, por për ta përgënjeshtuar, ose sikurse thotë një komentim tjetër se ata kanë

veshë që dëgjojnë vetëm përgënjeshttrimet e parisë së tyre. Ajeti thotë: **"Ata janë dëgjues të gënjeshtres..."**. Kjo fjali është përsëritur në këto dy ajete për të vërtetuar dhe për të përforcuar praninë e kësaj cilësie të shëmtuar e të ulët tek ata.

Gjithashtu, ajeti shton një cilësi tjetër të ulët të jehudinjëve dhe ajo është zakoni i tyre për të grumbulluar pasuri në mënyrë jo të ligjshme (haram) nëpërmjet kamatës, ryshfetit dhe të tjera si këto, siç thotë ajeti: **"...dhe e hanë me kënaqësi të madhe atë që është e ndaluar..."**.

Pastaj, ajeti i ka lënë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të përzgjedhë ndërmjet gjykimit të tyre ose t'i lërë ata të largohen ku thotë: **"...Nëse vijnë tek ti, gjykoji ata ose shmangu prej tyre!..."** Përzgjedhja këtu nuk do të thotë që Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të përdorë dëshirën dhe animin e tij që të zgjedhë njërin nga këto dy çështje, por qëllimi në këtë është që të ruajë shkaqet dhe rrethanat në çdo rast. Nëse e shikon çështjen që duhet të gjykohet, le të gjykohet dhe nëse e shikon të kundërtën t'i lërë dhe të distancohet prej gjykimit të tyre. Ajeti e forcon qetësinë në shpirtin e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke thënë: **"...Nëse shmangesh nga ata, nuk mund të të dëmtojnë aspak..."**

Sikurse ka përforcuar domosdoshmërinë e ndjekjes së drejtësisë dhe zbatimin e saj dhe nëse është rasti që duhet të gjykojë në mes tyre, ajeti thotë: **"...E, nëse i gjykon, gjykoji me drejtësi! Vërtet, All'llahu i do të drejtët."**

Komentuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme në çështjen e zgjedhjes së sistemit islam ndërmjet gjykimit të

jomyslimanëve me rregulla islame ose shmangies së tyre. Vallë, kjo për zgjedhje vazhdon me forcën e saj apo është pezulluar?

Disa mendojnë se njerëzit që jetojnë nën hijen e ligjit islam përfshihen nga dy anë, ana e të drejtave dhe ana e ndëshkimeve sipas rregullave islame, qofshin myslimanë apo jomyslimanë. Bazuar në këtë mendim, rregulli i për zgjedhjes ose është i pezulluar ose është i veçantë për ata jobesimtarë, të cilët nuk jetojnë nën hijen e sistemit islam, por kanë lidhje me myslimanët, ose kanë marrëdhënie të mira shoqërore.

Disa komentues të tjerë mendojnë se udhëheqësi islam është zgjidhës - edhe në ditët tona - në bashkëpunimin me jobesimtarët. Ai, ose të zbatojë rregullat islame tek ata, nëse e kërkon domosdoshmëria dhe interesi, ose të shmanget prej tyre dhe ata të udhëhiqen e të gjykohen me ligjet e tyre të posaçme. Për më shumë sqarime kthehu te librat e jurisprudencës islame.

Ajeti 43

وَكَيْفَ تَحْكُمُونَكَ وَعِنْدَهُمُ التَّوْرَةُ فِيهَا حُكْمُ اللَّهِ ثُمَّ يَتَوَلَّوْنَ مِنْ بَعْدِ
ذَلِكَ وَمَا أُوتِيَكَ بِالْمُؤْمِنِينَ ﴿٤٣﴾

"E qysh të drejtohen ata ty për t'i gjykuar, e ata kanë Teuratin, në të cilin është gjykimi i All'llahut, e madje edhe pas kësaj shmangen prej teje? Ata nuk janë besimtarë."

Komentimi

Ky ajet vazhdon të flasë për temën e gjykimit mes jehudinëve që e trajtuam edhe në dy ajetet e mëparshme, të cilat qartësojnë se jehudinjtë shkuan te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i kërkuan atij që t'i gjykojë ata. Ky ajet paraqet habinë e jehudinëve, të cilët edhe pse kishin Teuratin dhe përmante gjykimin e All'llahut, ata shkuan te Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i kërkuan që të gjykojë mes tyre. Ajeti thotë: **"E qysh të drejtohen ata ty për t'i gjykuar, e ata kanë Teuratin, në të cilin është gjykimi i All'llahut..."?**

Duhet të dihet se qëllimi me gjykim në këtë ajet është gjykimi i gjuajtjes me gurë për vepruesin e kurvërisë, mashkull a

femër qoftë, i cili ndodhet në Teurat në "Seferu Tethnije", në kapitullin 22.¹

Ajo që të habit në çështjen e atyre jehudinje është se edhe pse e kishin Teuratin mes tyre, edhe pse pohonin se nuk është pezulluar nga Kur'ani edhe pse e refuzonin Sheriatin islam, kur shikonin një rregull në Teurat që nuk përputhej me dëshirat e tyre, ata nuk e zbatonin atë dhe kërkonin për një rregull tjetër në ato burime që nuk i pranonin dhe nuk i besonin.

Më e habitshme është se kur ata i kërkuan Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të gjykonte mes tyre, nuk pranonin gjykimin e tij nëse ai ishte sipas gjykimit të Teuratis dhe nuk përshtatej me epshet dhe egon e tyre. Për këtë ajeti thotë: **"...e madje edhe pas kësaj shmangen prej teje..."** E, kjo përshak se ata në realitet, nuk ishin besimtarë të singertë. Nëse ata do të ishin besimtarë, nuk do të talleshin e t'i përçmonin ligjet e All'llahut në këtë formë, të cilën e përforcon edhe ajeti duke thënë: **"...Ata nuk janë besimtarë."**

Këtu mund të ketë një kundërshtim që është: Ajeti i nderuar pohon praninë e gjykimit të All'llahut në Teurat ndërkohë që ne nëpërmjet Kur'anit dhe transmetimeve islame dimë që Teurati është ndryshuar para ardhjes së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Përgjigjja jonë për këtë kundërshtim është se ne:

Së pari: Nuk themi se i gjithë Teurati është i ndryshuar, por përkundrazi pohojmë se në Teurat ka rregulla në përputhje me të vërtetën dhe realitetin. Rregulli i gjuajtjes me gurë – e cila është

¹ Kamusul Mukades, Seferu Tethnijeh, kap. 22, nr. 22.

tematika e kërkimit tonë, është nga rregullat që nuk është ndryshar nga dora e ndryshimit në Teurat.

Së dyti: Teurati, sido që të jetë gjendja e tij, nuk konsiderohet libër i ndryshuar tek jehudinjtë. Për këtë, ajo çfarë është e habitshme këtu është që jehudinjtë refuzojnë të zbatojnë ligjin e All'llahut edhe pse ai ekziston në Teuratin e tyre.

Ajeti 44

إِنَّا أَنْزَلْنَا التَّوْرَةَ فِيهَا هُدًى وَنُورٌ تَحْكُمُ بِهَا النَّبِيُّونَ الَّذِينَ أَسْلَمُوا
لِلَّذِينَ هَادُوا وَالرَّبَّانِيُّونَ وَالْأَحْبَارُ بِمَا اسْتُحْفِظُوا مِنْ كِتَابِ اللَّهِ
وَكَانُوا عَلَيْهِ شُهَدَاءَ فَلَا تَخْشَوُا النَّاسَ وَاخْشَوْنِ وَلَا تَشْتَرُوا بِعَاقِبَتِي
ثَمَنًا قَلِيلًا وَمَنْ لَمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ ﴿٤٤﴾

"Ne kemi dërguar Teuratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita. Sipas tij, Profetët që ia kishin dorëzuar veten All'Ilahut, i gjykonin hebrenjtë; por edhe të diturit dhe rabinët kështu vepronin, sepse atyre iu qe besuar mbrojtja e Librit të All'Ilahut, për të cilin ata dëshmonin. Prandaj, mos kini frikë nga njerëzit, por kini frikë vetëm prej Meje. Dhe mos i ndërroni Fjalët e Mia me ndonjë vlerë të vogël. Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur All'Ilahu, ata janë mohues."

Komentimi

Ky ajet dhe ai në vazhdim plotësojnë tematikën e përmendur në ajetet e mëparshme. Ajeti në fjalë qartëson rëndësinë e librit qiellor, i cili iu shpall Profetit Musa (*Paqja e All'Ilahut qoftë mbi të!*), Teurati, i cili përmban dritë dhe udhëzim që udhëzojnë kah e drejta dhe e vërteta. Në të vërtetë, drita që ndodhet në të është për të larguar errësitat e injorancës nga

mendjet e njerëzve. Ajeti thotë: **“Ne kemi dërguar Teuratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita...”**

Për këtë, Profetët që i janë bindur urdhrit të All'llahut dhe ata të cilët e kishin përgjegjësinë për të udhëhequr, pas zbritjes së Teuratit, kanë gjykuar në mesin e jehudinëve me gjykimin e këtij libri, për të cilin All'llahu i Lartësuar në këtë ajet thotë: **“...Sipas tij, Profetët që ia kishin dorëzuar veten All'llahut, i gjykonin hebrenjtë...”**

Po ashtu, edhe dijetarët jehudin, të mëdhenjtë dhe mendimtarët e tyre besimtarë e të singertë, kanë gjykuar sipas këtij libri qiellor, i cili ka mbërritur si amanet në duart e tyre dhe ata ishin dëshmues për këtë. Ajeti thotë: **“...por edhe të diturit dhe rabinët kështu vepronin, sepse atyre iu qe besuar mbrojtja e Librit të All'llahut, për të cilin ata dëshmonin...”**¹

Pastaj ajeti u drejtohet dijetarëve dhe mendimtarëve jehudin, të cilët kanë jetuar në atë kohë dhe u kërkon atyre që të mos u frikësohen njerëzve kur t'u qartësojnë rregullat e All'llahut.

Por, është obligim i atyre që t'i frikësohen vetëm All'llahut, të mos përulen para njerëzve, të mos kundërshtojnë urdhrat e All'llahut e të mos e fshehin të vërtetën. Nëse e bëjnë këtë, ata i pret ndëshkimi i rreptë, për të cilin All'llahu i Lartësuar thotë: **“...Prandaj, mos kini frikë nga njerëzit, por kini frikë vetëm prej Meje...”**

Më pas, ajeti paralajmëron përçmimin e argumenteve të All'llahut, ku thotë: **“...Dhe mos i ndërroni Fjalët e Mia me ndonjë vlerë të vogël...”**

¹ Kuptimin e fjalës "rabanij" e përmendëm në komentimin e ajetit 79 të sures "Ali Imran". Ndërsa fjala "Ahbar" është shumësi i fjalës "hibr" që ka kuptimin e çdo gjurme të mirë. Kjo përdoret edhe për mendimtarët të cilët lënë gjurmë të mira në shoqërinë e tyre. Gjithashtu, përdoret për bojën që përdoret për shkrim.

Vërtet, fshehja e së vërtetës dhe e rregullave të All'Ilahut burojnë ose nga frika e njerëzve ose nga nxitja për interesa personale. Cilado që të jetë arsyeja, ky është argument i besimit të dobët i degjenerimit personal. Këto dy arsye tregohen edhe në fjalitë kur'anore të latpërmendura.

Në fund ajeti përcjell një rregull të prerë e të ashpër për ata që gjykojnë kundër asaj që ka zbritur All'Ilahu i Lartësuar, ku thotë: **"...Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur All'Ilahu, ata janë mohues."**

Është e qartë se moszbatimi e gjykimi i asaj që ka zbritur All'Ilahu përfshin heshtjen dhe largimin nga gjykimi i All'Ilahut. Mosgjykimi me atë që ka zbritur All'Ilahu i çon njerëzit në humbje, sikurse përfshin edhe futjen e gjërave të reja që janë në kundërshtim me gjykimin e All'Ilahut.

Gjithashtu, është e qartë se shkallët e mosbesimit janë të ndryshme, fillojnë nga mohimi i ekzistencës së All'Ilahut e deri te mohimi i urdhrave të Tij. Sepse besimi i plotë e fton dhe e nxit njeriun që të veprojë sipas urdhrave të All'Ilahut. Kush nuk punon për All'Ilahun, nuk e ka besimin e plotë.

Ky ajet gjithashtu qartëson përgjegjësinë e madhe që kanë dijetarët dhe mendimtarët e çdo populli gjatë sfidave shoqërore dhe ngjarjeve që ndodhin në mjediset e tyre. Ai bën thirrje prerazi për t'i luftuar e për t'u bërë ballë devijimeve dhe për të mos pasur frikë nga asnjë njeri për të zbatuar ligjet e All'Ilahut.

Ajeti 45

وَكُتِبْنَا عَلَيْهِمْ فِيهَا أَنَّ النَّفْسَ بِالنَّفْسِ وَالْعَيْنَ بِالْعَيْنِ وَالْأَنْفَ بِالْأَنْفِ
وَالْأُذُنَ بِالْأُذُنِ وَالسِّنَّ بِالسِّنِّ وَالْجُرُوحَ قِصَاصٌ فَمَنْ تَصَدَّقَ بِهِ فَهُوَ
كَفَّارَةٌ لَهُ ۚ وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٤٥﴾

"Ne u caktuam atyre në Teurat: jeta me jetë, syri me sy, hunda me hundë, veshi me vesh, dhëmbi me dhëmb dhe plaga me plagë (të njëjtë me të). Por kushdo që fal shpagimin si lëmoshë, ka bërë një vepër që është shlyerje për gjynahet e veta. Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka zbritur All'llahu, ai është shkelës i vërtetë."

Komentimi

Dënimi dhe falja

Ky ajet shpjegon një pjesë tjetër të rregullave të dënimeve dhe ndëshkimeve të All'llahut të cilat kanë ardhur në Teurat. Prej atyre rregullave që gjenden në të janë edhe ato të rregulla të posaçme të ndëshkimit të vrasjes. Ajeti sqaron se kush vret një njeri të pafajshëm, atëherë kujdestarët e të vrarit kanë të drejtën e ndëshkimit të vrasësit për vrasjen e tij, jetën me jetë. Ajeti thotë: "Ne u caktuam atyre në Teurat: jeta me jetë..."

Po ashtu, syri me sy, veshi me vesh, hunda me hundë, dhëmbi me dhëmb dhe plaga me plagë. Ajeti thotë: **"...syri me sy, hunda me hundë, veshi me vesh, dhëmbi me dhëmb dhe plaga me plagë (të njëjtë me të)..."**

Bazuar në këtë, gjykimi i ndëshkimit duhet të bëhet në mënyrë të drejtë ndaj kriminelit që kryen një nga krimet e lartpërmendura, pa marrë parasysh racën, kombësinë, pozicionin e tij shoqëror dhe medh'hebin e tij.

Është e natyrshme se zbatimi i ligjit të ndëshkimit ndaj kriminelit është njësoj si zbatimi i ligjeve të tjera islame. Ai është i kushtëzuar me kushte e kriteret, të cilat përmenden në librat e jurisprudencës islame. Këto fjalë nuk janë të specifikuara e as të posaçme vetëm për bijtë e Izraelit sepse, Islami ka sjellë po të njëjtin rregull, sikurse ka ardhur në ajetin 178 të sures "El Bekare".

Ky ajet ka ndaluar dallimin jo të drejtë racor që mbizotëronte në atë kohë. Disa komentime të Kur'anit përmendin se një dallim i habitshëm mbizotëronte ndërmjet dy fiseve jehudite, Beni Nedhijr dhe Beni Kurejdha, të cilët jetonin në Medinen e Ndrishme në atë kohë. Dallimi ekzistonte deri në atë gradë sa që nëse një person nga fisi Beni Nedhijr vriste një person tjetër nga fisi Beni Kurejdha, vrasësi nuk gjykohej. Ndërsa, në rast se ndodhte e kundërta, për vrasësin nga fisi Benu Kurejdha zbatohesh gjykimi ndaj tij.

Kur lindi dhe u përhap drita e Islamit në Medine, fisi Benu Kurejdha e pyeti Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për këtë çështje dhe ai u përforcoi atyre se nuk ka dallim mes gjaqeve. Fisi Benu Nedhijr e kundërshtoi gjykimin e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe pretendoi se ky rregull është i veçantë vetëm për myslimanët. Atëherë, zbriti ky ajet, që

qartëson se ky rregull nuk është specifik vetëm për Islamin, sepse edhe feja jehudite ka këshilluar për ta zbatuar këtë ligj në formë të drejtë¹.

Në mënyrë që të mos hamendësohet se dënimi i vrasjes apo dënimi i plagosjes janë çështje të patjetërsueshme, ajeti shpjegon se ai i cili heq dorë nga e drejta e tij në këtë çështje dhe e fal vrasësin, atëherë falja e tij konsiderohet falje për atë (vrasësin). Për këtë ajeti thotë: **“...Por kushdo që fal shpagimin si lëmoshë, ka bërë një vepër që është shlyerje për gjynahet e veta...”**.

Duhet përmendur se përemri “bihi”, që ka ardhur në këtë fjali, është për dënimin. Mesa duket, ajeti e ka bërë sadekanë e dënimin (faljen e dënimin) dhuratë për vrasësin. Përdorimi i fjalës “*et tesaddak*” dhe premtimi i dhënë nga All’llahu për falësin, konsiderohet faktor nxitës për falje, sepse dënimi nuk mundet absolutisht që t’i kthejë njeriut atë çfarë ai humbi, por i dhuron atij një lloj qetësie dhe stabilizimi të përkohshëm psikik. Kurse falja, të cilën ia ka premtuar All’llahu falësit, ka mundësi që t’ia kompensojë atë çfarë ka humbur në një formë tjetër. Me anë të faljes, largohet nga zemra dhe shpirti i tij dhembja dhe shqetësimi dhe ky premtim konsiderohet si nxitësi më i mirë për të tillë njerëz.

Ka ardhur nga Halebij se ai e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për fjalën e All’llahut të Lartësuar, ku thotë: **“...Por kushdo që fal shpagimin si lëmoshë, ka bërë një vepër që është shlyerje për gjynahet e veta...”**. Ai ka thënë: Atij i falen gjynahe sa është masa e faljes së tij.”²

¹ Tefsiri “Kurtubij”, vëll. 3, f. 2188.

² “Usulul Kafij”, vëll. 7, f. 358. Tefsiri “Nurul Thekalejn”, vëll. 1, f. 637.

Vërtet, kjo shprehje kur'anore konsiderohet përgjigja më e mirë për ata që thonë se dënimi i veprave penale nuk është i drejtë dhe inkurajon shpirtin e hakmarrjes.

Ajo që kuptohet nga konteksi i përgjithshëm i këtij ajeti, është se lejimi i dënimit është për të frikësuar kriminelët dhe për të siguruar qetësinë në shpirtat e njerëzve të pafajshëm. Po ashtu, ajeti ka hapur derën e kthimit e të pendimit. Për këtë, Islami dëshiron pengimin dhe ndalimin e kryerjes së krimeve duke përdorur shkaqe dhe faktorë si frika dhe shpresa. Gjithashtu, qëllimi i Islamit është të ndalojë me sa të mundet hakmarrjen.

Në mbyllje, ajeti përforcon e thotë: **"...Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka zbritur All'Ilahu, ai është shkelës i vërtetë."**

A ka padrejtësi më të madhe se shkuarja pas ndjenjave dhe emocioneve mashtruese dhe gënjeshtare dhe lënia e vrasësit pa e marrë ndëshkimin e drejtësisë, me argumentin se gjaku nuk lahet me gjak? Sigurisht, që hapja e shtegut të vrasësve për të kryer krime është një tjetër padrejtësi ndaj njerëzve të pafajshëm.

Gjithashtu duhet patur parasysh se Teurati që sot është i përhapur në mesin e njerëzve, e përfshin këtë rregull. Këtë e gjejmë në kapitullin e 21, fraza 23 - 24 - 25, te "Seferul Khuruxh", ku thuhet: "jeta me jetë, syri me sy, dhëmbi me dhëmb, dora me dorë, këmba me këmbë, djegia me djegien, plagosja me palgosje, damkosja me damkosje."

Ajeti 46

وَقَفَّيْنَا عَلَىٰ آثَرِهِم بِعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ التَّوْرَةِ
وَأَتَيْنَاهُ الْإِنجِيلَ فِيهِ هُدًى وَنُورٌ وَمُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ التَّوْرَةِ
وَهُدًى وَمَوْعِظَةً لِّلْمُتَّقِينَ ﴿٤٦﴾

"Pas atyre Profetëve, Ne dërguam Isain, të birin e Merjemes, si vërtetues të Teuratit që kishte ardhur para tij. Dhe i dhamë atij Ungjillin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë, si përmbushje të asaj që ishte shpallur para tij në Teurat dhe si udhërrëfim e këshillë për ata që i frikësohen All'llahut."

Komentimi

Pas ajeteve që flisnin për Teuratin, vjen ajeti në fjalë që flet për Ungjillit dhe vërteton e përforcon profetësinë e Profetit Isa (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) pas Profetëve të mëparshëm. Argumentet që kanë ardhur në të (Ungjill) përputhen me argumentet që kanë ardhur në Teurat, ku ajeti thotë: "**Pas atyre Profetëve, Ne dërguam Isain, të birin e Merjemes, si vërtetues të Teuratit që kishte ardhur para tij...**"

Për këtë fjali kur'anore ka një komentim tjetër që është se Isai (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!) ka pranuar dhe ka pohuar gjithçka që ka zbritur në Teurat, i cili iu shpall Profetit Musa (Paqja e All'llahut qoftë mbi të!), ashtu siç kanë pranuar dhe pohuar të

gjithë Profetët profecinë e Profetëve të mëparshëm dhe drejtësinë e ligjeve që kanë ardhur me të.

Pastaj, ajeti flet për zbritjen e Ungjillit Profetit Isa (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), në të cilin ka udhëzim dhe dritë, ku thotë: **"...Dhe i dhamë atij Ungjillin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë..."** Fjala *dritë* është përdorur në Kur'an për Teuratin, për Ungjillin dhe për vetë Kur'anin. Për Teuratin, në suren "El Maide", ajeti 44 All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ne kemi dërguar Teuratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita."**

Kurse Ungjillin, ky ajet e ka cilësuar me dritë. Edhe Kur'anin Famëlartë All'llahu i Lartësuar në suren "El-Maide", në ajetin 15 thotë: **"Juve ju erdhi prej All'llahut dritë dhe libri i qartë (Kur'ani)"**.

Ashtu si drita që konsiderohet domosdoshmëri e patjetërsueshme për të gjitha krijesat, që të vazhdojnë jetën, po ashtu edhe fetë e All'llahut, ligjet dhe librat e Tij, konsiderohen domosdoshmëri e patjetërsueshme për udhëzimin dhe përsosurinë e shoqërisë njerëzore.

Është vërtetuar në parim se burimi i çdo lloj force, fuqie, lëvizjeje dhe të gjitha llojet e bukurisë, është drita. Të tilla janë edhe mësimet dhe udhëzimet e Profetëve. Nëse nuk do të ishte kjo dritë, errësira do të mbizotëronte mbi çdo vlerë njerëzore, qoftë kjo vlerë individuale apo shoqërore. Kjo është ajo çka vërejmë qartë në shoqëritë materialiste.

Në shumë vende, Kur'ani Famëlartë ka përsëritur se Teurati dhe Ungjilli janë libra qiellorë dhe se nuk ka dyshim që këto dy libra burimin e zbritjes e kanë nga ana e All'llahu të Lartësuar. Por, pasi kanë ndërruar jetë Profetët, këta libra janë ndryshuar, janë hequr të vërteta prej tyre dhe janë shtuar në to mite e legjenda. Kjo ka çuar në humbjen e vlerës së tyre të vërtetë

ose, në të vërtetë, librat origjinalë janë harruar dhe vendin e tyre e kanë zënë libra të tjerë.

Kështu që fjala *dritë*, të cilën Kur'ani Famëlartë e ka përdorur në këtë ajet, e ka për Teuratin dhe Ungjillin e vërtetë origjinal.

Pas kësaj, ajeti përsërit për të përforcuar se Isai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) nuk është i vetmi i cili e ka pohuar dhe e ka besuar Teuratin, por në të vërtetë Ungjilli – libri qiellor që i është zbritur atij – është një dëshmi tjetër për vërtetësinë e Teuratit. Ajeti thotë: **“...si përmbushje të asaj që ishte shpallur para tij në Teurat...”**

Në mbyllje, ajeti përforcon se ky libër qiellor përmban rrugët e udhëzimit dhe këshilla për njerëzit e devotshëm, ku thotë: **“...dhe si udhërrëfim e këshillë për ata që i frikësohen All'llahut.”**

Kjo shprehje është e njëjtë me shprehjen e cila ka ardhur në fillim të sures “El-Bekare”, ku flitet për Kur'anin Famëlartë: **“...Ai është udhërrëfyes për të devotshmit.”**

Në të vërtetë, kjo cilësi e veçori nuk kufizohet vetëm me Kur'anin, por është te të gjithë librat që përbajnë rrugët e udhëzimit për njerëzit besimtarë e të devotshëm.

Qëllimi me të devotshmit janë ata që kërkojnë të vërtetën dhe janë të përgatitur për ta pranuar këtë të vërtetë. Natyrisht, ata që i mbyllin dyert e zemrës me kryeneçësi e kokëfortë si përballë të vërtetës, kurrë nuk do të gjejnë dobi.

Ajo çfarë tërheq vëmendjen në këtë ajet është se në fillim përmend Ungjillin: **“...në të cilin ka udhëzim...”**, pastaj e ka përsëritur fjalën *udhëzim* në mënyrë të përgjithshme.

Ka mundësi që qëllimi me këtë ndryshim në përshkrim është shpjegimi i Ungjillit dhe librat e tjerë qiellorë përfshijnë argumente për udhëzimin e të gjithë njerëzve në mënyrë të përgjithshme. Dhe, në mënyrë të veçantë ky ajet është nxitës për udhëzim, edukim dhe përsosje të moralë ve të njerëzve të devotshëm të cilët meditojnë thelle.

Ajeti 47

وَلِيَحْكُمَ أَهْلُ الْأَيْمَانِ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ فِيهِ وَمَنْ لَمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ

"Le të gjykojnë ithtarët e Ungjillit ashtu siç ka shpallur All'llahu në të. Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur All'llahu, ai është keqbërës i vërtetë."

Komentimi

Ndalimi i të gjykuarit sipas ligjit të All'llahut

Ajetet e mëparshme folën për zbritjen e Ungjillit, ndërsa ky ajet vërteton dhe përforcon se ithtarët e Ungjillit duhet të zbatojnë dhe gjykojnë sipas ligjeve të All'llahut që kanë ardhur në këtë libër ku thotë: "Le të gjykojnë ithtarët e Ungjillit ashtu siç ka shpallur All'llahu në të..."

Është e natyrshme se me këtë ajet, Kur'ani nuk i urdhëron të krishterët që të vazhdojnë e të punojnë me rregullat e Ungjillit në kohën e Islamit. Sikur të ishte kështu, këto fjalë do të binin në kundërshtim me ajetet e tjera kur'anore. Jo vetëm kaq, ato do të ishin në kundërshtim me të gjithë Kur'anin, i cili lajmëroi për fenë e re dhe abrogoi fenë e mëparshme. Prandaj, qëllimi i kësaj është se të krishterët kanë marrë urdhra nga All'llahu, pas zbritjes së

Ungjillit, që të punojnë e të veprojnë me rregullat e ligjet e Kur'anit dhe t'i zbatojnë këto rregulla në të gjitha çështjet e tyre¹.

Në mbyllje ajeti dëshmon dhe përforcon shthurjen e atyre që nuk gjykojnë sipas asaj që ka zbritur All'llahu dhe se ata janë keqbërës, ku thotë: se ata që nuk ndalojnë për të zbatuar atë çfarë All'llahu ka zbritur nga rregullat dhe ligjet e tij janë prej keqbërësve: **"Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur All'llahu, ai është keqbërës i vërtetë."**

Ajo që tërheq vëmendjen është se në këtë ajet dhe në të tjerë të ngjashëm me të, herë përdoret fjala "kafir", jobesimtar, herë përdoret fjala "dhalim", i padrejtë, dhe herë tjetër fjala "fasik", i shthurur, për ata persona që nuk gjykojnë sipas ligjeve të All'llahut. Ndoshta kjo llojshmëri e përdorimit të fjalëve të ndryshme për ata që nuk gjykojnë me ligjet e All'llahut, është për të qartësuar se çdo ligj e rregull i All'llahut ka tri anë:

E para: Ligji përfundon te ligjvënësi, që është All'llahu.

E dyta: Ligji prek udhëheqësin dhe gjykatësin.

E treta: Ligji ka lidhje me individin apo me individët ndaj të cilëve zbatohen rregullat.

Pra, secila cilësi prej cilësive të përmendura mund të jetë treguese e një prej tri anëve sepse ai që nuk gjykon me atë që ka zbritur All'llahu, ka shkelur ligjin dhe kufirin e Tij dhe e ka injoruar atë ligj dhe e ka mohuar. Nga ana tjetër, duke u larguar nga ligji i All'llahut, ai i ka bërë padrejtësi njeriut të pafajshëm. Po ashtu, ka dalë jashtë kufijve të detyrave dhe përgjegjësisë së tij. Kështu që ai bëhet prej *fasikëve*, që do të thotë shkelje e kufirit të adhurimit dhe të obligimit.

¹ E vërteta që e përforcojnë shumë komentues është se fraza "*kulna*", thamë, mund të jetë e aluduar në këtë ajet ku kuptimi i ajetit të jetë: (thamë që ihtarët e Ungjillit...)

Ajeti 48

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ الْكِتَابِ
وَمُهَيِّمًا عَلَيْهِ ۖ فَاحْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ ۚ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ عَمَّا
جَاءَكَ مِنَ الْحَقِّ ۚ لِكُلِّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ شِرْعَةً وَمِنْهَاجًا ۚ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ
لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ لَيَبْلُوَكُمْ فِي مَا آتَاكُمْ ۚ فَاسْتَبِقُوا الْخَيْرَاتِ ۚ
إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ ﴿٤٨﴾

"Ne të kemi zbritur ty (o Muhammed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. Prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur All'llahu dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e Vërteta që të është shpallur. Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë. Sikur të donte All'llahu, do t'ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t'ju provojë në atë që ju ka dhënë, prandaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni te All'llahu e Ai do t'ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti."

Komentimi

Ky ajet flet për pozitën e Kur'anit, pasi ajetet paraardhëse përmendën librat e tjerë qiellorë, të cilët iu shpallën Profetëve të mëparshëm.

Fjala *muhejmin*, në origjinalitet përdoret për çdo gjë që ruan, mbikëqyr ose mbron diçka tjetër. Përderisa Kur'ani mbikëqyr ruajtjen e librave qiellorë të mëparshëm dhe i mbron ata libra nga devijimi dhe i plotëson ato, për atë (Kur'anin) është përdorur fjala *muhejmin*, që do të thotë *mbrojtës*, siç thotë ajeti: **"Ne të kemi zbritur ty (o Muhammed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre..."**

Kur'ani Famëlartë, përveç pohimit e pranimit të librave të mëparshëm qiellorë, ai përfshin, gjithashtu, argumente që janë në pajtueshmëri me atë çfarë ka ardhur në ato libra. Kur'ani është ruajtës dhe mbrojtës i tyre.

Në të vërtetë, librat hyjnorë, me gjithë ndryshimet mes tyre, kanë parime të përbashkëta dhe një qëllim të vetëm, i cili është edukimi i njeriut dhe ngritja e tij në shkallët e përsosmërisë shpirtërore e materiale. Çdo legjislacion i ri e ngre njeriun në një gradë më të lartë dhe përmban planprograme më të mira zhvillimi e përparimi. Përmendja e frazës **"mbrojtës të tyre"** pas fjalisë **"përmbushës të shkrimeve të mëparshme"**, tregon këtë të vërtetë se Kur'ani në të njëjtën kohë që i vërteton librat e mëparshëm, ai sjell planprograme më të përsosura për jetën.

Pastaj, ajeti, bazuar në të vërtetën e përmendur, i përforcon Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) domosdoshmërinë e gjykimit sipas mësimave dhe ligjeve të

Kur'anit në mesin e njerëzve, ku thotë: **“...Prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur All'llahu...”**

Kjo fjali fillon me germën *fe* (*tefri'eh*), e cila tregon përgjithësinë e rregullave islame në krahasim me rregullat e sheriateve të tjerë qiellorë. Këtu nuk ka kundërshtim mes kësaj çështjeje dhe çështjes së mëparshme në ajetin paraardhës, i cili i thoshte Profetit që të zgjidhte ose të gjykonte ndërmjet jehudinjëve ose t'i linte ata në gjendjen e tyre. Sepse, ky ajet e udhëzon Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se nëse ai dëshiron që të gjykojë ndërmjet ithtarëve të Librit, duhet që të gjykojë me mësimet dhe ligjet e Kur'anit.

Pastaj ajeti i thotë qartë që të largohet nga egot dhe dëshirat e ithtarëve të Librit, të cilët dëshirojnë që të zbatojnë ligjet e All'llahut sipas dëshirës së tyre duke thënë: **“...dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e Vërteta që të është shpallur...”**

Për të plotësuar çështjen, ky ajet tregon se çdo popull ka legjislacionin dhe sistemin e jetës, i cili i udhëzon në rrugën e drejtë. Ajeti thotë: **“...Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë...”**

Fjala *shera* apo *sheriat* ka kuptimin e rrugës që të çon tek uji. Përdorimi i fjalës *sheriat* për fenë është bërë sepse feja përmban të dhe mësimet që kanë si qëllim pastrimin e shpirtit të njeriut dhe garantimin e një jete të qetë e të sigurtë për shoqërinë njerëzore. Ndërsa fjala *nehexh*, apo *menhaxh*, përdoret për rrugën e qartë e të vërtetë.

Ragibi në librin e tij “Mufredat”¹, transmeton nga ibn Abasi se ndryshimi mes fjalëve *sheriat* dhe *menhaxh* qëndron në faktin se e para përdoret për të gjitha rregullat dhe ligjet që kanë ardhur në

¹ Mufredat Ragib, lënda *shera*.

Kur'anin Famëlartë, ndërsa e dyta përdoret për të gjitha rregullat dhe ligjet që kanë ardhur në Sunetin e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). (Ky argument, edhe pse është i mirë, por ne nuk zotërojmë argument të prerë për ta mbështetur).¹

Pastaj, ajeti tregon se nëse do të donte All'llahu që t'i bënte të gjithë njerëzit një popull të vetëm, që të ndiqnin një fe dhe një rregull të vetëm, Ai do ta bënte sepse është i Plotfuqishëm për gjithçka. Por kjo çështje bie ndesh me ligjin e përsosmërisë graduale dhe me periudhat e ndryshme të edukimit. Ajeti thotë: **"Sikur të donte All'llahu, do t'ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t'ju provojë në atë që ju ka dhënë..."**

Fjalja **"...që t'ju provojë në atë që ju ka dhënë..."** tregon atë çfarë thamë më sipër se All'llahu ka vendosur te njerëzit aftësi dhe mundësi që zhvillohen nën hijen e sprovave dhe nën dritën e mësimave të Profetëve. Kur njeriu shpalos një periudhë të caktuar, All'llahu i bën ata që të kalojnë në një gradë më të lartë. Kur mbaron periudha e edukimit, All'llahu sjell një periudhë tjetër edukative në dorën e një Profeti tjetër, sikurse ndodh planprogami në shkallët e mësimi të edukimit, që kalon i riu në shkollën e tij.

Në mbyllje, ajeti i drejtohet të gjithë njerëzisë dhe i bën thirrje që të garojnë për të kryer vepra të mira, në vend që të derdhin mundësitë e tyre në përçarje e përbuzje, ku thotë: **"...prandaj bëni gara për punë të mira..."**. Ai përforcon dhe vërteton se të gjithë njerëzit do të kthehen tek All'llahu dhe do t'i

¹ Disa prej komentuesve të mëdhenj besojnë se ekziston dallimi mes "fesë" dhe "shariatit". Ata thonë se feja është parimi i Teuhidit dhe i parimeve të tjera të përbashkëta mes të gjitha feve. Për këtë, feja është një e vetme në çdo situatë e në çdo kohë. Sheriati janë ligjet, rregullat dhe mësimet të cilat nganjëherë ndryshojnë mes feve mirëpo ne nuk zotërojmë argument të qartë për këtë thënie sepse këto dy fjalë në shumë vende janë përmendur si tregues i një kuptimi të vetëm.

lajmërojë ata Ditën e Gjykimit për çështjet rreth të cilave kanë pasur kundërshti. Ajeti thotë: **"...Të gjithë do të ktheheni te All'Ilahu e Ai do t'ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti."**

Ajetet 49 - 50

وَأَنِ احْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ وَاحْذَرْهُمْ أَنْ يَفْتِنُوكَ عَنْ بَعْضِ مَا أَنزَلَ اللَّهُ إِلَيْكَ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَاعْلَمُوا أَنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ أَنْ يُصِيبَهُمْ بِبَعْضِ ذُنُوبِهِمْ وَإِنَّ كَثِيرًا مِّنَ النَّاسِ لَفَاسِقُونَ أَفْحَكَمَ ۖ
الْجَاهِلِيَّةِ يَبْغُونَ ۚ وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللَّهِ حُكْمًا لِّقَوْمٍ يُوقِنُونَ ۚ

"Prandaj gjykoji sipas asaj që të ka shpallur All'Ilahu e mos ndiq dëshirat e tyre të kota! Ki kujdes që ata mos të të nxisin të largohesh nga një pjesë e asaj që të ka shpallur All'Ilahu! Nëse ata të kthejnë kurrizin e nuk dëgjojnë gjykimin tënd, atëherë ta dish se All'Ilahu do vetëm që t'i dënojë për disa gjynahe të tyre. Në të vërtetë, shumë njerëz janë të pabindur."

"A mos kërkojnë ata gjykimin (me ligjin) e (kohës së) injorancës (paganizmit paraislamik)?! E kush është gjykatës më i mirë se All'Ilahu për njerëzit që besojnë bindshëm?"

Shkaku i zbritjes

Disa komentues për shkakun e zbritjes së këyre ajeteve kanë transmetuar thënien e ibn Abasit i cili ka thënë se një grup nga paria e jehudinjëve bënë një komplot dhe ranë dakord që të

shkonin te Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me qëllim që ta devijonin nga Islami.

Ata shkuan tek Ai dhe i thanë atij se ata janë prej mendimtarëve dhe dijetarëve jehudinj dhe se nëse ata do ta pasonin atë (Profetin), sigurisht që edhe jehudinjtë e tjerë do ta pasonin. Ata pretenduan se mes tyre dhe një grupi tjetër gjendet konflikt. Ata kërkuan nga Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që ta gjykonte këtë çështje në dobi të tyre dhe i prematuan se nëse i përgjigjet kërkesës së tyre për këtë çështje, do të besonin në të. Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) refuzoi ta gjykojë këtë çështje me padrejtësi. Atëherë zbritën këto dy ajete.¹

Komentimi

Ajeti i parë përsërit përforcimin e All'llahu të Lartësuar për Profetin Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që të gjykojë ndërmjet ithtarëve të Librit sipas rregullave dhe ligjeve të All'llahut dhe të mos u dorëzohet dëshirave dhe epsheve të tyre, ku thotë: **"Prandaj gjykoji sipas asaj që të ka shpallur All'llahu e mos ndiq dëshirat e tyre të kota!..."**

Përsëritja e çështjes këtu është ose për shkak të tematikave që përmbledh ky ajet kur'anor ose për shkak se tematika e rregullit në këtë ajet ndryshon nga tematika e rregullit në ajetet e mëparshme sepse, tematika dhe rregulli në ajetet e mëparshme ka

¹ Tefsiri "El-Menar", vëll. 6, f. 421.

qenë kurvëria me të martuarën dhe tematika dhe rregulli në këto ajete është vrasja apo diçka tjetër.

Pastaj ajeti i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e i thotë që të bëjë kujdes nga komplotet e jehudinjëve, të cilët dëshirojnë që ta largojnë nga legjislacioni i drejtë e i vërtetë dhe i kërkon atij që të mbikëqyrë lëvizjet e tyre, ku thotë: **"...Ki kujdes që ata mos të të nxisin të largohesh nga një pjesë e asaj që të ka shpallur All'llahu..."**

Ky ajet vazhdimisht i drejtohet Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), se nëse ithtarët e Librit nuk i binden gjykimit të tij të drejtë, kjo është argument se gjynahet dhe mëkatet e tyre i kanë lidhur dhe i kanë privuar ata nga suksesi e mbarësia. Për shkak të këtyre gjynaheve dhe mëkateve All'llahu do t'i ndëshkojë ata. Ajeti thotë: **"...Nëse ata të kthejnë kurrizin e nuk dëgjojnë gjykimin tënd, atëherë ta dish se All'llahu do vetëm që t'i dënojë për disa gjynahe të tyre..."**

Shkaku i përmendjes së thënies **"për disa gjynahe të tyre"** dhe jo të gjitha gjynaheve, mund të jetë se ndëshkimi i të gjitha gjynaheve nuk bëhet në këtë botë. Në këtë jetë provohet një pjesë e tyre dhe pjesa tjetër mbeten për në Jetën Tjetër pas vdekjes.

Ky ajet nuk i përmend llojet e gjynaheve që ata kanë bërë. Ka mundësi që kjo të jetë tregues për fundin e jehudinjëve në Medine, për shkak të tradhëtive të vazhdueshme që kanë praktikuar. Kjo gjë i ka detyruar ata të lënë shtëpitë e tyre e të largohen nga Medina e Ndrishme. Ose dështimi i tyre, apo privimi për të mos patur sukses, është një lloj ndëshkimi për ta dhe për mëkatet e tyre të mëparshme sepse, mossuksesi konsiderohet në vetvete një lloj ndëshkimi. Pra, mëkatet e

vazhdueshme, kokëfortë sia dhe këmbëngulja në mëkate, çojnë në privimin nga gjykimet e drejta dhe në humbje gjatë gjithë jetës.

Në mbyllje ajeti tregon se këmbëngulja e atyre njerëve prej ithtarëve të Librit nuk duhet të jetë shkak i shqetësimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse shumë njerëz janë të devijuar nga rruga e drejtë siç thotë ajeti: **"...Në të vërtetë, shumë njerëz janë të pabindur."**

Pyetje: Disa mund të kundërshtojnë e të thonë se ky ajet inspiron mundësinë e devijimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) – All'llahu na ruajttë – dhe se All'llahu e paralajmëron atë për këtë. A përshtatet kjo çështje me gradën e pamëkatshmërisë (el ismetu) që gëzon Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)?

Përgjigjja: Në të vërtetë, *el ismetu*, pagabueshmëria nga mëkatet nuk do të thotë absolutisht se i pagabuari nuk mund të bëjë gabim. Kuptimi i pagabueshmërisë është se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamët (*Paqja qoftë mbi ta!*), me gjithë supozimin se mund të gabojnë, por ata kurrë nuk mëkatojnë, edhe pse mosbërja e mëkatit nga i pagabueshmi buron te kujdesja e All'llahut dhe te paralajmërimi i Tij. Pra, parajmërimi i All'llahut konsiderohet pjesë prej faktorit të pagabueshmërisë të Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që e ruan për të mos bërë mëkate e gabime.

Temën e pagabueshmërisë së Profetëve nga mëkatet do ta shpjegojmë me detaje të komentimi i ajetit 33 të sures "Ahzab" me lejen e All'llahut.

Ndërsa ajeti tjetër vjen me pyetjen e formës mohore: Vallë, ata që pretendojnë se janë prej ndjekësve të librave qiellorë, a

presin që ti o Profet të gjykosh mes tyre sipas rregullave të kohës para Islamit (xhahilijetit) në të cilët gjenden të gjitha llojet e ndasisë e të racizmit? Ajeti thotë: **"A mos kërkojnë ata gjykimin (me ligjin) e (kohës së) injorancës (paganizmit paraislamik)?"**

Por besimtarët nuk shohin asnjë ligj më të vlefshëm e më të mirë se ligji i All'llahut. Kjo duket në vijim të ajetit, ku thuhet: **"E kush është gjykatës më i mirë se All'llahu për njerëzit që besojnë bindshëm?"**

Në komentimin e ajeteve të mëparshme thamë se një lloj dallimi i habitshëm shtresor mbizotëronte në mesin e jehudinëve, ku nëse një pjesëtar i fisit Beni Kurejdha vriste një pjesëtar të fisit Beni Nedhijr, vrasësi dënohej. Por, nëse ndodhte e kundërta nuk do të zbatohej gjykimi i vrasjes për vrasësin.

Ky dallim famëkeq përfshinte borxhin dhe shpagimin. Ata u merrnin disa njerëzve një shpagim disa herë më të lartë kurse disa të tjerëve nuk ua merrnin fare shpagimin, ose i merrnin më pak. Kur'ani e ka mohuar këtë dallim dhe e ka konsideruar prej ligjeve të kohës para Islamit, ndërkohë që ligjet e All'llahut përfshijnë të gjithë njerëzit pa asnjë dallim.

Në librin "El Kafij" përcillet nga prijësi i besimtarëve Ali ibn Ebi Talib (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: *"Gjykimi është dy llojesh: Gjykimi me ligjin e All'llahut dhe gjykimi me ligjin e kohës para Islamit (el xhahilijetu). Kush gabon në gjykimin sipas ligjit të All'llahut, ka gjykuar me ligjin e injorancës."*¹

Në këtë mënyrë qartësohet se çdo mysliman që ndjek dhe zbaton ligjet e vendosura nga njerëzit dhe nuk zbaton rregullat dhe ligjet e All'llahut, në të vërtetë ai ecën në rrugën e injorancës (xhahilijetit).

¹ "Usulul Kafij", vëll. 7, f. 407 . Tefsiri "Nurul Thekalejn", vëll. 1, f. 640.

Ajetet 51 - 53

﴿يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الْيَهُودَ وَالنَّصَرَىٰ أَوْلِيَآءَ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَآءُ
 بَعْضٍ ۚ وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ مِنْكُمْ فَإِنَّهُ مِنْهُمْ ۗ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ
 فَتَرَى ۖ الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ يُسْرِعُونَ فِيهِمْ يَقُولُونَ خَشِيَ أَنْ
 تُصِيبَنَا دَآئِرَةٌ ۚ فَعَسَى ۖ اللَّهُ أَنْ يَأْتِيَ بِالْفَتْحِ أَوْ أَمْرٍ مِّنْ عِنْدِهِ ۖ فَيُصْبِحُوا
 عَلَىٰ مَا أَسْرُوا فِي أَنْفُسِهِمْ نَادِمِينَ ۝ وَيَقُولُ ۝ الَّذِينَ ءَامَنُوا أَهْوَآءًا
 الَّذِينَ أَقْسَمُوا بِاللَّهِ جَهْدَ أَيْمَانِهِمْ ۖ إِنَّهُمْ لَمَعَكُمْ ۚ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ
 فَأَصْبَحُوا خَاسِرِينَ ۝

"O ju që keni besuar! Mos i bëni miq e mbrojtës hebrenjtë dhe të krishterët! Ata janë mbrojtës të njëri-tjetrit. Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, All'llahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit."

"Ti i sheh ata me zemra të sëmura, sesi vrapojnë për t'u lidhur me ata (hebrenjtë) duke thënë: 'Druajmë se mos po na godet ndonjë fatkeqësi.' Mbase All'llahu do të sjellë fitore ose diçka

tjetër nga ana e Tij, kështu që ata do të pendohen për atë që kanë fshehur në veten e tyre."

"Atëherë besimtarët do të thonë: 'Vallë, këta janë ata që betoheshin solemnisht për All'llahun, se me të vërtetë ishin me ju?!' Veprat e tyre do të fshihen dhe ata do të jenë humbësit."

Shkaku i zbritjes

Shumë komentues të Kur'anit kanë transmetuar se Ubade ibn Samit El-Khazrexhij, pas betejës së Bedrit shkoi te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i përmendi se ai ka aleat jehudinjtë, të cilët janë të fortë dhe janë të shumtë në numër. Ai i siguroi Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), se dëshiron të shkëpusë miqësinë me ata si dhe me ata që kanë bashkëpunim dhe marrëveshje, përderisa kërcënojnë myslimanët në luftë. Ai i tha se don të jetë aleat me All'llahun e Lartësuar dhe me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e Tij dhe me askënd tjetër. Ndërsa Abdullah ibn Ebij e refuzoi shkëputjen e miqësisë me ata që kanë marrëveshje me jehudinjtë dhe kërkoi ndjesë sepse i frikësohej problemeve dhe pretendoi se ua kishte nevojën jehudinjëve.

Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shfaqti frikën e tij për Abdullahun dhe Ubaden për miqësinë e tyre me jehudinjtë duke treguar se rreziku i miqësisë së jehudinjve me Abdullahun është më i madh se rreziku i miqësisë së tyre me Ubade ibn Samet. Abdullahu tha: "Përderisa çështja është kështu, ai do të distancohet nga miqësia dhe besëlidhja me

jehudinjtë". Atëherë zbritën këto ajete për t'u tërhequr vërejtjen myslimanëve për aleancën me jehudinjtët dhe të krishterët.¹

Komentimi

Këto tre ajete në fjalë, i paralajmërojnë ashpër myslimanët që të bëhen aleatë me jehudinjtë dhe të krishterët.

Ajeti i parë i ndalon myslimanët që të bëjnë aleancë me jehudinjtë dhe të krishterët ose të mbështeten tek ata (sigurisht, besimi në All'Allah i obligon ata që të mos bëhen aleatë të tyre, nëse është për qëllime apo për dobi materiale). Ajeti thotë: **"O ju që keni besuar! Mos i bëni miq e mbrojtës hebrenjtë dhe të krishterët!..."**

Fjala *eulija* është shumësi i fjalës *uelij*, që rrjedh nga rrënja *uilajetu*, e cila e ka kuptimin *afrimitet i fortë mes dy gjërave*. Vjen edhe me kuptimin e *miqësisë, aleancës dhe mbikëqyrjes*.

Por, duke parë shkakun e zbritjes dhe argumentet e tjera që ekzistojnë, nuk është qëllimi ndalimi i myslimanëve në ngritjen e marrëdhënieve tregtare e shoqërore me jehudinjtë dhe të krishterët, por qëllimi është që myslimanët të mos jenë aleatë me ta e as t'u mbështeten atyre në përballje me armikun.

Çështja e aleancës ka qenë e përhapur në atë kohë në mesin e arabëve dhe përdorej fjala *el uelau*.

Ajo që tërheq vëmendjen në këtë ajet është se në të nuk përdoret fjala *ehlul kitab*, ithtarët e Librit, kur flet për ndjekësit e këtyre dy feve të njohura, por janë përdorur dy fjalët: jehudinjtë e të krishterët. Ndoshta kjo tregon se nëse jehudinjtë dhe të krishterët

¹ "Biharul Envar", vëll. 20, f. 168 dhe 605.

do të zbatonin dy librat e tyre qiellorë, atëherë ndjekësit e këtyre dy feve do të ishin aleatët më të mirë për myslimanët. Por ata u bashkuan me njëri-tjerin jo se urdhërojnë librat e tyre, por për qëllime politike e raciste.

Pas kësaj, ajeti qartëson me një shprehje të shkurtër shkaku të këtij ndalimi, ku thotë se këta dy grupe janë miq dhe aleatë me njëri-tjetrin ku thotë: **"...Ata janë mbrojtës të njëri-tjetrit..."**, që do të thotë se ata interesohen vetëm për interesat e veta dhe interesat e miqve të tyre dhe nuk u intereson interesi i myslimanëve. Për këtë, çdo mysliman, i cili bën miqësi ose bëhet aleat me ta, në të vërtetë do të bëhet pjesë e shoqërisë dhe e fesë së tyre. Këtë kuptim e përforcon edhe ajeti ku thotë: **"...Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata..."**

Është e natyrshme se All'Ilahu nuk i udhëzon personat e padrejtë, të cilët bëjnë tradhti ndaj vëllezërve e motrave të tyre myslimanë dhe mbështeten tek armiqtë e Islamit. Ajeti thotë: **"...Vërtet, All'Ilahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit."**

Ajeti pasardhës tregon arsyet të cilat bazoheshin zemrat e sëmura për të shfajësuar lidhjet e tyre jolegjitime (islame) me të huajt, mbështetjen tek ata dhe bërja aleancë me ta. Ata shfajësoheshin me frikën e lindjes së problemeve kur një ditë pushteti do të binte në duart e të huajve. Ajeti thotë: **"Ti i sheh ata me zemra të sëmura, sesi vrapojnë për t'u lidhur me ata (hebrenjtë) duke thënë: 'Druajmë se mos po na godet ndonjë fatkeqësi...'"**

Kur'ani u përgjigjet atyre që janë të dobët dhe i kanë zemrat e tyre të sëmura duke u sqaruar atyre se nëse ju mendoni se jehudinjtë dhe të krishterët mund të marrin në dorë udhëheqjen dhe pushtetin, gjithashtu, duhet të mendoni se All'Ilahu i përkrah

myslimanët që pushteti të bjerë në duart e tyre dhe ata që fshehin diçka brenda tyre të pendohen. Ajeti thotë: **“Mbase All'Ilahu do të sjellë fitore ose diçka tjetër nga ana e Tij, kështu që ata do të pendohen për atë që kanë fshehur në veten e tyre.”**

Kjo përgjigje kur'anore përfshin dy anë:

E para: Mendime të tilla me të vërtetë dalin nga zemra e sëmurë, nga persona, besimi i të cilëve tronditet dhe që e paragjykojnë All'Ilahun e Lartësuar. Nëse nuk do të ishin të tillë, nuk do të lejonin që në brendi të tyre të hynin kësisoj mendimesh.

E dyta: Përballja me ata me të njëjtin argument që ata paraqiten për shfajësim. Nëse aletrnativa e tyre se sundimi mund të bjerë në duart e jehudinjëve e të krishterëve përballat me alternativën, domosdoshmërisht, që është triumfi i myslimanëve dhe rënia e pushtetit në duart e tyre për të gjitha çështjet. Për këtë nuk ka asnjë arsye që të bashkohen, të bëjnë aleancë dhe të mbështeten tek ata.

Duke u bazuar në këtë komentim, fjala *“asa”*, *mbase*, që ka kuptimin e supozimit e të shpresës, në këtë ajet qëndron me kuptimin e saj fillestar, por disa komentues kanë thënë se kjo fjalë këtu ka kuptimin e premtimit të prerë nga ana e All'Ilahut për triumfin e myslimanëve.

Ndërsa qëllimi me fjalinë **“...ose diçka tjetër nga ana e Tij...”**, e cila ka ardhur pas fjalës *fitore*, është se myslimanët, në të ardhmen, ose do të fitojnë ndaj armiqve të tyre nëpërmjet rrugës së luftës ose pa luftë, ku fuqia dhe pushteti i tyre do të zgjerohet deri në atë shkallë saqë armiqët t'u binden dhe t'u dorëzohen myslimanëve pa pasur nevojë për të hyrë në luftë.

Thënë ndryshe: fjala *fitore* tregon për fitoren ushtarake të myslimanëve dhe fjalia **“...ose diçka tjetër nga ana e Tij...”**, tregon

për fitoren e myslimanëve nga ana shoqërore, ekonomike e të tjera si këto.

Me të vërtetë, ky sugjerim nga ana e All'Ilahut të Lartësuar, duke e pasur parasysh se ai është i ditur për të gjitha ata që do të ndodhin në të ardhmen, ajeti argumenton e tregon fitoren ushtarake, shoqërore e ekonomike, të cilat do t'i arrijnë në të ardhmen myslimanët.

Në mbyllje ajeti tregon të ardhmen e veprave të hipokritëve dhe u qartëson atyre se kur të triumfojnë myslimanët besimtarë e të zbulohet e vërteta e veprave të hipokritëve, – besimtarët do të thonë të mahnitur: Këta janë ata hipokritë të cilët hiqeshin si besimtarë dhe betoheshin se janë besimtarë dhe se janë me ne? Si është e mundur që arritën deri në këtë cak? Ajeti thotë: **"Atëherë besimtarët do të thonë: 'Vallë, këta janë ata që betoheshin solemnisht për All'Ilahun, se me të vërtetë ishin me ju?!...'"**

Në të vërtetë, për shkak të hipokrizisë së tyre u shkuan dëm të gjitha veprat e punët, sepse ato nuk buronin nga një qëllim i mirë e i pastër. Për këtë, u bënë prej të humburve si në këtë botë, ashtu edhe në Botën Tjetër, siç e përforcon edhe ajeti ku thotë: **"...Veprat e tyre do të fshihen dhe ata do të jenë humbësit."**

Fjalja e fundit, në të vërtetë i ngjan përgjigjes së pyetjes së aluduar, sikur një person pyet: Cila do të jetë e ardhmja e tyre? Përgjigjja e kësaj pyetjeje është se veprat e tyre do të fshihen dhe ata do t'i rrethojë humbja në çdo skaj. Pra, edhe sikur ata të kenë bërë vepra që burojnë nga qëllimet e mira e të singerta, ata nuk do të arrijnë asnjë rezultat pozitiv nga ato vepra të mira, për shkak të devijimit në hipokrizi e idhujtari.

Këtë çështje e kemi shpjeguar në vëllimin e dytë të këtij komentimi në shpjegimin e ajetit 217 të sures "El Bekare".

Hulumtime

Mbështetja te të huajt

Për shkakun e zbritjes së këtyre tre ajeteve, përmendet ngjarja për dy persona të quajtur, Ubadetu ibn Samet dhe Abdullah ibn Ebij, mirëpo, kjo nuk ka dyshim se për këta dy persona nuk tregohet se janë prej personaliteteve historike, por, nënkuptohet se ata përfaqësojnë dy medh'hebe ideologjik e shoqërorë. I pari bën thirrje për mosbashkëpunim e mosbërje aleancë me të huajt, mosdorëzimi i pushtetit në duart e myslimanëve dhe mosbesimi në bashkëpunimin me ata. Ndërsa i dyti mendon se çdo njeri apo popull në këtë botë është i mbushur me probleme dhe në disa raste ka nevojë që të mbështetet diku. Nganjëherë nevoja të fton që të zgjedhësh ndihmë dhe mbështetje në mesin e të huajve, me argumentin se miqësia me to nuk ta ulë vlerën dhe dobinë dhe se patjetër një ditë prej ditësh kjo miqësi do të japë frytin e saj.

Kur'ani Famëlartë e hedh poshtë argumentin e dytë dhe i paralajmëron qartë myslimanët që të mos bien pre e këtij lloji mendimi. Por fatkeqësisht disa myslimanë e kanë harruar dhe e kanë injoruar këtë urdhër të madh kur'anor dhe kanë përzgjedhur në mesin e të huajve se te kush të mbështeten. Historia e ka vërtetuar se shumica e problemeve, të cilat i kanë goditur myslimanët, e kanë burimin te kjo zgjedhje e gabuar!

Andaluzia (Spanja e sotme) konsiderohet argument i gjallë dhe i dukshëm për këtë çështje, që tregon se si myslimanët në

mbështetjen e tyre te vetja mundën të ndërtonin qytetërimin dhe zhvillimin më të madh në Andaluzi. Por si rezultat i mbështetjeve të tyre në forcat e huaja i humbën shumë lehtë të gjitha ato përfitime të mëdha.

Perandoria Osmane e cila shumë shpejt u shkri, siç shkrihet bora në verë, konsiderohet një argument tjetër për këtë çështje.

Gjithashtu, historia e sotme dëshmon më së miri se sa shumë humbje kanë goditur myslimanët për shkak të devijimit të tyre nga mesazhi i tyre (feja e tyre) dhe mbështetja e tyre në shumë çështje tek të huajt. Është e çuditshme se ky gjumë vazhdon të mbështjellë botën islame dhe akoma nuk është zgjuar megjithë katastrofat që e godasin për shkak të mbështetjes së tyre në fuqitë e huaja.

Sido që të jetë, i huaji mbetet i huaj dhe sado të marrë pjesë dhe të bashkëpunojë me ne në fusha të kufizuara, në përfundim distancohet në momentet më kritike.

Sot më tepër se kurrë është obligim i myslimanëve që të kenë kujdes dhe ta dëgjojnë këtë thirrje kur'anore dhe të mbështeten vetëm tek All'illahu i Lartësuar dhe te fuqitë e tyre që Ai ua ka dhuruar atyre.

Profeti Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'illahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i ka kushtuar një rëndësi të madhe kësaj çështjeje, derisa e refuzoi ndihmën e jehudinjëve në luftën e Uhudit, ku treqind prej tyre u shprehën të gatshëm për të qëndruar në anën e myslimanëve kundër idhujtarëve. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'illahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i

ktheu mbrapsht kur ata kishin arritur në mesin e rrugës dhe nuk e pranoi propozimin e tyre, ndërkohë që ky numër njerëzish mund të luante rol të madh dhe ndikues në betejën e Uhudit. Përse i refuzoi ata Profeti? I refuzoi sepse ai nuk e përjashtonte prej tyre mundësi e poshtërimit të tij dhe të myslimanëve në momentet më kritike gjatë luftës, të kthehen e të bashkëpunojnë me armiqtë dhe t'i zhduknin ata myslimanë të mbetur nga ushtria myslimane.

Ajeti 54

يَتَأْتِيهِمُ الَّذِينَ ءَامَنُوا مَنْ يَرْتَدَّ مِنْكُمْ عَنْ دِينِهِ ۖ فَسَوْفَ يَأْتِي اللَّهَ بِقَوْمٍ يُحِبُّهُمْ
وَيُحِبُّونَهُ ۚ أَذِلَّةٌ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ أَعِزَّةٌ عَلَى الْكَافِرِينَ تَجَاهِدُونَ فِي سَبِيلِ
اللَّهِ وَلَا تَخَافُونَ لَوْمَةَ لَائِمٍ ۚ ذَٰلِكُمْ فَضْلُ اللَّهِ يُؤْتِيهِ مَنْ يَشَاءُ ۚ وَاللَّهُ وَاسِعٌ

عَلَيْهِمُ

"O ju që keni besuar! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se All'Ilahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e All'Ilahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e All'Ilahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. All'Ilahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur."

Komentimi

Pas përfundimit të tematikës së hipokritëve, ajeti në fjalë flet për ata që e braktisin fenë e drejtë islame. Ky ajet ka ardhur me një ligj të përgjithshëm, i cili mbart paralajmërim për të gjithë myslimanët, ku përforcon se ai i cili braktis fenë e tij, nuk i bën asnjëherë dëm All'Ilahut, as fesë e as shoqërisë islame, sepse All'Ilahu është Sipërmarrës dhe çon njerëz të aftë dhe të gatshëm për ta ruajtur këtë fe të pastër. Për këtë ajeti thotë: "O ju që keni

besuar! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni se All'llahu do të sjellë njerëz..."

Pastaj, ajeti tregon cilësitë e atyre mbrojtësve të fesë dhe që kanë marrë mbi supe këtë përgjegjësi madhore. Ato cilësi janë:

E para: Ata e duan All'llahun dhe nuk mendojnë asgjë përveçse arritjen e kënaqësisë së Tij. All'llahu i do ata dhe ata e duan All'llahun, siç thotë ajeti: **"...që i do dhe që e duan..."**.

E dyta dhe e treta: Shprehin thjeshtësi, përlulje e mëshirë për besimtarët. Ndërsa janë të ashpër e të fortë ndaj armiqve, ku All'llahu i lartësuar thotë: **"...Të përlulur me besimtarët dhe të ashpër me mohuesit..."**

E katërta: Puna e tyre e vazhdueshme është xhihadi në rrugën e All'llahut, ku thotë: **"...që luftojnë në rrugë të All'llahut..."**

E pesta: Cilësia e fundit që tregon ky ajet për ata që e mbrojnë këtë fe është se ata nuk u frikësohen qortuesve në rrugën e tyre për të zbatuar urdhrat e All'llahut dhe për të mbrojtur të vërtetën. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortimi..."**

Përveç kësaj, ata zotërojnë guxim e trimëri për t'u bërë ballë zakoneve dhe traditave të gabuara dhe për të mbajtur qëndrim të prerë përballë shumicës devijuese, të cilët përshkak të shumicës së tyre talleshin me besimtarët.

Në mbyllje, ajeti përforcon se arritja dhe përfitimi i këtyre cilësive të larta janë prej mirësive të All'llahut që ia dhuron kujt të dojë dhe për atë që e shikon se është i aftë për ato cilësi nga robtë e Tij, ku thotë: **"...Kjo është mirësia e All'llahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë..."**

Në përfundim, ajeti shpjegon se hapësirat e mirësisë së All'llahut dhe bujarisë së Tij janë të gjëra dhe Ai i di ata që janë të

aftë prej robve të Vet, ku thotë: **"...All'llahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur."**

Kanë ardhur shumë transmetime islame, të cilat i kanë përmendur komentuesit, që flasin rreth identitetit të personave të përcaktuar në këtë ajet. Atëherë, kush janë përkrahësit e Islamit, të cilët All'llahu i Lartësuar i ka lavdëruar me këto cilësi?

Në shumë transmetime që kanë ardhur nga burimet e shijave dhe të sunive lexojmë se ky ajet ka zbritur për Ali ibn Ebi Talib (*Paqja qoftë mbi të!*), për luftën e tij ndaj tradhtarëve dhe dezertuesve nga feja (nxitësit e luftës së Xhemelit, ushtrisë së Muaviut dhe të Khauarixheve). Ajo që tregon për këtë është fjala e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur pa dobësinë e udhëheqësve të ushtrisë islame në çlirimin e Khajberit dhe një natë mbajti fjalim në mesin e ushtrisë islame dhe tha: *"Nesër do ta marrë flamurin një njeri që e do All'llahun dhe të Dërguarin e All'llahut dhe atë e do All'llahu dhe i Dërguari i Tij. I vendosur e jo dezertues nuk kthehet derisa All'llahu t'i japë triumfin në dorën e tij."*¹

Transmetime të shumta kanë treguar se ky ajet ka zbritur në çështjen e ndihmëtarëve të Imam Mehdiut të premtuar, të cilët do t'u bëjnë ballë dezertuesve me të gjitha mundësitë dhe do ta mbushin botën me drejtësi e besim.

Ajo për të cilën nuk ka dyshim në mesin e këtyre transmetimeve është fakti se nuk ka papajtueshmëri në këtë ajet, sepse ajeti bazuar në metodologjinë e Kur'anit Famëlartë, qartëson kuptimin e përgjithshëm dhe i konsideron Ali ibn Ebi Talibin dhe Selman Farsiun vërtetues të këtij kuptimi, i cili përfshin edhe persona të tjerë të cilët ecin në të njëjtën rrugë, edhe pse hadithet nuk përmendin emrat e tyre.

¹ "Thkakul Hak", vëll. 3, f. 200.

Është për të ardhur keq se në komentimin e këtij ajeti është përfshirë fanatizmi medh'hebor dhe nacionalist. Ky fanatizëm arriti të përfshijë persona të cilët nuk zotërojnë asnjë aftësi dhe nuk gëzojnë asnjë nga cilësitë që përmendëm. Prej atyre personave është Ebu Musa Eshariji, që bëri budallallëkun e njohur historik e cila e drejtoi Islamin drejt rënies në humnerë dhe e vendosi prijësin e besimtarëve Ali ibn Ebu Talibin në një pozicion të vështirë.¹

E habitshme në këtë çështje është kalimi i gjurmëve të ekstremizmit, që vërehet në disa libra shkencorë, në një mënyrë të frikshme, te njerëzit dhe tek dijetarët e tyre gjithashtu. Duket se një dorë e fshehtë po përpiqet të përçajë myslimanët dhe nuk lejon bashkimin e tyre. Ky ekstremizëm ka arritur të përfshijë edhe historinë paraislamit. Sot vërejmë që ata ekstremistë e kanë quajtur një rrugë të madhe, që ndodhet afër shtëpisë së All'llahut (Qabe), me emrin "Ebu Sufjan". Kjo rrugë është më e madhe dhe më gjigante se rruga e Ibrahimit (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), ndërtuesi i Qabesë së Shenjtë.

Të tillë ekstremistë akuzojnë shumë myslimanë me idhujtari (shirk) jo për ndonjë gjë, porse lëvizjet dhe qëndrimet e atyre myslimanëve nuk përputhen me dëshirat dhe me metodologjinë e tyre të veçantë. Me këtë, duket se Islami kufizohet vetëm me këtë metodologji, ose ata janë të vetmit që e mbrojnë Kur'anin, ose vetëm ata janë të obliguar e jo të tjerët që të sqarojnë se kush është mysliman e kush është jomysliman (kafir) sipas egos dhe dëshirave të tyre.

Është tronditës fakti se fjala *teuhid*, që është simbol i bashkimit të myslimanëve, sot përdoret nga disa grupe të

¹ Tefsir "Tabarij", vëll. 6, f. 184.

caktuara për të përçarë myslimanët dhe për të akuzuar një pjesë të tyre me idhujtari e paganizëm. Një dijetar u drejtohet atyre ekstremistëve me thënien e tij: “Me të vërtetë, ju keni arritur deri në atë shkallë ku, nëse Izraeli sundon një grup tuajin, gëzohet grupi tjetër për këtë sundim. Nëse Izraeli godet grupin tjetër, për këtë goditje gëzohet grupi i parë. A nuk është kjo ajo çfarë dëshirojnë dhe kanë për qëllim armiqtë e Islamit?”

Është e drejtë të thuhet se në takimet e shumta të zhvilluara mes nesh dhe një grupi dijetarësh ekstremist u zbulua maska se ka shumë prej atyre që logjikojnë në këtë grup të cilët janë të pakënaqur me këtë gjendje. Jam takuar me një dijetar nga Jemeni në Qabe, i cili tha përpara profesorëve të mëdhenj të Mekës se akuzimi i ithtarëve të Kibles (akuzimi i myslimanëve) me idhujtari, konsiderohet mëkati më i madh dhe se selefët e mëparshëm punëmirë e kanë urreyer këtë gjë. Kjo fjalë u tha prej tij kur po bisedohej rreth çështjes së kufijve të idhujtarisë (shirkut).

Ky dijetar shprehu keqardhjen e tij për injorantët që i akuzojnë njerëzit me idhujtari, duke treguar se ato mbartin me këtë veprim një përgjegjësi të madhe.

Ajeti 55

إِنَّمَا وَلِيُّكُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَالَّذِينَ ءَامَنُوا الَّذِينَ يُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَيُؤْتُونَ

الزَّكَاةَ وَهُمْ رَاكِعُونَ ﴿٥٥﴾

"Miqtë dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm All'llahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët që falin namazin dhe japin zekatin, duke qenë të përlur (në adhurim) ndaj All'llahut."

Shkaku i zbritjes

Ka ardhur në tefsirin "Mexhmaul Bejan", tefsire e libra të tjerë, përcjellë nga Abdullah ibn Abasi, thënia e tij se ai një ditë ka qenë ulur pranë pusit të Zemzenit dhe u transmetonte njerëzve hadithet e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Papritmas atyre iu afrua një person, i cili kishte veshur çallmë dhe kishte vendosur mbi fytyrën e tij një shami. Sa herë që ibn Abasi lexonte hadithin nga i Dërguari i All'llahut , ai lexonte një hadith nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke filluar me shprehjen: "Ka thënë i Dërguari i All'llahut ...". Ibn Abasi u betua që të prezantohej se kush ishte. Burri e ngriti shaminë nga fytyra dhe thirri: "O ju njerëz! Kush më ka njohur mua, më ka njohur e kush nuk më njeh, unë jam Xhundub ibn Xhenade El Bedrij Ebu Dherr El Gafarrij. Kam dëgjuar të Dërguarin e All'llahut me këta të dy dhe e kam

shikuar me këta të dy, kur ai thotë: "Aliu është udhëheqësi i të drejtëve dhe luftëtari i idhujtarëve. Është triumfues ai që e ndihmon atë dhe i poshtëruar ai që e përçmon atë."

Pastaj Ebu Dherri shtoi: Një ditë prej ditëve unë kam falur me të Dërguarin e All'llahut namazin e drekës. Një lypës kërkoi në xhami dhe atij nuk iu përgjigj askush. Lypësi ngriti duart drejt qiellit dhe tha: 'O Zoti im, dëshmo se unë kërkova në xhaminë e të Dërguarit të All'llahut dhe askush nuk më dha. Aliu ishte në ruku dhe i tregoi gishtin e tij të vogël të dorës së djathtë, në të cilin kishte një unazë. Lypësi u afrua dhe e mori unazën nga gishti i tij i vogël në sy të Profetit . Kur Profeti e kreu namazin, ngriti kokën nga qielli dhe tha: "O All'llahu im, Musai t'u lut ty dhe tha: 'O Zoti im, zgjeroma kraharorin tim, lehtësoma punën time dhe zgjidhma nyjën e gjuhës time. Më jep një ndihmës nga familja ime, Harunin, vëllanë tim! Ma rrit fuqinë nëpërmjet atij dhe bëma ortak në punën time'."¹ Ti i the: "... 'Ne do të forcojmë ty me vëllanë tënd dhe që të dyve do t'ju japim fuqi. Kështu, ata nuk do të mund t'ju afrohen juve'."² O All'llahu im. Unë jam Muhammedi, Profeti Yt, i Dashuri Jot! O All'llahu im, zgjeroma kraharorin tim, lehtësoma punën time dhe bëje Aliun ndihmësin tim që eshdudu bihi dhahri". Ebu Dherri tha: Pa e mbaruar i Dërguari i All'llahut fjalën e tij, erdhi Xhebraili nga ana e All'llahut të Lartësuar dhe tha: "O Muhammed lexo!" Profeti i tha: "Çfarë të lexoj?" Xhebraili i tha: Lexo: "**Miqtë dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm All'llahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët që falin namazin dhe japin zekatin, duke qenë të përulur (në adhurim) ndaj All'llahut.**"³

¹ Sure "Ta Ha" ajeti 25-32

² Sure "El Kasas", ajeti 35.

³ Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 2, f. 210.

Është e natyrshme se shkak i zbritjes ka ardhur me transmetime të ndryshme nga njëra-tjetra, siç do të sqarohet, por të gjitha janë të një mendimi në thelb e në parim.

Komentimi

Ky ajet ka filluar me fjalën *innema*, nga e cila përfitohet kufizim, përveçsim. Me këtë, vilajeti i çështjeve të myslimanëve është kufizuar në tre që janë: All'llahu i Lartësuar, i Dërguari i Tij dhe ata që besojnë e falin namazin e japin zekatin, duke qenë të përlurur në adhurim, siç thotë ajeti: **"Miq të dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm All'llahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët që falin namazin dhe japin zekatin, duke qenë të përlurur (në adhurim) ndaj All'llahut."**

Pa dyshim qëllimi me përkulje në këtë ajet është përkulja në namaz dhe nuk do të thotë përlurje, sepse All'llahu e ka përdorur këtë term në Kur'an për të treguar se rukuja është shtylla e tretë e namazit.

Në shtesë të transmetimeve të ardhura për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, që flasin se Imam Ali ibn Ebi Talibi e dha sadeka unazën e tij në namaz – që do ta shtjellojmë me detaje –, fjalia **"që falin namazin"**, konsiderohet argument për këtë çështje. Në Kur'an nuk ka ndonjë shenjë për domosdoshmërinë e dhënies së zekatit me përlurje. Por ka ardhur përforsimi për ta dhënë zekatin me nijet të pastër dhe jo për qëllime të tjera.

Sikurse nuk ka dyshim se fjala *el velij*, në këtë ajet nuk do të thotë i dashur e përkrahës sepse, vilajeti me kuptimin e dashurisë e përkrahjes nuk kufizohet vetëm tek ata që falin namazin, japin zekatin dhe janë të përkulur (në ruku). Por, kjo fjalë përfshin çdo

mysliman që është i obliguar ta mbrojnë njëri-tjetrin, madje t'i mbrojnë edhe ata që nuk e kanë obligim të japin zeqat. Duhet që të gjithë ata të jenë miq dhe ta mbrojnë njëri-tjetrin.

Nga këtu na qartësohet se qëllimi i fjalës *velij* ka kuptimin e vilajetit të çështjes, mbikëqyrjes dhe të drejtën e veprimit e të drejtimit material e shpirtëror, veçanërisht se ajo ka ardhur e shoqëruar me vilajetin e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të All'llahut.

Në këtë mënyrë, ky ajet konsiderohet argument kur'anor, i cili argumenton udhëheqjen dhe qenien e Imam Ali ibn Ebu Talibit udhëheqës për myslimanët.

Dy hulumtime

1 - Dëshmia e haditheve, komentuesve dhe historianëve

Më lart thamë se shumë prej literaturave islame dhe burimeve të Ehli Sunetit përmbajnë shumë transmetime që thonë se ky ajet ka zbritur për Imam Ali ibn Ebi Talibin. Disa nga këto transmetime përmendin se Imam Aliu ia dha sadeka unazën e tij nevojtarit kur ishte në ruku duke falur namaz. Po ashtu, disa transmetime nuk përmendin dhënien e sadekasë, por janë mjaftuar me pohimin se ky ajet ka zbritur për Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*).

Të gjitha këto transmetime kanë ardhur nga ibn Abasi, Amar ibn Jasir, Abdullah ibn Selam, Selmetu ibn Kuhejl, Enes ibn

Malik, Utbetu ibn Hakijm, Abdullah ibn Ebij, Abdullah ibn Galib, Xhabir ibn Abdullah El Ensarij dhe Ebu Dherr El Gafarij.¹

Në shtesë të këtyre dhjetë transmetuesve të përmendur, librat e Ehli Sunetit e përcjellin të njëjtin transmetim nga vetë Ali ibn Ebi Talibi.²

Është interesante se në librin “Gajetul Meran”, janë transmetuar 23 hadithe nga burimet e Ehli Sunetit dhe 19 hadithe nga burimet e Shiave.³

Numri i librave që i kanë transmetuar këto transmetime është më shumë se tridhjetë. Të gjitha këto libra të shkruara nga autorë të Ehli Sunetit si: Muhibu Dijn Tabarij në “Dhekhairul Ukba”, faqe 88; El Alametu Kadij Sheukani në tefsirin “Fet’hul Kadij” vëllimi 2, faqe 50. Prej atyre burimeve janë: “Xhamiul Usul”, vëllimi 9, faqe 478; “Esbabu Nuzul”, i El Uahidij faqe 148; “Lubabu Nukul” i Sujutit, faqe 90; “Tedhkiretu Sibti i ibn Xheuzij” faqe 18; “Nurul Ebsar i Sheblenxhij”, faqe 105; Tefsiri “Tabarij”, faqe 165; “El Kafij Esh Shafij i ibn Haxher El Askalani”, faqe 56; “Mefatihul Gajb i Raziut”, vëllimi 3, faqe 431; Tefsiri “Durrul Menthur”, vëllimi 2, faqe 393; “Kenzul Ummal”, vëllimi 6, faqe 391; Musned ibn Merdouijeh; Musmed ibn Shejkh; Sahih En Nisai, Xhem'u Bejne Sihahu Sitte, e shumë libra të tjerë që e kanë transmetuar hadithin e “Vilajetit.”⁴

Këtu lind pyetja: Si është e mundur në këtë rast të mohohen këto hadithe dhe burimet e transmetimeve të tyre, ndërkohë që për shkakun e zbritjes së ajeteve të tjera janë mjaftuar me një ose dy hadithe?! Ndoshta fanatizmi verbues sektar është shkak i

¹ “Thkakul Hak”, vëll. 2, f. 309-410.

² “Murraxheat i Sejd Abdul Husejn Sherefudijn”, f. 155.

³ “Minhaxhul Beraeh”, vëll. 2, f. 350.

⁴ “Thkakul Hak”, vëll. 2, faqe 399. “Gadijir”, vëll. 2, f. 52.

inJORIMIT të të gjitha këtyre haditheve dhe dëshmime të dijetarëve për shkakun e zbritjes së këtij ajeti.

Sikur të mos i merreshin parasysh të gjitha këto transmetime që kanë ardhur në komentimin e këtij ajeti, të cilat janë të shumta, do të obligoheshim që të mos mbështeteshim te asnjë hadith për të shpjeguar tekstet kur'anore. Të pakta janë ato ajete të cilat kanë hadithe kaq shumë për shkakun e tyre të zbritjes sa ka ky ajet.

Kjo çështje ka qenë aq shumë e qartë saqë Hasan ibn Thabiti, poet i njohur, bashkëkohës dhe shok i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), përmbajtjen e ajetit të vilajetit e ka sjellë të thurur në një poezi dedikuar Ali ibn Ebi Talibit, në të cilën thotë:

*Ti je ai i cili e dhe zekatin kur ishe në ruku
U bëftë kurban shpirti im për ty o përulësi më i mirë
E All'llahu shpalli për ty vilajetin më të mirë
Dhe e sqaroi atë në ajetet e qarta të sheriatit*

Kjo poezi, me një ndryshim të vogël, përmendet në shumë libra siç janë : “Ruhul Meanij” i Alusit, “Kifajetul Talib” i Kenxhij Shafiut e shumë libra të tjerë.

2- Përgjigja për tetë kundërshtimet

Një grup fanatikësh nga Ehli Suneti vazhdimisht kundërshtojnë shkakun e zbritjes së këtij ajeti për Ali ibn Ebi Talibin. Gjithashtu, edhe për komentimin e fjalës *velajetu*, që ka ardhur në këtë ajet me kuptimin e *mbikëqyrjes, drejtimit e*

udhëheqjes. Në vijim po paraqesim disa prej kundërshtimeve më të rëndësishme për studim e kritikë.

Kundërshtimi i parë: Kanë thënë se frazaa *el ledhijne, të cilët*, ka ardhur e shoqëruar me fjalën *amenu, besuan*, në këtë ajet nuk mund të përdoret për njëjës. Kjo përfshin kundërshtimin e tyre për transmetimet që thonë se ky ajet ka zbritur për Ali ibn Ebi Talib duke thënë se ajeti tregon për numrin shumë të thotë **"...që falin namazin dhe japin zekatin, duke qenë të përulur** (në adhurim) **ndaj All'llahut."** Atëherë, si është e mundur që ky ajet të ketë zbritur për një person si Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*)?

Përgjigja: Librat e letërsisë arabe janë të mbushura me fraza që përshkruajnë njëjës me shumës. Edhe Kur'ani përmban të tilla fjali, si në ajetin e mallkimit (mubahelitit), ku ka ardhur fraza **"gratë tona"** në numrin shumë, ndërkohë që transmetimet e shumta që përmendin shkakun e zbritjes së këtij ajeti thonë se qëllimi i këtij shumësi është vetëm Fatime Zahra (*Paqja qoftë mbi të!*). Gjithashtu, edhe fjala **"vetat tona"**, në të njëjtin ajet, është në numrin shumë, ndërkohë në ngjarjen e mallkimit me Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk është paraqitur asnjë burrë tjetër, përveç Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*)

Po kështu në ajetin 173 të sures "Ali Imran" lexojmë në luftën e Uhudit fjalën e All'llahut të Lartësuar: **"...të cilëve njerëzit u thanë: 'shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni!'** e kjo gjë ua shtoi atyre besimin..." Në xhuzin e tretë të këtij tefsiri, te komentimi i këtij ajeti thamë se disa komentues përmendin se ajeti ka zbritur për Naim ibn Mesud, i cili ishte vetëm një person, ndërkohë në ajet është përdorur numri shumë.

Në ajetin 52 të kësaj sureje lexojmë fjalën e All'llahut të Lartësuar: **“duke thënë: ‘Druajmë se mos po na godet ndonjë fatkeqësi’”**, ndërkohë që kjo pjesë e ajetit ka zbritur për një person të vetëm, sikurse ka ardhur rreth shkakut të zbritjes dhe ai është Abdullah ibn Ebij.

Gjithashtu, ajeti i parë i sures “El Mumtehin”, ajeti i tetë i sures “Munafikun” dhe dy ajetet 215 e 274 të sures “El Bekare”. Në të gjitha këto ajete lexojmë se shprehjet kanë ardhur në numrin shumë, ndërkohë që në shkakun e zbritjes thuhet se qëllimi është për një person të vetëm.

Përshkrimi i një personi me formën e shumësit në Kur'anin Famëlartë ose është për shkak të rëndësisë së këtij personi dhe për të qartësuar rolin e tij, ose për të paraqitur rregullin e Kur'anit në formë të përgjithshme edhe nëse e vërteta e tij është e kufizuar në një person të vetëm. Në shumë ajete të Kur'anit gjendet përemri në numrin shumë për All'llahun e Vetëm dhe kjo tregon madhështinë e All'llahut të Lartësuar.

Është e natyrshme se përdorimi i shumësit për të treguar njëjësin konsiderohet kundërshti me atë çfarë është në aparencë dhe nuk lejohet pa patur argument. Por me praninë e transmetimeve të shumta që kanë ardhur për çështjen e zbritjes së ajetit, ne kemi argument të qartë për këtë komentim, ndërkohë që në vende të tjera, komentimi është mjaftuar me më pak se ky argument?!

Kundërshtimi i dytë: Fahri Raziu dhe disa fanatikë të tjerë të ashpër kanë thënë: Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte i njohur për përkushtim ndaj All'llahut, veçanërisht në namaz, të cilit i kanë hequr gjatë namazit një shigjetë të ngulur në këmbën e tij, pa e ndier dhimbjen, sikurse ka ardhur në transmetimet e njohura. Si

mund të thuhet se ai ka dëgjuar gjatë namazit fjalët e lypësit dhe ka reaguar ndaj tij?

Përgjigja: Në të vërtetë, ata që kanë ardhur me këtë kundërshtim kanë harruar se dëgjimi i zërit të lypësit dhe përpjekja për ta ndihmuar atë nuk konsiderohet argument i pavetëdijes dhe mospërqëndrimit të njeriut, përkundrazi, është vetë drejtimi e përqendrimi për te All'llahu i Lartësuar. Gjatë namazit, Aliu e braktiste veten e tij dhe me të gjithë qenien e vet i drejtohej All'llahut të Madhëruar. Dihet se afrimiteti të krijesat e All'llahut konsiderohet gjithashtu afrimetet tek All'llahu i Lartësuar. Thënë më qartë: Dhënia e zekatit gjatë namazit konsiderohet adhurim brenda një adhurimi tjetër dhe nuk nënkupton kryerjen e një veprë të pëlqyeshme në brendi të adhurimit. Çka nuk përshtatet me thelbin e adhurimit është veprimi dhe mendimi për një çështje të veçantë në jetën personale, ndërsa të drejtuarit dhe të vepruarit e asaj me të cilën është i kënaqur All'llahu, kjo përshtatet plotësisht me thelbin e adhurimit dhe e përforcon atë.

Është e domosdoshme që këtu të përfocojmë se shkrirja në të drejtuarit kah All'llahu nuk do të thotë që njeriu të humbë ndjenjat e tij dhe vullnetin e tij, por me vullnetin e tij njeriu largon çdo lloj mendimi që nuk kanë lidhje me All'llahun e Lartësuar. Është interesante që ekstremizmi e ka çuar Fahri Raziun deri në atë cak saqë e ka konsideruar shenjën e Imam Aliut me gisht për lypësin që të marrë unazën, si vepër që bie në kundërshtim me namazin. Ndërkohë ka më shumë vepra të tjera se sa ajo shenja që ka bëri Imam Aliu, që kryhen gjatë namazit, të cilat as nuk sjellin dobi e as dëm atij. Prej atyre veprave është përshembull: vrasja e insekteve të dëmshme, vrasja e gjarprit, e akrepit, apo ngritja e fëmijës nga vendi i tij, apo dhe ushqimi i tij me gji, dhe, të gjitha

këto juristët nuk i konsiderojnë veprime të tepërta në namaz. Vallë, si mund të thuhet se ajo shenjë që bëri Imam Aliu të konsiderohet nga veprimet e tepërta në namaz?! Ky gabim nuk mund të jetë i çuditshëm nga një dijetar që e ka kapluar ekstremizmi.

Kundërshtimi i tretë: Një tjetër kundërshtim në këtë fushë është se fjala *velij*, që ka ardhur në këtë ajet, do të thotë *mik*, *mbrojtës* e të ngjashme me këto dhe nuk do të thotë *mbikëqyrës*, *udhëheqës* i çështjeve.

Përgjigjja: Në komentimin e këtij ajeti sqaruam se fjala *velij* që ka ardhur në këtë ajet, nuk mund të jetë me kuptimin *mik* ose *mbrojtës*, sepse këto dy cilësi përfshijnë të gjithë myslimanët besimtarë dhe nuk janë të veçuara për besimtarët e treguar në këtë ajet, të cilët e falin namazin dhe japin zekatin gjatë përuljes (rukusë). Thënë ndryshe: miqësia dhe përkrahja janë dy rregulla të përgjithshme, ndërsa ky ajet ka për qëllim sqarimin e një rregulli të veçantë për një person të vetëm.

Kundërshtimi i katërt: Kanë thënë gjithashtu se Aliu nuk zotëronte asgjë nga materialet e kësaj bote që ai ta kishte obligim zekatin. Nëse themi se qëllimi i ajetit është për sadekanë e pëlqyer, atëherë ajo nuk quhet zekat.!

Përgjigjja e parë: Në të vërtetë historia ka treguar se Aliu zotëronte pasuri të mjaftueshme, të cilën e ka arritur me duart dhe djersën e tij dhe e ka dhënë atë në rrugën e All'llahut. Në këtë fushë transmetohet se Aliu ka liruar një mijë robër, të cilët i ka blerë me pasurinë e tij që e ka arritur me mund. Përveç kësaj pasurie, ai merrte edhe pjesën e vet që i takonte nga plaçkat e luftës. Duke u bazuar në këtë, Aliu zotëronte një pasuri ose pemë hurmash nga të cilat jepet zekati.

Përgjigjja e dytë: Në shumë raste Kur'ani Famëlartë e ka përdorur fjalën zekat me kuptimin e sadekasë së pëlqyeshme, veçanërisht në suret që kanë zbritur në Mekë, në të cilat kjo fjalë tregon për sadekan e pëlqyer. Obligimi i dhënies së zekatit ka ardhur pas emigrimit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në Medinë, sikurse ka ardhur në ajetin 3 të sures "Neml", në ajetin 39 të sures "Rrum", në ajetin 4 të sures "Lukman", në ajetin 7 të sures "Fussilet" e të tjera.

Kundërshtimi i pestë: Disa thonë: Edhe sikur të binden se Aliu është khalife (udhëheqës, prijës) pas Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) drejtpërsëdrejti, kjo nuk do të thotë se Aliu ka qenë *veli*, mbikëqyrës, në kohën e të Dërguarit të All'llahut, sepse *vilajeti* i tij në kohën e Profetit nuk ka qenë *vilajet* real, por ka qenë i imponuar. Kurse ky ajet në dukje tregon për *vilajet* real.

Përgjigjja: Në fjalët e përditshme – gjithashtu në tregimet letrare – vërejmë përdorimin e një emri të veçantë ose veçorie të veçantë për persona që nuk i gëzojnë këto veçori reale, por i zotërojnë me forcë. Kjo është e njëjtë me një person që cakton për fëmijët e tij një sipërmarrës dhe mbikëqyrës. Personi i dytë bëhet menjëherë sipërmarrës dhe mbikëqyrës sapo vendos i pari. Këto dy cilësi ai i pretendon edhe kur caktuesi është gjallë.

Në transmetimet që kanë ardhur nga burimet e shijave dhe të sunive lexojmë se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e ka quajtur Aliun khalif, dhe uesij të tij, ndërkohë që këto dy terma nuk janë zbatuar në kohën e Profetit . Gjithashtu, Kur'ani Famëlartë përban të njëjtat thënie. Prej atyre është ajo që ka ardhur nga Zekerija, i cili iu lut All'llahut të

Lartësuar e tha: **“Më dhuro nga ana jote një pasardhës (velij), që të më trashëgojë mua dhe familjen e Jakubit.”**¹

Është e njohur se qëllimi me fjalën *velij*, në këtë ajet është për mbikëqyrësin, i cili merr përsipër administrimin. Shumë njerëz e përcaktojnë që kur janë gjallë se kush e zë pozicionin e tyre pas vdekjes. Që nga momenti i caktimit, ai person quhet zëvendës apo pasardhës.

Kundërshtimi i gjashtë: Gjithashtu, kanë thënë: Përse nuk është mbështetur Aliu në këtë argument të qartë për të mbrojtur të drejtën e tij?

Përgjigjja: Gjatë hulumtimit që kanë trajtuar transmetimet për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, vërejtëm se ky hadith në shumë libra është transmetuar nga vetë Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), si në: Musnedin e ibn Merdovejh, në Kezul Ummal dhe në ibn Shejkh. Ky është tregues se Imam Aliu ka argumentuar të drejtën e vet me këtë ajet.

Në librin e vlefshëm “El Gadijr”, është përcjellë nga libri i “Selijm ibn Kajs El Hilalij” një hadith i detajuar, nga i cili përfitohet se kur Aliu ka qenë i zënë me luftën e Sifinit, ka folur në fushën e betejës përpara njerëzve, duke argumentuar me shumë argumente të drejtën e tij. Në mesin e këtyre argumenteve, Imami ka përmendur edhe këtë ajet.²

Në librin “Gajetul Meram”, transmetuar nga Ebu Dherri, thuhet se ditën *Esh Shura* (konsultimit) Aliu ka sjell argument këtë ajet.³

Kundërshtimi i shtatë: Kanë pretenduar se ky komentim që ne kemi sjellë në këtë ajet, nuk përshtatet me ajetet e ardhura para

¹ Sure “Merjem”, ajetet 5-6.

² Gadijr”, vëll. 1, f. 196.

³ Minhaxhul Beraet”, vëll. 2, f. 363.

dhe pas këtij ajeti, sepse në këto ajete fjala *vilajetu* ka ardhur me kuptimin "*es sidakatu*", miqësi.

Përgjigjja: E kemi thënë disa herë se ajetet e Kur'anit për shkak të zbritjes së tyre në mënyrë graduale, sipas ngjarjeve e ndodhive të ndryshme, nuk kanë gjithmonë lidhje me ngjarjet për të cilat kanë zbritur ajetet. Pra, ajetet e një sureje të vetme apo ajetet pasardhëse të kësaj sureje, nuk kanë gjithmonë kuptim të ndërlidhur dhe nuk tregojnë për kuptim të njëjtë. Për këtë shpesh ndodh që për dy ajete të njëpasnjëshme të transmetohen dy ngjarje të ndryshme ose dy shkaqe zbritjeje. Si rezultat, secili ajet flet për ngjarjen e vet të veçantë. Meqenëse ky ajet thotë: **“Miqtë dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm All’Ilahu...”**, sipas shkakut të zbritjes së tij, ka ardhur për çështjen e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili dha unazën e tij gjatë rukusë. Ndërsa ajetet paraardhëse dhe pasardhëse, siç e pamë dhe do ta shohim, kanë zbritur për ngjarje të tjera. Për këtë, nuk mund të bazohemi shumë në çështjet e lidhjes së kuptimeve ndërmjet ajeteve.

Gjendet një lloj përshtatjeje ndërmjet këtij ajeti dhe ajeteve paraardhëse dhe pasardhëse, sepse ajetet e tjera flasin për *vilajetin* me kuptimin e *ndihmës dhe përkrahjes*. Ndërsa ajeti në fjalë flet për *vilajetin* me kuptimin e *udhëheqjes* dhe të *urdhërimit*. Është e natyrshme se udhëheqësi dhe urdhëruesi në çështjet e një shoqërie të caktuar, në të njëjtën kohë është udhëheqës, mbrojtës i dashur e mik i shoqërisë së tij. Sigurisht, çështja e udhëheqjes dhe e mbrojtjes konsiderohet domosdoshmëri absolute e punëve të udhëheqjes.

Kundërshtimi i tetë: Së fundmi ata thonë se nga e solli Aliu këtë unazë të çmuar? Sërish pyesin a nuk konsiderohet veshja e kësaj unaze të çmuar një lloj shpenzimi i tepërt? A nuk

konsiderohen këto çështje argument për mossaktësinë e këtij komentimi?

Përgjigjja: Në të vërtetë, ekzagjerimet që kanë ardhur për çështjen e vlerës së unazës të cilën Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e dha zekat gjatë rukusë, nuk ka asnjë bazë dhe asnjë argument. Ajo çfarë thuhet për vlerën e kësaj unaze, siç thuhet se vlente sa të ardhurat e Shamit, është një ekzagjerim i afërt me legjendat se sa me të vërtetën. Kjo përmendet në transmetime të dobëta.¹ Ndoshta këto transmetime janë vendosur për të zbehur të vërtetën e çështjes dhe për ta shfaqur sikur të jetë çështje e pavlerë. Ndërsa transmetimet e sakta, të cilat kanë ardhur për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, janë të zbrazëta nga këto legjenda.

¹ Këto transmetime kanë ardhur të dobëta në tefsirin “Burhan”, vëll. 1, f. 485.

Ajeti 56

وَمَنْ يَتَوَلَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَالَّذِينَ ءَامَنُوا فَإِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ

الْغَالِبُونَ ﴿٥٦﴾

"Ata që marrin për mik e mbrojtës All'llahun, të Dërguarin e Tij dhe ata që kanë besuar, (ta dinë se) pa dyshim, pala (partia) e All'llahut do të jetë fitues."

Komentimi

Ky ajet ka ardhur plotësues për përmbajtjen e ajetit të mëparshëm. Ai përforcon dhe ndjek po atë qëllim të atij ajeti dhe i lajmëron myslimanët se triumfi do të jetë për ata të cilët e pranojnë udhëheqjen e All'llahut, të Dërguarit të Tij dhe të atyre që kanë besuar, të cilët i tregoi ajeti i mëparshëm.

Ata të cilët e pranuan këtë udhëheqje, ky ajet i cilëson se me të vërtetë janë pala (grupi, partia) e All'llahut që gjithmonë janë triumfues. Ajeti thotë: **"Ata që marrin për mik e mbrojtës All'llahun, të Dërguarin e Tij dhe ata që kanë besuar, (ta dinë se) pa dyshim, pala (partia) e All'llahut do të jetë fitues."**

Ky ajet, gjithashtu, përfshin një argument tjetër që përforcon kuptimin e komentuar në ajetin e mëparshëm të fjalës *vilaje*, e cila

do të thotë *mbikëqyrje* e *udhëheqje*, se shprehja (hizbullah) përforcon se fitorja do të jetë e kësaj pale dhe kanë lidhje me shtetin islamik.

Nuk ka lidhje absolutisht me miqësinë, e cila është një çështje e thjeshtë dhe e zakonshme. Kjo në të vërtetë përforcon se udhëheqja, që ka ardhur në këtë ajet, do të thotë mbikëqyrje, udhëheqje dhe rregull për shoqërinë islame, sepse kuptimi i fjalës "el hizb", parti përfshin sistemin, rregullin dhe sigurinë për të arritur qëllimet e përbashkëta.

Duhet të vërejmë me kujdes një pikë të rëndësishme, e cila është se qëllimi i frazës "**...ata që kanë besuar...**", që ndodhet në këtë ajet, nuk është për të gjithë personat besimtarë, por është për atë person që përmendet në ajetin e mëparshëm me cilësitë e posaçme.

Ndërsa çështja e fitores, të cilën ia ka garantuar ajeti palës (partisë) së All'llahut, a është vetëm fitorja shpirtërore apo përfshin fitoren në të gjitha sferat dhe në të gjitha fushat materiale dhe shpirtërore?

Nuk ka dyshim se përgjithshmëria e përdorur në ajet tregon për fitoren e përgjithshme në të gjitha anët. Është e natyrshme se çdo grup që ndriçohet nën flamurin e palës (partisë) së All'llahut, sigurisht që mbushet e zbukurohet me besim të fortë, me përkushtim e devotshmëri, bën vepra të mira dhe garon për t'u bashkuar e për të bashkëpunuar. Ai gëzon vetëdije të mjaftueshme dhe do të arrijë fitoren e triumfin në të gjitha fushat e jetës. Ndërsa plogështia e dobësia që vërejmë sot në mesin e myslimanëve për të arritur këtë fitore e triumf, është në të vërtetë shkaku – në përgjithësi – i humbjes së këtyre cilësive që treguam

më lart. Këto janë cilësitë e personave që bashkohen nën flamurin e palës (partisë) së All'llahut.

Në vend që fuqitë dhe potencialin e tyre myslimanët t'i përdorin për dëbimin e armiqve dhe për zgjidhjen e problemeve të tyre shoqërore, i shfrytëzojnë ato për të dobësuar njëri-tjetrin.

Ajeti 22 i sures "Muxhadele" gjithashtu ka treguar një pjesë të cilësive të palës (partisë) së All'llahut (hizbullah), të cilat do t'i sqarojmë me lejen e All'llahut kur të mbërrijmë te komentimi i kësaj sureje.

Ajetet 57 - 58

يَتَّيِّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الَّذِينَ اتَّخَذُوا دِينَكُمْ هُزُوءًا وَلَعِبًا مِّنَ
الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِن قَبْلِكُمْ وَالْكَفَّارَ أَوْلِيَاءَ ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِن
كُنْتُمْ مُّؤْمِنِينَ وَإِذَا ۞ نَادَيْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ اتَّخَذُوهَا هُزُوءًا وَلَعِبًا ۚ
ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ لَا يَعْقِلُونَ ۞

"O ju që keni besuar! Mos i bëni miq ata që fenë tuaj e marrin për tallje dhe lojë, qofshin ata prej atyre që u është dhënë Libri para jush apo prej mohuesve; frikësojuni All'llahut, nëse jeni besimtarë!"

"Kur thërrisni për namaz, ata tallen dhe luajnë, sepse janë njerëz që nuk kuptojnë."

Shkaku i zbritjes

Ka ardhur në tefsiret "Mexhmaul Bejjan", "Ruhul Xhinan" dhe "El Kebijr" se dy prej idhujtarëve, që quheshin Refat dhe Suejd, e shprehën Islamin në dukje (me hipokrizi), e më pas u bashkuan me hipokritët. Disa myslimanë kanë pasur shoqëri me këta dy persona dhe u kanë treguar atyre respekt e mirënjohje.

Atëherë zbritën këto dy ajete që i ndalojnë ata myslimanë që të bashkëpunojnë me këta dy persona.¹

Këtu qartësohet se kur këto dy ajete flasin për el *vilajetu*, kanë për qëllim *shoqërimin*, *miqësinë*, e *dashurin*, sepse shkaku i zbritjes së këtyre dy ajeteve ndryshon nga shkaku i zbritjes së dy ajeteve të mëparshme dhe nuk mund të konsiderohet njëri nga të dy argument për tjetrin.

Përsa i përket shkakat të zbritjes së ajetit të dytë, prej këtyre dy ajeteve, transmetohet se një grup nga jehudinjtë dhe nga të krishterët, kur e dëgjonin *ezanin*, ose kur shihnin myslimanët duke falur namazin, talleshin me ta. Për këtë, Kur'ani Famëlartë u tërheq vërejtjen myslimanëve që të mos bëjnë miqësi me ta dhe me të tjerë si ata.²

Komentimi

Ky ajet kur'anor i paralajmëron besimtarët që të mos i bëjnë miq hipokritët dhe armiqtë. Mirëpo, që të mos ndikohen negativisht myslimanët nga ana emocionale dhe shpirtërore dhe për t'u tërhequr atyre vëmendjen ndaj këtij rregulli, Kur'ani u drejtohet me këtë mënyrë: **"O ju që keni besuar! Mos i bëni miq ata që fenë tuaj e marrin për tallje dhe lojë, qofshin ata prej atyre që u është dhënë Libri para jush apo prej mohuesve..."**

¹ Tefsiri Mexhmaul Bejan, vëll. 3, f. 365.

² Tefsiri "Mexhmaul Bejan", vëll. 3, f. 365.

Për ta përforcuar paralajmërimin, në mbyllje ajeti thotë: **"...frikësojuni All'Ilahut, nëse jeni besimtarë."** që do të thotë se miqësia me armiqtë dhe hipokritët nuk përshtatet asnjëherë me devotshmërinë dhe besimin.

El huzuu janë fjalë që shoqërohen me lëvizje që shfaqin përçmimim e tallje dhe përdoret për të tallur apo për të përçmuar diçka apo një person të caktuar.

Ragib Asfahani në librin e tij "Mufredat" ka thënë se *el huzuu* i thuhet një veprimi me shaka dhe përçmim për një person i cili nuk është i pranishëm. Po ashtu, në raste të rralla përdoret edhe për përçmimin e një personi që është i pranishëm.

Ndërsa fjala *el leib* është veprim që bëhet pa qëllim të vërtetë e të rregullt ose që nuk ka asnjë qëllim. Disa lojëra fëmijësh janë emërtuar me këtë fjalë për të njëjtin shkak. Ajeti i dytë vazhdon hulumtimin rreth çështjes së ndalimit të shoqërisë e miqësisë me hipokritët dhe ithtarët e Librit, të cilët i përçmojnë dhe tallen me rregullat islame. Ai tregon një nga praktikatat e tyre tallëse e përçmuese, që është argument për këtë çështje. Ajeti thotë: **"...Kur thërrisni për namaz, ata tallen dhe luajnë..."**¹

Pas kësaj, ajeti sqaron faktorët e kësaj talljeje. Ai thotë se ky grup në të vërtetë e bën këtë gjë nga padija dhe nga largimi i tyre nga e vërteta, ku thotë: **"...sepse janë njerëz që nuk kuptojnë."**

¹ Komentuesit kanë mendime të ndryshme rreth përemrit "ha", atë, që gjendet në fjalën "ittakhedhuha" se a është për namazin apo për thirrjen. Nga shkaqet e zbritjes përfitohet se është për të dyja sepse hipokritët dhe idhujtarët talleshin si me ezanin ashtu edhe me namazin. Por e jashtëmja e ajetit forcon alternativën e dytë, pra përemri është për namazin.

Dy hulumtime

1- Ezani, një slogan i madh Islam

Vërtet, çdo popull, në çdo kohë e në çdo vend, ka moton e veçantë me të cilën fton individët e tij dhe nxit ndërgjegjet e tyre për të kryer obligimet e tyre individuale e shoqërore. Në kohët e sotme, kjo çështje është përhapur shumë.

Të krishterët i ftojnë njerëzit e tyre që të marrin pjesë në ritet e tyre në kisha duke i rënë këmbanave. Kjo është mënyra dhe sllogani i tyre në çdo kohë.

Islami ka sjellë ezanin slogan e moto, për të thirrur myslimanët. Ky sllogan konsiderohet si ndikuesi më i madh e tërheqës i shpirtave të njerëzve në krahasim me slloganet e feve të tjera. Autori i tefsirit “El Menar” tregon se disa të krishterë ekstremistë kur dëgjojnë ezanin e myslimanëve, nuk gjejnë qetësi derisa ta pohojnë ndikimin e madh shpirtëror që ka Ezani tek ata që e dëgjojnë.

Ky autor, gjithashtu, tregon se në një qytet të Egjiptit janë parë një grup prej të krishterëve të tubuar gjatë thirrjes së Ezanit të myslimanëve për ta dëgjuar këtë melodi qiellore.

A ka sllogan më afër shijes dhe qetësisë për dëgjuesit se ai që fillon me përmendjen e emrit të All'llahut, që dëshmon për Njëtimin e Tij që përmend Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), dhe që bën thirrje për shpëtim e vepra të mira, dhe përfundon përsëri me përmendjen e All'llahut? Pra, ezani fillon me emrin e All'llahut dhe përfundon me emrin e All'llahut me fjali të radhitura e melodioze, me fjali të shkurta, kuptimplote e të qarta, të cilat në brendinë e saj përmbajnë edukim.

Për këtë, shumë transmetime islame e përforcojnë zbatimin e thirrjes së ezanit. Është transmetuar nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në hadithin e njohur, i cili ka thënë: “Muezinët e kanë qafën më të gjatë se të gjithë njerëzit në Ditën e Gjykimit.”¹ Kjo lartësi është e njëjta lartësi e gradës së udhëheqjes, e cila i fton e u bën thirrje njerëzve për tek All'llahu i Lartësuar dhe tek adhurimi, siç është kryerja e namazit.

Në të vërtetë, thirrja e ezanit në kohën e namazit në minaret e qyteteve islame është thirrje për liri dhe fllad përkëdhelës që i dhuron shpirtit pavarësi e krenari. Ezani i kënaq myslimanët e pastër, mbjell frikë në shpirtrat e armiqve dhe konsiderohet simbol i rezistencës së Islamit. Argument për këtë çështje, është pohimi i personalitetit të shquar anglez që ka thënë para një grupi të krishterë: 'Përderisa emri i Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thirret ende përmbi minare, përderisa Qabeja është e pranishme dhe Kur'ani i udhëzon e i drejton ende myslimanët, është e pamundur të nguliten rregullat e politikës angleze në tokat islame.’²

Me keqardhje të madhe, duke patur parasysh çfarë thamë për ezanin, kohët e fundit disa myslimanë të cekët e kanë hequr nga mediat e tyre, radiot dhe televizionet, këtë sllogan madhështor islam, i cili përfaqëson rezistencën e fesë e të kulturës së tyre gjatë të gjitha kohërave, dhe në vend të ezanit kanë vendosur programe pa vlerë. E lusim All'llahun që t'i udhëzojë ata të kthehen në rreshtat e myslimanëve.

¹ El Uesail, vëll. 5, f. 367, kap. 2 hadithi 21.

² Thënësi i kësaj thënieje është "Klodston", i cili konsiderohet prej politikanëve të lartë të kohës së tij.

Është më se e natyrshme se ezani për shkak të përmbajtjes së tij të bukur e mahnitës, ka nevojë që të thirret me një zë të bukur e tërheqës.

2- Ezani i është shpallur Profetit

Në disa transmetime të transmetuara në burimet e Ehli Synnetit përmenden histori të habitshme rreth ezanit që nuk përshtaten me logjikën islame.

Ajo çfarë kanë transmetuar në këtë tematikë është se Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pasi u pyet nga shokët e tij për të gjetur një mënyrë për t'i njoftuar njerëzit për kohët e namazit, u konsultua me shokët e tij. Secili prej tyre paraqiti supozimin e tij. Prej atyre sugjerimeve ishin: të ngrihet një flamur i veçantë në kohët e namazit, ose të ndizet një zjarr, ose t'i bihet kambanës. Profeti nuk pranoi asnjë nga këto sugjerime. Pastaj Abdullah ibn Zubejr dhe Umer ibn Khatab kanë parë në ëndërr një person që i urdhëronte ata të dy ta thërrasin ezanin për t'i lajmëruar njerëzit për në namaz dhe u mësoi atyre mënyrën se si ta thërrisnin ezanin. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pranoi këtë.¹

Në të vërtetë, ky transmetim i vendosur, konsiderohet tallje dhe përçmim për pozitën e lartë të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ku supozon se në vend që ai (Profeti) të mbështetej tek Revelata për çështje të ezanit, u mbështet te ëndërra që kishin parë shokët e tij.

E vërteta e kësaj tematike është ajo që është transmetuar nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*), se ezani i ka zbritur Profetit (*Paqja*

¹ Tefsijr Kurtubij, vëll. 6, f. 225.

dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) tregon se kur ia shpalli Xhebraili ezanin dhe ikametin Profetit (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), dhe ia mësoi ato atij, Profeti kishte vendosur kokën që të pushonte në prehërin e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Pastaj Profeti (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ngriti kokën dhe e pyeti Aliun a e kishte dëgjuar ezanin e Xhebrailit dhe Aliu e pohoi këtë. Për herë të dytë e pyeti Aliun se a e mësoi atë dhe ai pohoi sërish. Pastaj Profeti (Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), kërkoi nga Aliu që të thërriste Bilalin, i cili kishte një zë të bukur, që t'ia mësonte atij ezanin dhe ikametin.¹

Për më tepër informacion për këtë tematikë shih librin “En Nas uel Ixhtihad”, i Sejjid Abdul Husejn Sherefu Dijni.²

¹ El Uesail, vëll. 4, f. 612.

² En Nasu uel Ixhtihad, f. 128.

Ajetet 59 - 60

قُلْ يٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ هَلْ تَنقِمُونَ مِنَّآ إِلَّآ أَن ءَامَنَّا بِٱللَّهِ وَمَآ أُنزِلَ
 إِلَيْنَا وَمَآ أُنزِلَ مِن قَبْلُ وَأَنَّ أَكْثَرَكُمْ فَٰسِقُونَ ﴿٥٩﴾ هَلْ أُنَبِّئُكُمْ
 بِشَرِّ مِّن ذَٰلِكَ مَثُوبَةً عِندَ ٱللَّهِ ۚ مَن لَّعَنَهُ ٱللَّهُ وَغَضِبَ عَلَيْهِ وَجَعَلَ
 مِنْهُمُ ٱلْقِرَدَةَ وَٱلْخَنَازِيرَ وَعَبَدَ ٱلطَّاغُوتَ ۚ أُوْلَٰئِكَ شَرُّ مَكَّٰنًا وَأَضَلُّ
 عَن سَوَآءِ ٱلسَّبِيلِ ﴿٦٠﴾

“Thuaj: ‘O ithtarët e Librit! A na urreni për ndonjë arsye tjetër, përveç asaj se besojmë në All'Ilahun dhe në shpalljet që na janë zbritur neve dhe se shumica prej jush janë të pabindur ndaj All'Ilahut?’”

“Thuaj: ‘A doni t’ju tregoj kush do të marrë dënimin më të rëndë nga All'Ilahu? Ata që All'Ilahu i ka mallkuar dhe me të cilët është zemëruar, duke i shndërruar në majmunë dhe derra, si dhe ata që adhurojnë djallin. Ata janë në vendin më të mjerueshëm dhe janë më larg rrugës së vërtetë.’”

Shkaku i zbritjes

Transmeton Abdullah ibn Abasi se një grup jehudinjsht kanë shkuar te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe i kërkuar që t'u shpjegojë atyre besimin e tij. Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), u tha atyre se ai beson në All'llahun, që është i Vetëm dhe nuk ka shok, beson çdo gjë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit, Musait dhe Isait dhe çdo gjë që u ka ardhur Profetëve është e vërtetë, u tha se ai nuk bën dallim ndërmjet Profetëve të All'llahut. Ata iu përgjigjën se nuk e njohin Isanë dhe që nuk besojnë në profecinë e tij. Pastaj i thanë Profetit se ata nuk njohin fe më të keqe se feja e tij! Për këtë shkak kanë zbritur këto dy ajete duke iu përgjigjur atyre smirakëve.¹

Komentimi

Në këtë ajet, All'llahu i Lartësuar e urdhëron Profetin e Tij (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'i pyesë ithtarët e Librit se përse i kritikojnë dhe i kundërshtojnë myslimanët. A është besimi në All'llahun e Vetëm dhe besimi në atë çfarë i është zbritur Profetit Islam dhe Profetëve përpara tij, shkak i kundërshtimit dhe i kritikimit? Për këtë ajeti thotë: **“Thuj: ‘O ithtarët e Librit! A na urreni për ndonjë arsye tjetër, përveç asaj se besojmë në All'llahun dhe në shpalljet që na janë zbritur neve...”**

¹ Tefsiri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 3, f. 367. Tefsiri “Kurtubij”, vëll. 6, f. 233.

Gjithashtu, ajeti tregon një anë tjetër nga anët e mburrjes dhe të paturpësisë së jehudinjëve, ekstremizmin e pashpirt dhe logjikën e cekët të tyre që i ka nxitur për të tallë e për të urreyer çdo person dhe çdo fe, përveç vetes e fesë së tyre. Si rezultat i këtij ekstremizmi, ata e shihnin të drejtën si të zhdrejtë dhe të zhdrejtën si të drejtë.

Në mbyllje ajeti qartëson se urrejtja dhe kritikët e jehudinjëve ndaj myslimanëve, të cilët besojnë në All'llahun e në librat e Tij, nuk është gjë tjetër sepse, shumica e tyre janë të pabindur e të zhytur në mëkate. Për shkak të devijimit të tyre dhe të ndotjes së tyre nga mëkatet, ata shpifin ndaj çdo personi të ndershëm që ndjek të vërtetën dhe që ecën në rrugën e drejtë. Ajeti thotë: **"...dhe se shumica prej jush janë të pabindur ndaj All'llahut?"**

Është e pakundërshtueshme se në një mjedis të mbushur me shkatërrim e mosbindje, ka raste që ndryshojnë raportet, ku e drejta bëhet e zhdrejtë dhe e zhdrejta bëhet e drejtë dhe vepra e mirë dhe e dobishme bëhet e keqe dhe çdo vepër e keqe konsiderohet e mirë dhe e vlefshme. Natyrisht, kjo është shpërlarje truri, si rezultat i zhytjes në gabime e gjynahe, deri në gradën e dhënieve pas tyre me pasion.

Është e vlefshme që të tregohet se ky ajet i kritikon të gjithë ithtarët e Librit (jehudinjtë e të krishterë). Është e qartë se ajeti ka veçuar vetëm një grup të vogël, që është i sinqertë e i rregullt, nga shumica që janë mëkatarë, me përdorimin e fjalisë *"shumica prej jush"* në shprehjen e fundit të tij.

Ajeti i dytë krahason besimet e devijuara, veprat e ithtarëve të Librit dhe ndëshkimi që do t'i kaplojë ata për talljen që i bëjnë

besimtarëve myslimanë, që të qartësohet se cili nga këto dy grupe meriton të kritikohet, duke u të rhequr vërejtje kundërshtarëve dhe ekstremistëve për fanatizmin e tyre.

Në këtë krahasim, ajeti i kërkon Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'i pyesë ata: A është besimi në All'llahun e Vetëm dhe në Librat e Tij, të cilëve ai ua ka shpallur Profetëve të tij, i vlefshëm për kritikë e urrejtje, apo janë veprat e këqija që burojnë nga njerëzit, të cilët do t'i përfshijë ndëshkimi i All'llahut të Madhëruar?

Ajeti i drejtohet Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që t'i pyesë nëse ata dëshirojnë të dinë se cilët janë njerëzit që do të kenë ndëshkimin më të madh tek All'llahu për ato vepra që ata kanë bërë. Për këtë ajeti thotë: **"Thuaj: 'A doni t'ju tregoj kush do të marrë dënimin më të rëndë nga All'llahu?...'"**

Nuk ka dyshim se besimi në All'llahun dhe në Librat e Tij është një çështje e lavdërueshme. Krahasimi ndërmjet besimit dhe veprave e mendimeve të ithtarëve të Librit është shkak-pasojë.

Pas kësaj, ajeti fillon me shpjegimin e tematikës dhe sqaron se ata që i përfshin mallkimi i All'llahut dhe zemërimi i Tij, i shndërron në majmunë dhe derra. Ata që adhurojnë djallin dhe idhujt do të jetojnë në këtë botë dhe në Botën Tjetër një jetë të mjerueshme, sepse janë larguar shumë nga rruga e vërtetë. Për këtë ajeti thotë: **"...Ata që All'llahu i ka mallkuar dhe me të cilët është zemëruar, duke i shndërruar në majmunë dhe derra, si dhe ata që adhurojnë djallin. Ata janë në vendin më të mjerueshëm dhe janë më larg rrugës së vërtetë."**

Tani do të shpjegojmë edhe kuptimin e fjalës '*meskh'* *shndërrim*, i cili e ndryshon formën e njeriut, se a përfshin ky shndërrim anën trupore apo ka si qëllim ndryshimin mendor dhe moral?

Këtë do ta shpjegojmë te komentimi i ajetit 163 të sures "El Araf" në një mënyrë më të hollësishme, me lejen e All'llahut të Lartësuar.

Ajetet 61 - 63

وَإِذَا جَاءُوكُمْ قَالُوا ءَامَنَّا وَقَدْ دَخَلُوا بِالْكَفْرِ وَهُمْ قَدْ خَرَجُوا بِهِ^ج
وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا كَانُوا يَكْتُمُونَ وَتَرَى^{٦١} كَثِيرًا مِّنْهُمْ يُسْرِعُونَ فِي
الْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ وَأَكْلِهِمُ الشُّحْتَ^ج لِبَيْسٍ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ
لَوْلَا^{٦٢} يَنْهَاهُمُ الرَّبَّانِيُّونَ وَالْأَحْبَارُ عَنِ قَوْلِهِمُ الْإِثْمَ وَأَكْلِهِمُ
الشُّحْتَ^ج لِبَيْسٍ مَا كَانُوا يَصْنَعُونَ^{٦٣}

"Kur vijnë te ju, thonë: 'Besojmë'. Në të vërtetë, ata jobesimtarë hynë e jobesimtarë dolën! All'lahu e di mirë çfarë fshehin ata."

"Ti i sheh shumë nga ata që nxitojnë drejt gjynaheve, armiqësisë dhe ngrënies së fryteve të fitimit të paligjshëm. Njëmend, sa të këqija janë ato vepra!"

"Përse rabinët dhe dijetarët nuk i ndalojnë ata të thonë fjalë të ulëta (për Zotin) dhe të hanë fitimet e paligjshme? Sa keq veprojnë ata!"

Komentimi

Ajeti i parë, prej këtyre tre ajeteve, ka ardhur për të plotësuar tematikën që trajtuan ajetet e mëparshme rreth hipokritëve, ku zbulon dyfytërsinë e tyre dhe u tërheq vërejtjen myslimanëve se kur hipokritët prezantohen te ju për të shprehur besimin, në zemrat e tyre vlon mosbesimi dhe largohen prej tyre myslimanë, mirëpo zemrat e tyre janë ende të mbushura me mosbesim. Thëniet, arsyetimi dhe argumentimi i myslimanëve, nuk lë asnjë ndikim tek ata hipokritë. Ajeti thotë: **“Kur vijnë te ju, thonë: ‘Besojmë’. Në të vërtetë, ata jobesimtarë hynë e jobesimtarë dolën...”**

Prandaj është obligim i myslimanëve që të mos mashtrohen me ata që e shfaqin të vërtetën e besimit dhe pranojnë faljet e myslimanëve sa për sy e faqe e për mashtrime.

Ajeti përforcon se hipokritët sado që të fshihen në hipokrizinë e tyre, nuk ka dyshim se All'illahu e di mirë çfarë fshehin ata, ku thotë: **“...All'illahu e di mirë çfarë fshehin ata.”**

Ajeti i dytë përmend një lloj tjetër shenjash të hipokritëve, ku tregon se shumica e tyre ndjekin rrugën e mëkateve, padrejtësisë, ngrënies së pasurisë me pa të drejtë dhe garojnë me njëri-tjetrin në këto punë. Për këtë gjë, ajeti thotë: **“Ti i sheh shumë nga ata që nxitojnë drejt gjynaheve, armiqësisë dhe ngrënies së fryteve të fitimit të paligjshëm...”**, që do të thotë se ata garojnë në gabime, në rrugën e gjynaheve dhe të padrejtësisë. Ata sikur garojnë drejt qëllimeve që u sjell krenarinë dhe lartësinë. Garojnë ndërmjet tyre në këtë rrugë pa pasur turp.

Është e vlefshme të tregohet këtu se fjala *ithm* mund të ketë ardhur me kuptimin *mosbesim* "kufr", siç ka ardhur edhe me kuptimin e të gjitha llojeve të mëkateve. Përderisa kjo fjalë në këtë

ajet ka ardhur e shoqëruar me fjalën *armiqësi*, disa komentues kanë thënë se ajo ka kuptimin vetëm për mëkatet që ka kryer vetë personi. E kundërta është me armiqësinë ku njeriu shkel të drejtat e tjetrit. Po ashtu, mund të supozohet se ardhja e fjalës *armiqësi* pas fjalës *mëkat* në këtë ajet është sipas rregullit të përmendjes së përgjithshmes përpara të veçantës, ndërsa ardhja e shprehjes "*suhtun*", *ngrënies së fryteve të fitimit të paligjshëm*, pas fjalës *gjynah* e *armiqësi* tregon përmendjen e më të veçantës.

Kur'ani Famëlartë, së pari qorton hipokritët për të gjitha mëkatet që ata kanë kryer, pastaj ka specifikuar dy mëkatet më të mëdha që janë më të rrezikshme. Ato të dyja janë padrejtësia dhe ngrënia e pasurisë në rrugë të ndaluar.

Pra, Kur'ani Famëlartë e qorton dhe i të rheq vërejtje këtij grupi hipokritësh prej ithtarëve të Librit për paturpësinë dhe mburrjen e tyre në kryerjen e këtyre mëkateve, e në veçanti të kryerjes së padrejtësinë dhe ngrënies së pasurisë në rrugë të ndaluar. Për ta përforcuar të shëmtuarën e këtyre veprave, All'llahu i Lartësuar urdhëron e thotë: **"...Njëmend, sa të këqija janë ato vepra!"**

Kjo fjali tregon se këto mëkate nuk kryheshin rastësisht, por ata i bënin ato gjithmonë e me vendosmëri.

Pas kësaj, ajeti i tretë flet për dijetarët e tyre, të cilët i aprovinin mëkat e popullit të tyre ose heshtnin ndaj tyre, ku thotë: **"Përse rabinët dhe dijetarët nuk i ndalojnë ata të thonë fjalë të ulëta (për Zotin) dhe të hanë fitimet e paligjshme?..."**

Më përpara kemi treguar se fjala *Rabanijun* është shumësi i fjalës *Rabanij* që rrjedh nga fjala *rabun*, e cila do të thotë *dijetar* ose *mendimtar* dhe *edukues*, që i thërret njerëzit për tek All'llahu i

Lartësuar. Mirëpo, kjo fjalë, në shumë raste, është përdorur për dijetarët e fesë së krishterë.

Ndërsa fjala *Ahbar* e cila është shumësi i fjalës *hiber*, që ka për qëllim dijetarët, të cilët lënë pas gjurmë të mira për shoqërinë. Kjo fjalë është përdorur shumë shpesh për dijetarët e jehudinjëve. Përsa i përket mospranisë së fjalës "*uduanun*", armiqësi, e cila ka ardhur në ajetin e mëparshëm, disa e kanë argumentuar me thënien se fjala (*ithmun*) që ka ardhur në këtë ajet, i përfshin të gjitha kuptimet dhe ndër to edhe kuptimin e fjalës *armiqësi*.

Në këtë ajet ka ardhur fjala "**...Ata të thanë fjalë të ulëta...**", e cila e ndryshon nga ajo që ka ardhur në ajetin e mëparshëm. Ndoshta kjo tregon se është obligim i dijetarëve që t'i ndalojnë njerëzit që të flasin fjalë të këqija ashtu siç janë të ngarkuar t'i ndalojnë njerëzit nga bërja e punëve të këqija.

Ndoshta fjala "*kaulun*", mund të ketë ardhur këtu me kuptimin e besimit. Që do të thotë se dijetarët që kanë për qëllim ndreqjen e një shoqërie të prishur e të shthurur, dhe po ashtu është obligim për ata që në fillim të ndryshojnë besimet e gabuaratë cilat janë të përhapura në shoqëri. Nëse nuk arrihet ndryshimi ideologjik, nuk mund të arrihet ndreqja dhe përmirësimi në anën praktike. Në këtë mënyrë, ajeti u shpjegon dijetarëve se revolucioni ideologjik është baza dhe rrugëdalja e çdo rregullimi që dëshirohet të realizohet në çdo shoqëri të prishur e të shthurur.

Në mbyllje, Kur'ani Famëlartë përdor të njëjtën mënyrë qortuese, të cilën e ndoqi me mëkatarët e vërtetë. Ai i qorton dijetarët që heshtin dhe e lënë urdhrin në të mirë dhe ndalimin nga e keqja dhe e quan të shëmtuar heshtjen e tyre, ku thotë: "**...Sa keq veprojnë ata!**"

Po ashtu, ajeti shpjegon të ardhmen e atyre që e lënë pas dore urdhrin në të mirë dhe ndalimin nga e keqja, e në veçanti nëse janë dijetarë, sepse fundi i tyre do të jetë si ai i atyre që bëjnë mëkate.

Transmetohet nga ibn Abasi, komentuesi i njohur, se ka thënë: Ky ajet është më i rrepti që i qorton dijetarët që injorojnë përgjegjësitë e tyre dhe ata që heshtin ndaj mëkateve. Është e pakundërshtueshme se ky rregull nuk kufizohet vetëm me dijetarët jehudinj dhe të krishterë, por përfshin të gjithë dijetarët, cilado qoftë feja e tyre, nëse heshtin përpara ndotjeve të shoqërisë së tyre me mëkate dhe kur shohin njerëzit që garojnë në padrejtësi dhe shthurje, sepse ligji i All'llahut është një dhe i vetëm për të gjithë njerëzit.

Ka ardhur nga prijësi i besimtarëve Ali ibn Ebi Talibi, në një nga fjalimet e tij, se shkaku i shkatërrimit të popujve të mëparshëm është kryerja e mëkateve, heshtja e dijetarëve të tyre dhe ndalimi i tyre për të parandaluar të keqen. Për këtë shkak, All'llahu u ka çuar sprova e katastrofa. Është obligim i njerëzve që të urdhërojnë në të mirë dhe të ndalojnë nga e keqja, me qëllim që të mos implikohen me një fund si ai i popujve të mëparshëm.¹

I njëjti kuptim ka ardhur në fjalën e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) në "Nehxhul Belaga", në fund të fjalimit të tij të "El Kasiatu" (fjalimi 192), thënia e tij: "Me të vërtetë, All'llahu i Lartësuar nuk i ka mallkuar popujt e mëparshëm, vetëm se ata e lanë urdhrin në të mirë dhe ndalimin nga e keqja. Ai i mallkoi mendjelehtët për shkak të bërjes së mëkateve dhe i mallkoi dijetarët përshkak se braktikën ndalimin."

¹ Tefsiri Nurul Thekalejn, vëll. 1, f. 649. Usulul Kafij, vëll. 5, f. 57.

Ajo që tërheq vëmendjen këtu është se kur ajeti i mëparshëm foli për të shkuarën e njerëzve në përgjithësi ka përdor shprehjen: **“Njëmend, sa të këqija janë ato vepra!”**. Ndërsa në këtë ajet, kur flet për dijetarët ka përdor shprehjen: **“Sa keq veprojnë ata!”**

Fjala "*es sun'u*" ka kuptimin e çdo pune në të cilën përdoret përvoja dhe mjeshtria. Ndërsa fjala "*el amelu*" përdoret për të gjitha veprimet, edhe pa përvojë. Në këtë mënyrë, shprehja: **“sa keq veprojnë ata”**, përfshin në kontekstin e saj turpin më të madh, sepse njerëzit në përgjithësi kur bëjnë mëkat, e bëjnë nga injoranca e tyre, ndërsa dijetari, i cili nuk e kryen detyrën e tij, e bën mëkatin me dije dhe me mendim të kthjellët. Prandaj, ndëshkimi i tij është më i madh e më i rreptë sesa mëkati dhe ndëshkimi i injorantit.

Ajeti 64

وَقَالَتِ الْيَهُودُ يَدُ اللَّهِ مَغْلُولَةٌ ۚ غُلَّتْ أَيْدِيهِمْ وَلُعِنُوا بِمَا قَالُوا ۚ بَلْ يَدَاهُ مَبْسُوطَتَانِ يُنفِقُ كَيْفَ يَشَاءُ ۚ وَلَيَزِيدَنَّ كَثِيرًا مِّنْهُم مَّا أُنْزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ طُغْيَانًا وَكُفْرًا ۚ وَالْقَيْنَا بَيْنَهُمُ الْعَدَاوَةَ وَالْبَغْضَاءَ إِلَى يَوْمِ الْقِيَمَةِ ۚ كُلَّمَا أَوقَدُوا نَارًا لِلْحَرْبِ أَطْفَأَهَا اللَّهُ ۚ وَيَسْعَوْنَ فِي الْأَرْضِ فَسَادًا ۚ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُفْسِدِينَ ﴿٦٤﴾

"Hebrenjtë (jehudinjtë) thonë: 'Dora e All'llahut është e shtrënguar.' Iu lidhshin duart atyre dhe qofshin të mallkuar për atë që thonë! Përkundrazi, të dyja Duart e Tij janë të hapura. Ai dhuron dhe njep si të dojë. Ajo që të është shpallur ty (Muhammed) nga Zoti yt, me siguri që shumicës prej tyre do t'ua shtojë mosbindjen dhe mohimin. Ne kemi futur ndërmjet tyre armiqësi dhe urrejtje deri në Ditën e Kiametit. Kurdo që ata ndezin zjarrin e luftës, All'llahu e shuan atë. Ata përpiqen të shkaktojnë ngatërresa në Tokë, por All'llahu nuk i do ngatërrestarët."

Komentimi

Ky ajet paraqet një nga të vërtetat e qarta të fjalëve të kota, të cilat i thonin jehudinjtë. Edhe ajeti i mëparshëm i ceku ato, por në një mënyrë të përgjithshme.

Historia tregon se në një periudhë kohe jehudinjtë kanë arritur në majën më të lartë të pushtetit dhe të forcës dhe kanë sunduar mbi një pjesë të rëndësishme të tokës. Këtë pushtet të tyre mund ta dëshmojë mbretëria e Sulejmanit dhe e Daudit (*Paqja qoftë mbi ta!*) si përfaqësues të shtetit të jehudinjë ve. Pushteti i jehudinjëve vazhdonte lartësimin dhe dobësimin deri në ardhjen e Islamit. Jehudinjtë e kanë deklaruar rënien e pushtetit të tyre, veçanërisht në Hixhaz ku Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ka bërë luftë me jehudinjtë e fiseve Beni Nedhijr, Benij Kurejdha dhe jehudinjtë e Khajberit, gjë që çoi në dobësimin përfundimisht të pushtetit të tyre.

Në këtë situatë, kur disa jehudinj e përmendnin pushtetin e mëparshëm të fuqishëm të tyre, thoshin me përçmim e tallje: "me të vërtetë, dora e All'Ilahut është e lidhur me pranga (*All'Ilahu na ruajt!*) dhe ai nuk ka dhembshuri për jehudinjtë!" Thuhet se këto fjalë i ka thënë Fekhas ibn Azura, kryetari i fisit Beni Kajnaka, apo Nebash ibn Kajs, sikurse përmendin disa komentues.

Meqenëse pjesa tjetër prej bijve jehudinj shprehën kënaqësinë ndaj fjalëve të të parëve të popullit të tyre, për këtë Kur'ani ua atribuon këto fjalë të gjithë jehudinjve ku thotë: **"Hebrenjtë (jehudinjtë) thonë: 'Dora e All'Ilahut është e shtrënguar.'"**

Duhet të dihet se fjala *jed* që do të thotë *dorë*, në gjuhën arabe përdoret në shumë kuptime dhe prej atyre janë : kuptimi i *gjymtyrës së dorës, i mirësisë, i pushtetit, i forcës dhe i ligjeve*. Është e

pakundërshtueshme se kuptimi më i njohur e më i përhapur i kësaj fjale është *dorë*, përshkak se shumicën e punëve njeriu e kryen me anë të dorës. Kjo fjalë përdoret edhe në formë figurative.

Në shumë transmetime të ardhura nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*), përfitohet se ky ajet tregon për atë çfarë besonin jehudinjtë rreth çështjes së caktimit e të paracaktimit (kada e kader) dhe përfundimit dhe vullnetit. Ata mendonin se All'llahu ka caktuar çdo gjë që kur ka filluar krijimin dhe çdo gjë që dëshironte të ndodhë, ndodhte. Gjithashtu besonin se në praktikë All'llahu nuk mund të ndryshojë asgjë.¹

Është e pakundërshtueshme se vazhdimësia e ajetit që përmban shprehjen: **"...Përkundrazi, të dyja Duart e Tij janë të hapura..."**, sikurse do të vijë sqarimi, mbështet kuptimin e parë. Ka mundësi që kuptimi i dytë të shoqërohet me të parin sepse kur u shua ylli i pushtetit të tyre, jehudinjtë besonin se kjo shuarje e pushtetit të tyre ka qenë e caktuar dhe duart e All'llahut janë të prangosura e Ai nuk mund të bëjë asgjë përballë këtij fundi.

All'llahu i Lartësuar u përgjigjet atyre duke i qortuar për këtë besim të tyre, ku thotë: **"...Iu lidhshin duart atyre dhe qofshin të mallkuar për atë që thonë!..."**. Pastaj, për ta quajtur të pavlerë këtë besim të prishur të tyre, All'llahu i Lartësuar urdhëron e thotë: **"...Përkundrazi, të dyja Duart e Tij janë të hapura..."**.

All'llahu i Lartësuar nuk është i imponuar në veprimet e Tij. Gjithashtu, Ai nuk është i sunduar nga imponimi natyral e as nga imponimi historik, por vullneti i Tij është mbi çdo gjë dhe vepron në çdo gjë.

Ajo që tërheq vëmendjen këtu është se jehudinjtë e kanë përdorur fjalën *dorë* në numrin njëjës, sikurse ka ardhur në fillim

¹ Tefsiri Nurul Thakalejn, vëll. 1, f. 639. Tefsiri Burhan, vëll. 1, f. 486.

të këtij ajeti, por All'llahu i Lartësuar në përgjigjen e Tij ndaj tyre ka thënë: **"...Përkundrazi, të dyja Duart e Tij janë të hapura..."**. Kjo, përveçse është përforcim i tematikës, është edhe një anë e ëmbël figurative që paraqet ekzistencën e madhështisë së All'llahut dhe faljen e Tij. Kjo për faktin se bujarët janë ata që japin çfarë të duan për të tjerët me të dyja duart e hapura. Përveç kësaj, përmendja e dy duarve është figurative për forcën dhe fuqinë absolute. Ose mund të jetë për të treguar mirësitë materiale e shpirtërore të kësaj bote dhe të Botës Tjetër.

Pastaj ajeti tregon se shenjat e All'llahut, të cilat çjerrin maskën e besimit të tyre, në vend që të ndikojnë pozitivisht në ndalimin e tyre nga rruga e gabuar, i zhysin ata më shumë në mburrje, në urrejtje, në padrejtësi e në mosbesim. Ajeti thotë: **"...Ajo që të është shpallur ty (Muhammed) nga Zoti yt, me siguri që shumicës prej tyre do t'ua shtojë mosbindjen dhe mohimin..."**.

Pas kësaj ajeti përforcon se mburrja, padrejtësia e mosbesimi i tyre do të zhduken dhe do të marrin ndëshkimin e rreptë të All'llahut në këtë botë, përshkak të përhapjes së armiqësisë e zilisë ndërmjet tyre deri Ditën e Gjykimit. Ajeti thotë: **"...Ne kemi futur ndërmjet tyre armiqësi dhe urrejtje deri në Ditën e Kiametit..."**.

Komentuesit e Kur'anit kanë mendime të ndryshme për kuptimin e shprehjes **"armiqësi e urrejtje"**, që ka ardhur në këtë ajet. Nëse do të vërejmë gjendjen që e gëzojnë jehudinjtë, e cila është e veçantë dhe jo e qëndrueshme, dhe po të shohim historinë e jetës së tyre, të shoqëruar me përçarje e urrejtje, do të na konstatohet se gjendet një faktor i vetëm për këtë gjendje të tyre.

Ai është mosprania e uniteti dhe e sinqeritetit në mesin e njerë zve në rang botëror. Nëse ata do të gëzonin unitet e

singeritet, nuk do ta vuanin këtë përçarje e këtë humbje gjatë gjithë historisë.

Armiqësinë dhe urrejtjen e vazhdueshme ndërmjet ithtarëve të Librit e kemi sqaruar në mënyrë më të detajuar në komentimin e ajetit të 14 të kësaj sureje.

Në mbyllje, ajeti tregon përpjekjen e jehudinjëve për të ndezur zjarrin e luftërave. Tregon për ndihmën dhe përkujdesjen e All'llahut të Lartësuar dhe për mirësinë e Tij ndaj myslimanëve, për t'i shpëtuar ata nga këto zjarre shkatërruese, ku thotë: **"...Kurdo që ata ndezin zjarrin e luftës, All'illahu e shuan atë..."**.

Kjo dukuri konsiderohet një nga mrekullitë e Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sepse jehudinjtë kanë qenë njerëzit më të fortë në mesin e banorëve të Hixhazit dhe më të ditur për çështjet e luftës. Përveç kësaj ata zotëronin fortesa, kala e hendeqeve ndihmëse, si dhe potencial të madh ekonomik, i cili ka qenë për ta faktor ndihmës në çdo konflikt, ku edhe kurejshët kanë kërkuar ndihmë prej tyre. Fisi Ous dhe Hazrexh garonin që të bënin aleancë me ta, të përfitonin nga miqësia e tyre dhe të arrinin ndihmën prej tyre në fushën ushtarake. Por, papritmas humbën potencialin e tyre dhe jehudinjtë e Beni Nedhijr, Beni Kurejdha dhe Beni Kajnaka u detyruan që të linin shtëpitë e tyre. Po ashtu, ranë fortifikatat e kalatë e Khajberit dhe banorët e Fedekut prej jehudinjëve u dorëzuan te myslimanët. Edhe ata që jetonin në rrethinat e Hixhazit e humbën shpresën dhe u detyruan që të përulën përpara madhësisë së Islamit. Ata jo vetëm që nuk kishin mundësi të ndihmonin idhujtarët por u detyruan të linin fushën e betejës.

Pastaj ajeti qartëson se ata (jehudinjtë) nuk e ndalojnë mbjelljen e farës së përçarjes e të shkatërrimit në tokë, ku thotë:

"...Ata përpiqen të shkaktojnë ngatërresa në Tokë...". Gjithashtu, ajeti përforcon duke thënë: **"...por All'Ilahu nuk i do ngatërrestarët."**

Me këtë argumentohet se mënyra se si u drejtohet Kur'ani jehudinjëve nuk përqendrohet mbi bazë racizmi, por etaloni që përdor Kur'ani në përballjen me kritikën e tyre është etaloni i punëve dhe i veprave që veprohen nga çdo racë, individ apo grupacion. Në ajetet vijues do të vërejmë se Kur'ani, me gjithë veprat që vepruan jehudinjtë dhe të krishterët, e ka lënë të hapur portën e pendimit për ata.

Ajetet 65 - 66

وَلَوْ أَنَّ أَهْلَ الْكِتَابِ ءَامَنُوا وَاتَّقَوْا لَكَفَّرْنَا عَنْهُمْ سَيِّئَاتِهِمْ
وَلَأَدْخَلْنَاهُمْ جَنَّاتِ النَّعِيمِ وَلَوْ أَنَّهُمْ أَقَامُوا التَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ
وَمَا أُنْزِلَ إِلَيْهِم مِّن رَّبِّهِمْ لَأَكَلُوا مِن فَوْقِهِمْ وَمِن تَحْتِ أَرْجُلِهِمْ
مِّنْهُمْ أُمَّةٌ مُّقْتَصِدَةٌ وَكَثِيرٌ مِّنْهُمْ سَاءَ مَا يَعْمَلُونَ

"Sikur ithtarët e Librit të besonin dhe të ruheshin nga mohimi, Ne do t'ua mbulonim veprat e këqija dhe do t'i shpinim në kopshtet e kënaqësisë."

"Sikur ata t'i përmbaheshin Teuratit e Ungjillit dhe asaj që u është shpallur nga Zoti i tyre, ata do të kënaqeshin me frutet (që rriten) sipër dhe poshtë tyre. Disa prej tyre janë të matur, por shumë prej tyre bëjnë vepra të këqija."

Komentimi

Ajetet e mëparshme përdorën mënyrën e kritikës ndaj metodologjisë së ithtarëve të Librit. Ndërsa këto dy ajete kanë ardhur në përputhje me domosdoshmërinë e parimeve të edukimit njerëzor, për të hapur derën e kthimit e të pendimit përpara të devijuarve të ithtarëve të Librit, që të kthehen në rrugën e përsosmërisë dhe për t'u paraqitur atyre një mësim të vërtetë që ata duhet ta ndjekin. Për të vlerësuar rolin e pakicës së

ithtarëve të Librit që kanë jetuar në atë kohë dhe nuk kanë ndjekur gabimet e shumicës, ajeti thotë: **"Sikur ithtarët e Librit të besonin dhe të ruheshin nga mohimi, Ne do t'ua mbulonim veprat e këqija..."**. Por ky vlerësim shkon edhe më larg, sepse All'llahu u ka premtuar atyre Xhennetin dhe mirësitë e Tij ku thotë: **"...dhe do t'i shpinim në kopshtet e kënaqësisë."** Kjo tregon për mirësitë shpirtërore në Botën Tjetër.

Ajeti i dytë tregon për ndikimin e thellë që ka besimi dhe devotshmëria në këtë botë për njeriun. Ai përforcon se nëse ithtarët e Librit do të zbatonin Teuratin dhe Ungjillin, do t'i bënë ata udhëzim e ligj për jetën e tyre, do të zbatonin gjitha çfarë u është zbritur nga Zoti i tyre në librat qiellorë të mëparshëm apo në Kur'anin Famëlartë, ata do t'i mbulonte mirësia e All'llahut nga qielli e nga toka. Ajeti thotë: **"Sikur ata t'i përmbaheshin Teuratit e Ungjillit dhe asaj që u është shpallur nga Zoti i tyre, ata do të kënaqeshin me frutet (që rriten) sipër dhe poshtë tyre..."**

Nuk ka dyshim se qëllimi me të përmbajturit e Teuratit e Ungjillit është zbatimi i asaj që mbeti nga këto dy libra të vërtetë, që kanë qenë në duart e tyre në atë kohë dhe nuk do të thotë zbatimi i atyre që u ndryshuan.

Qëllimi me fjalinë **"...dhe asaj që u është shpallur nga Zoti i tyre..."**, është për të gjithë librat qiellorë dhe ligjet e All'llahut, sepse në këtë fjali nënkuptohet rregulli i përgjithshmërisë. Në të vërtetë ajo tregon ndalimin e përzierjes së fanatizmit racor me çështjet fetare të All'llahut. Nuk ka rëndësi qenia e këtij libri në gjuhën arabe apo në gjuhën hebraike, por të rëndësishme janë rregullat dhe ligjet e All'llahut që kanë ardhur në këto libra dhe në librat e tjerë qiellorë. Me këtë, Kur'ani ka dashur dhe don - aq sa

është e mundur –, të shuajë zjarrin e fanatizmit racor tek ata dhe të hapë rrugën për të depërtuar thellë në shpirtat dhe zemrat e tyre. Për këtë, përemrat e përmendur në këtë ajet kanë si qëllim ithtarët e Librit. Ato përemra janë: *i tyre, prej Zotit të tyre, sipër tyre dhe poshtë tyre*.

Kjo ka për qëllim largimin e tyre nga urrejtja dhe krenaria e tyre dhe të mos imagjinojnë se përlja e bindja e tyre përpara Kur'anit do të thotë përlje ndaj arabëve, por është përlje ndaj All'llahut të Lartësuar.

Nuk ka dyshim se zbatimi i Teuratit e i Ungjillit është zbatim i parimeve qiellore që kanë ardhur në këto dy libra, sepse të gjitha parimet dhe mësimet – sikurse e kemi treguar më përpara – të cilat i kanë sjellë Profetët, janë unike dhe nuk kanë dallim mes tyre, përveç dallimit se disa janë të plotë dhe disa më të plotë. Kjo nuk bie ndesh me abrogimin që ka ardhur për disa rregulla në Sheriatin islam, ku një rregull i mëpasshëm abrogon një rregull të mëparshëm.

Përkufizimi i fjalës është se ajeti i fundit edhe një herë përforcon këtë parim bazë që thotë se ndjekja e mësimëve qiellore, me të cilat kanë ardhur Profetët, nuk është vetëm për të lulëzuar jetën e Botës Tjetër, e cila vjen pas vdekjes, përkundrazi, ato janë refleksione të gjera për këtë botë materiale të njeriut. Ato forcojnë shoqëritë, bashkojnë radhët e individëve të saj, rrisin dhe zhvillojnë mundësitë e tyre, shtojnë mirësitë e tyre dhe garantojnë jetë të lumtur e të vazhdueshme të shoqëruar me siguri e qetësi.

Nëse shohim pasuritë dhe potencialet e mëdhaja njerëzore që shpërdorohen kjo është si rezultat i devijimit të këtyre mësimëve. Ata garojnë për të prodhuar armë të shkatërrimit në

masë dhe konflikte të pamëshirshme që çojnë në shkatërrim. Të gjitha këto janë argument i gjallë për këtë të vërtetë, se këto pasuri dhe potenciale përdoren për të përhapur shkatërrimin në këtë botë.

Vërtet, kokat e mëdhaja (inteligjente), të cilat garojnë dhe punojnë me zell e pa u lodhur për të plotësuar e për të zgjeruar prodhimin e armëve luftarake, si dhe për të zgjeruar vatrën e konfliktit, përbëjnë një pjesë të rëndësishme prej potencialeve njerëzore. Sa e bukur dhe tërheqëse do të bëhej kjo jetë nëse të gjitha këto potenciale e mundësi do të shfytëzoheshin në rrugën e zhvillimit e të ndërtimit?!

Është e vlefshme që të vërejmë se thënia e All'llahut të Lartësuar: **“sipër tyre dhe poshtë këmbëve të tyre...”**, do të thotë se mirësitë e qiellit dhe të tokës do t'i mbulojë ata besimtarë. Po ashtu supozohet që këto thënie të jenë figurative për të gjitha të mirat në përgjithësi, sikurse ka ardhur në trashëgiminë e letërsisë arabe thënia e tyre: *'Në të vërtetë, filani është zhytur në mirësi nga maja e kokës deri te gishtat e këmbëve.'*

Ky ajet konsiderohet si përgjigje e një prej thënieve të jehudinjëve, e cila është përmendur në ajetet e mëparshme, ku përforcon se shkaku i ndërprerjes së mirësive të All'llahut ndaj tyre nuk është ajo çfarë ata kanë supozuar se qenia e shenjtë e All'llahut është jobujare (All'llahu është i Pastër nga këto e na ruajtë nga të tilla mendime!), apo dora e Tij është e shtrënguar. Por shkak i ndërprerjes së mirësive kanë qenë veprat e këqija të cilat i ndryshuan raportet e jetës së tyre materiale e shpirtërore dhe i nxinë ato. Nëse nuk pendohen, All'llahu kurrë nuk do t'i shpëtojë nga pasojat e këtyre veprave të këqija.

Në fund, ajeti tregon për pakicën punëmirë nga ithtarët e Librit, e cila ka zgjedhur rrugën e drejtë në jetën e tyre, në të kundërt me rrugën e shumicës së devijuar ku thotë: **"...Disa prej tyre janë të matur, por shumë prej tyre bëjnë vepra të këqija."**

Po e njëjta shprehje, e cila flet për pakicën e drejtë dhe punëmirë prej ithtarëve të Librit, përmendet në ajetin 159 dhe 181 të sures "El A'raf" dhe në ajetin 75 të sures "Al Imran."

Ajeti 67

﴿يَأَيُّهَا الرَّسُولُ مَا بَلَغَ أُنْزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ^ط وَإِنْ لَمْ تَفْعَلْ فَمَا
بَلَغَتْ رِسَالَتُهُ^ج وَاللَّهُ يَعَصُمُكَ مِنَ النَّاسِ^ق إِنَّ اللَّهَ يَهْدِي
الْقَوْمَ الْكَافِرِينَ

"O i Dërguar! Shpall atë që të është zbritur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; All'llahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që All'llahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë."

Komentimi

Zgjedhja e khalifit (prijësit të myslimanëve) është periudha e mbylljes së Mesazhit

Vërtet, ky ajet ka aromë të veçantë që e dallon nga ajetet e mëparshme dhe ajetet që vijojnë. Ai i drejtohet vetëm të Dërguarit të All'llahut dhe sqaron detyrën e tij. Ajeti fillon me thirrjen drejtuar të Dërguarit të All'llahut dhe i thotë: "O i Dërguar!..." dhe e urdhëron atë me plot qartësi dhe i thotë " Shpall atë që të është zbritur nga Zoti yt!..."¹

¹ Fraza "bel'lig", sipas Ragibit në librin "El Mufredat", është më përforcuese se fjala "eb'lig".

Më pas, që përforcimi të jetë më i madh e më i fortë, e paralajmëron atë dhe i thotë: **"...Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij..."**

Pastaj, ajeti e qetëson Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sikur duket se diçka e shqetëson atë, dhe i kërkon atij që të qetësohet dhe të mos u frikësohet njerëzve, ku thotë: **"...All'llahu të ruan ty prej njerëzve..."**

Në mbyllje të ajetit gjendet paralajmërim, kërcënim dhe ndëshkim për ata që e mohojnë këtë mesazh të veçantë nga kokëforcë sia, ku thotë: **"...Natyrisht që All'llahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë."**

Mënyra e këtij ajeti, stili i tij i veçantë, përsëritjet e përforcimit dhe gjithashtu fillimi i tij, të gjitha kë to i drejtohen të Dërguarit të All'llahut me thënien: **"O i Dërguar!"**, shprehje e cila në Kur'an pë rmendet vetëm dy herë, kërcënimi i tij se mospërcjellja e këtij mesazhi të veçantë është një neglizhencë, kjo mënyrë e stil i veçantë i Kur'anit ka ardhur vetëm në këtë ajet - të gjitha këto tregojnë se bëhet fjalë për një çështje shumë të rëndësishme: mospërcjellja e këtij mesazhi konsiderohet mospërcjellje e mesazhit të All'llahut.

Për këtë çështje ka patur shumë kundërshtarë të ashpër deri në atë gradë sa që Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ka qenë i shqetësuar dhe ka pasur frikë se këta kundërshtarë do t'i nxirrnin probleme Islamit e myslimanëve. Për këtë, All'llahu i Lartësuar e qetëson Profetin për këtë gjë.

Duke marrë në konsideratë historikun e zbritjes së këtij ajeti, i cili pa dyshim që ka zbritur në fund të jetës së Profetit , lind kjo pyetje: Vallë, çfarë është ky mesazh kaq i rëndësishme për të

cilin All'llahu e urdhëron të Dërguarin e Tij që t'ua përcjellë atë njerëzve?

A është i veçantë ky mesazh për Njëtimin, idhujtarinë dhe shkatërrimin e idhujve? Mirëpo këto çështje iu sqaruan Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanëve vite më parë.

Apo kjo çështje ka lidhje me rregullat e ligjet islame, megjithëse më të rëndësishmit e rregullave dhe ligjeve zbritën më parë se të zbriste ky ajet?

Apo është rezistencë përballë ithtarëve të Librit, jehudinjëve dhe të krishterëve? Mirëpo ata, siç e mësuam, nuk përbëjnë ndonjë problem, pasi kanë përfunduar ngjarjet e Beni Nedhijr, Beni Kurejdha, Beni Kajnaka, Hajber, Fedek dhe Nexhran.

Apo është çështje që ka lidhje me hipokritët? Porse ata u dëbuan nga shoqëria islame pas çlirimit të Mekës, zgjerimit të pushtetit të myslimanëve dhe mbizotërimit të tyre në gjithë Gjirin Arabik.

Atëherë, çfarë është kjo çështje kaq e rëndësishme, e cila u shfaq në muajt e fundit të jetës së të Dërguarit të All'llahut dhe zbriti ky ajet me gjithë këto përforci? Nuk ka dyshim se shqetësimi i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ishte frika për personalitetin dhe jetën e tij, por në të vërtetë ishte frika se hipokritët do ta kundërshtonin dhe ata do të vendosnin pengesa për të penguar myslimanët dhe për t'i devijuar ata.

A ka çështje tjetër që mund të mbartë këto cilësi, përveçse çështjes së caktimit të zëvendësit të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe caktimit të së ardhmes së Islamit?

Do t'u kthehemi transmetimeve të ndryshme që kanë ardhur në shumë libra të Ehli Sunetit dhe të Shiave për çështjen e

këtij ajeti, që të qartësojmë nëse janë të dobishme të përforcojmë atë që shpjeguam më lart. Pastaj do të trajtojmë kundërshtimet dhe kritikën që kanë ardhur nga disa komentues të Ehli Sunetit rreth këtij komentimi.

Hulumtime

1- Zbritja e ajetit të Tebligut (shpalljes)

Edhe pse rregullat e nxituara dhe fanatizmi sektar – me keqardhje – janë bërë pengesë e zbulimit të vërtetave të këtij ajeti në fjalë, ka dijetarë, komentues historian dhe dijetarë të hadithit, të cilët kanë shkruar dhe kanë thënë shumë qartë se ky ajet ka zbritur për Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*).

Këto transmetime i ka përcjellë një grup prej shokëve të Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si Zejd ibn Erkam, Ebu Said El Khudrij, ibn Abbas, Xhabir ibn Abdullah El Ensarij, Ebu Hurejra, El Berae ibn Azib, Hudhejfeh, Amir ibn Lejla ibn Dumreh dhe ibn Mes'ud, të cilët kanë thënë se ky ajet ka zbritur për Aliun dhe për çështjen e "Jeumul Gadijr", ditës së Gadirrit.

Disa nga këto hadithe kanë ardhur në një rrugë të vetme, si transmetimet e Zejd ibn Erkam.

Disa të tjera nga këto kanë ardhur nga njëmbëdhjetë rrugë, si transmetimi i Ebu Said El Khudrij dhe transmetimi i ibn Abasit.

Disa të tjera kanë ardhur nga tri rrugë, si transmetimi i Berae ibn Azib. Ndërsa dijetarët që i kanë sjellë këto transmetime në librat e tyre janë shumë. Prej atyre përmendim:

- El Hafidh Ebu Naim El Asfahanij në librin “Ma nuzile linel Kur'ani fi Alijin” marrë nga libri "El Khasais", faqe 29;
- Ebul Hasan Uahidij En Nijsaburi, në librin “Esbabu Nuzul”, faqe 150;
- Hafidh Ebu Said Sexhestani, në librin “Velajetu”;
- Ibn Asakir Shafij, (shih “Ed Durrul Menthur”, vëll. 3, f. 298);
- Fakhru Razij, në tefsirin “El Kebijr”, vëll. 3, f. 636;
- Ebu Is'hak Hamuvijnij, në librin “Feraid Simtijn”;
- Ibn Sabbag Malikij, në librin “Fusul Muhimeh”, f. 27;
- Xhelaludijn Sujutij, në librin “Durrul Menthur”, vëll. 3, f. 298;
- Kadij Sheukanij, në librin “Fet'hul Kadij”, vëll. 3, f. 57;
- Shehabudijn Alusij Shafij, në librin “Ruhul Meanij”, vëll. 6, f. 172;
- Esh Shejkh Sulejman Kanduzij El Hanefij, në librin “Jenabiul Meuddeh”, f. 120;
- Bedrudijn Hanefij, në librin “Umdetul Karij fij Sherah Sahih El Buharij”, vëll. 8, f. 584;
- Egjiptiani shejkh Muhammed Abduh, në tefsirin “El Menar” vëll. 6, f. 463;
- El Hafidh ibn Merdeuijeh, që ka vdekur në vitin 416 sipas hixhrit, transmeton nga Sujutij në “Durrul Menthur”, vëll. 2, f. 298.

E shumë të tjerë, që përveç tyre, kanë treguar edhe shkakun e zbritjes së këtij ajeti.¹

Sigurisht, ne nuk themi se këta dijetarë dhe komentues të Kur'anit kanë pranuar se ky ajete ka zbritur për Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), por qëllimi ynë është se ata vetëm kanë përmendur transmetime të veçanta në librat e tyre. Por, pasi i kanë transmetuar këto transmetime të njohura, nuk i kanë pranuar ato,

¹ Për më tepër sqarime, shih librin “Gadij”, vëll. 1, f. 214.

ose nga frika e rrethanave që i rrethonin, ose nga nxitimi në gjykim dhe nga qëndrimi pengues për të nxjerrë një gjykim të rregullt. Përveç këtyre që u thanë, ata janë përpjekur- sipas mundësisë së tyre - për ta errësuar të vërtetën e këtyre transmetimeve duke i shfaqur si të parëndësishme. Për shembull, Razij, i cili është i njohur për ekstremin e tij sektar në disa çështje të veçanta, e ka renditur shkakun e zbritjes së këtij ajeti si alternativë e dhjetë pasi përmend nëntë alternativa të tjera të gjitha të dobëta, të pabaza e të pavlera.

Kjo nuk është e habitshme nga Razij, sepse kjo është metodologjia dhe mendimi i tij në çdo çështje. Mirëpo, ne habitemi nga shkrimtarë me potencial, si Sejid Kutub në tefsirin “Fi Dhilalil Kur’an” dhe Muhammed Reshid Rrida, në tefsirin e tij “El Menar”, të cilët e kanë anashkaluar plotësisht përmendjen e shkakut të zbritjes së këtij ajeti që përmendet në burimet bazë të literaturave islame, ose e kanë dobësuar rëndësinë e shkakut të zbritjes deri në atë masë, saqë sipas tyre nuk tërheq vëmendje dhe është i parëndësishëm.

Vallë, a kanë qenë rrethanat që nuk i kanë lejuar ata ta përmendin të vërtetën, apo perdet e fanatizmit kanë qenë më të trasha për t'i përshkruar drita?! Nuk e dimë!!! Ka të tjerë që e kanë konsideruar zbritjen e këtij ajeti për Aliun një çështje plotësisht të pranueshme, por kanë hezituuar ta pohojnë se ky ajet tregon për çështjen e *vilajetit* dhe të *khilafetit* (udhëheqjes) pas Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'Ilhut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në dashtë All'Ilhu do të paraqesim dilemat e tyre!

Si do që të jetë, transmetimet e shumta që kanë ardhur në librat e Ehli Sunetit, pa përmendur librat e Shijave, për këtë tematikë janë të shumtë dhe nuk mund të mohohen e as të anashkalohen lehtë.

Ne nuk e dimë se përse është e mjaftueshme një hadith i vetëm apo dy hadithe në shkaqet e zbritjes së ajeteve të tjerë dhe nuk janë të gjitha këto transmetime të mjaftueshme për çështjen e zbritjes së këtij ajeti?! A ka diçka të veçantë në këtë ajet që nuk është në ajetet e tjera? A vërehet atje ndonjë argument logjik që e nxit gjithë këtë ngurtësim?

Një çështje tjetër që duhet patjetër të tregohet është se: Transmetimet të cilat i kemi përmendur më sipër të gjitha kanë lidhje me zbritjen e këtij ajeti për Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), pra transmetimet e veçanta në zbritjen e këtij ajeti. Ndërsa transmetimet që kanë ardhur në ngjarjen e Gadijr Khum-it dhe Hytbja e mbajtur nga i Dërguari i All'llahut dhe lajmërimi për caktimin e Aliut udhëheqës pas tij, janë më të shumta se këto.

Eruditi dhe dijetari i shquar El Emijni në librin e tij "El Gadijr" e transmeton ngjarjen e "Gadijrit" nga 110 shokët e të Dërguarit të All'llahut me gjithë zinxhirin e tyre të transmetimit, dhe, nga 84 Tabijn dhe nga 360 dijetarë dhe gjuhëtarë e letrarë të shquar myslimanë, gjë që nuk lë dyshim se hadithi i "Gadijr-it" është një nga hadithet më të sakta që ka ardhur në transmetimet konsekuente (muteuatireh). Nëse dikush dyshon në qenien e këtij hadithi konsekuent, sigurisht që nuk do të pranojë hadith tjetër konsekuent.

Meqenëse studimi i të gjitha këtyre transmetimeve të veçanta në çështjen e zbritjes së këtij ajeti, gjithashtu, edhe studimi i transmetimeve të veçanta të ngjarjes së Gadijr Khum-it, kërkojnë shkrimin e një libri të madh dhe (po ta bëjmë këtu) ne na largon nga rruga e komentimit, por do të mjaftohemi vetëm me kaq.

2- Ngjarja e Gadijr Khum-it e përmbledhur

Transmetimet që përmendin këtë ngjarje dhe që e përshkruajnë atë ashtu siç ka ndodhur janë të shumta. Ato transmetime janë të ndryshme ku disa janë të gjata, disa të tjera shumë përmbledhëse dhe disa të tjera trajtojnë një anë të caktuar të ngjarjes. Nga të gjitha këto transmetime, nga historia islame, si dhe duke vërejtur argumentet e rrethanat e ndodhjes së kësaj ngjarjeje, sqarohet si vijon: Vërtet, në vitin e fundi të jetës së Profetit Muhammed (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), myslimanët së bashku me të Dërguarin e All'llahut kryen ritet e Haxhit të Lamtumurës në mënyrë madhështore. Ky Haxh ndikoi shumë në shprtitat e njerëzve. Pasi ka mbaruar Haxhi, zemrat e tyre u mbuluan nga një rritje e madhe shpirtërore, ku ndihej kënaqësia e thellë e këtij adhurimi madhështor.

Në këtë haxh kanë marrë pjesë një numër i madh myslimanësh¹. Nga myslimanët e pranishëm kishte persona që po fluturonin nga gëzimi dhe hareja që All'llahu i Lartësuar i nderoi ata me kryerjen e këtij adhurimi.

Nuk kanë qenë vetëm banorët e Medinës ata që e kanë shoqëruar Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në këtë haxh, por e kanë shoqëruar delegacione myslimane nga i gjithë Gjiri Arabik, për të fituar nderimin e shoqërimit në këtë Haxh të Lamtumurës.

Dielli lëshonte rrezet e tij përvëluese në luginë e në fusha. Por kënaqësia shpirtërore e këtij udhëtimi lehtësoi çdo gjë. U afrua koha e drekës dhe udhëtarët e shumtë iu afruan tokës së El Xuhfetu nga dukej toka e "Gadijr Khum-it" e thatë dhe e djekur.

¹ Thuhet se numri i tyre ka qenë 90 000, thuhet 120 000 dhe thuhet 124 000.

Zona e Gadijr Khum-it ndodhet në kryqëzimin e katër rrugëve, në të cilën haxhinjtë duhet të shpërndareshin për në drejtimet e tyre. Rruga për në Medine ishte në drejtim të veriut, rruga për në Irak ishte në drejtim të lindjes, rruga për në Egjipt ishte në drejtim të perëndimit dhe rruga për në Jemen ishte në drejtim të jugut. Në këtë vend duhet të realizohej çështja më e rëndësishme e këtij udhëtimi dhe e kujtimeve të tij. Myslimanët do të dëgjonin obligimin e fundit të tyre apo të njiheshin me periudhën e fundit prej periudhave të sukseshme të cilën do t'ua përcillte i Dërguari i All'llahut përpara se ata të ndaheshin dhe të largoheshin në rrugët e tyre.

Ka qenë ditë e Enjte e vitit të dhjetë të hixhretit dhe kishin kaluar tetë ditë nga festa e Kurban Bajramit, kur i Dërguari i All'llahut i urdhëroi haxhinjtë që të ndalonin. Myslimanët thirrën ata që ishin në fillim të karvanit që të ktheheshin dhe pastaj pritën që të bashkoheshin edhe ata që ishin të fundit. Dielli kishte arritur në pikun e qiellit dhe myezini i Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), thirri ezanin për të falur namazin e drekës (ylesë). Njerëzit filluan të përgatiten me shpejtësi për të falur namazin. Era ishte aq djegëse e përvëluese, sa që disa u detyruan që të vendosnin një pjesë të petkut të tyre poshtë këmbëve dhe një pjesë sipër kokave të tyre, për t'u mbrojtur nga nxehtësia e tokës dhe nga rrezet e diellit.

Në atë shkretëtirë nuk kishte asgjë për hije apo oaz të gjelbërt për të kënaqur të shikuarit e për t'u rehatuar, përveçse disa shkurreve të vogla të zhveshura që përballeshin me nxehtësinë e fortë. Disa u strehuan te këto shkurre dhe vendosën rrobat e tyre mbi to për hije dhe i Dërguari i All'llahut të pushonte aty. Mirëpo erërat e nxehta hynin në ato çadra dhe shpërndante nxehtësinë e saj përvëluese në to.

Përfundoi namazi i mesditës. Haxhinjtë shpejtuan për të ngritur çadrat e tyre të vogla që mbartnin me vete që të mbroheshin nga nxehtësia përvëluese. Porse Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i lajmëroi ata që të përgatiteshin për të dëgjuar mesazhin e ri të All'llahut në ligjëratën e tij. Kishte prej atyre që nuk mund ta shihnin Profetit për shkak të largësisë. Për këtë shkak ata i ndërtuan Profetit një minber prej samarëve të deveve, ku u ngjit i Dërguari i All'llahut e tha: *"Falënderimi i takon All'llahut. Prej tij ndihmë kërkojmë, e në Atë besojmë. Atij i mbështetemi e i kërkojmë të na ruajë nga e keqja e vetave tona dhe nga veprat e këqija. Atë që e udhëzon All'llahu askush nuk e humbet dhe atë që Ai e humbet askush nuk e udhëzon. Dëshmoj e deklaroj se nuk ka të Adhuruar tjetër përveç All'llahut dhe dëshmoj e deklaroj se Muhammedi është robi dhe i Dërguari i Tij."*

E më pas tha: *"O ju njerëz, sapo më lajmëroi mua i Gjithëdijsmi se i ka dhënë jetë një Profeti sa gjysma e jetës së Profetit që ka qenë para tij. Me të vërtetë, unë jam në prag të thirrjes e ta pranoj (jam pranë vdekjes). Vërtet, unë jam përgjegjës dhe ju jeni përgjegjësa. Çfarë më thoni: Ata thanë dëshmojmë se me të vërtetë ti e përcolle mesazhin dhe këshillove e luftove. All'llahu të shpërbleftë me të mira!"*

(Profeti) tha: *"A nuk dëshmoni se nuk ka Zot tjetër përveç All'llahut dhe se Muhammedi është robi i Tij dhe i Dërguari i Tij? Se Xhenneti është i vërtetë, zjarri i vërtetë, vdekja e vërtetë dhe se All'llahu do t'i ringjallë të gjithë ata që janë në varre?"* Ata thanë: *"Po, me të vërtetë dëshmojmë për këtë."*

(Profeti) tha: *"O All'llahu im, dëshmo!"*. Pastaj tha: *"O ju njerëz a po dëgjoni?"* Ata thanë: *"Po."*

Pastaj mbizotëroi një heshtje e thellë dhe nuk u dëgjua veçse lëvizja e lehtë e erës. I Dërguari i All'llahut tha: *"Shikoni (mendoni) se si do të më kundërshtoni mua në dy gjëra të rëndësishme."*

U dëgjua një zë që pyeti: “Cilat janë ato dy gjëra të rëndësishme, o i Dërguari i All’llahut?”

I Dërguari tha: “E rëndësishmja më e madhe është Libri i All’llahut. Një pjesë është në dorën e All’llahut të Lartësuar dhe një pjesë në duart tuaja. Kapuni fort pas tij e mos humbisni! Tjetra është më e vogël, janë pasardhësit e mi. Me të vërtetë, më lajmëroi i Gjithëdijshmi se ata të dyja nuk ndahen deri sa të më paraqiten mua Heudi (burim në Xhennet). E kam pyetur Zotit tim për këto të dyja, prandaj mos dilni para atyre të dyjave se do të shkatërroheni dhe mos i neglizhoni se do të shkatërroheni.”

Pastaj kapi dorën e Aliut e ngriti derisa iu duk e bardha e pëllëmbës së tij dhe i gjithë populli e njohu atë. Profeti tha: “O ju njerëz! Cili është më parësori tek myslimanët sesa vetë vetat e tyre?” Ata thanë: “All’llahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.”

Profeti tha: “Me të vërtetë, All’llahu është Udhëheqësi im dhe unë jam udhëheqësi i besimtarëve. Unë jam më parësor tek ata se sa vetat e tyre. Për atë që unë isha udhëheqës, Aliu do të jetë udhëheqësi i tij” Këtë e përsëriti tri herë.

Në transmetimin e imam Ahmedit, imam i hambelive, thuhet se e ka përsëritur katër herë. Pastaj tha: “O All’llahu im, ndihmoje atë që e ndihmon atë (Aliun) dhe luftoje atë që e lufton atë. Dua je atë që e do atë (Aliun) dhe urreje atë që e urren atë. Triumfoje atë që e triumfon atë dhe poshtëroje atë që e poshtëron atë. Çoje të drejtën me atë ngado që të jetë. Sigurisht, i pranishmi të lajmërojë jotëpranishmin.”

Myслиmanët nuk janë shpërndarë derisa zbriti i besueshmi (Xhebraili) i shpalljes së All’llahut, me fjalën e Tij: **“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj...”**¹

¹ Sure "Maide", ajeti 3.

Pastaj i Dërguari i All'llahut tha: *"All'llahu është më i Madhi për përsosjen e fesë dhe për plotësimin e mirësisë e dhuntisë së Tij. All'llahu im është i kënaqur me mesazhin tim dhe me vilajetin e Aliut pas meje."* Pas kësaj njerëzit u ngritën dhe e përgëzuan prijësin e besimtarëve. Prej atyre kanë qenë Ebu Bekri dhe Umeri. Të gjithë i thoshin: *"Urime, urime o ibn Ebi Talib, u gdhive dhe u ngryse prijësi im dhe prijësi i çdo besimtari e besimtareje."* Ibn Abazi ka thënë: *"Betohem në All'llahun se është bërë obligim për të gjithë njerëzit."*

Më pas, Hasan ibn Thabiti, poeti i të Dërguarit të All'llahut i mori leje Profetit që përjetësinë e kësaj ndodhie ta përcillte me poezinë e tij:

*"Profeti i tyre i thërret ata në Khum atë Ditë Gadijri,
dhe sa duhej dëgjuar i Dërguari kur thirri!
Tha: 'Cili është i pari juaj dhe I juaj kujdestar?'
Ata u përgjigjën – pa pipëtirë ndonjë kundërshtar - :
Ti je udhëheqësi ynë dhe i yni kujdestar
dhe nuk do të gjesh ti sot tek ne asnjë kundërshtar.'
I tha atij: 'Çohu, o Ali, sepse unë
të kam pëlqyer ty pas meje udhëzues e prijëtar.
Për atë që kam qenë udhëheqës, ky është i tiji udhëheqës
Jini për të përkrahës besnikë dhe ndjekës.'
E atëherë, u lut: 'O All'llahu im, dua je të tijn ashik
dhe bëhu armik i atij që i bëhet Aliut armik.'"¹*

¹ Këtë poezi e kanë transmetuar dijetarë të mëdhenj të Ehli Sunetit, si: Hafidh Ebu Naim En Nejsaburi, Hafidh Ebu Said Es Sexhestani, El Khauarizmij El Malikij, El Hafidh Ebu Abdilal El Merzebanij, El Kenxhij Esh Shafij, Xhelaludijn Sujutij, Sibti ibn El Xheuzij, Sadrudijn El Hameuj dhe shumë të tjerë ("Biharul Enuar", vëll. 37, f. 112).

3- Dialogje dhe keqkuptime

Nuk ka dyshim se nëse ky ajet nuk do të kishte zbritur për khilafetin e Aliut, do të mjaftohej – sikurse thamë – me më të paktën e transmetimeve dhe argumenteve që ndodhen po në këtë ajet. Shumica e komentuesve të mëdhenj, në komentimin e këtyre ajeteve kur'anore, mjaftohen me një të dhjetën e këtyre transmetimeve që kanë ardhur për çështjen e zbritjes së këtij ajeti, ose me më pak. Është për të ardhur keq që perdja e fanatizmit është bërë pengesë e pranimi të shumë të vërtetave.

Ata që mbartin flamurin e kundërshtimit të komentimit të këtij ajeti dhe të transmetimeve të shumta që kanë ardhur për çështjen e zbritjes së tij, veçanërisht kundërshtojnë edhe transmetimet konsekuente (*muteuatiire*) të ngjarjes së Gadirrit, ndahen në dy grupe:

Grupi i parë: Janë ata të cilët që në fillim kanë mbajtur shpirtin e kokëfortë sisë e të mosbindjes duke i akuzuar ashpër shijat dhe duke i sharë e ofenduar ata.

Grupi i dytë: Janë ata të cilët deri diku e kanë ruajtur shpirtin e kërkimeve në hulumtime e kërkime dhe kanë ndjekur rrugën e argumentimit. Për këtë, ata e pohojnë një anë të të vërtetave, por, pasi kanë paraqitur disa dilema, ndoshta si rezultat i rrethanave të tyre të veçanta ideologjike, nuk përqendrohen tek ajeti dhe transmetimet që kanë lidhje me të.

Përfaqësuesi më i dukshëm i grupit të parë është Ibn Tejmija me librin e tij "*Minhaxhu Suneh*", i cili duket se në mes të ditës i mbyll sytë e tij dhe e bllokoi të dëgjuarit me gishtat e tij e më pas thërret: "Ku është dielli?" Ai, as nuk është i gatshëm të hapë sytë për të parë disa të vërteta dhe as nuk i heq gishtat nga

veshët për të dëgjuar klithmën e muhaditheve dhe të komentuesve. Por vazhdon me sharje, fyerje e përulje.

Në të vërtetë, shkaqet e tyre janë injoranca, mosbindja, fanatizmi i bashkuar me urrejtje të cilat nxisin që të mohohen të pakundërshtueshmet e të qarta që nuk mund t'i fshehë askush.

Për këtë ne nuk i rëndojmë vetat tona nga thëniet e tyre e as nuk i rëndojmë lexuesit që të dëgjojnë përgjigjet e tyre. Çfarë mund të thuhet për atë që mburret e krenohet me plot padituri dhe injoron atë numër të madh dijetarësh të mëdhenj islamë dhe komentues, shumica e të cilëve janë prej Ehli Sunetit, të cilët e kanë thënë se ky ajet ka zbritur për Aliun? Çfarë mund të thuash për një njeri, i cili fton në verbëri ndaj të vërtetës, që pretendon se asnjë dijetar nuk thotë asgjë për këtë çështje në librin e tij?! Cila është vlera e fjalës së tij që të meritojë kërkimin dhe studimin?!

Është vlefshme që të përmendet se ibn Tejmija për të shfajsuar veten e vet përballë të gjithë këtyre librave të konsiderushëm, të cilët thonë se ky ajet ka zbritur për Aliun, mbështetet në një thënie qesharake duke thënë: "Me të vërtetë, dijetarët të cilët e dinë se çfarë thonë, nuk mendojnë se ky ajet ka zbritur për Aliun."!!

Mesa duket "dijetarët që e dinë se çfarë thonë" janë ata dijetarë që bashkojnë zërin tyre me zërin e ibn Tejmijes dhe me kokëfortë sinë e tij ekstreme. Ndërsa, ai që nuk e bashkon zërin e tij me zërin e ibn Tejmijes, ai është i ditur i cili nuk di çfarë thotë. Kjo logjikë ka bërë që në mendjen e tij të mbjellë urrejtjen dhe egoizmin prandaj më mirë të mos merremi me të tillë njerëz.

Kurse paqartësitë që ka hedhur grupi i dytë i dijetarëve, prej të cilave ka që ja vlen të hulumtohen, ne do t'i trajtojmë si vijon:

a- A është kuptimi i fjalës "Meula" më i merituari për të vepruar me pushtet të plotë?

Prej kundërshtimeve më të rëndësishme që kanë ardhur për ngjarjen e Gadijrit është se kuptimet e fjalës *meula* janë *mik*, *ndihmues* dhe *i dashur*. Është e mundur që edhe në ajet, kjo fjalë të ketë gjithashtu ato kuptime.

Përgjigjja për këtë kundërshtim nuk është e vështirë, sepse çdo mendues i drejtë e di se përmendja e dashurisë së Aliut për njerëzit nuk ka nevojë për të gjitha këto premisa; as për të mbajtur hytbe në atë shkretëtirë djegëse dhe në atë të nxehtë përvëlues; as për të ndaluar gjithë atë grup njerëzish dhe për të dëgjuar të gjitha ato pohime të njëpasnjëshme prej tyre. Dashuria e myslimanit për vëllanë e vet mysliman është nga kuptimet e qarta, të cilën e ka miratuar feja islame që në fillim të thirrjes së saj.

Pastaj, kjo çështje nuk është prej çështjeve që nuk e ka përcjellë i Dërguari i All'llahut deri në atë kohë, por ai e ka përcjellë dhe e ka qartësuar shumë herë. Sikurse kjo çështje nuk ka qenë prej çështjeve shqetësuese për Profetin e as nuk e frikësonte atë që All'llahu ta qetësonte. Gjithashtu, çështja e dashurisë nuk ka qenë aq e rëndësishme, saqë ajeti përdor këtë mënyrë të rreptë kur i drejtohet të Dërguarit të All'llahut duke i thënë: **"Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij."** Të gjitha këto tregojnë se çështja ka qenë më e madhe sesa dashuria e zakonshme e saj, sepse ajo dashuri ka qenë prej bazave të vëllazërisë islame që me lindjen e mesazhit islam.

Pastaj, nëse qëllimi është për të qartësuar këtë lloj dashurie e miqësie të zakonshme, përse i Dërguari All'llahut u mbështet në dëgjimin e të gjitha atyre pohimeve nga të pranishmit përpara se të paraqiste qëllimin e tij të vërtetë? Përse duhet t'i pyeste ata: "A

nuk jam më i pari te ju sesa vetja juaj?"¹ A përputhet kjo me qartësimin e dashurisë dhe të miqësisë së zakonshme? Pastaj, dashuria e miqësia e zakonshme nuk kanë nevojë që njerëzit të jenë të pranishëm dhe as nuk ka nevojë që vetë Umeri të përgëzojë Aliun me fjalën e tij: *"u bëre prijësi ynë dhe prijësi i çdo myslimani e myslimaneje."*²

Dashuria e myslimanit është obligim. Edhe Aliu është si të gjithë myslimanët dhe është detyrë dashuria për atë. Kjo nuk është diçka e re që duhet të urohet në atë ditë apo në vitin e fundit të jetës së të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

A nuk e vë re kërkuesi i njëanshëm e i drejtë përmbajtjen e hadithit "thekalejn" se çështja ka lidhje me udhëheqjen, sepse Kur'ani është udhëheqësi i parë për myslimanët pas vdekjes së të Dërguarit të All'llahut dhe Ehli Bejti është udhëheqësi i dytë?

b- Lidhja e ajeteve

Nganjëherë mund të thuhet se ajetet e mëparshme dhe ajetet pas këtij ajeti, në vijim tregojnë çështjen e ithtarëve të Librit dhe devijimet e tyre. Këtë e thotë autori i tefsirit "El Menar", në vëllimin 6, faqe 466 dhe këmbëngul në këtë thënie.

Por, kjo nuk ka asnjë problem, sikurse e kemi thënë në komentimin e këtij ajeti, sepse, së pari ndryshimi i ritmit të ajetit ndryshon nga tematika e ajeteve të mëparshme dhe atyre të mëpasshme. Dhe së dyti, e kemi përsëritur sa e sa herë se Kur'ani

¹ Kjo frazë është përmendur në shumë transmetime.

² Kjo pjesë e hadithit njihet si pjesa e "urimit". Atë e kanë përcjellë shumë prej dijetarëve të mëdhenj, prej komentuesve, transmetuesve të haditheve dhe historianëve nga Ehli Syneti nëpërmjet disa as'habëve si: ibn Abbasi, Ebu Hurejra, El Berae ibn Azeb, Zejd ibn Erkam... Eruditi Emijni (All'llahu qoftë i kënaqur me të!) e ka përcjellë këtë hadith nga 60 dijetarë prej dijetarëve të Ehli Synetit në xhuzin e parë të librit të tij "El Gadijr".

nuk është libër akademik që duhet të ndahet në tematika, kapituj dhe rreshta të veçantë, por ajetet kanë zbritur sipas nevojës dhe ngjarjeve të ndryshme.

Për këtë vërejmë se, përshembull, kur Kur'ani flet për një nga luftërat, kalon e tregon një rregull tjetër. Ose në kohën kur flet për jehudinjtë dhe të krishterët u drejtohet myslimanëve dhe u tregon atyre një rregull prej rregullave islame të mëparshme. (Për sqarime më të shumta shih hulumtimin tonë në fillim të komentimit të këtij ajeti.)

Prej të habitëshmeve është se disa ekstremistë e fanatikë janë të vendosur se ky ajet ka zbritur në fillim të Profetësisë së Profetit Muhammed, megjithëse surja "El Maide" ka zbritur në fund të jetës së të Dërguarit të All'llahut. Nëse thonë se vetëm ky ajet ka zbritur në Mekë në fillim të profetësisë, e pastaj është futur këtu për përshtatshmëri, ne themi se kjo është absolutisht në kundërshtim me atë çfarë kërkoni sepse, ne e dimë se i Dërguari i All'llahut në fillim të profetësisë nuk është përplasur as me jehudinjtë dhe as me të krishterët. Atëherë ky nuk ka lidhje as me ajetin përpara tij dhe as me atë pas tij (*përqendrohu*).

Të gjitha këto janë argumente se ky ajet është përballur me stuhinë e ekstremizmit dhe të fanatizmit, duke u rrethuar nga disa paqartësi (pikëpyetje) që nuk gjenden te ajetet e tjera.

c- A e përmendin Sahihat këtë ngjarje?

Disa thonë: Si mund të pranohet ky hadith, kur nuk ka ardhur në dy Sahihat, në atë të Muslimit e të Buhariut? Edhe kjo është gjithashtu prej thënieve të habitshme, sepse:

Së pari: Shumë hadithe të konsiderueshëm të cilat i kanë pranuar tek Ehli Syneti nuk janë vetëm te Sahihu i Muslimit dhe i Buhariut. Ky hadith nuk është i pari nga lloji i tij në këtë rast.

Së dyti: Vallë, a janë vetëm këto dy libra të saktë e të pranueshëm tek ata, duke pasur parasysh që ky hadith ka ardhur në disa libra të tjerë të konsiderueshëm prej tyre? Madje edhe në gjashtë Sahihat (në të cilët mbështetet Ehli Syneti), si “Sunen ibn Maxhe”, “Musnedu Ahmed” si dhe dijetarë, si “Hakim Nejsaburi”, “Dhehebij”, “ibn Haxher”, e kanë pohuar rregullsinë e transmetimit të këtij hadithi, megjithëse njiheshin për fanatizëm. Kështu që nuk është e largët që Buhariu dhe Muslimi të bien nën presionin politik që ka mbizotëruar në kohën e tyre dhe nuk kanë mundur, ose nuk kanë dashur të thoshin atë çfarë nuk përshtatet me pushtetin e asaj kohe në librat e tyre.

d- Përse nuk kanë argumentuar Aliu dhe Ehli Bejti me këtë hadith?

Disa thonë: Sikur hadithi i Gadijrit, me gjithë madhështinë e tij, të jetë kaq i rëndësishëm dhe i saktë, përse nuk kanë argumentuar me këtë hadith Aliu, Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) pasuesit dhe të dashurit e tyre kur ka qenë kaq e domosdoshme? A nuk ka qenë më mirë që ata të argumentonin me këtë transmetim të rëndësishëm konstatimin e të drejtës së Aliut?

Gjithashtu, kjo është një tjetër thënie që buron nga mosnjohja me burimet (librat) islame në fushën e hadithit, tefsirit dhe të historisë sepse, në shumë libra të dijetarëve të Ehli Synetit përmendet se Aliu, Imamët e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) dhe ndjekësit e tyre me të vërtetë e kanë përdorur argument hadithin e Gadijrit.

Khatib El Khauarizmij El Hanefij në librin "El Menakib" transmeton nga Amir ibn Uathiletu se ka thënë: “Isha te dera Ditën e Konsultimit (Esh Shura) me Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) në shtëpi dhe e dëgjova të thoshte: "Do t'ju argumentoj juve me atë të

cilën nuk mundet ta ndryshojë as arabi i juaj dhe as i huaji (joarabi) i juaj.” Pastaj tha: “Ju betohem në All’llahun, o ju grup njerëzish: A ka ndonjë në mesin tuaj që e ka Njëtuar All’llahun përpara meje?” Ata thanë: "Jo." Pastaj vazhdoi të numërojë virtytet dhe veçoritë e tij..., derisa tha: “Ju betohem në All’llahun, a ka ndonjë në mesin tuaj, përveç meje, për të cilin i Dërguari i All’llahut të ketë thënë: Për atë që unë isha udhëheqës edhe Aliu është udhëheqësi i tij. O All’llah, dua je atë që e do atë (Aliun), dhe, luftoje atë që e lufton atë, ndihmoje atë që e ndihmon atë. I pranishmi t’ia përcjellë atij që nuk është i pranishëm, përveç meje?” Ata thanë: “O All’llah. Jo...”¹

Këtë transmetim e përmend El Hameuij në “Feraid Simtijn”, kapitulli 58, ibn Hatim në “Ed Durru'n Nedhijm”, Darkutnij, ibn Ukdetu dhe ibn Ebi Hadijjd në “Sherh Nehxhul Belaga” vëllimi 6, faqe 167.

Po në ‘Feraid Semtijn’, kapitullin 58, lexojmë se Aliu e ka sjell si dëshmi Hadithin e Gadijrit përpara një grupi njerëzish në xhami në kohën e Osmanit. Edhe në Kufe, gjithashtu, është mbështetur në këtë hadith për të përgënjeshtuar mendimin e atyre që mohonin udhëheqjen e tij (khalifatin) pas të Dërguarit të All’llahut.

Autori i librit “Gadijr” thotë se katër nga sahabët dhe katërmbëdhjetë nga Tabiinët e kanë transmetuar këtë hadith sipas asaj që kanë transmetuar burimet e njohura të Ehli Syneetit.

Sikurse thotë Hakim Nejsaburij në librin “El Mustredrek”, vëllimi 3, faqe 371, se Aliu ka dëshmuar me këtë hadith përpara Talhas në ditën e luftës së Xhemelit. Gjithashtu, edhe në luftën e Sefinit, sikurse thotë Selijm ibn Kajs El Hilalij se Aliu ka qenë në garnizonin e tij përpara një grupi muhaxhirësh dhe ensaresh që kishin ardhur nga skajet e qyteteve dhe ka dëshmuar me këtë

¹ El Menakib f. 217.

hadith. Aty u ngritën dymbëdhjetë persona, të cilët kishin luftuar në Bedër me të dërguarin e All'llahut, dhe dëshmuar se e kishin dëgjuar këtë hadith nga i Dërguari i All'llahut .¹

Pas Aliut, në këtë hadith është mbështetur edhe zonja e Islamit, Fatime Zahraja dhe dy prijësit (Imamët) Hasani dhe Hysejini (*Paqja qoftë mbi ta!*), Abdullah ibn Xhafer, Amar ibn Jasir, Kajs ibn Sad, Umer ibn Abdul Aziz, Me'mum, udhëheqësi abasit. Madje Amr ibn Åas në një letër drejtuar Muaviut ka dashur që me të t'i konstatojë atij (Muaviut) se ai ka dije të plotë për të vërtetat e veçanta të gjithsecilit, Aliut dhe Muaviut, për sa i përket udhëheqjes (khilafetit). Me qartësi ka dëshmuar me hadithin e Gadijrit. Këtë e ka trasmetuar Khatijb El Khauarizmi El Hanefij në librin e tij "El Menakib", faqe 124.

e- Kuptimi i fjalisë së fundit të ajetit

Thonë: Nëse se ky ajet veçon caktimin e Aliut në udhëheqje (*khilafe*) pas vdekjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe që ka lidhje me ngjarjen e Gadijrit, atëherë çfarë lidhje kanë të gjitha këto me fjalinë e fundit të ajetit ku All'llahu i Lartësuar thotë: **"Natyrisht që All'llahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë."**

Për t'iu përgjigjur këtij kundërshtimi mjafton të dimë se fjala *kufër*, në gjuhësi dhe në Kur'an, do të thotë *mohim, kundërshtim dhe braktisje*. Nga një herë ka qëllim mohimin e All'llahut dhe profetësinë e të Dërguarit të All'llahut, nganjëherë e ka kuptimin e *mohimit të disa rregullave ose kundërshtimin e tyre*. Në ajetin 97 të sures "Ali Imran", e cila ka lidhje me Haxhin, All'llahu i Lartësuar urdhëron e thotë: **"...E kush nuk beson, All'llahu nuk ka nevojë**

¹ Biharul Anuar, vëll. 33, f. 141.

për askënd.” Në ajetin 102 të sures “El Bekare, i cili përshkuan magjinë dhe ata që janë ndotur me magjinë, thuhet: **“Këto engjëj nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: ‘Ne jemi dërguar për t’iu vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues (duke) mësuar apo ushtruar magjinë!’”**

Në ajetin 22 të sures “Ibrahim” vërejmë se shejtani u përgjigjet atyre që i janë bindur dhe e kanë ndjekur atë. Ditën e Gjykimit u thotë: Nga mosbindja juaj ndaj urdhrave të All’llahut, më bëtë mua ortak me Atë, unë sot i mohoj veprat tuaja: **“...Unë tani e mohoj që më bëtë ortak me All’llahun ...”** Atëherë nuk është e habitshme që Kur’ani ta përdorë fjalën *kufr* si mohim për ata që e kundërshtojnë çështjen e udhëheqjes e të khilafetit.

f- A mund të ekzistojnë dy udhëheqës në njëjtën kohë?

Një nga pretekstet e tjera që ata nxjerrin për ta kundërshtuar këtë hadith konsekuent dhe këtë ajet është se: Nëse i Dërguari i All’llahut e ka emëruar Aliun ditën e Gadijrit khalife dhe udhëheqës, kjo do të thotë se kanë ekzistuar dy drejtues e udhëheqës në të njëjtën kohë.

Mirëpo, duke parë rrethanat e veçanta kohore të zbritjes së këtij ajeti dhe të ardhjes së këtij hadithi, gjithashtu, edhe argumentet e inspiruara nga hytbja e të Dërguarit të All’llahut, të gjitha këto i mohojnë pretekstet e tyre. Ne e dimë se ngjarja ka ndodhur në fund të jetës së të Dërguarit të All’llahut dhe ai u përcjellte njerëzve urdhëresat e fundit, sepse ka thënë: *“Me të vërtetë unë jam në prag që të lutem e të më përgjigjet (në prag të vdekjes).”*

Vërtet, ai që e thotë këtë nuk ka dyshim se është në vazhden për të caktuar pasardhësin e tij dhe cakton plane për të

ardhmen, jo për të tashmen. Kështu që është më se e qartë se ai nuk ka për qëllim të lajmërojë ekzistencën e dy udhëheqësve ose dy prijësve në të njëjtën kohë.

Ajo që tërheq vëmendjen është se disa dijetarë të Ehli Syneetit thonë se i Dërguari i All'llahut e ka caktuar Aliun udhëheqës e prijës, por ai nuk caktuar datën e caktimit të tij. Cili është problemi që ai të jetë pas tre udhëheqësve?

Me të vërtetë, kjo është një çështje çoroditëse! Ata kapen pas ngjyrave të ndryshme të kundërshtimit që të largohen nga e vërteta! A nuk i pyesin vetat e tyre se: Nëse i Dërguari i All'llahut ka dashur të caktojë prijësin e katërt për t'u siguruar të ardhmen myslimanëve, përse nuk e ka caktuar prijësin e parë, të dytë e të tretë në ditën e ngjarjes së Gadijrit?

Në fund e përsërisim thënien tonë të mëparshme për të plotësuar tematikën e kërkimit tonë, e cila është: Nëse nuk do të ekzistonin pikëpamje të veçanta në këtë çështje, nuk do të ndodhnin të gjitha këto kundërshtime e dilema rreth këtij ajeti e hadithi, nuk ndodhte një gjë e tillë as në ajetet e hadithet e tjera.

Ajetet 68 - 69

قُلْ يٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ لَسْتُمْ عَلَىٰ شَيْءٍ حَتَّىٰ تُقِيمُوا ٱلتَّوْرَةَ
وَمَاوَٱلْإِنجِيلَ أُنزِلَ إِلَيْكُمْ مِّن رَّبِّكُمْ ^ط وَلَيَزِيدَنَّ كَثِيرًا مَّا مِّنْهُمْ
أُنزِلَ إِلَيْكَ مِن رَّبِّكَ طُغْيَٰنًا وَكُفْرًا ^ط فَلَا تَأْسَ عَلَى ٱلْقَوْمِ ٱلْكَٰفِرِينَ
إِنَّ  ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا وَٱلَّذِينَ هَادُواْ وَٱلصَّٰبِئُونَ وَٱلنَّصْرَىٰ مَن
ءَامَنَ بِٱللَّهِ وَٱلْيَوْمِ ٱلْآخِرِ وَعَمِلَ صَٰلِحًا فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَ
هُم مُّخْزَنُونَ 

"Thuaj (o Muhammed): 'O ithtarët e Librit! Nuk do të keni asgjë në vijë, derisa t'i përmbaheni Teuratit e Ungjillit dhe asaj që ju është shpallur nga Zoti juaj (Kur'ani). Ajo që të është shpallur ty nga Zoti yt, do t'ua shtojë shumicës së tyre mosbindjen dhe mohimin. Por ti mos u hidhëro për mohuesit."

"Ata që besojnë (në Kur'an), hebrenjtë, të krishterët dhe sabinët - kushdo prej tyre që beson All'Ilahun dhe Ditën e Fundit (sipas Kur'anit) dhe bën vepra të mira (sipas Islamit), nuk do të frikësohet dhe as që do të dëshpërohet."

Shkaku i zbritjes

Ka ardhur në tefsirin "Mexhmaul Bejan" dhe në tefsirin "Kurtubij" nga ibn Abasi se ka thënë: "Një grup hebrejsh kanë shkuar tek i Dërguari i All'llahut dhe i kanë thënë: "A nuk pohon se Teurati është i zbritur nga All'llahu?" Profeti u ka thënë: "Sigurisht që po." Kanë thënë: "Vërtet, ne besojnë në të, por nuk besojnë në gjë tjetër përveç tij. (Në të vërtetë, Teurati konsiderohet pjesë e përbashkët ndërmjet nesh e atyre, por Kur'ani është libër i veçantë për ju.). Atëherë zbriti ajeti i parë nga këto dy ajete.¹

Komentimi

Në komentimin e ajeteve të mëparshme të kësaj sureje kemi vërejtur se një pjesë e madhe e tyre kanë trajtuar pengesat që vendosnin ithtarët e Librit (hebrejtë e të krishterët) në rrugën e myslimanëve si dhe debatet dhe pyetjet që drejtonin. Ky ajet, gjithashtu, tregon një anë tjetër për këtë tematikë. Ai i përgjigjet logjikës së tyre të dobët e të pabazë që e konsideron Teuratin libër që është i pranueshëm te myslimanët dhe jehudinjtë e lënë Kur'anin duke e konsideruar atë tematikë të mosmarrëveshjes.

Për këtë, ajeti i drejtohet të dërguarit të All'llahut, duke i thënë: **"Thuaj (o Muhammed): 'O ithtarët e Librit! Nuk do të keni asgjë në vijë, derisa t'i përmbaheni Teuratit e Ungjillit dhe asaj që ju është shpallur nga Zoti juaj (Kur'ani).'"**

Këta libra – sikurse kemi thënë – burojnë nga i njëjti burim dhe parimet e tyre janë të përbashkëta. Përderisa ky libër

¹ Tesir "Mexhmaul Bejan", vëll. 3, f. 383-384. Tefsir "El Kurtubi", vëll.6, f. 245.

(Kur'ani) është libri i fundit i librave qiellorë, ai është më i ploti, më i përsosuri dhe është më i vlefshmi për ta zbatuar. Po ashtu, edhe librat e mëparshëm mbartin përgëzime dhe udhëzime për Librin e fundit, Kur'anin. Nëse ata, sipas pretendimit të tyre, e pranojnë Teuratin dhe Ungjillin dhe janë të sigurtë në pretendimin e tyre, atëherë ata duhet t'i pranojnë edhe përgëzimet, edhe udhëzimet. Kur t'i shohin ato shenja në Kur'an, duhet të ulin kokat e tyre para atyre shenjave.

Ky ajet tregon se nuk mjafton që të pretendosh, por patjetër duhet të ndjekësh atë çfarë ka ardhur në këta libra qiellorë dhe të veprohet sipas tyre. Pastaj, çështja nuk është “libri ynë e “libri juaj”, por ato janë libra qiellorë të shpallur nga All'llahu i Lartësuar. Si dëshironi ju me logjikën tuaj të cekët e të pabazë, të mos e njihni Librin e fundit qiellor?

Kur'ani tregon gjendjen e shumicës së tyre, që nuk merr mësim e këshilla nga këto ajete dhe nuk udhëzohet me to. Për shkak të shpirtit të kokëfortësisë, atyre u shtohet padrejtësia dhe mohimi. Ajeti thotë: **“...Ajo që të është shpallur ty nga Zoti yt, do t'ua shtojë shumicës së tyre mosbindjen dhe mohimin...”** Të gjithë ata që mohojnë të vërtetat, atyre u shtohet edhe më shumë mohimi dhe asgjë e mirë nuk ndikon në ato shpirtra të mbushur me kokëfortësi si e mosbindje.

Në mbyllje të ajetit, All'llahu ia lehtëson shqetësimin të Dërguarit të Tij me thënien: **“...Por ti mos u hidhëro për mohuesit.”**

Sigurisht, ky ajet nuk është i kufizuar vetëm me jehudinjtë, por përfshin edhe myslimanët. Nëse ata mjaftohen vetëm me shqiptimin e Islamit dhe i nuk zbatojnë mësimet e Profetëve, e në veçanti ajo çfarë ka ardhur në librin e tyre qiellor, Kur'anin, ata nuk do të kenë as gradë e as pozitë tek All'llahu i Lartësuar në

jetën e tyre individuale e shoqërore, por gjithmonë do të mbessin të përulur e të humbur në çështjet e tyre.

Ajeti në vazhdim rikthehet për ta vazhduar edhe një herë këtë të vërtetë dhe përforcon se të gjithë popujt dhe ndjekësit e cilitdo grupimi, pa përjashtim, qofshin myslimanë, jehudinj, sabinë¹ apo të krishterë, nuk kanë shpëtim për ata nga frika e së ardhmes vetëm nëse besojnë në All'llahun, në Ditën e Gjykimit dhe bëjnë vepra të mira. Ajeti thotë: **"Ata që besojnë (në Kur'an), hebrenjtë, të krishterët dhe sabinët - kushdo prej tyre që beson All'llahun dhe Ditën e Fundit (sipas Kur'anit) dhe bën vepra të mira (sipas Islamit), nuk do të frikësohet dhe as që do të dëshpërohet."**

Ky ajet, në të vërtetë, është një përgjigje e prerë ndaj atyre që mendojnë se do të shpëtojnë nën hijen e një populli të caktuar dhe parapëlqejnë mësimet e disa Profetëve nga disa të tjerë dhe e pranojnë thirrjen fetare mbi bazë të fanatizmit racor. Ajeti thotë se rruga e shpëtimit është t'u largohemi këtyre fjalëve.

Sikurse e kemi treguar në komentimin e ajetit 62 të sures "El Bekare", e cila është e përafërt në përmbajtje me këtë ajet, disa janë përpjekur për të konstatuar se ky ajet konsiderohet argument për "paqen e përgjithshme".

Por, siç e kemi thënë, ajeti vendos një kufi ndarës midis çdo thënieje me fjalën e tij: **"dhe bën vepra të mira."** Me çdo fjalë zbulon të vërtetën, në veçanti ndryshimin mes feve, ku i obligon njerëzit për të punuar me legjislacionin e fundit të All'llahut, sepse veprimi me ligjet e anuluarat nuk konsiderohet vepër e

¹ Sabinët janë ndjekësit e Jahjait, të Nuhut apo të Ibrahimit. Ata i kemi përmendur në mënyrë të detajuar në komentimin e ajetit 62 të sures "El Bekare."

mirë. Por vepër e mirë konsiderohet ajo vepër që bëhet sipas legjislacioneve që gjenden në Librin e fundit, Kur'ani.

Gjendet një alternativë e pranueshme në komentimin e kësaj fjalie kur'anore: **“Kushdo prej tyre që beson në All'Ilahun dhe Ditën e Fundit sipas Kur'anit dhe bën vepra të mira...”**, e cila është se kjo fjali është e veçantë për jehudinjtë, të krishterët dhe sabinët, sepse thënia **“Ata që besojnë”**, që përmendet në fillim, nuk ka nevojë për një kufizim apo kushtëzim. Për këtë, kuptimi i ajetit është kështu: Me të vërtetë, besimtarët dhe myslimanët, gjithashtu, jehudinjtë, të krishterët dhe sabinët, të gjithë do të jenë të shpëtuar, me kusht që të besojnë e të pranojnë Islamin e të bëjnë vepra të mira. Në të vërtetë, rruga është e hapur për të gjithë. (*Medito me përqendrim e saktësi.*)

Ajetet 70 - 71

لَقَدْ أَخَذْنَا مِيثَاقَ بَنِي إِسْرَءِيلَ إِلَيْهِمْ رُسُلًا ۖ كَمَا
جَاءَهُمْ رَسُولٌ بِمَا لَا تَهْوَىٰ أَنفُسُهُمْ فَرِيقًا كَذَّبُوا وَفَرِيقًا
يَقْتُلُونَ ﴿٧٠﴾ وَحَسِبُوا أَنَّا لَنَكُونَ فَتْنَةً فَعَمُوا وَصَمُوا ثُمَّ تَابَ
اللَّهُ عَلَيْهِمْ ثُمَّ عَمُوا وَصَمُوا كَثِيرٌ مِّنْهُمْ ۖ وَاللَّهُ بَصِيرٌ بِمَا
يَعْمَلُونَ ﴿٧١﴾

"Ne bëmë besëlidhje me bijtë e Izraelit dhe u çuam të dërguar. Por, sa herë që u vinte ndonjë i dërguar me porosi që s'ua donte shpirti, ose e mohonin, ose e vrisnin."

"Ata mendonin se nuk do t'i gjente kurrfarë dënimi, prandaj ngelën të verbër dhe të shurdhët. Pastaj, All'Ilahu ua pranoi pendimin, por përsëri shumë nga ata u bënë të verbër dhe të shurdhër (ndaj së vërtetës); All'Ilahu e sheh mirë se çfarë bëjnë ata."

Komentimi

Në ajetet 12, 83, 84 dhe 93 të sures “El Bekare”, tregohet për besëlidhjen dhe premtimin që u ka marrë All’llahu i Lartësuar bijëve të Izraelit. Ky ajet e përmend edhe një herë këtë besëlidhje, ku thotë: **“Ne bëmë besëlidhje me bijtë e Izraelit dhe u çuam të dërguar...”** Duket se kjo besëlidhje është po e njëjta besëlidhje që është përmendur në ajetin 93 të sures “El Bekare”, pra që të veprohet me atë që ka zbritur All’llahu.

Pastaj thotë se ata, jo vetëm që nuk kanë punuar sipas kësaj besëlidhjeje, por: **“...Por sa herë që u vinte ndonjë i dërguar me porosi që s’ua donte shpirti, ose e mohonin, ose e vrisnin.”**. Kjo është rruga e të devijuarve dhe e egoistëve, të cilët, në vend që të ndjekin udhëheqësit e tyre, janë të vendosur që të ndjekin dëshirat dhe egot e tyre. Sipas tyre, të udhëzuarit dhe Profetët nuk e meritojnë të jetojnë.

Në këtë ajet folja *kedh’dhebu* që do të thotë *i mohonin*, ka ardhur në kohën e shkuar, kurse fofja *jektulune*, që do të thotë *vrasin*, ka ardhur në në kohën e tashme. Ndoshta kjo për të ruajtur përshtatjen e fjalive në fund të ajeteve të mëparshme dhe ajeteve në vijim, ku të gjitha kanë ardhur në kohën e tashme, sepse folja në kohën e tashme në gjuhën arabe, tregon për vazhdimësi. Qëllimi në këtë tregues është vazhdimësia e këtij shpirti tek jehudinjtë, sepse përgënjeshtrimi që u bënin Profetëve dhe vrasja e tyre nuk ka qenë diçka spontane, por ka qenë rrugë, mënyrë dhe metodologji e tyre.

Ajeti në vazhdim tregon mendjemadhësinë e tyre për të gjitha ato padrejtësi e krime që kanë bërë. Ajeti thotë: **“Ata**

mendonin se nuk do t'i gjente kurrfarë dënimi...". Që do të thotë se ata i bënë ato të këqija, mendonin se dënimi dhe sprova e All'llahu nuk do të zbriste mbi ta. Ata besonin – sikurse e tregojnë qartë ajetet e tjera – se janë raca dhe kombi më i lartë dhe më i ngritur mbi sipërfaqen e tokës dhe se janë bijtë e All'llahut!!

Në fund, kjo mendjemadhësi e rrezikshme u shndërrua në një perde që ua mbuloi sytë dhe veshët. Për këtë ajeti thotë: **"...Prandaj ngelën të verbër dhe të shurdhër..."**, nga mospranimi i ajeteve dhe i argumenteve të All'llahut dhe nga dëgjimi i fjalëve të vërteta.

Por, pasi ata i goditi ndëshkimi i All'llahut dhe i shikuan rezultatet e veprave të tyre të shëmtuara, u penduan dhe kërkuan falje, sepse e mësuan se premtimi i All'llahut është i vërtetë dhe ata nuk janë raca apo kombi më i mirë njerëzor. All'llahu e pranoi pendimin e tyre, ku thotë: **"...All'llahu ua pranoi pendimin..."**. Por kjo gjendje e pendimit nuk zgjati shumë, sepse ata iu kthyen padrejtësisë e mosbesimit të tyre të mëparshëm dhe u larguan nga e vërteta dhe e drejta. Mbulesa e pavendosmërisë u kthye sërish si rezultat i zhytjes në mëkate. Atyre iu verbuan sytë dhe iu shurdhuan veshët për herë të dytë, siç thotë ajeti: **"...por përsëri shumë nga ata u bënë të verbër e të shurdhër** (ndaj së vërtetës)". Nuk arrinin të shihnin ajetet dhe argumentet dhe as të dëgjonin fjalët e vërteta dhe shumë prej tyre në këtë rast u verbuan.

Ndoshta, përmendja e fjalës *të verbër* para fjalës *të shurdhër* ka kuptimin se në fillim ata duhet t'i shohin shenjat, argumentet e All'llahut të Lartësuar dhe mrekullitë e të Dërguarit të All'llahut, pastaj të dëgjojnë mësimet e Tij dhe t'i kuptojnë ato.

Përmendja e togfjalëshit *shumë nga ata* pas përsëritjes së fjalës *të verbër e të shurdhër* ka ardhur për të qartësuar se gjendja e pavëmendshmërisë, e injorancës, e verbërisë dhe e mosdëgjimit të

këtyre të vërtetave nuk kanë qenë në përgjithësi, sepse në mesin e tyre ka qenë një pakicë e drejtë. Ky është një argument se qortimi që u bën Kur'ani jehudinjëve nuk përmban asnjë anë racizmi apo sektarizmi, por ai (Kur'ani) u drejtohet sipas veprave të tyre.

Vallë, a është përsëritja e shprehjes *e të verbër e të shurdhër* një karakteristikë e përgjithsme përforcimi apo tregues për dy ndodhi të ndryshme?

Disa komentues mendojnë se përsëritja e këtyre dy shprehjeve tregon për dy ngjarje të ndryshme që u kanë ndodhur bijve të Izraelit:

E para: Lufta e Babilut

E dyta: Lufta e persëve dhe e romakëve. Kur'ani i tregon në mënyrë kalimtare këto dy ngjarje në fillim të sures "Beni Israil" (Isra).

Bijtë e Izraelit kanë rënë shumë herë në këtë gjendje dhe kur shihnin rezultatin e veprave të tyre të shëmtuara, pendoheshin e pastaj ktheheshin si më parë, gjë që ka ndodhur disa herë e jo vetëm dy herë.

Në mbyllje të këtij ajeti ka ardhur një fjali e shkurtër me një kuptim të thellë, e cila thotë se All'llahu nuk është asnjëherë i pavetëdijshëm për veprat e tyre. Ai sheh çdo gjë që ata bëjnë. All'llahu i Lartësuar thotë: **"...All'llahu e sheh mirë se çfarë bëjnë ata."**

Ajetet 72 - 74

لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ هُوَ الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ
وَقَالَ الْمَسِيحُ يَبْنِي إِسْرَءِيلَ أَعْبُدُوا اللَّهَ رَبِّي وَرَبَّكُمْ إِنَّهُ مَن
يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَاهُ النَّارُ وَمَا
لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ
ثَلَاثُ ثَلَاثَةٍ وَمَا مِنْ إِلَهٍ إِلَّا إِلَهُ وَاحِدٌ وَإِن لَّمْ يَنْتَهُوا عَمَّا
يَقُولُونَ لَيَمَسَّنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ أَفَلَا
يَتُوبُونَ إِلَى اللَّهِ وَيَسْتَغْفِرُونَهُ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَحِيمٌ

"Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë: 'All'Ilahu është Mesihu, i biri i Merjemes!', sepse vetë Mesihu ka thënë: 'O bijtë e Izraelit, adhuronit All'Ilahun, që është Zoti im dhe Zoti juaj!' Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç All'Ilahut, All'Ilahu do t'ia ndalojë Xhennetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri. Për të padrejtët nuk ka ndihmës."

"Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë: 'All'Ilahu është njëri prej Trinisë!' Nuk ka veçse një Zot të Vetëm të vërtetë! Nëse nuk heqin dorë nga ato që thonë, patjetër që jobesimtarët nga mesi i tyre do t'i godasë një dënim i dhembshëm."

"Përse ata nuk kthehen me pendesë tek All'illahu e t'i kërkojnë falje Atij?! All'illahu është Falës dhe Mëshirëplotë."

Komentimi

Pas kërkimeve dhe shpjegimeve të mëparshme rreth çështjes së devijimit të jehudinjëve, që gjendeshin në ajetet e mëparshme, këto ajete edhe ato në vijim, flasin për devijimin e të krishterëve. Ajetet fillojnë me devijimin më të rëndësishëm me "hyjnizmin e Mesisë (Isait)" dhe "adhurimin e trinisë", ku thotë: **"Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë: 'All'illahu është Mesihu, i biri i Merjemes!'..."**

A ka mohim (kufr) më të madh kur All'illahun e Madhëruar i Cili nuk ka as vend e as kohë dhe se Ai është Qenia absolute, e bashkojnë me krijesat e kufizuara nga të gjitha anët dhe që e cilësojnë Atë me cilësitë e krijesave? Ndërkohë që vetë Isai (Mesihu) u thotë qartë bijve të Izraelit: **"...sepse vetë Mesihu ka thënë: 'O bijtë e Izraelit, adhuroni All'illahun, që është Zoti im dhe Zoti juaj!'..."** Me këtë, Profeti Isa (*Paqja qoftë mbi të!*), mohon çdo ngjyrë prej ngjyrave të idhujtarëve, refuzon ekzagjerimin e teprinë (el gulu'u" për personalitetin e tij dhe e konsideron veten krijesë si të gjitha krijesat e tjera të krijuara nga All'illahu i Lartësuar).

Për ta forcuar më shumë përforcimin e kësaj çështjeje dhe për të larguar çdo dilemë e gabim, ajeti thotë: **"...Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç All'illahut, All'illahu do t'ia ndalojë Xhennetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri..."**

Më tej vazhdon e përforcon se politeizmi (shirku) dhe ekzagjerimi e tepria (el guluu) janë padrejtësi e qartë, ku thotë: **"...Për të padrejtët nuk ka ndihmës."**

Më përpara kemi treguar se historia e krishterë përforcon dhe dëshmon se trinia nuk ka qenë e njohur në shekujt e parë të krishterimit dhe as në kohën e Profetit Isa (*Paqja qoftë mbi të!*). Madje edhe në ungjijtë që ekzistojnë sot – me gjithë devijimet dhe shtesat në to - nuk gjen qoftë një tregues të vogël për trininë. Këtë fakt e pohojnë vetë hulumtuesit e krishterë. Për këtë, këmbëngulja e Mesihut (*Paqja qoftë mbi të!*), për çështjen e Njëtimit është në përshtatje me burimet ekzistuese të krishterëve dhe konsiderohet prej argumenteve të madhështisë së Kur'anit.¹

Është e domosdoshme të kihet parasysh se tematika që trajton ajeti, është ekzagjerimi dhe bashkimi i Mesihut me All'llahun. Thënë ndryshe: **"Njëtimi në trinitet."** Ndërsa ajeti në vijim tregon çështjen e "numrit të zotave" në mendimin e të krishterëve, pra "*Triniteti në Njëtim*" dhe thotë: **"Pa dyshim, janë jobsimtarë ata që thonë: 'All'llahu është njëri prej Trinisë!'..."** Shumë komentues të Kur'anit, si Tabrisij në "*Mexhmaul Bejjan*", Shejh Tusij në "*Tibjan*" Fahri Razij dhe Kurtubij në tefsiret e tyre, janë shprehur se ajeti i mëparshëm tregon për grupin e krishterë, që quhet "*Jeakubetu*". Ky grup beson se All'llahu është i bashkuar me Mesihun. Por ky ajet ka ardhur për çështjen e dy grupë ve të tjetë që quhen "*El Melekanijetu*" dhe "*En Nesturijetu*", të cilët besojnë në trininë, ose në tre zota.²

Mirëpo, ky mendim ndaj të krishterëve – sikurse e thamë edhe më përpara – nuk pajtohet me realitetin, sepse besimi në trinitet është i përgjithshëm tek të krishterët në përgjithësi, sikurse Njëtimi te ne myslimanët është besim i përgjithshëm. Por, në të

¹ Për sqarime më të shumta rreth trinisë dhe bashkimit në trinitet shih fundin e ajetit 171 të sures "Nisa".

² Tefsir "Mexhmaul Bejan", vëll. 3, f. 391. Tefsirul "Kebijr", vëll. 12, f. 59.

njëjtën kohë që ata besojnë në Njëtim, thonë se tre zotat e vërtetë bashkohen në një Zot të vetëm!

Me sa duket, këto dy ajete tregojnë dy anë të kundërta të këtyre dy çështjeve: e para tregon bashkimin e tre Zotave, e dyta tregon numrin e këtyre zotave. Në të vërtetë, ardhja e këtyre dy çështjeve njëra pas tjetrës, tregon për një nga argumentet e qarta të parregullsisë së besimit të tyre. Si është e mundur që All'Ilahu të jetë një i Vetëm me Mesihun e me shpirtin e shenjtë dhe herës tjetër të jetë tri gjëra? A është e logjikshme që tre të jenë të barabartë me një?!

Këtë të vërtetë e përforcon fakti se nuk kemi gjetur në mesin e të krishterëve asnjë grup që nuk beson në tre zotat (trinitet).¹

Kur'ani Famëlartë u përgjigjet atyre me një përgjigje të prerë, ku thotë: "**...Nuk ka veçse një Zot të Vetëm të vërtetë!...**" Në përmendjen e fjalës *min*, që do të thotë *veçse*, përpara fjalës *Ilah*, që do të thotë *Zot* gjendet një mohim i fortë për çdo të adhuruar tjetër. Pastaj, All'Ilahu u tërheq vërejtje me një gjuhë të ashpër, ku thotë: "**...Nëse nuk heqin dorë nga ato që thonë, patjetër që jobesimtarët nga mesi i tyre do t'i godasë një dënim i dhembshëm.**"

Disa thonë se fjala *min* në frazën *minhum*, tregon qartësim, por në dukje ajo ka kuptimin "disa" dhe tregon për ata që kanë qëndruar në mosbesimin e tyre edhe pasi u ka bërë thirrje Kur'ani në Njëtim dhe nuk tregon për ata që janë penduar. Për këtë, autori i tefsirit "El Menar" përmend një histori rreth paqartësisë së

¹ Në disa transmetime dhe në disa libra historie përmendet se gjendet një grup i pakët prej të krishterëve të cilët nuk besojnë në trinitet por ata besojnë në bashkimin e Isait me All'Ilahun. Mirëpo në këtë kohë nuk kemi dëgjur për ata.

trinitetit të krishterët dhe teuhidit të tyre që e përcjell nga libri “Idhharul Hak”, në të cilën thuhet:

Tre persona u bënë të krishterë. Disa priftërinj u mësuan atyre çështjet e domosdoshme të besimit, veçanërisht besimin në trininë. Një prej të krishterëve shkoi te ky prifti dhe e pyeti: Përse je i krishterë? Ai i tha: Tre persona u bënë të krishterë. E pyeti atë: “A kanë mësuar ndonjë gjë nga besimi i domosdoshëm?” Po -tha ai. Dhe thirri njërin nga ata që t’i tregonte. E pyet atë prifti për besimin e trinitetit. Ai i thotë: “Me të vërtetë, ti më ke mësuar se janë tre Zota! Njëri prej tyre është në qiell, i dyti lind nga barku i Merjemes së virgjër dhe i treti është ai i cili ka zbritur në formën e pëllumbit te zoti i dytë, pasi është bërë djalosh tridhjetëvjeçar”. Prifti u zemërua dhe e dëboi atë duke thënë: Ky është injorant.

Pastaj kërkoi tjetrin prej tyre dhe e pyeti. Ai i tha: “Me të vërtetë, ti më ke mësuar se Zotat kanë qenë tre, njëri prej tyre është kryqëzuar dhe mbetën dy zota”. Prifti u zemërua dhe e dëboi.

Pastaj kërkoi të tretin, që ishte më i zgjuar e mbrojtës i besimit dhe pyeti. Ai i tha: “O zotëria im kam mësuar atë çfarë më keni mësuar dhe i kam kuptuar plotësisht falë mirësive të Mesihut se: një janë tre dhe tre janë një. Njëri prej tyre u kryqëzua e vdiq. Të gjithë vdiqën për arsye të bashkimit dhe tani nuk ka zot, përndryshe duhet të mohohet bashkimi!”

Në ajetin e tretë Kur'ani u bën thirrje që të pendohen nga ky besim mohues që All'illahu t'i falë. Ajeti thotë: **"Përse ata nuk kthehen me pendesë tek All'illahu e t'i kërkojnë falje Atij?! All'illahu është Falës dhe Mëshirëplotë."**

Ajetet 75 - 77

مَا الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهِ الرُّسُلُ
وَأُمُّهُ صِدِّيقَةٌ ۖ كَانَا يَأْكُلَانِ الطَّعَامَ ۗ فَانْظُرْ كَيْفَ نُبَيِّنُ
لَهُمُ الْآيَاتِ ثُمَّ انْظُرْ أَنَّى يُؤْفَكُونَ ۚ قُلْ ۖ أَتَعْبُدُونَ مِنْ
دُونِ اللَّهِ مَا يَمْلِكُ لَكُمْ ضَرًّا وَلَا نَفْعًا ۚ وَاللَّهُ هُوَ السَّمِيعُ
الْعَلِيمُ ۚ قُلْ ۖ يٰٓأَهْلَ الْكِتَابِ تَغْلُوا لَا فِي دِينِكُمْ غَيْرَ الْحَقِّ
وَلَا تَتَّبِعُوا أَهْوَاءَ قَوْمٍ قَدْ ضَلُّوا مِنْ قَبْلُ وَأَضَلُّوا كَثِيرًا وَضَلُّوا
عَنْ سَوَاءِ السَّبِيلِ ۚ

"Mesihu, i biri i Merjemes, është vetëm një i dërguar. Edhe para tij kanë kaluar të dërguar. Nëna e tij përherë ka qenë e drejtë. Që të dy, hanin ushqim. Shiko si ua shpjegojmë atyre shpalljet tona dhe shih si largohen nga e Vërteta!"

"Thuaju (o Muhammed): 'Si mundet vallë, që ju adhuroni në vend të All'Ilahut, atë që nuk është në gjendje t'ju sjellë as dëm e as dobi, ndërkohë që All'Ilahu dëgjon dhe di çdo gjë?!'"

"Thuaj: 'O ithtarët e Librit!' Mos i shkelni kufijtë e së vërtetës në besimin tuaj dhe mos ndiqni dëshirat e një populli, që gaboi

më parë, nxori prej udhës së drejtë shumë njerëz dhe vetë u shmang nga udha e drejtë."

Komentimi

Këto ajete plotësojnë tematikën e ekzagjerimit dhe teprisë (el guluu) ndaj Mesihut (*Paqja qoftë mbi të!*) tek të krishterët, që përmendej në ajetet e mëparshme, dhe të besimit të tyre në hyjnizimin e tij. Këtë besim të tyre Kur'ani e zhduk me disa ajete të shkurtëra. Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë fillon me pyetje drejtuar atyre se çfarë ndryshimi shohin ata tek Mesihu dhe nuk e shohin tek të dërguarit e tjerë përderisa e hyjnizuan Mesihun të birin e Merjemes. Edhe Mesihun të birin e Merjemes All'llahu e ka dërguar siç ka dërguar Profetët e tjerë përpara tij. Ajeti thotë: **"Mesihu, i biri i Merjemes, është vetëm një i dërguar. Edhe para tij kanë kaluar të dërguar..."**

Nëse dërgimi i tij nga ana e All'llahut ka qenë shkak për ta hyjnizuar dhe për të bërë shirk, përse nuk është njësoj me Profetët e tjerë?

Por, ne e dimë se të krishterët e devijuar nuk janë të bindur se Isai (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) është i Dërguari i All'llahut.

Besimi i tyre i përgjithshëm në kohët e sotme është se e konsiderojnë Isain (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) birin e Zotit dhe se ai është vetë All'llahu, në një prej kuptimeve, dhe ka ardhur për t'u shlyer mëkatet njerëzve (se ai nuk ka ardhur për t'i udhëzuar dhe për t'i drejtuar ata). Për këtë arsye e kanë quajtur me emrin "flijuesi", i cili e flijoji veten për gjynahet e njerëzve.

Për ta përforcuar më shumë çështjen, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Nëna e tij përherë ka qenë e drejtë..."** Që do të thotë se: Si është e mundur të jetë Zot dikush që ka nënë, e cila e ka mbajtur në mitrën e saj, dhe që është nevojtar për shumë gjëra? Pastaj, nëse nëna e tij ka qenë përherë e drejtë, kjo do të thotë se edhe ajo ka qenë në vijën e mesazhit të Mesihut, në përshtatje me të dhe mbrojtëse e atij Mesazhi. Për këtë, ai ka qenë rob prej robëve të afërt të All'llahut. Është obligim që të mos adhurohet, siç ndodh në mesin e të krishterëve, të cilët përulen përpara një skulpture deri në atë kufi sa që e adhurojnë.

Përsëri, Kur'an i sjell argument tjetër për të mohuar hyznizimin e Mesihut, ku thotë: **"...Që të dy, hanin ushqim..."** Si mund të jetë zot, ose të krahasohet me Zotin, ai që ka nevojë për ushqim, ai që nëse nuk ushqehet për disa ditë do të dobësohet dhe nuk do të jetë në gjendje të lëvizë ?!

Në mbyllje ajeti nga njëra anë tregon qartësinë e këtyre argumenteve dhe nga ana tjetër tregon kokëfortësinë dhe injorancën e tyre, ku thotë: **"...Shiko si ua shpjegojmë atyre shpalljet tona dhe shih si largohen nga e Vërteta!"**. Përsëritja e fjalës *undhur* që do të thotë *shiko*, në këtë ajet, është për dy anë: e para për të treguar argumentet e qarta e të mjaftueshme për çdo njeri dhe e dyta për të sqaruar reagimin negativ që buron nga mendjemadhësia e kokëfortësia.

Për të plotësuar argumentin e mëparshëm, ajeti në vazhdim e mohon adhurimin e tyre ndaj Mesihut, edhe pse ata e dinë se ai ka fizionomi njerëzore dhe ka nevojë për gjëra si të gjithë njerëzit e tjerë dhe se ai nuk është në gjendje për të larguar të keqen nga vetja e tij. Si është e mundur që t'u largojë të këqijat të tjerëve? All'llahu i Lartësuar thotë: **"Thuaju (o Muhammed): 'Si mundet**

vallë, që ju adhuron në vend të All'llahut, atë që nuk është në gjendje t'ju sjellë as dëm e as dobi'..."

Shumë herë, atij dhe ndjekësve të tij u është bërë keq nga armiqtë e tyre. Nëse nuk do t'i përfshinte mëshira e All'llahut, nuk do të kishin mundur që të hidhnin as edhe një hap përpara.

Në fund, All'llahu i paralajmëron ata të mendojnë; ose të paragjykojnë se All'llahu nuk i dëgjon çfarë thonë ata; ose All'llahu nuk e di se çfarë fshehin ata. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...ndërkohë që All'llahu dëgjon dhe di çdo gjë"** Ajo që tërheq vëmendjen është se çështja e të qenit të Mesihut (Isait) (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*), njeri që ka nevoja materiale e trupore, të cilën e thotë Kur'ani në këtë ajet e në ajetet e tjera, është prej pengesave më të mëdhaja përballë të krishterëve, të cilët e pretendojnë hyjnizimin e tij. Për këtë, ata janë përpjekur ta shfajësojnë këtë gjë me të gjitha mënyrat. Madje, nganjëherë janë detyruar që ta dyzojnë Mesihun. Nga njëra anë thpënë se ai është i biri i zotit, madje ai është vetë zoti. Nga ana tjetër thonë se ai është trup dhe krijesë prej krijesave të All'llahut. E të tjera shfajësime të cilat janë argumenti më i mirë i dobësisë së logjikës së tyre.

Patjetër duhet patur parasysh se në këtë ajet është përdorur fjala *ma* në vend të fjalës *min*, e cila zakonisht përdoret për të treguar jofrymorët. Ndoshta nga kjo përfitohet përfshirja e sendeve të tjera që adhuroheshin dhe idhujt e gdhendur nga gurët ose nga drurët. Qëllimi i kësaj është se nëse u lejohet njerëzve adhurimi i krijesës, atë herë u lejohet edhe adhurimi i idhujve, sepse të gjitha këto të adhuruar janë krijesa. Hyjnizimi i Mesihut është i njëjtë me adhurimin e idhujve dhe jo adhurimin e All'llahut.

Ajeti në vazhdim e urdhëron të Dërguarin e All'llahut – pasi i tregon gabimin e ithtarëve të Librit në hyjnizimin e Isait – që

t'i ftojë ata me argumente të qarta që ata të kthehen nga ky rrugëtim i gabuar, ku thotë: **"Thuaj: 'O ithtarët e Librit!' Mos i shkelni kufijtë e së vërtetës në besimin tuaj..."**

Në të vërtetë, ekzagjerimi dhe tepria e të krishterëve është e njohur. Mirëpo ekzagjerimi i jehudinjëve të cilët i përfshin thënia: **"O ithtarët e Librit"**, ka të bëjë me atë që thonë për Uzejrin, që e kanë konsideruar birin e All'llahut. Ekzagjerimi lind kur të humburit ndjekin dëshirat dhe egot e tyre. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...dhe mos ndiqni dëshirat e një populli, që gaboi më parë, nxori prej udhës së drejtë shumë njerëz dhe u shmang nga rruga e drejtë."**

Këtu tregohet gjithashtu ajo që ndodhi në historinë e krishterimit, sepse çështja e trinitetit dhe e ekzagjerimit në çështjen e Mesihut nuk ka ekzistuar në shekujt e parë të krishterimit. Por kur kristianizmin e përqaftuan disa indian dhe të ngjashëm me ta në adhurimin e idhujve të krishterë, kanë futur në të disa gjëra nga feja e tyre e mëparshme, si trinitetin dhe idhujtarinë.

Në të vërtetë, triniteti i indianëve (besimi në tre Zota: Brahama, Fijshnu dhe Sijga), historikisht, ka qenë më përpara se triniteti i të krishterëve, i cili nuk ka dyshim se është ndikuar prej tij. Në ajetin 30 të sures "Et Teube", pas përmendjes së ekzagjerimit të jehudinjëve dhe të krishterëve në çështjen e Uzejrit dhe të Isait, All'llahu i Lartësuar thotë: **"i imitojnë fjalët e jobesimtarëve të mëparshëm."**

Fjala "*dal'luu*", kanë humbur, në këtë ajet ka ardhur e përsëritur dy herë për sa u përket jobesimtarëve nga të cilët ithtarët e Librit morën ekzagjerimin dhe teprinë. Ndoshta kjo përsëritje është për përforsim sepse ata më parë ishin të humbur, pastaj kur i çuan edhe të tjerët në rrugë të humbur nëpërmjet

thirrjes së tyre, ata ranë në humbje tjetër. Kush përpiket për të çuar të tjerët në humbje, në të vërtetë është më në humbje se ata, sepse ai i harxhoi fuqitë e tij për të çuar veten e vet dhe të tjetër në rrugën e mjerimit. Ai mbart mëkatetet e të tjerëve, gjithashtu, mbi shpatullat e tij. A e pranon një njeri që ecën në rrugën e drejtë, që krahas mëkateve të tij, të mbart edhe mëkatet e tij dhe mëkatet e të tjerëve?

Ajetet 78 - 80

لُعِنَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ بَنِي إِسْرَءِيلَ عَلَى لِسَانِ دَاوُدَ
وَعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ ۚ ذَٰلِكَ بِمَا عَصَوْا وَكَانُوا يَعْتَدُونَ ﴿٧٨﴾
كَانُوا لَا يَتَنَاهَوْنَ عَنْ مُنْكَرٍ فَعَلُوهُ ۚ لَبِئْسَ مَا كَانُوا
يَفْعَلُونَ تَرَىٰ ۚ ﴿٧٩﴾ كَثِيرًا مِّنْهُمْ يَتَوَلَّوْنَ الَّذِينَ كَفَرُوا ۚ
لَبِئْسَ مَا قَدَمَتْ لَهُمْ أَنفُسُهُمْ أَن سَخِطَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ وَفِي الْعَذَابِ
هُمۜ خَالِدُونَ ﴿٨٠﴾

"Ata izraelitë që ishin mohues, u mallkuan me gjuhën e Dautit dhe të Isait, të birit të Merjemes, për shkak se kundërshtonin, shkelnin çdo kufi."

"dhe nuk e ndalonin njëri-tjetrin të bënin vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata!"

"Ti e sheh se shumë prej tyre miqësohen me jobesimtarët. Me të vërtetë, e keqe është ajo që i përgatisin ata vetes: që All'illahu të zemërohet me ta dhe të mbesin në dënim përjetësisht."

Komentimi

Këto ajete tregojnë të ardhmen fatkeqe në të cilën përfundojnë mohuesit e mëparshëm, me qëllim që ithtarët e Librit të nxjerrin mësim dhe të mos i ndjekin ata verbërsiht. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **“Ata izraelitë që ishin mohues, u mallkuan me gjuhën e Dautit dhe të Isait, të birit të Merjemes...”**

Këtu mund të lindë pyetja: Përse është përmendur vetëm emri i këtyre dy pejgambereve dhe i askujt tjetër? Komentuesit e Kur'anit kanë disa mendime. Disa kanë thënë se shkak për këtë është se ata të dy janë Profetët më të shquar pas Musait, disa të tjerë kanë thënë se shkak në këtë është se shumica e ithtarëve të Librit krenoheshin se janë nga gjeneza e Dautit.

Ajeti si fillim përmend se Daudi i mallkonte të gjithë ata që ecin në rrugën e mosbesimit e të padrejtësisë. Disa thonë se ajeti tregon dy ngjarje historike, të cilat i kanë zemëruar këta dy Profetë dhe kanë mallkuar një grup nga bijtë e Izraelit. Dauti ka mallkuar banorët e qytetit "Ijlia", të njohur me emrin (as'habul sebt), banorët e të shtunës. Historia e tyre do të shpjegohet më hollësisht te komentimi i sures “El Araf”. Isai ka mallkuar një grup nga populli i tij që vendosën të ndjekin rrugën e mohimit dhe të kundërshtimit edhe pas zbritjes së sofrës nga qielli.

Si do që të jetë, ajeti tregon se vetëm me të qenit e njeriut nga bijtë e Izraelit, ose nga ndjekësit e Mesihut e të Daudit dhe larg rrugës së tyre, nuk mund të jetë shkak për shpëtimin e njeriut, madje këta dy Profetë i kanë mallkuar cilindo që ndiqte të kundërtën e rrugës së tyre.

Në fund të ajetit ka përforsim të kësaj çështjeje dhe sqarim për shkakun e mallkimit. Ajeti thotë: **"...për shkak se kundërshtonin, shkelnin çdo kufi."**

Ajeti në vazhdim fillon me qortim dhe përforsim se ata asnjëherë nuk e kanë pranuar se kanë përgjegjësi shoqërore dhe nuk ndalonin të keqen. Madje, disa nga punëmirët e tyre duke heshtur, kur i shihnin duke bërë të këqija, i nxitnin, praktikisht, keqbërësit që të veprojnë. Ajeti thotë: **"dhe nuk e ndalonin njëri-tjetrit të bënin vepra të këqija..."** Për këtë, veprat e tyre kanë qenë të këqija e të shëmtuara, siç thotë edhe ajeti: **"...Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata!"**

Në komentimin e këtij ajeti kanë ardhur transmetime nga i Dërguari i All'llahut dhe Ehli Bejti, që janë argumente që përmbajnë mësimë të shumta.

I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *"Do të urdhëroni në të mirë e do të ndaloni nga e keqja, do të kapni dorën e mendjelehtëve e do ta zhvilloni të keqen ndaj së mirës ose do të godasë All'llahu zemrat e njëri-tjetrit dhe do t'ju mallkojë juve sikurse i ka mallkuar ata."*¹

Në hadithin e transmetuar nga Imami Sadik (*Paqja qoftë mbi të!*) në komentimin e fjalës së All'llahut të Lartësuar, ku thotë: **"Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata!"**, ai ka thënë: *"Ndërsa me të vërtetë ata nuk kanë hyrë në vendet e tyre dhe nuk janë ulur me ata. Por kur takoheshin me ta qeshnin në fytyrat e tyre dhe zbaviteshin me ta."*²

Ajeti i tretë tregon një mëkat tjetër, nga mëkatet e tjera që bënin ata, ku thotë: **"Ti e sheh se shumë prej tyre miqësohen me jobesimtarët..."**

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejan", fundi i ajetit në fjalë. Tefsiri "Kurtubij", vëll. 4, f. 2250. Hadith i ngjashëm është përcjellë nga Termidhiu.

² Tefsir "El Burhan", vëll. 1, f. 492. Tefsir "Nurul Thakalejn", vëll. 1, f. 661.

Është e pakundërshtueshme se miqësia e tyre nuk ka qenë miqësi e zakonshme, por ka qenë e përzier me llojet e mëkateve dhe i inkurajonin veprat dhe mendimet e gabuara. Për këtë, ajeti me shprehjen e fundit, i kundërshton veprat e tyre, të cilat kanë bërë për Ditën e Ringjalljes. Ato janë vepra që e bëjnë të obligueshëm zemërimin e All'Ilahut dhe ndëshkimin e Tij të përhershëm. All'Ilahu i Lartësuar thotë: **“Me të vërtetë, e keqe është ajo që i përgatisin ata vetes: që All'Ilahu të zemërohet me ta dhe të mbesin në dënim përjetësisht.”**

Përsa i përket pyetjes: Cili është qëllimi i fjalës *me jobesimtarët*? Disa kanë thanë se qëllimi është për idhujtarët e Mekës, që u miqësuan me jehudinjtë. Disa të tjerë kanë thënë se ata janë zullumqarët dhe të padrejtët, të cilët jehudinjtë e shkuar i shtrinin atyre dorën e miqësisë. Këtë mendim e përforcon hadithi i transmetuar nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) i cili ka thënë: *“Do të drejtojnë mbretër mizorë. Ua zbukurojnë atyre qejfet dhe egot e veta që të fitojnë dynjanë e tyre.”*¹

Atëherë nuk gjendet problem që ky ajet të përfshijë të dy këto dy kuptime, madje të jetë më i përgjithshëm se dy kuptimet.

¹ Tefsir “Mexhmaul Bejan”, vëllimi 3, faqe 397.

Ajeti 81

وَلَوْ كَانُوا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَمَا أَلْنَبِيِّ أَنْزَلَ إِلَيْهِ مَا اتَّخَذُوهُمْ
أَوْلِيَاءَ وَلَكِنَّ كَثِيرًا مِّنْهُمْ فَسِقُونَ ﴿٨١﴾

"Sikur ata t'i besonin All'lahut, të Dërguarit dhe asaj që i është shpallur atij, nuk do t'i merrnin jobesimtarët për miq. Por, shumica prej tyre janë të pabindur."

Komentimi

Ky ajet u tregon atyre rrugën e shpëtimit. Kjo rrugë është se nëse ata vërtet besojnë në All'llahun e Lartësuar, në të Dërguarin e Tij dhe në atë çfarë i është zbritur atij, kurrë nuk do të vendosnin që të bënin miqësi me armiqtë e All'llahut e as nuk do t'u mbështeshin atyre asnjëherë. Për këtë ajeti thotë: **"Sikur ata t'i besonin All'lahut, të Dërguarit dhe asaj që i është shpallur atij, nuk do t'i merrnin jobesimtarët për miq."** Por, fatkeqësisht, janë të paktë ata që iu bindën urdhrave të All'llahut. Shumica e tyre kanë dalë nga rruga e bindjes së Tij dhe vazhdojnë rrugën e mosbindjes. Për këtë, ajeti thotë: **"...Por, shumica prej tyre janë të pabindur"**.

Është e qartë se fjala *Nebijj*, në këtë ajet ka për qëllim të Dërguarin e Islamit, Muhammedin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kjo për faktin se Kur'ani

Famëlartë e ka përdorur këtë fjalë në shumë ajete me këtë kuptim. Kjo tematikë është përsëritur në dhjetëra ajete.

Gjendet aleternativë tjetër në komentimin e këtij ajeti që thotë, se përemri në fjalën *kanu*, është për mushrikët dhe adhuruesit e idhujve. Pra, sikur ata mushrikë tek të cilët mbështeten jehudinjtë dhe kanë besim tek ata, t'i besonin Profetit dhe Kur'anit, nuk do t'i zgjidhnin jehudinjtë shokë e miq të tyre.

Ky është tregues i qartë për humbjen dhe shthurjen e tyre. Kjo sepse, edhe pse pretendojnë se ndjekin librat qiellorë, ata marri për miq adhuruesit e idhujve përderisa janë mushrikë. Mirëpo, nëse ata drejtohen kah All'lahu dhe librat e Tij, largohen prej tyre. Me sa duket, komentimi i parë është më afër me të dukshmen e ajeteve ku përemrat kanë për qëllim një pikë të përbashkët që janë jehudinjtë.

PËRMAJTJA E LIBRIT

TEMA

Ajetet 148 - 149	5
Komentimi.....	5
Hulumtime.....	8
Falja ndaj agresorit dhe ndikimi në prirjen armiqësore	8
Ajetet 150 - 152	10
Komentimi.....	11
Nuk ka dallim mes Profetëve	11
Përshtatshmëria mes mëkatit dhe ndëshkimit.....	12
Ajetet 153 - 154	15
Komentimi.....	16
Qëllimi i jehudinjeve nga shpikja e shfajësimeve.....	16
Ajetet 155 - 158	20
Komentimi.....	21
Plane të tjera armiqësore të praktikuara nga jehudinjtë.....	21
Hulumtime.....	24
Legjenda e kryqit	24
Ajeti 159	29
Komentimi.....	29
Ajetet 160 - 162	33
Komentimi.....	34
E ardhmja e të mirëve dhe e të këqijve jehudinj.....	34
Ajetet 163 - 166	38
Komentimi.....	39
Hulumtime.....	43
Ajetet 167 - 169	46

Komentimi.....	47
Ajeti 170	49
Komentimi.....	49
Ajeti 171	51
Komentimi.....	52
Lejenda imagjinare e trinitetit.....	52
Hulumtime.....	57
Doktrina e trinitetit është bestytnia më e madhe e krishterimit.....	57
Ajetet 172 - 173	65
Shkaku i zbritjes.....	66
Komentimi.....	66
Mesihu (Isai) është rob i All'llahut	66
Dy hulumtime.....	68
Ajetet 174 - 175	70
Komentimi.....	70
Drita e dukshme	70
Ajeti 176	72
Shkaku i zbritjes.....	73
Komentimi.....	73
Surja "El Maide"	77
Ajeti 1	79
Komentimi.....	79
Domosdoshmëria e mbajtjes së premtimit dhe e zbatimit të marrëveshjes.....	79
Dy hulumtime.....	82
Ajeti 2	87
Komentimi.....	88
Tetë rregulla dhe procedura në një ajet të vetëm.....	88
Hulumtime.....	91
Bashkëpunimi në vepra të mira.....	91
Ajeti 3	95
Komentimi.....	96

Ekuilibrimi në përdorimin e mishit.....	100
Hulumtime.....	102
Kur e ka plotësuar All'Ilahu fenë e myslimanëve.....	102
Ajeti 4	114
Shkaku i zbritjes.....	114
Komentimi.....	115
Gjuetia e lejuar.....	115
Ajeti 5	119
Komentimi.....	120
Rregulli i ushqimit të ithtarëve të Librit dhe rregulli i martesës me ta.....	120
Rregulla e martesës me jomyslimanet.....	125
Ajeti 6	129
Pastrimi i trupit dhe i shpirtit.....	130
Dy hulumtime.....	136
1- Filozofia e abdesit dhe e tejumumit.....	136
2- Filozofia e guslit.....	137
Ajeti 7	141
Komentimi.....	141
Besëlidhja hyjnore.....	141
Ajetet 8 - 10	145
Komentimi.....	146
Thirrja që bazohet në drejtësi.....	146
Hulumtime.....	148
Drejtësia, shtylla më e rëndësishme e Islamit.....	148
Ajeti 11	152
Komentimi.....	152
Ajeti 12	155
Komentimi.....	156
Ajeti 13	160
Komentimi.....	160
Dy hulumtime.....	162

1- Veprimet devijuese të jehudinjëve.....	162
2- A e bën All'llahu zemrën e njeriut të ashpër?.....	163
Ajeti 14	165
Komentimi.....	165
Armiqësi e përjetshme.....	165
Hulumtime.....	168
Ajetet 15 - 16	170
Komentimi.....	171
Ajeti 17	175
Komentimi.....	175
Si mundet të jetë Mesihu (Isai) Zot?!.....	175
Ajeti 18	179
Komentimi.....	179
Ajeti 19	183
Komentimi.....	183
Ajetet 20 - 26	187
Komentimi.....	189
Bijtë e Izraelit dhe Toka e Shenjtë.....	189
Ajetet 27 - 29	200
Komentimi.....	201
Vrasja e parë që ka ndodhur mbi sipërfaqen e tokës.....	201
Hulumtime.....	203
Ajetet 30 - 31	205
Komentimi.....	205
Ajeti 32	210
Komentimi.....	211
Ajetet 33 - 34	215
Shkaku i zbritjes.....	215
Komentimi.....	216
Ndëshkimi i atij që kryen agresion.....	216
Ajetet 35	221
Komentimi.....	221

Rëndësia e ndërmjetësimit (teuasulit) te All'Ilahu.....	221
Ndërmejtësimi (teuasuli) në transmetimet islame.....	224
Hulumtime.....	228
Ajetet 36 - 37.....	231
Komentimi.....	231
Ajetet 38 - 40.....	233
Komentimi.....	234
Ndëshkimi i vjedhjes.....	234
Hulumtime.....	236
a) Kriteret e ndëshkimit të vjedhësit.....	236
b) Sasia që duhet prerë nga dora e vjedhësit.....	237
c) Ndëshkimi i vjedhësit dhe thëniet e armiqve të Islamit.....	237
d)- Kundërshtime të tjera.....	239
Ajetet 41 - 42.....	240
Shkaku i zbritjes.....	241
Komentimi.....	244
Gjykimi ndërmjet triumfuesve dhe armiqve.....	244
Ajeti 43.....	250
Komentimi.....	250
Ajeti 44	253
Komentimi.....	253
Ajeti 45.....	256
Komentimi.....	256
Dënimi dhe falja	256
Ajeti 46.....	260
Komentimi.....	260
Ajeti 47.....	264
Komentimi.....	264
Ndalimi i të gjykuarit sipas ligjit të All'Ilahut.....	264
Ajeti 48.....	266
Komentimi.....	267
Ajetet 49 - 50	271

Shkaku i zbritjes.....	271
Komentimi.....	272
Ajetet 51 - 53.....	276
Shkaku i zbritjes.....	277
Komentimi.....	278
Hulumtime.....	282
Mbështetja te të huajt.....	282
Ajeti 54.....	285
Komentimi.....	285
Ajeti 55.....	290
Shkaku i zbritjes.....	290
Komentimi.....	292
Dy hulumtime.....	293
1 - Dëshmia e haditheve, komentuesve dhe historianëve.....	293
2- Përgjigja për tetë kundërshtimet.....	295
Ajeti 56.....	304
Komentimi.....	304
Ajetet 57 - 58.....	307
Shkaku i zbritjes.....	307
Komentimi.....	308
Dy hulumtime.....	310
1- Ezani, një slogan i madh Islam	310
2- Ezani i është shpallur Profetit	312
Ajetet 59 - 60.....	314
Shkaku i zbritje.....	315
Komentimi.....	315
Ajetet 61-63.....	319
Komentimi.....	320
Ajeti 64	325
Komentimi.....	326
Ajetet 65-66.....	331
Komentimi.....	331

Ajeti 67	336
Komentimi.....	336
Zgjedhja e khalifit (prijësit të myslimanëve) është periudha e mbylljes së Mesazhit.....	336
Hulumtime.....	339
1- Zbritja e ajetit të Tebligut (shpalljes).....	339
2- Ngjarja e Gadijr Khum-it e përmbledhur.....	343
3- Dialogje dhe keqkuptime.....	348
a- A është kuptimi i fjalës "Meula" më i merituari për të vepruar me pushtet të plotë?.....	350
b- Lidhja e ajeteve.....	351
c- A e përmendin Sahihat këtë ngjarje?.....	352
d- Përse nuk kanë argumentuar Aliu dhe Ehli Bejti me këtë hadith?.....	353
e- Kuptimi i fjalisë së fundit të ajetit.....	355
f- A mund të ekzistojnë dy udhëheqës në njëjtën kohë?.....	356
Ajetet 68 - 69	358
Shkaku i zbritjes.....	359
Komentimi.....	359
Ajetet 70 - 71	363
Komentimi.....	364
Ajetet 72 - 74	367
Komentimi.....	368
Ajeti 75 - 77	372
Komentimi.....	373
Ajetet 78 - 80	378
Komentimi.....	379
Ajeti 81	382
Komentimi.....	382

أالمثل فى تفسير كتاب الله المنزل

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازى

الجزء السادس

الترجمة الى اللغة الألبانية: وُلُنتْ مَرِيَا و آگيم رچای

تيرانا: 2016

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب اللہ المنزل (جزء ششم)

نویسنده: فقیہ مفسر حضرت آیۃ اللہ العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلہ)

ترجمہ بھڑبان آلبانی: اُولُنْتُ مَرْيَا وَاَكِيْم رچای

زیر نظر: اُولُنْتُ مَرْيَا

تایپ: کمریہ کاظمی

ویرایش: دورینا باشا

مقابلہ: ویولسا کارای

صفحہ بندی و جلد: صبریہ فرا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2016